

IX 9Marks

PARATHËNIA NGA BRIAN FIKKERT

KISHA NË VENDE TË VËSHTIRA

SI U SJELL JETË KISHA LOKALE
TË VARFËRVE DHE NEVOJTARËVE

Mez McConnell
dhe Mike McKinley

“Dy pastorë nga dy brigje të kundërta të Oqeanit Atlantik kanë bashkuar forcat për të na rrëfyer histori në lidhje me përkujdesjen baritore të njerëzve në vende të vështira. Majk Mekinli dhe Mez Mekonell janë vërtet të përkushtuar ndaj asaj që thotë Bibla, i kanë për zemër njerëzit dhe e kanë për zemër kishën lokale. Rrëfimet e tyre reflektojnë dashuri, gëzim, humor dhe urtësi. Lutem që ky libër bindës dhe sfidues do të nxisë edhe shumë të tjerë që të mundohen për përhapjen e ungjillit aty ku sot nuk ka dëshmi të krishterë.”

Mark Dever, Pastor kryesor, Kisha Baptiste Capitol Hill, Washington, DC; President i 9Marks Ministries

“Mez Mekonell dhe Majk Mekinli kanë shkruar një libër për të cilin kishim nevojë. *Kisha në vende të vështira* ka ardhur vërtet në kohën e duhur dhe do të shërbejë për trajnimin e një brezi të interesuar për ta çuar ungjillin në vende dhe situata të vështira, si dhe për të mbjellë kisha atje. Ata që e marrin seriozisht madhështinë e Perëndisë dhe hirin e Tij, duhet të digjen nga pasioni për ta bërë kishën që të mblidhet edhe në vendet më të vështira. Mezi dhe Majku na nxisin që t’i shkojmë deri në fund kësaj pune.”

J. Ligon Dankan III, Kancelar dhe Drejtor ekzekutiv, Seminari Teologjik i Reformuar, Jackson, Mississippi

“Mekonell dhe Mekinli na kanë bërë një shërbim të madh duke bashkëpunuar për ta shkruar këtë libër të rëndësishëm, të lehtë për t’u lexuar e plot pasion. Rrallë më ka qëlluar të lexoj një vepër që shkrin në një ambientin për ungjillin dhe realizmin e ftohtë e të vendosur. Kjo ndodh mbase sepse është një vepër e shkruar prej punëtorëve të fushës dhe jo prej teoricienëve. U bëftë ky libër një pikë gjenerimi për një mori punëtorësh të rinj, me qëllim që të kryejnë detyrën e rëndësishme të arritjes së atyre që nuk janë as shpesh, edhe as lehtësisht të arritshëm.”

Steve Timmis, Drejtor ekzekutiv, rrjeti kishëmbjellës Acts 29

“Më së fundi kemi në duar një libër në lidhje me këtë aspekt thelbësor të misionit të ungjillit që është i pasur me Biblën, me ungjillin në qendër dhe me kishën në fokus! Aq më tepër që është shkruar për të krishterët e zakonshëm prej dy djemve që e kanë luajtur fort këtë lojë. *Kisha në vende të vështira* është një dhuratë për kishën.”

Jared C. Wilson, Drejtori për strategjinë e përmbajtjes, Seminari Baptist Teologjik i Midwestern

“Në qoftë se në zemër keni dhembshuri për më të dobëtit dhe të vuajturit e botës, atëherë merreni dhe lexojeni këtë libër. Mirëpo, më duhet t’ju paralajmëroj se ky nuk është libri që mund të merret si i mirëqenë. Përkundrazi, është libri që vërtet duhet ta lexoni. Majk Mekinli dhe Mez Mekonell na thonë se ndonëse mund të jetë një gjë e pashpirt të shpërfillësh nevojat e të dobëve dhe të vuajturve, nevoja më e madhe që ata kanë, është e njëjta nevojë që kemi të gjithë, pra, që t’i kthejmë shpinën mëkatit, të përqafojmë Krishtin dhe të rritemi në hirin dhe njohurinë e Krishtit në një bashkësi të shëndoshë besimtarësh të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit nën udhëheqjen besnike të pastorëve dashamirës që do ta pajisin kishën për shërbesën në vazhdim. Po nuk e bëmë këtë, thjesht po plotësojmë nevojat e tyre tokësore, pa u ofruar atyre shpresën për një jetë të ndryshuar sot.”

Juan R. Sanchez Jr., Pastor kryesor, Kisha Baptiste High Pointe, Austin, Texas

KISHA NË VENDE TË VËSH TIRA

Libra të tjerë nga 9Marks

The Compelling Community: Where God's Power Makes a Church Attractive, Mark Dever and Jamie Dunlop (2015)

The Pastor and Counseling: The Basics of Shepherding Members in Need, Jeremy Pierre and Deepak Reju (2015)

Why Trust the Bible?, Greg Gilbert (2015)

Who Is Jesus?, Greg Gilbert (2015)

Nëntë shenja të një kisha të shëndetshme, botimi i 3-të, Mark Dever (2013)

Finding Faithful Elders and Deacons, Thabiti M. Anyabwile (2012)

Am I Really a Christian?, Mike McKinley (2011)

What Is the Gospel?, Greg Gilbert (2010)

Biblical Theology in the Life of the Church: A Guide for Ministry, Michael Lawrence (2010)

Church Planting Is for Wimps: How God Uses Messed-up People to Plant Ordinary Churches That Do Extraordinary Things, Mike McKinley (2010)

It Is Well: Expositions on Substitutionary Atonement, Mark Dever and Michael Lawrence (2010)

What Does God Want of Us Anyway? A Quick Overview of the Whole Bible, Mark Dever (2010)

The Church and the Surprising Offense of God's Love: Reintroducing the Doctrines of Church Membership and Discipline, Jonathan Leeman (2010)

Çfarë është anëtari i shëndetshëm i kishës?, Thabiti M. Anyabwile (2008)

12 Challenges Churches Face, Mark Dever (2008)

The Gospel and Personal Evangelism, Mark Dever (2007)

What Is a Healthy Church?, Mark Dever (2007)

***Si të ndërtojme kisha të shëndetshme*,
redaktuar nga Mark Dever dhe Jonathan Leeman**

Church Elders: How to Shepherd God's People Like Jesus, Jeramie Rinne (2014)

Evangelism: How the Whole Church Speaks of Jesus, J. Mack Stiles (2014)

Expositional Preaching: How We Speak God's Word Today, David R. Helm (2014)

Ungjilli: Si e portretizon kisha bukurinë e Krishtit, Ray Ortlund (2014)

Sound Doctrine: How a Church Grows in the Love and Holiness of God, Bobby Jamieson (2013)

Church Discipline: How the Church Protects the Name of Jesus, Jonathan Leeman (2012)

Church Membership: How the World Knows Who Represents Jesus, Jonathan Leeman (2012)

KISHA NË VENDE TË VËSHTIRA

*Si u sjell jetë kisha lokale
të varfërve dhe nevojtarëve*

Mez McConell dhe
Mike McKinley

Parathënie nga
Brian Fikkert

Titulli në original: *Church in Hard Places:
How the Local Church Brings Life to the Poor and Needy*

Copyright © 2016 by Mez McConnell and Mike McKinley

Botuar nga Crossway
1300 Crescent Street
Wheaton, Illinois 60187

Ky libër u soll në gjuhën shqipe nga Qendra “IGNIS”.
Për më shumë informacione vizitoni dritez.al.

Përkthimi i këtij libri në shqip u mundësua nga SETS
(Southeastern Europe Theological Seminary)

Përktheu: Elton Tahirllari
Redaktoi: Vilma Dina
Përshtatja e faqesjes në gjuhën shqipe: IGNIS

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla ABS 2009, përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.). Të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, incizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër, pa marrë leje me shkrim nga botuesi.

9Marks ISBN: 979-8-89218-097-9

Përmbajtja

Një fjalë për serinë	9
Parathënie.....	11
Hyrje.....	15
Pjesa 1: Ungjilli në vende të vështira	
1 Çfarë është varfëria?.....	25
2 Për çfarë ungjilli kanë nevojë ata?.....	37
3 A është e rëndësishme doktrina?	63
Pjesa 2: Kisha në vende të vështira	
4 Problemi i organizatave parakishtarë	79
5 Zgjidhja e kishës lokale	91
6 Vepra e ungjillëzimit.....	105
7 Roli i predikimit.....	119
8 Rëndësia e anëtarësisë dhe disiplinës.....	131
Pjesa 3: Vepra kishëmbjellëse në vende të vështira	
9 Përgatituni	149
10 Përgatit punën	163
11 Përgatitu që të ndryshosh mendim	177
12 Përgatitu për shërbesën e mëshirës?	193
Përfundim: Llogarit çmimin... dhe shpërblimin.....	205

Një fjalë për serinë

Seria e librave 9Marks nis me dy ide bazë. E para, kisha lokale është shumë herë më e rëndësishme për jetën e krishterë nga sa e kuptojnë ndoshta shumë të krishterë të kohëve të sotme. Në shërbesën 9Marks ne besojmë që një i krishterë i shëndetshëm është një anëtar i shëndetshëm i kishës.

E dyta, kishat lokale rriten plot jetë dhe gjallëri kur e organizojnë jetën e tyre rreth Fjalës së Perëndisë. Perëndia flet. Kishat duhet ta dëgjojnë dhe ta ndjekin. Kaq e thjeshtë është. Kur një kishë dëgjon dhe ndjek atë që thotë Perëndia, ajo nis t'i ngajë Atij, të cilin e ndjek. Ajo kishë reflekton dashurinë dhe shenjtërinë e Tij. Ajo kishë shfaq lavdinë e Tij. Kisha do t'i ngajë Krishtit, teksa ia vë veshin Atij. Për këtë arsye, lexuesi mund të vërë re që të gjithë librat “9 marks”, të bazuar në librin e Mark Dever, *Nëntë shenjat e një kishë të shëndetshme*, fillojnë me Biblën:

- Predikimi ekspozues;
- Teologjia biblike;
- Një kuptim biblik i ungjillit;
- Një kuptim biblik i konvertimit;
- Një kuptim biblik i ungjillëzimit;
- Një kuptim biblik i anëtarësisë së kishës;
- Një kuptim biblik i disiplinës në kishë;
- Një kuptim biblik i dishepullimit dhe i rritjes; si dhe
- Një kuptim biblik i udhëheqësisë së kishës.

Ka shumë më tepër për t'u thënë në lidhje me çfarë duhet të bëjnë kishat për të qenë të shëndetshme, si për shembull për lutjen. Mirëpo këto nëntë praktika janë ato të cilat ne besojmë se shpërfillen më shpesh në kohët e sotme (ndryshe nga lutja). Prandaj, mesazhi ynë themelor për kishat është ky: mos shihni drejt praktikave më të mira të biznesit ose drejt stileve që janë më në modë; shihni drejt Perëndisë. Filloni duke ia vënë sërish veshin Fjalës së Tij.

Seria e librave 9Marks është rezultat i gjithë këtij projekti. Këto libra kanë për qëllim shqyrtimin më nga afër dhe nga këndvështrime të ndryshme të nëntë shenjave. Disa prej këtyre librave u drejtohen pastorëve. Disa të tjerë u drejtohen anëtarëve të kishës. Shpresa jonë është që të gjithë këta libra do të ndërthurin shqyrtimin e kujdesshëm biblik, reflektimin teologjik, vlerësimin kulturor, zbatimin e përbashkët, dhe madje edhe pak nxitje personale. Librat më të mirë të krishterë janë gjithmonë njëkohësisht teologjikë dhe praktikë.

Parathënie

Një prej prirjeve më të rëndësishme gjatë këtyre dy dekadave të fundit ka qenë përkushtimi i shtuar i të krishterëve ungjillore në luftën kundër varfërisë. Një mori librash, konferencash dhe shërbesash kanë marrë përsipër t'i mobilizojnë dhe pajisin të krishterët që të realizojnë mandatin biblik: “të zbatosh drejtësinë, të duash mirësinë” (Mikea 6:8). Një prirje e tillë është vërtet ngazëlluese, sepse përkujdesja për skamnorët është një nga detyrat parësore të Jezu Krishtit dhe dishepujve të Tij (Luka 7:18–23; 1 e Gjonit 3:16–18).

Fatkeqësisht, kemi vërejtur edhe një prirje të dytë: angazhimin në rënie ndaj kishës lokale. Megjithëse këtë prirje e ndeshim gjerësisht, duket se është më e dukshme mes të krishterëve që e kanë veçanërisht për zemër drejtësinë sociale. Faktikisht, ndodh rëndom që njerëzit që punojnë me kohë të plotë për zbutjen e varfërisë, jo vetëm janë të pezmatuar me kishën lokale, por edhe e shohin atë me përbuzje. Kjo prirje është një tragjedi e vërtetë me pasoja të shumëfishta, njëra prej të cilave është se përpjekjet e shtuara në ndihmë të të varfërve janë të destinuara të dështojnë. Këto janë fjalë të ashpra dhe kanë nevojë për më tepër shpjegim.

Varfëria është një problem thellësisht i ndërlikuar për t'u zgjidhur. Siç e kemi bërë të qartë te libri ynë *Kur ndihma lëndon* (*When Helping Hurts*), varfëria i ka rrënjët te marrëdhëniet e

prishura të njerëzve me Perëndinë, veten, të tjerët dhe mbarë krijimin. Këto marrëdhënie janë të prishura për shkak të ndërthurjes komplekse të mëkatit të vetë njeriut, njerëzve shfrytëzues, padrejtësive të sistemeve, si dhe forcave demoniake. Kemi të bëjmë me shumë gjëra që nuk t'i zë syri në pamje të parë, kështu që lipset që zgjidhjet të shkojnë përtej servirjes së supës me garuzhde, dhurimit të teshave apo shpërndarjes së kuponëve ushqimorë, sado të rëndësishme të jenë këto. Faktikisht, problemi i varfërisë është kaq i ndërlikuar, saqë nevojitet një mrekulli për ta çrrënjësuar atë.

Lajmi i mirë i ungjillit ka të bëjë me Mbretin Jezus, i Cili përdor fuqinë dhe pushtetin e Tij për ta mposhtur mëkatin e vetë skamnorëve dhe të shfrytëzuesve të tij, si dhe padrejtësitë e sistemeve, dhe forcat demoniake që qëndrojnë në rrënjë të varfërisë (Kololianëve 1:15–20). Është Mbreti Jezus që mund ta bëjë gjithë këtë, kështu që të varfrit, dhe ky është një grup që na përfshin të gjithëve ne, kanë nevojë që të kenë një takim jetëndryshues me Të. Kur flas për “takim”, nuk e kam fjalën për një takim të vetëm. Përkundrazi, e kam fjalën për një marrëdhënie organike dhe të thellë me vetë personin e Jezu Krishtit, i Cili i shpëton njerëzit prej mëkateve të tyre dhe i fut ata në një botë të re, në të cilën nuk do të ketë më shfrytëzues, padrejtësi sistemesh apo forca demoniake... dhe ku nuk do të ketë as varfëri (Gjoni 17:20–23; Efesianëve 1:2–23; Zbulesa 21:1–4). Të varfrit duhet të lidhen si mishi me thuan me Mbretin Jezus, dhe Ai është i pranishëm, në mënyrë të mistershme ndonëse të vërtetë, në kishën e Tij (Efesianëve 1:23).

Është e pamundur që të zbutet varfëria, në kuptimin e saj të plotë, jashtë kishës lokale dhe në mungesë të saj.

Kështu që, nëse dëshirojmë ta zbusim varfërinë, na nevojiten kisha që gjenden në “vende të vështira”, pra, aty ku jetojnë të varfrit. Për fat të keq, shumë kisha e kanë selinë larg të varfërve, ndërsa ato që gjenden më pranë tyre, janë shpesh të

papërgatitura për një shërbesë të efektshme. Pikërisht kjo është arsyeja se përse na nevojitet kjo vepër.

Duke u bazuar në përvojat e tyre personale si njerëz nevojtarë dhe si pastorë të kishave në “vende të vështira”, Majk Meikinli dhe Mez Mekonell ofrojnë këshilla praktike për sa i përket përdorimit të veprimtarive të zakonshme të kishës, të cilat përfshijnë predikimin e Fjalës, lutjen, llogaridhënien dhe dishepullimin, për t’i sjellë të varfrit te një takim jetëndryshues me Mbretin Jezus. Këto aktivitete “rutinë” funksionojnë, sepse Perëndia i ka paracaktuar që të funksionojnë! Bëhet fjalë për teknikat kryesore që Perëndia i ka përcaktuar për t’i sjellë njerëzit në një marrëdhënie jetëndryshuese me Mbretin Jezus dhe për t’i ushqyer në atë marrëdhënie. Për pasojë, autorët me të drejtë digjen nga dëshira për t’i mbajtur këto aktivitete në qendër të vëmendjes, në vend që t’i lëmë ato në një qoshe të harruar.

Mund të mos bini dakord me çdo fjalë të këtij libri. Faktikisht, do të doja që disa gjëra të ishin shprehur ndryshe. Mirëpo, le të mos jetë kjo një pengesë. Majku dhe Mezi trajtojnë një çështje shumë të rëndësishme, ndonëse të neglizhuar, e cila është absolutisht vendimtare për përparimin e mbretërisë së Perëndisë dhe për zbutjen e varfërisë: Si mund të mbjellim kisha plot jetë në vende të vështira? Si dikush që ia ka kushtuar gjithë jetën luftës kundër varfërisë, nuk mendoj se ekziston një temë tjetër që është më e kohës apo më e rëndësishme.

Brian Fikkert

Bashkautor i librit *When Helping Hurts: How to Alleviate Poverty Without Hurting the Poor... and Yourself*

Themelues dhe president i Qendrës Chalmers në Covenant College

Hyrje

Unë (Mezi) isha pesëmbëdhjetë vjeç kur më ndodhën dy gjëra: njërin nga shokët e mi e vranë me thikë në rrugë, dhe rashë në kontakt me kishën për herë të parë në jetën time. Një kishë lokale organizoi funeralin e shokut tim.

Ndërtesa e kishës ishte e madhe, mund të them gati-gati hijerëndë, e ndërtuar me tulla të kuqe si gjaku i shokut tim që derdhej lumë, duke shkaktuar edhe mbytjen e këtij të fundit, teksa po e transportonin për në spital. Nuk kam për ta harruar kurrë atë kishë. Kishte dyer druri në formë harku dhe mbrojtëse me shufra hekuri në dritaret me xhama plot ngjyra. Kambanorja e saj dukej sikur çante qiellin. Ajo qëndronte krenare në mes të kompleksit tonë të banesave sociale (amerikanët i quajnë ato “projekte strehimi”), të rrethuara prej një deti ndërtesash me çati të zymta, ngjyrë gri dhe me suvatim guralecësh.

Kisha hapej vetëm kur vdiste dikush. Mirëpo, tani dikush kishte vdekur. E mbaj mend se si qëndroja jashtë asaj ndërtese nën shiun e rrebeshtë, teksa njerëzit e futën arkëmortin e shokut tim brenda dhe ia dorëzuan atë një Perëndie, tek i Cili askush prej nesh nuk besonte. Pas kësaj, për mua kishat ishin të lidhura me të vdekurit.

Disa herë e shihnim drejtuesin e kishës tek futej nëpër dyqane. Ne e gjuanim me gurë ose i hidhnim bishta cigaresh. Natyrisht, sa herë e bënim këtë, ai na buzëqeshte. Kjo është ajo që bëjnë drejtuesit e kishave, apo jo? A nuk duhet ta kthejnë ata faqen tjetër,

e kështu me radhë? Feja dhe ajo kishë në veçanti ishin gjëra që nuk kishin fare lidhje me ne. Ne flisnim në lidhje me to vetëm kur i vinim në lojë. E vetmja gjë për të cilën ajo kishë të bënte punë, ishte të shërbente si strehë kur pije cigare jashtë, në mes të shiut.

Ndërsa rritesha, banesat tona sociale morën të tatëpjetën. Nga fundi i viteve '80 dhe fillimi i '90, ramë nën zgjedhën e drogave. Njerëz që kishin qenë miq tërë jetën, u prishën me njëri-tjetrin për shkak të lakmisë. Shtëpitë zunë të ngjanin si të vjetra e të lëna pas dore, teksa njerëzit e mirë të lagjes nisën t'ia mbathnin prej saj. Lulet dhe shkurret përpara shtëpisë u zhdukën për t'ua lënë vendin motoçikletave dhe pjesëve të makinave. Radhë të tëra shtëpish përfunduan me dritare të mbyllura me dërrasa, teksa plehrat, barishtet e egra dhe jashtëqitjet e qenve gjendeshin përreth tyre si një shenjë degradimi i thellë.

Mirëpo, e mbaj mend ndërtesën e kishës, sërish e kuqe dhe e rrethuar prej leshesh bari të mirëmbajtura përsosmërisht, e cila dukej sikur nuk ia ndiente fare për shpërbërjen e jetëve tona. Ishte përherë bosh dhe po aq e vdekur për ne, sa edhe gurët e varrit që e rrethonin, ama ishte po ashtu një vend i mistershëm për mua dhe shokët e mi. Vite më pas, teksa jetoja në një strofull kokaine, duke shitur drogë dhe duke pasur telashe me ligjin, e hidhja vështrimin nga dritarja e katit të tetë dhe e këqyrja atë ndërtesë. Ashtu siç isha, i mjegulluar nga droga, mendoja për Perëndinë: Vallë, a ekzistonte Ai me të vërtetë? A mendonte Ai ndonjëherë për njerëz si puna ime? E vrisja mendjen se përse ajo ndërtesë ishte përherë bosh. Mbase gjendej mes nesh për t'u tallur me jetët tona mëshirëndjellëse. Po ashtu, mendoja me vete se përse e kishin ndërtuar një vend të tillë vetëm për të vdekurit. Në qoftë se dikush do të më thoshte atëherë se kisha lokale do të më shpëtonte jetën një ditë, me siguri që do të kisha qeshur me ju. Isha i sigurt se i vetmi rast kur do të gjendesha brenda asaj ndërtese, do të ishte kur të më çonin brenda një arkemorti. Fatmirësisht, e kisha gabim.

Kush jemi ne?

Ky është një libër i shkruar prej dy njerëzve, të cilët përnjëmend besojnë se Shkrimi mëson se ungjilli është lajmi i mirë për të varfrit dhe nevojtarët, dhe se kisha është për të gjithë njerëzit në të gjitha vendet, pavarësisht se cilës shtrese shoqërore i përka-sin ata. Po, është e vërtetë se shumë kisha kanë vdekur, si puna e asaj kishës ku u mbajt funerali i shokut tim. Kjo është një gjë vërtetë tragjike. Sa e rëndësishme është, pra, që kishat e mbu-shura me jetë falë ungjillit të shkojnë pas të varfërve, të pastre-hëve, hallexhinjve! E shkruajmë këtë libër me shpresë se kisha në vendet perëndimore do t'ia marrë dorën detyrës së saj për ta çuar dritën në vendet e errëta dhe të lëna pas dore, që gjenden përreth tyre.

Kjo është origjina ime. Më braktisën në moshën dyvjeçare dhe u rrita prej disa familjeve kujdestare. Në moshën gjashtë-mbëdhjetëvjeçare jetoja rrugëve. Mirëpo, Perëndia e theu zemrën time falë dëshmisë këmbëngulëse të disa të krishterëve që më vizituan në burg, dhe kështu më shpëtoi. Qysh prej vitit 1999, kam qenë pastor/kishëmbjellës i përfshirë me kohë të plotë në shërbesën e kishës. Gjatë kësaj kohe isha bashkë-drejtues në një kishë baptiste me njerëz të shtresës së mesme, shërbeva si pastor të rinjsh për një kishë ungjillore në një lagje të varfër brenda qytetit, themelova një organizatë humanitare në ndihmë të fëmijëve të rrugës, mbolla një kishë për fëmijët e rrugës në një prej qyteteve më të varfra të Brazilit të Veriut, si dhe mbikëqyra rijetësimin e një kisha në një prej komplekseve më të varfra të banesave sociale në mbarë Skocinë, kishë e cila quhet Kisha Komunitare e Nidrit. Jam i shkurtër, i kam idetë e qarta për gjithçka, plot pasion dhe i etur që ta shoh këtë lloj vepre të marrë formë dhe të zgjerohet kudo ku ka banesa so-ciale në Skoci dhe gjetkë në Mbretërinë e Bashkuar. Jam më se lumturisht i martuar me Miriamin dhe babai i dy vajzave të mitura.

Çfarë është një Skemë?

Një skemë skoceze strehimi është kryqëzimi i një parku ri-morkiosh amerikan me një projekt strehimi urban amerikan dhe me një rezervë amerikano-indiane. Skemat u ndër-tuan fillimisht si banesa me kosto të ulët për klasën “e re” punëtore (pas Revolucionit Industrial), duke zëvendësuar shumë prej lagjeve të varfra. Sot, ato përbëhen prej një për-zierje banesash sociale dhe shtëpish të blera prej banorëve të tyre.

Majk Mekinli është pastori drejtues i Kishës Baptiste Sterling Park, një rijetësim kisha në shtetin e Virxhinias. Ndryshe nga unë, Majku është i gjatë dhe nuk i ka edhe aq idetë e qarta për gjithçka (përveçse për gjëra të lidhura me futbollin amerikan dhe muzikën pank rrok). Ai ka shkruar disa libra dhe është anëtar bordi në organizatën Radstok, një rrjet ndërkombëtar kishash që mbjellin kisha. Majku dhe gruaja e tij Karen kanë pesë fëmijë jashtëzakonisht të pashëm (ose të paktën kështu më thotë ai mua).

E mira e të shkruajturit këtë libër së bashku është se vijmë prej situatave jetësore dhe përvojave në shërbesë krejtësisht të ndryshme. Kisha e Majkut gjendet në një prej rrethinave të pasura të Uashington, DC, mirëpo ajo kishë ka gjetur mënyrën se si të shërbejë në mënyrë të frytshme edhe mes të pastrehëve, punëtorëve të varfër dhe imigrantëve të paligjshëm të zonës së saj. Unë drejtoj tashmë një kishë që gjendet në një prej skemave më të vështira të vendit tim, si dhe mbikëqyr veprën kishëmbjellëse që po kryhet në disa vende të tjera të ngjashme përmes 20Skemave (20schemes), e cila është shërbesa kishëmbjellëse e kishës sonë. 20Skemat ekziston që të rijetësojë dhe të mbjellë kisha të ungjillit në komunitetet më të varfra të Skocisë. Në qoftë se gjithçka shkon sipas planit, grupi im do të mbjellë kisha të tjera në njëzet skema të tjera strehimi gjatë dhjetëvjeçarit të ardhshëm.

Mjedisi jetësor i të dyve ne është i ndryshëm. Majku shërben në një mjedis shumëkulturor, ndërsa unë një mjedis pak a shumë njëkulturor (megjithëse gjërat janë në ndryshim e sipër). Shtojni kësaj edhe faktin që kulturat tona janë të ndryshme, sepse njëri është amerikan dhe tjetri është evropian, dhe bëjini vetë llogaritë se ç’përzjerje interesante jemi.

Megjithatë, që të dy ne jemi të përkushtuar ndaj ungjillit të Zotit Jezu Krisht si lajmi i mirë për një botë që po vdes. Që të dy jemi të përkushtuar ndaj kishës lokale si platforma prej nga shpallet ky lajm dhe zëri me anë të të cilit kjo gjë bëhet, si vendi ku të kthyerit në besim dishepullohen dhe ku vihen në zbatim të gjitha elementet e disiplinës dhe anëtarësisë kishtarë. Ne jo vetëm që besojmë në rëndësinë e tyre, por edhe shpallim hapur domosdoshmërinë e tyre për punën tonë.

Çfarë është një “vend i vështirë”?

Vendosëm që ta quajmë këtë libër *Kisha në vende të vështira*, por duhet ta bëjmë të qartë se po e përdorim mbiemrin “të vështira” qëllimisht. Në Brazil, kam punuar me fëmijë, të cilët pa i mbushur pesë vjeç dilnin dhe shisnin çamçakëzë për të plotësuar nevojat e familjes. Kur nuk arrinin të fitonin mjaftueshëm, dhe kjo gjë ndodhte shpesh, ata hidheshin në kthetrat e prostitucionit nga të rritur të paskrupullt. Ishte një jetë qeni dhe e tillë vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite për miliona e miliona njerëz. Në njëfarë mënyre, po, ky është një vend “i vështirë” për të shërbyer.

Mirëpo, ky është një vlerësim i përciptë. Kam vënë re se kur u tregoj histori si këto pastorëve të tjerë, ata shpesh më rrahin shpatullat dhe më thonë: “Të lumtë shok. Unë kurrë nuk do ta bëja dot atë që bën ti. Duket kaq e vështirë puna jote.” Ju lutem, mos më keqkuptoni. Unë e vlerësoj shumë reagimin e tyre dhe është një gjë e mirë kur t’i rrahin shpatullat herë pas here. Mirëpo, ja se cila është dilema ime: në njëfarë mënyre,

nuk është aspak e vështirë. Madje do të thosha se të jetosh dhe të punosh mes të varfërve mund jetë një gjë mjaft e lehtë. Disa herë më vjen ta shpall zyrtarisht se jam një pastor mashtrues dhe t'u them shokëve të mi që shërbejnë në zona më të pasura: “Ju lumtë, more shokë! Ju jeni ata të cilëve ju ka rënë për pjesë shërbesa më e vështirë.”

Kur dëgjoj se pastorët po përlëshen me një mori problemesh në lagjet e pasura nëpër Evropë dhe Shtetet e Bashkuara, më zënë e më dalin djersë të ftohta. Si ia del që të ungjillëzosh në një lagje ku të gjithë marrin rroga të mira, jetojnë nëpër shtëpi cilësore dhe mbase e kanë një makinë (ose dy) në garazhin e shtëpisë së vet? Si ia del që të thyesh koracën e krenarisë intelektuale të një botëkuptimi që e konsideron fenë si të padenjë për ta, dhe që beson se shkenca i ka të gjitha përgjigjet e mundshme? Si ia del të dëshmosh në një zonë ku çmimi mesatar i shtëpive e kalon 400,000 dollarshin? Si ia del t'i flasësh një robi që as ia ndien fare për Krishtin, sepse ia ka marrë mendjen materializmi i tij? Si ia del të punosh në një lagje të mbushur me qytetarë të rregullt e të sjellshëm, të cilët nuk e tradhtojnë gruan, nuk i rrahin fëmijët e nuk i kalojnë mbrëmjet të droguar në divan duke parë televizor? Ky po që është një vend i vështirë për të shërbyer. Madje, në njëfarë mënyre, edhe më i vështirë, sesa vendi që përmenda më lart. Po skëterrë fare!

Në skemën skoceze të strehimit ku unë shërbej si pastor, çdo ditë të javës e bën nga një bisedë për Jezusin. Mund t'i them dikujt që është mëkatar, dhe ai me shumë gjasë do të më japë të drejtë. Shumë rrallë ndesh ateistë mes të varfërve. Po ashtu, njerëzit kanë më tepër kohë që të ndalen për t'u shtruar në muhabet. Tek ta, ndjesia e komunitetit është e fortë, sepse që të gjithë jetojnë pranë njëri-tjetrit. Nuk është një kulturë njerëzish që udhëtojnë nga një orë a dy për të vajtur në punë. Në qoftë se gjen kohë për t'u kushtuar vëmendje, ata do të vijnë në një veprimtari të organizuar prej teje, edhe pse e dinë që do t'u

predikosh nga Shkrimi. Natyrisht, ka edhe shumë prej tyre që nuk do të vinin. Mirëpo, thelbi i asaj që po them, është se punoj në një kulturë që është pak a shumë e hapur ndaj ungjillit. Në rast se ka armiqësi këtu në Skoci ndaj *kishës si një institucion*, kjo rrjedh nga fakti se ajo perceptohet si *klubi i personave të shtresës së lartë*. Pjesa më e vështirë e shërbesës është dishepullimi dhe disiplina. Në fakt, mund të thuhet se është e lehtë t'i sjellësh njerëzit te dera e kishës. Gjëja më e vështirë për të bërë, është që ta mbash pastër shtëpinë, kur të gjithë janë futur brenda.

Pra, thelbi i gjithë kësaj sa u tha më sipër është që ne e quajmë këtë libër *Kisha në vende të vështira*, sepse kështu përcjellim lehtësisht idenë se po flasim për mbjelljen, rijetësimin dhe rritjen e kishave që përpiqen të arrijnë skamnorët dhe të nëpërkëmburit e shoqërisë. Nuk është dëshira jonë që të pretendojmë të japim një gjykim përfundimtar se kush e kryen shërbesën e krishterë në vendin më të vështirë të mundshëm. Kushdo që jemi dhe kudo që e gjejmë veten duke i shërbyer Mbretit Jezus, le të gëzo-hemi në privilegjin e përbashkët që kemi.

Përse u shkrua ky libër?

Ky, pra, është një libër që përpiqet të ndajë me ju bindjen tonë se është mjaft e nevojshme puna e kishës në këto vende të vështira. Natyrisht, ka shumë të humbur edhe në vendet e pasura dhe jemi shumë dakord që të ketë më shumë kisha dhe kisha më cilësore në ato zona. Mirëpo, nëse keni lindur, jetoni dhe do të vdisni në një vend të pasur në Amerikë ose në Skoci, të pakta janë gjasat për të pasur qasje në një dëshmi ungjilli. Skemat e Skocisë dhe projektet e strehimit dhe parqet amerikane të rirmorkiove janë plot e për plot me njerëz, të cilët kanë të njëjtën marrëdhënie me kishën sikurse edhe unë në rininë time; ata e shohin si një vend ku mund të marrin ndonjë pako ndihmash herë pas here, por jo si një vend ku gjenden fjalët e jetës. Në

shumicën e rasteve, kisha nuk e shtrin praninë e saj në vende të tilla. Mirëpo, edhe kur është e pranishme, është kaq e pashëndetshme, saqë prania e saj kthehet në një humbje për kauzën e Krishtit. Kjo situatë duhet të ndryshojë.

Kështu që, në rast se je një i krishterë që po mendon nëse je i aftë për ta çuar ungjillin në një vend të vështirë, shpresojmë se ky libër do të të nxisë për atë që Zoti mund të bëjë përmes besimtarëve të thjeshtë në kishat besnike që gjenden në këto komunitete. Në qoftë se je një drejtues kisha dhe dëshiron ta mobilizosh anëtarësinë e kishës që ta çojë ungjillin në një vend të vështirë pranë jush, ky libër do të të japë disa këshilla praktike që duhen ndjekur, dhe do të të tregojë gjërat që nuk duhet t'i bësh, të cilat do të të ndihmojnë gjatë rrugës. Në qoftë se je një kishëmbjellës dhe po mendon seriozisht të mbjellësh një kishë në një lagje të varfër, ky libër do të të tregojë se nga t'ia nisësh dhe cilat janë gjërat më të rëndësishme. Kushdo që të jeni, ne shpresojmë se ky libër do t'iu frymëzojë që të hiqni dorë nga rehatia juaj për t'u shërbyer të varfërve te dera ngjitur, apo në një lagje a vend tjetër.

Pjesa 1

**UNGJILLI NË
VENDE TË VËSHTIRA**

Çfarë është varfëria?

Ky nuk është një libër për varfërinë. Ky është një libër rreth mbjelljes, udhëheqjes dhe pjesëmarrjes në kisha që arrijnë njerëz që gjenden në periferi të shoqërisë njerëzore, pra, njerëz që jetojnë “në vende të vështira”. Është një libër që flet si të jesh pjesë e një kisha që arrin të varfrit. Kështu që menduam se ia vllente ta nisnim librin duke e lodhur pak trurin për të gjetur një përkufizim të *varfërisë*.

Varfëria nuk është edhe aq e lehtë për t’u përkufizuar. Shërbesa e kishës sime bën që të biem në kontakt (unë, Majku) me lloj-lloj njerëzish nevojtarë. Në një lagje fqinje me tonën, ne u shpërndajmë ndihma ushqimore imigrantëve latino-amerikanë, të cilët nuk e gëzojnë të drejtën ligjore për të përfituar shërbimin e ndihmës sociale. Në një lagje tjetër, punojmë me njerëz që jetojnë në një strehë për të pastrehët. Në një tjetër akoma, punojmë me imigrantë adoleshentë, të cilët konsiderohen një kategori në rrezik dhe që janë nxënës në një gjimnaz të zonës. Nga të gjitha këndvështrimet, këta janë njerëz që ne do t’i konsideronim si “të varfër”. Mirëpo, duke njohur gjithnjë e më shumë njerëz në secilin prej këtyre grupeve, u bëmë

të vetëdijshëm për faktin se përvoja e tyre e varfërisë është e ndërlikuar.

Një herë fola me një burrë që sapo kishte ardhur në qytetin tonë nga një vend shumë i varfër i Amerikës Qendrore. Ai ishte i uritur dhe me ndihmën e një përkthyesi më tha se nuk kishte ngrënë asgjë atë ditë. Teksa po bashkëbisedonim, u bë e qartë se unë dhe ky burrë kishim pikëpamje të ndryshme rreth gjendjes së tij ekonomike. Sipas mendimit tim, të mos vije asgjë në gojë për njëzet e katër orë ishte gjëja më e keqe që mund t'i ndodhte dikujt. Kurrë nuk më ka ndodhur që të vuaj nga uria kundër vullnetit tim. Për këtë burrë, përkundrazi, kjo nuk ishte aspak e pazakontë. E vërteta është se gjendja e tij kishte qenë edhe më e keqe në vendin prej nga vinte. Shqetësimi i tij kryesor nuk ishte pamundësia për të gjetur punë që të mbulonte shpenzimet e veta, përkundrazi, pezmatimi i tij vinte nga fakti që nuk po fitonte mjaftueshëm para për t'i dërguar në Amerikën Qendrore, me qëllim që të ndihmonte familjen e tij. Sado e vështirë që të dukej gjendja e tij për momentin, ai ishte i vetëdijshëm për faktin se tashmë mund të siguronte aq shumë të mira materiale, sa nuk kishte pasur ndonjëherë në jetën e vet. Kështu që ai nuk e mendonte veten si të varfër.

Nga ana tjetër, le të marrim për shembull banorët e strehës lokale për të pastrehët. Këta njerëz janë qytetarë amerikanë. Shumica e tyre flet anglisht, e kuptojnë se si funksionon kultura amerikane dhe kanë të drejtë të përfitojnë prej programeve shtetërore të ndihmës sociale. Ata kanë një standard jetese shumë më të ulët, sesa prisnin që ta kishin në jetën e tyre. Mirëpo, nëse ndaleni për një çast, e shihni se duhet të mendohemi pak më tepër se përse duhet t'i përshkruajmë ata si "të varfër". Tekefundit, ata konsumojnë ushqim të shëndetshëm, përfitojnë përkujdesje shëndetësore dhe i kanë të gjitha shërbimet higjienosanitare. Vërtet ata flenë në fjetore të tejmbushura me njerëz, por ato janë të ngrohta në dimër dhe të freskëta në

verë. Po ashtu, ata kanë televizor kabllor, dritë elektrike dhe fjalëkryqe për të kaluar kohën në mënyrë sa më argëtuese. Në qoftë se për një çast do të zhvendoseshim në lagjet e varfra të Nju Delit apo në zonat rurale të Zimbabves, me siguri që nuk do të mendonit se të pastrehët e Virxhinias Veriore po vuajnë të zitë e ullirit. Rehatia e tyre do të ishte për t'u pasur zili.

Megjithatë, falë intuitës ne kuptojmë se të pastrehët e lartpërmendur amerikanë janë të varfër. Ta mohosh këtë fakt duket si një justifikim patetik për t'u shmangur detyrimin për përkujdesje dhe ndihmë. Tekefundit, cili prej nesh që ka një shtëpi dhe një punë për së mbari, do të donte ta ndërronte jetën e tij me ndonjërin prej tyre? Thelbi i asaj që po them, është se varfëria është më e ndërlikuar, sesa diçka që mund të llogaritet përciptas në shifra dhe simbole valutash.

Çfarë është varfëria?

Kur mendojmë për varfërinë, ne si perëndimorë e konceptojmë atë nga këndvështrimi i mundësisë për të përdorur burimet e ndryshme. Ne kemi një të ashtuquajtur “kufi varfërie”, një prag të ardhurash, i cili përcakton se kush konsiderohet i varfër sipas vlerësimeve të qeverisë. Politikanët dhe gazetarët flasin shpesh për faktin se të varfrit nuk kanë mundësi për të përfituar arsim cilësor, ushqime të shëndetshme, banesa me çmim të arsyeshëm dhe kujdes shëndetësor të përshtatshëm. Ligjërimi publik, në lidhje me plotësimin e nevojave të të varfërve, zakonisht përqendrohet te mënyrat më të mira për t'i ndihmuar ata, që të sigurojnë gjërat që iu mungojnë.

Në librin e tyre të shkëlqyer, *Kur ndihma lëndon*, autorët Stiv Korbet (Steve Corbett) dhe Brajan Fikërt analizojnë një studim të realizuar nga Banka Botërore, i cili u kërkoi të varfërve që të përshkruanin se çfarë do të thoshte të ishte i varfër. Kështu, ata kuptuan se përshkrimi që të varfrit i bëjnë varfërisë së tyre, shpesh shkon përtej listës së gjërave që atyre iu mungojnë. Ata

kanë prirje të flasin për përvoja të tilla si pafuqishmëria, mungesa e shpresës, humbja e kuptimit të jetës dhe të pasurit turp.¹ Kështu që, sigurimi i burimeve që atyre iu mungojnë, nuk do t'i zbusë përmasat e thella të varfërisë që këta njerëz përjetojnë.

Le të marrim, për shembull, njerëzit që jetojnë në skemat e strehimit të Edinburgut, pikërisht aty ku Mezi shërben. Falë ndihmës së qeverisë, njerëzit atje kanë mundësinë të përfitojnë kujdes shëndetësor, banesa sociale, arsim dhe burimet materiale që u nevojiten për të ushqyer familjet e tyre. Mirëpo, për shkak të një mënyre jetese fort të rrënjosur që karakterizohet nga varësia nga drogat, alkoolizmi, krimi dhe familjet e prishura, njerëzit që banojnë nëpër skema, mbeten peng i një jete plot varfëri e mjerim. Ata nuk kanë nevojë për bukë, por përkundrazi për një mënyrë të re jetese.

Për këtë arsye, ne besojmë fort se kishat që mjaftohen vetëm me shpërndarjen e ndihmave materiale për nevojtarët, po humbin një mundësi të mirë për t'u shërbyer atyre në një nivel më të thellë. Pa dyshim, pasja e ushqimeve dhe e një strehe për të futur kokën janë mjaft të rëndësishme. Thelbi i shëmbëlltyrës së Samaritanit të Mirë është i vlefshëm edhe sot e kësaj dite, sepse të qëndrosh indiferent ndaj dikujt që është në nevojë, është një gjë aspak e krishterë. Mirëpo, vetëm burimet materiale dhe trajnimet për të fituar aftësi të reja për punë, nuk janë të mjaftueshme në vetvete për të plotësuar të gjitha nevojat e të varfërve. Gjëja më e pashoqe që kisha lokale ka dhe që mund t'ua ofrojë atyre që kanë ngecur në llucën e varfërisë, është ungjilli i Jezu Krishtit. Ungjilli nuk është një zgjidhje për varfërinë, të paktën jo në kuptimin që i zgjidh dhe i heq qafe ato mijëra probleme, me të cilat ballafaqohen të varfrit gjatë jetës së tyre në këtë tokë. Mirëpo, fjala e ungjillit është mesazhi i Perëndisë për të gjithë ata njerëz që kanë rënë pre e modeleve të ndërli-

¹ *When Helping Hurts: How to Alleviate Poverty without Hurting the Poor... and Yourself* (Chicago: Moody, 2009), 49–52.

kuara të mëkatit personal dhe sfidave të sistemeve që e përbëjnë varfërinë.

Megjithëse disa prej këtyre sfidave nuk ndryshojnë në këtë jetë (Gjoni 12:8), ungjilli vjen tek i varfri me lajmin e mirë të një Perëndie që nuk e kurseu Birin e Tij, por e dha atë lirisht për shpëtimin e mëkatarëve. Ungjilli vjen te një i varfër me premtimin e fuqisë së Frymës së Shenjtë për të na ndryshuar dhe shenjtëruar ne, duke thyer modelet e rrënjosura brenda nesh të sjelljes vetëshkatërruese. Ungjilli vjen te një i varfër me thirrjen për t'u penduar për mënyrën e padobishme të jetesës që iu la atij trashëgim prej paraardhësve të vet (1 e Pjetrit 1:18). Ungjilli vjen te një i varfër me mesazhin se ai mund të bëhet tej mase i pasur, edhe pse gjendja e tij ekonomike mbetet e njëjtë (Zbulesa 2:9). Ungjilli vjen te një i varfër me një mesazh shprese për një botë që do të bëhet e re, ku sëmundja dhe varfëria dhe frika do të zhduken fare (Zbulesa 21:4). Është bindja jonë e fortë se gjëja, për të cilën të varfrit kanë më tepër nevojë, është mesazhi i ungjillit. Gjërat e tjera mund të jenë shumë të rëndësishme, por ato mbeten prapëseprapë dytësore.

Tri kolona

Në qoftë se për një çast e përfytyroni këtë libër si një ndërtesë, dini se bindja jonë për sa i përket nevojës thelbësore për ungjillin është themeli i saj. Mirëpo, përveç themelit janë edhe tri besime të tjera që shërbejnë si kolona për ta mbajtur peshën e gjithë strukturës së tij.

1. Ungjilli do të përhapet

Së pari, *ungjilli është një mesazh që duhet përhapur*. Dhiata e Re na e bën të qartë në mënyrë të përsëritur se kur mesazhi i ungjillit vjen në botë, ai vjen me një forcë qendërikëse. Në përmbushje të fjalëve të Zotit te Veprat e Apostujve 1:8, mesazhi i vdekjes dhe ringjalljes së Tij u përhap nga qendra në Jerusalemin,

drejt Judesë dhe Samarisë dhe me kalimin e kohës në mbarë botën. Përhapja e ungjillit anembanë botës ishte kaq e shpejtë dhe dramatike, saqë vetëm tridhjetë vjet pas ringjalljes së Krishtit kishte njerëz që besonin në Jezusin në vende të tilla si Siria, Greqia, Italia, Egjipti, Afrika e Veriut dhe Persia. Pikërisht për këtë arsye, Pali mund t'i shkruante kishës në Kolos për “fjalët e së vërtetës së ungjillit, që erdhi te ju, si dhe *në gjithë botën*, dhe po jep fryt, sikurse edhe ndër ju” (Kolozianëve 1:5–6).

Kjo është edhe historia e librit të Veprave të Apostujve, ku Luka na tregon se si fuqia e Frymës e shtyu ungjillin që të largohej prej qendrës së tij. Mesazhi i krishterë nuk mund të mbetej brenda Jerusalemit, kombit të Izraelit apo edhe rajonit të Lindjes së Mesme. Përkundrazi, duhet të përhapej në mbarë botën. Fakti që dy djem të bardhë nga Skocia dhe Amerika po e shkruajnë këtë libër, është prova e këtij fakti. Fakti që ti je një i krishterë, i cili (me shumë gjasë) nuk banon në Jerusalem, është prova e këtij fakti. Ungjilli duhet të shkojë përpara duke u përhapur tek të gjithë njerëzit (Mateu 28:18–20).

2. Ungjilli do të përhapet mes të varfërve

Së dyti, në Shkrimin e shenjtë ne shohim se megjithëse ungjilli duhet t'i arrijë të gjitha kombet, *ne duhet të presim që ai të përhapet veçanërisht mes të varfërve*. Kjo është një çështje që ka të bëjë qoftë me atë çfarë na mëson historia, qoftë me një parim teologjik. Është e vërtetë se kishte të pasur e të fuqishëm mes atyre që u kthyen fillimisht në besimin e krishterë (Teofili dhe Lidia na vijnë ndër mend si shembuj të kësaj që sapo thamë; po ashtu, shih Filipianëve 4:22). Jakobi iu drejtua të pasurve që qenë të pranishëm në bashkësitë e besimtarëve (Jakobi 2:2). Mirëpo, në shumicën e rasteve, kisha duket se u shtri kryesisht mes njerëzve që nuk bënin pjesë tek elitat e kohës. Kur ra zia e bukës në Jerusalem, kishës së atjeshme i mungonin burimet për të mbijetuar me fuqitë e veta. Kur kishat e Maqe-

donisë mblodhën oferta për vëllezërit dhe motrat e tyre në Jerusalemin, ata e bënë këtë përkundër “varfërisë së tyre të thellë” (2 e Korintasve 8:2). Apostulli Pal i shkroi kështu kishës në Korint: “Shikoni në fakt thirrjen tuaj, vëllezër; sepse ndër ju ka jo shumë të urtë sipas mishit, jo shumë të fuqishëm, jo shumë fisnikë” (1 e Korintasve 1:26).

Mirëpo, përhapja e ungjillit mes të varfërve asokohe nuk ishte një aksident i historisë apo produkt i forcave të fuqishme shoqërore, siç mund të shpjegohet thjesht duke vënë në dukje faktin se të varfrit janë më të gatshëm që të përqafojnë një mesazh shprese. Përkundrazi, Shkrimi i shenjtë na thotë se mesazhi i krishterimit ngriti fole ndër nevojtarët për shkak të zgjedhjes së qëllimshme të Perëndisë. Ashtu siç shkroi Jakobi: “Dëgjoni, vëllezërit e mi të dashur, a nuk i zgjodhi Perëndia të varfrit e botës, që të jenë të pasur në besim dhe trashëgimtarë të mbretërisë që ua premtoi atyre që e duan?” (Jakobi 2:5).

Perëndia është i zellshëm në shfaqjen e lavdisë së Tij. Në qoftë se Ai do ta derdhte shpëtimin e Tij me shumicë mbi të fuqishmit, të pasurit dhe të bukurit, do të dukej sikur Ai po u fal atyre diçka që faktikisht ata e kanë fituar vetë. Mirëpo, duke u bërë të mira atyre që nuk kanë asgjë për t’i dhënë Atij, Perëndia shfaq madhështinë e Tij, duke e lënë pa fjalë sistemin e botës. Dëgjoni sërish Palin tek u thotë korintasve: “Por Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët; dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat e dobëta të botës për të turpëruar gjërat e forta; dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat jo fisnike të botës dhe gjërat e përçmuara, edhe gjërat që nuk janë, për të asgjësuar ato që janë, që asnjë mish të mos mburret përpara Tij” (1 e Korintasve 1:27–29).

3. Ungjilli do të përhapet përmes Kishës Lokale

Kolona e tretë që e mban në këmbë këtë libër, është *shpallja se shtrirja e kishave lokale është mjete më i zakonshëm që*

përdor Perëndia për përhapjen e ungjillit. Kisha qëndron në qendër të planit shpëtues të Perëndisë. Dashuria e Tij nuk qëndron mbi një turmë të madhe individësh të izoluar, por ajo thërrret nga bota dhe krijon një popull që mund të quhet “populli i Perëndisë” (1 e Pjetrit 2:9–10). Dhe në qoftë se kisha është në zemër të qëllimeve të Perëndisë, atëherë bashkësia lokale duhet të jetë në zemër të realizimit të misionit. Kjo nuk e mohon faktin se individët mund ta përhapin ungjillin pa pasur lidhje me një bashkësi lokale besimtarësh. Thjesht po themi se kjo e fundit përbën një formë të shtrembëruar ungjillëzimi.

Perëndia e ka projektuar kishën që të jetë mjeti që e çon lajmin e Tij shpëtues anembanë botës. Kishat lokale e mësojnë Fjalën e Perëndisë çdo javë pa pushim, qoftë për të dishepuulluar besimtarët, qoftë edhe për të ungjillëzuar jobesimtarët. Ato dërgojnë misionarë dhe mbjellin kisha të reja me synimin për ta çuar lajmin e ungjillit në vende të cilave iu mungon një dëshmi ungjilli.

Mirëpo, është e rëndësishme ta pranojmë se kisha është diçka më tepër sesa një pikë predikimi e lajmit për Jezusin. Ajo është në vetvete një demonstrim i qartë i ungjillit që ajo shpall. Ekzistenca e kishës lokale dëshmon për fuqinë dhe vërtetësinë e ungjillit. Ajo i jep besueshmëri dhe fuqi bindëse mesazhit të ungjillit. Siç thotë studiuesi i shkencës së misionit, apo siç quhet ndryshe misiologu, Lesli Njubigin (Lessli Newbiggin), bashkësia është hermeneutika e ungjillit.² Është mënyra se si bota arrin ta kuptojë mesazhin e ungjillit. Kisha lokale është një bashkësi të pajtuarish, pra, përbëhet prej atyre që janë pajtuar me Perëndinë dhe (besoj se nuk e prisnit këtë) me njëri-tjetrin.

Në kishë, hebrenjtë dhe johebrejtë, këta armiq të lashtë, shkrihen në një trup të vetëm si për të shfaqur urtësinë dhe lavdinë e Perëndisë përpara botës. Duke reflektuar në lidhje

² *The Gospel in a Pluralist Society* (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1989), 222.

me këtë fakt te Letra drejtuar Efesianëve 3:8–10, Pali shkruan rreshtat e mëposhtme: “Mua, më të voglit nga gjithë shenjtorët, m’u dha ky hir për të predikuar midis paganëve pasurinë e pahulumtueshme të Krishtit, dhe të ndriçoj të gjithë se ç’është bashkësia e misterit, i cili që prej jetëve që fshehur në Perëndinë, që krijoi gjithçka nëpërmjet Jezu Krishtit; që nëpërmjet kishës, t’u bëhet e njohur tani principatave dhe pushteteve, në vendet qiellore, urtësia e shumëllojshme e Perëndisë.”

Si do ta njohë gjithësia urtësinë e Perëndisë? Ajo dhe gjithçka në të do ta njohin atë në saje të ekzistencës së kishës lokale. Teksa pjesëtarët e kishës e duan njëri-tjetrin në atë mënyrë që është e pakuptueshme për botën, ata u tregojnë të gjithëve se ungjilli është i vërtetë. Teksa ata i duan të jashtmit dhe i mirëpresin ata brenda kishës, kisha jep dëshmi për fuqinë e ungjillit për të ndryshuar zemrat. Teksa ata u shpenzojnë paratë, kohën dhe jetët e tyre në përpjekje për të siguruar përhapjen e ungjillit, ata tregojnë si duken jetët e ndryshuara rrënjësisht, të çliruara prej kotësisë së pashpresë të jetës pa Perëndinë. Kisha e shpall ungjillin dhe pastaj jeton të vërtetat radikale dhe jetëndryshuese të ungjillit brenda bashkësisë së saj. Pra, pasqyron ungjillin. Mënyra e pashoqe se si Perëndia i ka konceptuar kishat lokale shërben veçanërisht për të nxitur përhapjen e ungjillit. Kjo do të thotë se Perëndia e ka konceptuar posaçërisht kishën që të realizojë detyrën e përlëvdimit të Perëndisë përmes përhapjes së mesazhit të Tij shpëtues. E dalloni këtë gjë edhe në strukturën udhëheqëse të kishës, sepse Jezu Krishti, i ngjitur lart në qiell, i ka dhënë secilës bashkësi besimtarësh njerëz, detyra e të cilëve është që “t’i ndreqin shenjtorët për veprën e shërbimit” për rritjen e trupit të Krishtit (Efesianëve 4:12; shih gjithashtu 4:11–16).

Kështu që, sipas këtij këndvështrimi, kisha është një grup i mbledhur besimtarësh, që është pajisur me drejtues të dhënë nga Perëndia për ta çuar ungjillin në botën përreth saj. Drejtu-

esit e kishës (sipas renditjes që na jep Pali: apostujt, profetët, ungjilltarët, barinjte dhe mësuesit) i janë dhënë bashkësisë së besimtarëve me qëllim që shenjtorët të pajisen për veprën e shërbesës. Kjo është pjesa më e madhe e punës që unë dhe Mezi bëjmë si pastorë, dhe po ky është përshkrimi i punës për gjithë pleqtë e kishave tona.

Sikur kjo të mos mjaftonte, kisha po ashtu banohet dhe pajiset me dhurata nga Fryma e Shenjtë për ndërtimin e trupit. Fryma i ka dhënë kishës lokale përzierjen e duhur dhe larminë e dhuratave që i nevojiten për të kryer punën e saj në botë. Kisha do ta realizojë detyrën e saj, në qoftë se anëtarët e saj i ushtrojnë këto dhunti me besnikëri në fuqinë e Frymës. Pa mendoni pak për detyrën e ungjillëzimit. Ajo vërtet i bën shumë të krishterë që të ndihen nervozë dhe fajtorë. Ata e dinë se duhet t'u flasin të tjerëve për Jezusin, por ndihen sikur nuk janë edhe aq të mirë në këtë punë, kështu që i qëndrojnë larg ungjillëzimit. Mirëpo, le ta zëmë se marrim katër të krishterë dhe u japim atyre detyrën që ta ndajnë lajmin e mirë me të tjerët:

- Alani është një njeri shumë i shoqërueshëm. Ai është i mirë për t'u njohur me njerëz të tjerë dhe për të ndërtuar miqësi të reja. Mirëpo, ai nuk është edhe aq i mirë për t'ua shpjeguar qartazi besimin e tij të tjerëve. Ai nuk u përgjigjet si duhet pyetjeve dhe as e shpjegon saktë se kush është Jezu Krishti.
- Dhuntia e Karlës është mikpritja. Në shtëpinë e saj vijnë rregullisht vizitorë, të cilët Karla arrin që t'i bëjë të ndihen të dashur, sikur të ishin në shtëpinë e tyre. Mirëpo, ajo e ka të vështirë të hapë një bisedë në lidhje me çështjet e rëndësishme të jetës me të ftuarit e saj.
- Rauli është një luftëtar i vërtetë lutjeje. Atij i pëlqen të lutet për orë të tëra, duke i kërkuar Zotit që të ketë mëshirë për të pashpëtuarit.

- Naomi është një person i mbyllur. E ka shumë të vështirë të zërë vetë miqësi me të tjerët, por kur dikush e prezanton atë me dikë të tjetër dhe i jep udhë bisedës, ajo është shumë e përgatitur për të folur për Krishtin në një mënyrë të qartë dhe të efektshme.

Nëse secili prej tyre vepron në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, ata zor se do të ungjillëzojnë dikë së afërmi. Mirëpo, në qoftë se këta katër persona i vendos në një kishë edhe ata e jetojnë jetën e besimit së bashku, befas kemi një përzierje dhuntish dhe një shkrirje pikash të forta, të cilat mund t'i kthejnë ata në një skuadër shumë të fortë ungjillëzuese.³

Në çdo pjesë të saj, Dhiata e Re e merr si të mirëqenë se këto dhunti janë dhënë dhe duhen ushtruar në kontekstin e kishës lokale. Mund të bëhet një punë e madhe ungjillëzuese së bashku me të tjerë anëtarë të kishës, por edhe ungjillëzimi individual nuk duhet bërë pa mbështetjen, përkujdesjen, lutjen dhe inkurajimin e kishës lokale që qëndron pas këtyre individëve. Mirëpo, edhe kur njerëzit vijnë te Krishti, ata duhet të integrohen plotësisht në jetën e bashkësisë lokale të besimtarëve, ku do të marrin ndihmën e nevojshme për t'u rritur dhe pjekur në Krishtin, duke u bërë edhe pjesë e jetës së trupit.

Përmbledhja e kapitullit

Pra, le ta përmbledhim gjithçka sa thamë më lart: në qoftë se është vullneti i Perëndisë që të varfrit dhe të nëpërkëmburit e shoqërisë të jenë përfituesit e dashurisë dhe të shpëtimit të Tij, dhe në qoftë se mënyra më e zakonshme që të varfrit të dëgjojnë për këtë dashuri dhe shpëtim është përmes dëshmisë së kishës lokale, atëherë duket se kishat e krishtera duhet të angazhohen fuqimisht për themelimin e kishave që do të arrijnë vendet ku

³ Tim Chester dhe Steve Timmis e theksojnë këtë gjë të libri i tyre *Total Church* (Wheaton, IL: Crossway, 2008), 59–60.

jetojnë të varfrit. Kjo do të thotë se duhen mbjellë kisha të reja aty ku nuk ka asnjë për momentin. Do të thotë po ashtu që duhet punuar për ta shëruar një kishë të sëmure që gjendet në një vend të vështirë, me qëllim që ajo të kthehet plotësisht në jetë. Mbase do të thotë që një kishë e vështirë duhet nxitur dhe drejtuar që të përqafojë përgjegjësinë e vet për ta çuar ungjillin tek të varfrit. Pikërisht për këto gjëra flet ky libër. Ne jemi të shqetësuar për faktin se shumë drejtues kishash po kërkojnë vende të mira, ku mund të arrijnë lehtë suksesin që dëshirojnë (sukses i cili përkufizohet si një kishë e mirëthemeluar, e cila është financiarisht e pavarur), në vend që të zgjedhin vende që kanë shumë nevojë për dëshminë e ungjillit.

Duke thënë këtë, ne nuk jemi dogmatikë për atë se ku duhet t'i shpenzoni përpjekjet tuaja. Unë dhe Mezi shërbejmë në kontekste shumë të ndryshme. Ai e ka fort për zemër që t'i mobilizojë dhe trajnojë njerëzit për të themeluar kisha në banesat sociale të Skocisë. Unë e kam fort për zemër që t'i arrij latino-amerikanët që jetojnë në Virxhinian Veriore. Ne nuk pretendojmë se i dimë të gjitha ato që ju duhet të bëni në vendin ku ju jetoni, mirëpo ne kemi mjaft përvojë praktike (ky është tog-fjalëshi i koduar për fjalinë “kemi bërë shumë gabime në këtë fushë”) për sa i përket kishave që arrijnë të varfrit dhe nevojtarët. Ja pse është shpresa jonë se mund t'i ndajmë disa prej këtyre përvojave dhe vëzhgimeve, me qëllim që ju të sfidoheni për t'u angazhuar në kisha që i arrijnë vendet e vështira dhe të varfrit përreth tyre.

Për çfarë ungjilli kanë nevojë ata?

Gjatë kohës që u angazhova me një shërbesë kishëmbjelljeje në Brazil dhe gjatë punës sime këtu në Edinburg, unë (Mezi) kam pritur vizitat e shumë skuadrave misionare afatshkurtra. Ndonëse e vlerësoj ndihmën e tyre, gjatë këtyre viteve kam vënë re se shumë grupe që përbëhen prej njerëzve qëllimmirë e Jezus-dashës nga Britania e Madhe dhe nga Shtetet e Bashkuara vijnë te ne me furça boje dhe çekanë në duar, por pa e kuptuar aspak mesazhin e ungjillit që ata mendojnë se kanë ardhur t'ua shpallin të tjerëve.

Shumë të rinj flasin për ungjillin sikur ky të kishte vetëm të bënte me ta dhe me ndjenjën e tyre të vetëvlerësimit. Ata mund të jenë në dijeni të elementeve si dashuria e Jezusit ose vdekja e Tij në kryqin e Golgotës, mirëpo zor se gjendet dikush që mund të japë një përshkrim të saktë e gjithëpërfshirës të mesazhit të Ungjillit. Kjo të bën të ndihesh sikur e kemi kthyer lajmin më madhështor në historinë e botës në një sistem terapie për të ndihmuar veten, të mbështjellë me zhargonin e kishës dhe atë të psikologjisë popullore.

Pa mendoni pak: në qoftë se kjo gjë është e vërtetë për anëtarët e kishave, që marrin pjesë në udhëtime misionare afatshkurta, të cilët me shumë gjasë janë mes të krishterëve më aktivë, sa më e vërtetë duhet të jetë kjo për anëtarët e tjerë të kishave!

Gjërat kanë vajtur aq keq, sa që në kishën tonë, Kisha Komunitare e Nidrit, jemi detyruar që të zhvillojmë kurse me temën “Çfarë është Ungjilli?” dhe “Si të japim dëshminë tonë” *me skuadrat misionare afatshkurtra, që na vizitojnë!* Pra, nuk mund ta marrim më si të mirëqenë që të ashtuquajturit të krishterë e kuptojnë dhe arrijnë ta komunikojnë në mënyrë logjike ungjillin. Është ironik dhe pak i trishtuar fakti që njerëzit harxhojnë goxha para dhe bëjnë udhëtime shumë të gjata që të na ndihmojnë për të ndarë një mesazh që ata e kanë të pamundur që ta shpjegojnë me fjalët e tyre.

Mirëpo, atëherë, çfarë është ungjilli vallë? E kuptoj se kjo mund të duket si një pyetje e thjeshtë dhe e kotë për t’u bërë. Tekefundit, nëse digjesh nga dëshira për t’i ndihmuar të varfrit, me shumë gjasë e konsideron veten si një besimtar të pjekur. Mirëpo, përvoja na ka mësuar që të mos e marrim asgjë për të mirëqenë. Shumë njerëz që vijnë për të shërbyer në zonat më të varfra, mendojnë se tashmë e zotërojnë mjeshtërisht mesazhin e ungjillit, por kjo nuk është aspak e vërtetë. Dhe kuptimi i duhur i mesazhit sjell një ndryshim shumë të madh kur u shërben të varfërve (dhe gjithkujt tjetër!). Një ungjill i rremë apo madje i paplotë është si një pilulë sheqeri. Mund ta gënjejë të sëmurin që ky të mendojë se po shërohet, por nuk ka asnjë fuqi për ta shëruar atë.

Perëndia, Njeriu, Krishti, Përgjigja

Ungjilli është aq i thellë dhe aq i bukur, sa për t’ia zënë kohën edhe studiuesit më të shkëlqyer, por po ashtu edhe aq i thjeshtë, sa që një fëmijë ta kuptojë dhe të besojë në të. Mesazhi është

pafundësisht i thellë dhe i gjerë, mirëpo mund ta përmbledhim atë me katër fjalët e mëposhtme.¹

1. Perëndia

Perëndia është i pafundmë e i përjetshëm, Krijuesi i shenjtë i të gjitha gjërave. Vetëm Ai e meriton gjithë përlëvdimin, nderimin dhe lavdinë. Sytë e Tij janë tepër të dëlirë për ta parë të keqen (Habakuku 1:13) dhe Ai nuk do ta lërë mëkatën pa e ndëshkuar (Eksodi 34:7).

ZOTI mbretëron, popujt le të dridhen!

Ai është ulur mbi kerubinët, toka le të dridhet!

ZOTI është i madh në Sion

dhe i shkëlqyeshëm mbi të gjithë popujt.

Ata do ta kremtojnë emrin Tënd të madh dhe të tmerrshëm!

Ai është i shenjtë!

Mbreti është i fuqishëm dhe e do drejtësinë.

Ti e ke vendosur të drejtën dhe ushtrove te Jakobi gjykim dhe drejtësi.

Përlëvdoni ZOTIN, Perëndinë tonë,

dhe bini përmbys përpara stolit të këmbëve të Tij!

Ai është i shenjtë! (Psalmi 99:1–5)

2. Njeriu

Perëndia e krijoi burrin dhe gruan sipas shëmbëlltyrës së Vet. Qëllimi më sublim i njerëzimit është ta përlëvdojë Perëndinë duke pasqyruar karakterin e Tij dhe duke jetuar një jetë adhurimi të bindur e të gëzueshëm. Mirëpo, mbarë njerëzimi ra në Adamin (Romakëve 5:12) dhe të gjithë njerëzit e konfirmojnë vendimin e paraardhësit të tyre duke u rebeluar me dashje kundër Krijuesit të tyre (Romakëve 3:9–18).

¹ Për një trajtim të plotë të mesazhit të ungjillit, shih librin e Greg Gilbert *What Is the Gospel?* (Wheaton, IL: Crossway, 2010).

Disa njerëz kanë peshoren e tyre për ta matur mëkatin. Për sa kohë që nuk po i bëjnë keq tjetërkujt dhe nuk po kryejnë ndonjë krim, ata mendojnë se gjithçka është në rregull. Mirëpo, ata e kanë shumë gabim. Bibla shprehet qartë për faktin se ne nuk e fillojmë rrugëtimin e jetës si fletë të bardha dhe pastaj gjykohemi për çfarë bëjmë më pas. Ne të gjithë e nisim jetën si fajtorë. Tashmë jemi të dënuar, sado e mirë që të na duket vetja.

Ai ju dha jetë edhe juve, që ishit të vdekur në shkelje dhe në mëkate, në të cilat keni ecur dikur, sipas ecjes së kësaj bote, sipas prijësit të pushtetit të ajrit, sipas frymës që vepron tani në bijtë e mosbindjes, ndërmjet të cilëve edhe ne dikur jetuam në lakmitë e mishit tonë duke i plotësuar vullnetet e mishit dhe të mendjes; dhe ishim prej natyre bij të zemërim-it, si edhe të tjerët. (Efesianëve 2:1–3)

3. Krishti

Perëndia Atë e dërgoi Birin e Tij që të merrte trajtë njeriu, me qëllim që të na shpëtonte ne. Jezusi jetoi një jetë bindjeje të përsosur ndaj Perëndisë dhe plot dëshirë e dha jetën e Tij si një flijim për mëkatet e popullit të Vet. Kur e gozhduan në kryq, Jezusi qëndroi në vend të tyre dhe e mbarti mbi Vete fajin dhe ndëshkimin e tyre, madje duke u bërë mallkim për ta (Galatasve 3:13; 1 e Pjetrit 2:24; 3:18). Tri ditë pas kryqëzimit të Tij, Jezusi u ringjall nga vdekja në fitore mbi mëkatin dhe vdekjen, dhe ka premtuar të kthehet për të gjykuar botën dhe për t'i bërë të gjitha gjërat të reja.

...sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash atë që edhe mora, se Krishti vdiq për mëkatet tona, sipas Shkrimeve, dhe se u varros dhe se u ringjall në të tretën ditë, sipas Shkrimeve. (1 e Korintasve 15:3–4)

4. Përgjigja

Mëkatarët nuk mund të shpresojnë që ta fitojnë faljen në saje të veprave të tyre të mira. Perëndia i urdhëron të gjithë njerëzit kudo ku ndodhen, të kthehen prej mëkateve të tyre dhe të besojnë në Jezusin (Veprat e Apostujve 17:30; 20:21). Të ndjekësh Jezusin do të thotë që duhet të hedhim poshtë të gjitha përparësitë dhe dashuritë, që më parë pushtonin zemrat tona (Luka 14:33).

Pastaj e thirri pranë vetes turmën me dishepujt e Vet dhe u tha: “Kushdo që do të vijë pas meje, ta mohojë vetveten, ta marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë. Sepse ai që do ta shpëtojë jetën e vet do ta humbasë; por ai që do ta humbasë jetën e vet për hirin tim e për ungjillin, do ta shpëtojë.” (Marku 8:34–35)

Si funksionon ungjilli

Pra, sapo e përvijua mesazhin. Mirëpo, ky nuk është një ushtrim akademik. Të kuptuarit e duhur të ungjillit nuk është thjesht një çështje saktësie teologjike. Përkundrazi, ka të bëjë tërësisht me realitetin e shërbesës së përditshme ndaj njerëzve në nevojë. Në të vërtetë, nuk mund të ketë shërbesë ungjilli dhe as shpresë për të sëmuret që lëngojnë nga sëmundja e mëkatit nëse nuk e kuptojmë si duhet këtë mesazh.

Çdo aspekt i mesazhit të ungjillit që u përmend më lart, është pikërisht ajo çfarë duhet të dëgjojnë njerëzit nëpër skemat e strehimit të Skocisë. Në të vërtetë, është mesazhi të cilin çdo njeri duhet ta dëgjojë, veçse shumë të krishterë qëllimshëm mendojnë se ndihma për nevojtarët kërkon një qasje tjetër.

Mirëpo, problemi themelor që njerëzit në nevojë kanë, është pikërisht dështimi i tyre për të kuptuar secilën prej këtyre katër aspekteve të ungjillit. Le t'i përsërisim këto katër pika, duke u ndalur për të vërejtur se si lidhen ato me jetën dhe vuajtjet e njerëzve të thyer e nevojtarë.

1. *Perëndia*

Dëshiroj t'ju tregoj për Lakin. Ai po mbyll të tridhjetat dhe nuk është rritur në familje të krishterë. Ai u rrit nëpër familje kujdes-tare dhe është produkti i dy dekadave reformash institucionale të pasuksesshme. Ushqimi i tij i përditshëm ishin debatet televizive, dokumentarët e History Channel TV, të spërkatura këto me ca erëza spiritizmi, të shoqëruara me një koktej teorish konspirative në lidhje me kuptimin e jetës. Laki ka qejf të flasë për Perëndinë, por zakonisht vetëm kur është i dehur, ose kur dergjet në shtëpinë e dikujt tjetër nën ndikimin e drogave.

Kur është esëll nga droga dhe alkooli, Laki nuk është edhe aq i sigurt nëse Perëndia vërtet ekziston. Tekefundit, shkenca e ka hedhur poshtë ekzistencën e Perëndisë, apo jo? Në qoftë se ju e pyesni se si e ka bërë këtë shkenca, Laki nuk është edhe aq i sigurt. Mirëpo, ai është i sigurt se kjo gjë ka të bëjë me evolucionin dhe me njëfarë shpërthimi të madh.

Mirëpo, e vetmja gjë që Laki e di me siguri, është që, nëse Perëndia ekziston, Ai nuk do t'ia dijë fare për njerëzit si puna e tij. Vetë jeta e tij është prova më e mirë për këtë. Në qoftë se Perëndia ekziston, Ai nuk është se na do edhe aq shumë, meqë na lë të vuajmë dhe të na ndodhin gjëra të këqija. Në qoftë se Perëndia ekziston, atëherë gjëja më e mirë për të cilën Laki mund të shpresojë, është që të jetojë çastin dhe të besojë se Perëndia do ta falë atë më vonë.

Unë kam punuar qoftë me fëmijët e rrugës në Brazil, ashtu edhe me banorët e lagjeve të varfra pranë qendrës së qytetit në Skoci. Dhe përvoja që kam mbledhur, më thotë se ata janë jashtëzakonisht të ngjashëm në të menduarin e tyre për Perëndinë. Që të dyja grupet kanë një botëkuptim të lindur, që e përfshin të mbinatyrshmen. Ata nuk e kanë problem që të besojnë në ekzistencën e ndonjë lloj qenieje të mbinatyrshme (apo “perëndie”). Mirëpo, të mos ju hutojë kjo që sapo thashë: ata nuk digjen nga dëshira për të pasur një marrëdhënie me Perën-

dinë. Apostulli Pal e bën të qartë se “mendja e mishit është armiqësi ndaj Perëndisë” (Romakëve 8:7). Mirëpo, nuk keni për të gjetur shumë ateistë të bindur intelektualisht në një skemë strehimi apo nëpër rrugët e Brazilit.

Problemi nuk është se njerëzit nuk besojnë në Perëndinë. Problemi ka të bëjë me atë se në çfarë perëndie besojnë ata.

- Ata e shohin Perëndinë si të *parëndësishëm*. Ai nuk ka as lidhjen më të vogël me jetën e tyre të përditshme; Ai është si ajo gjëja që shpluhurohet për t’u përdorur në një dasmë, pagëzim apo funeral. Ai nuk të bën punë për ndonjë gjë tjetër.
- Ata e shohin Perëndinë si të *painteresuar*. Në teori ky perëndi është i aftë që t’i ndihmojë ata, mirëpo ai nuk ka asnjë interes që ta bëjë këtë. Për ta është një gjë e pabesueshme fakti që Perëndia mund të “njihet” në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale. Ata mendojnë se Perëndia (dhe për pasojë edhe kisha) është i interesuar vetëm që të fitojë zemrat e të pasurve.
- Ata e shohin Perëndinë si një qenie *shpirtbutë*. Për një banor të zakonshëm të skemave, Perëndia nuk është i shenjtë. Ai nuk e urren mëkatin. Ai është i detyruar që të jetë medoemos një qenie e mirë. Kjo i bën ata të besojnë se Ai do të bëjë një lëshim për ta, kur të vijë dita e fundit. Dhe në qoftë se është kështu, atëherë përse duhet të shqetësohen që t’i binden Atij sot? Në fund të fundit, kanë kohë edhe nesër për ta kënaqur Perëndinë me jetën e vet.

Për shkak të kaq shumë ideve të gabuara rreth Perëndisë, është e domosdoshme që ne ta shpallin qartë natyrën e Perëndisë mes të varfërve. Duhet të paraqesim një Perëndi që është i shenjtë dhe që do t’i bëjë ata që të japin llogari, dhe ky është një sulm frontal kundër qasjes së tyre moralisht të *çlirët* ndaj jetës. Duhet të paraqesim një Perëndi që mund të njihet dhe

që në Krishtin ia zbuloi Vetën në mënyrë të përkryer njerëzve mëkatarë. Ky do të ishte vërtet një shkëlqim fytyrës kundër perëndive të asaj kulture. Perëndia ynë është i denjë për gjithë shërbimin tonë. Ai do t'ia zërë vendin vetes sonë si objekti kryesor i shërbimit dhe adhurimit. Kur ne e njohim këtë Perëndi dhe njihemi prej Tij, fitojmë një sasi jetëndryshuese qëllimpasjeje dhe vetëbesimi në jetën tonë.

Le të marrim për shembull rastin e Robit, i cili është dyzet e ca vjeç dhe ish-përdorues heroine, vjedhës dhe keqbërës profesionist. Robi bënte çfarë t'i donte zemra, kur i donte zemra, dhe pa e vrarë mendjen aspak për pasojat e veprimeve të veta. Vidhte, gënjente dhe i lëndonte njerëzit sa herë që t'i thoshte mendja. Sipas botëkuptimit të tij, nuk kishte Perëndi dhe asnjë kuptim për jetën. Për të jeta ishte mbijetesa e më të fortit.

Një ditë, Robi dëgjoi për Perëndinë dhe sytë iu hapën për të parë natyrën e Perëndisë: shenjtërinë e pafundme të Zotit, dashurinë e Tij të përsosur dhe zemërimin e Tij të pashuar ndaj mëkatit dhe mëkatarëve. Kjo njohuri ia ndryshoi jetën Robit. Tashmë ai i nënshtrohet Krijuesit dhe Gjykatësit të vet. Tashmë e kupton se interesimi plot dashuri dhe përkujdesja personale e Perëndisë për të ekzistojnë në harmoni të plotë me shenjtërinë hyjnore. Si rrjedhim, Robi nuk jeton më si një pulë pa kokë. Ai jeton duke pasur një qëllim, shpresë dhe një drejtim për jetën. Ai nuk kryen më krime. Ai nuk i qëndron më larg fëmijëve të vet. Ai tashmë jeton në mënyrë të përgjegjshme si dikush që e di se Ati i tij qiellor e do dhe kujdeset për të, si dhe pret që të sillet si fëmija i Tij.

Gjithë ky ndryshim që ka ndodhur në jetën e Robit, i cili është edhe lloji i ndryshimit që programet sociale përpiqen të arrijnë (edhe me shumë të drejtë), është pikërisht i lidhur me ndryshimin në teologjinë e tij. Robi tashmë e kupton se kush është vërtet Perëndia dhe ky fakt ka sjellë një ndryshim rrënjësor në jetën e tij.

Mosparaqitja e natyrës së Perëndisë në një mënyrë besnike dhe biblike sjell pasoja të rënda në shërbesën ndaj të varfërve, kudo ku ata jetojnë.

2. Njeriu

A ju ka qëlluar të keni qenë për vizitë diku dhe fëmija i vogël i shtëpisë bën namin nëpër shtëpi? Fëmija bërtet në kupë të qiellit dhe ia vë zjarrin bishtit të maces, kur befas e ëma e tij e rraskapitur kthehet e turpëruar duke ju mërmëritur diçka për Gjonin e shkretë “që është lodhur”. Seriozisht? Ju e keni kapur në ajër që Gjoni është një shejtan fëmijë i paedukatë, megjithëse do të ishte e pasjellshme për t’ia thënë së ëmës.

Ne të gjithë shfajësohemi, aq më tepër kur bëhet fjalë për sjelljen tonë. E po, këto lloj shfajësimesh janë të përhapura gjerësisht, sidomos në shumë prej vendeve ku shërbejmë. Ekziston një mendësi e vërtetë prej viktime në shumë prej skemave të strehimit. Është si të gjendesh në një burg të hapur ku të gjithë të burgosurit pretendojnë se i kanë futur gabimisht brenda, sepse janë të pafajshëm. “Nuk është faji im” është lajtmotivi jetësor i shumicës së njerëzve në skemën ku unë jetoj dhe shërbej.

Kur isha i ri, kaloja orë të tëra duke u këshilluar prej terapistëve dhe punëtorëve socialë. Ata ma mbushën mendjen me idenë se isha një njeri i mirë, i cili kishte rënë pre e rrethanave të këqija jetësore. Ata më thoshin se në qoftë se do të kisha pasur të njëjtat mundësi jetësore si tjerët, atëherë nuk do të kisha qenë aq i zemëruar dhe i hidhëruar me botën.

Kohë pas kohe ndesh të njëjtën mendësi në punën time. Njerëzit ndihen të pafuqishëm dhe mjaft dyshues tek ballafaqohen me botën përreth tyre; ata mendojnë se janë të pafuqishëm për t’i ndryshuar rrethanat e tyre jetësore dhe dyshojnë se mbarë bota është kundër tyre. Po ashtu, ndodh një dinamikë e çuditshme kur njerëzit ndihen krenarë për rrethanat e tyre të këqija jetësore, kur atyre iu duket sikur janë të vetmit që e dinë

se çfarë do të thotë të vuash. Sipas tyre, jeta i përkëdhel gjithë të tjerët përveç tyre.

Pali, një vagabond i pastrehë për gati dy dekada, e shpreh kështu këtë ndjesi: “Përpara se ta kuptoja veten nga këndvështrimi i Biblës, unë mendoja se isha një njeri i mirë që bënte herë pas here gjëra të këqija, por kjo ndodhte vetëm sepse po mundohesha t’i bëja gjërat si duhet. Për mua njerëzit, madje edhe të ashtuquajturit shokë të mi, ishin pengesa që nuk më linin të merrja atë çka dëshiroja.”

Riki, një njëzetvjeçar i pastrehë dhe alkoolist agresiv, bie dakord me këtë: “Mendoja se isha i pavlerë, duke u endur drejt vdekjes, vazhdimisht në depresion, jeta s’kish kuptim, dhe vazhdoja ta gënjeja veten duke i thënë se do të vinte dita kur si me magji të gjitha gjërat do të rregulloheshin. Mirëpo, gjithçka bëja, ishte të pija dhe të luaja kumar edhe më fort se më parë. Njerëzit përreth meje më bënë përshtypje vetëm në qoftë se vishnin rrobat dhe këpucët e duhura. As që ma ndiente për ta apo për çfarë ata ishin në të vërtetë. Ata më interesonin vetëm kur mund të më shërbenin për ndonjë qëllim të caktuar.”

Jeta e tyre edhe imja nisi të ndryshonte vetëm kur Bibla na ballafaqoi me mbrapshtinë e gjendjes sonë mëkatore përpara një Perëndie të shenjtë e të drejtë. Romakëve 1:20 flet qartë në lidhje me këtë çështje: “Sepse cilësitë e Tij të padukshme, fuqia e Tij e përjetshme dhe hyjnia e Tij, duke qenë të dukshme nëpërmjet veprave të Tij që nga krijimi i botës, shihen qartë, me qëllim që ata të jenë të pashfajësueshëm.”

Bibla na sfidon që ta pranojmë mëkatin tonë dhe të marrim përgjegjësi për gjërat që kemi bërë. Po, është e vërtetë se jemi që të gjithë viktima të mëkatit në një mënyrë ose në një tjetër. Po, duhet të shfaqim dhembshuri, mëshirë dhe simpati. Po, duhet të qajmë me ata që qajnë dhe të vajtojmë me ata që vajtojnë. Mirëpo, Bibla nuk na lejon kurrë që t’i përdorim veprimet e të tjerëve si një shfajësim për gjërat që ne vetë i kemi bërë.

Kushdo që dëshiron t'i ndihmojë banorët e zonave të varfra duhet t'i nxisë ata që të mos e shohin më veten vetëm si viktima, por si mëkatarë dhe si rebelë kokëfortë. Ne kryejmë mëkate, sepse jemi njerëz mëkatarë, që jetojmë në rebelim kundër Krijuesit tonë. Perëndia është i zemëruar me mëkatin dhe mëkatarët. Zemërimi i Tij është i drejtuar kundër nesh, dhe Ai nuk është si ata mësuesit që të vënë një notë më të lartë, ngaqë i vjen keq për ty.

Fillimisht kjo e vërtetë ngjan me një bar të hidhur, por me kalimin e kohës e kupton që është nga ato barna që të shpëtojnë dhe ndryshojnë jetën për mirë. Fakti që njerka ime i përdori veshkat e mia si një thes boksi gjatë pjesës më të madhe të femijërisë sime, nuk më çliron as edhe një grimë nga përgjegjësia për rebelimin tim të mbrapshtë e mëkatar kundër Perëndisë. Në goftë se dikush më merr për krahu dhe më thotë se Jezusi më do dhe se gjithçka do të rregullohet herët a vonë, ky person nuk është duke më bërë asnjë të mirë. Thjesht po më dërgon në ferr dhe po i vjedh Perëndisë lavdinë që i përket vetëm Atij.

Kjo mund të tingëllojë si një fjalë e ashpër. Përkundrazi, efektet pastorale të kësaj të vërtete janë të jashtëzakonshme. Pali, i pastrehu që u përmend më lart, tashmë e sheh ndryshe veten dhe botën. Dëgjoni se si e përshkruan veten tani: “Unë vetë isha problemi. Problemi qëndronte në zemrën dhe zgjedhjet e mia. Natyrisht, më kanë ndodhur shumë gjëra të këqija, por tani që e shoh veten ashtu si më sheh Perëndia, jam i lirë që t'i bëj ndryshe zgjedhjet e mia, por edhe që të jem më pak i hidhur dhe më në paqe me veten.”

Riki ndihet njësoj: “Të kuptuarit e së vërtetës se isha një mëkatar, më ndihmoi që ta kuptoja veten më mirë. Më ndihmoi që ta kuptoja përse bëja zgjedhje aq idiote. Tashmë i shoh njerëzit ndryshe. Jemi që të gjithë në të njëjtën varkë, madje edhe të pasurit. Në vend që t'u mbaj mëri atyre që kanë gjërat që unë nuk i kam, më vjen keq për ta, sepse nuk e kanë Krish-tin. Unë kam një zemër për të tjerët si kurrë më parë.”

Po nuk i ndihmuam të varfrit që ta shohin veten ashtu siç i përshkruan Bibla, do t'i lëmë ata që të mbeten të zënë në kurth dhe të pandihmë, porsì një brejtës brenda një karuseli të mbyllur. Ata do të jenë të destinuar që të vazhdojnë ta shohin veten në qendër të një bote që është e gjitha për ta dhe që përbëhet prej problemeve të tyre. Mirëpo, kur i ndihmojmë të varfrit që ta kuptojnë veten ashtu siç i sheh Perëndia, ne ia hapim derën një shndërrimi ungjilli të vërtetë e të thellë, i cili shkon përtej përfytyrimeve tona më të shfrenuara.

3. Krishti

Fatmirësisht, mesazhi i ungjillit nuk mbaron me mirësinë e Perëndisë dhe me mëkatshmërinë e njeriut. Në rast se do të ishte kështu, nuk do të ishte një lajm i mirë. Mirëpo, e vërteta është se Perëndia e ka bërë punën e Vet për t'i dhënë zgjidhje gjendjes sonë të tmerrshme. Perëndia dërgoi Birin e Tij që të jetonte për ne dhe të vdiste për ne në kryq, dhe pastaj të ringjallej së vdekurish po për ne. Kështu që ekziston një mënyrë për të pasur një marrëdhënie të ndërsjellë e plot dashuri me Të. Një ditë Ai do të kthehet për t'i bërë të gjitha gjërat e reja dhe ne do të shijojmë bashkësi të përjetshme me Të, së bashku me gjithë shenjtorët e Tij dhe ushtrinë e Tij qiellore.

Ajo çfarë e bën zemrën time të këndojë edhe më fort, është të diturit e çmimit që Ai pagoi për ta bërë këtë për mua. Të diturit e faktit që Krishti vdiq për mëkatet e mia, më ngjall emociione të forta. Perëndia vërtet kujdeset për njerëzit “e vegjël”. Është një gjë që më ngjall një shpresë të vërtetë, më pajis me një litar shpëtimi dhe më çliron nga kurthi i mendësisë prej viktime. Ata prej nesh që kanë përvoja negative në jetën e tyre familjare, mund të kapen fort pas shembullit më madhështor të dashurisë vetëfljuese në historinë e gjithësisë.

Ja se çfarë thotë një prej shokëve të mi: “Jezusi e vendos gjithçka në perspektivën e duhur. Dikur ndihesha keq për veten

time. Ndihesha sikur më kishin trajtuar padrejtësisht. Unë nuk e njihja tim atë dhe ai më braktisi, megjithëse nuk kisha bërë asnjë gabim. Dikur zemërohesha me këtë fakt. Mirëpo, tani Perëndia është im Atë dhe Ai më do, megjithëse vazhdoj të bëj gabime. Dhe kjo gjë më jep siguri. Perëndia nuk do të largohet prej meje kur ta kem punën pisk. Në fakt, Ai dërgoi Birin e Vet që të vuante një vdekje të tmerrshme me qëllim që të më shpëtonte mua.”

E gjitha kjo duket kaq e pakuptueshme. Kaq shumë njerëz që duhet të na donin, kanë bërë pikërisht të kundërtën. Mirëpo, ja ku është dikush që duhet të ishte i zemëruar me ne, i Cili, përkundrazi, vdes në kryq për ne! Jo vetëm kaq, por Ai na erdhi pas kur po ia mbathnim larg Tij. Është njëlloj sikur të kishim një vëlla të madh mbrojtës, i cili na ruan gjithë kohës se mos pengohemi diku, mirëpo ky nuk është një vëlla dosido, por vetë Mbreti i gjithësisë!

Fëmijërinë dhe rininë e hershme i kalova nëpër jetimore dhe familje birësuese të panumërta, duke u abuzuar në shumë mënyra. Më ndodhën shumë gjëra dhe unë bëra shumë gjëra të tjera që më bënë të ndihesha fajtor, i turpëruar dhe i hutuar, ndërsa isha fëmijë dhe më pas djalë i ri. Dhe me thënë të drejtën, doja vetëm të merrja hak për gjithçka që më ndodhi. Zbulova që madje edhe në vitet e para të jetës së krishterë lutesha që ajo shumicë njerëzish që mbante përgjegjësi për vuajtjet e mia, të digjej në ferr.

Natyrisht, asokohe nuk e kisha kuptuar ende hirin. Nuk e kisha kuptuar si duhet as shlyerjen, pra, faktin që kjo paqja e porsagjetur me Perëndinë që paguar me çmimin e Birit të Tij. Mirëpo, me kalimin e kohës Perëndia m’i hapi sytë për të parë se sakrifica e Tij sublime donte të thoshte se të gjitha mëkatet e mia qenë falur, se ato nuk ishin më realiteti përkufizues i jetës sime. Nuk kisha më të drejtë që të vazhdoja të zhgërryhesha në to.

Kjo vepër sublimë faljeje zuri të depërtojë në çdo pore të mënyrës se si lutesha për anëtarët e familjes, të njohurit e dikurshëm dhe prindërit birësues. Teksa Fryma vazhdonte të vepron-te në jetën time, lutjet për mallkimin e tyre të përjetshëm u zëvendësuan prej lutjeve plot lot për shpëtimin e tyre. Sakrifica madhështore e Krishtit e pushtoi me kaq shumë dashuri frymën time, saqë e kisha të pamundur ta mbaja fshehur në zemër atë zjarr urrejtjeje. Dashuria e Tij e mposhti urrejtjen time dhe më çliroi prej ciklit që kishte qenë shkaku i vetëshkatërrimit tim për kaq shumë kohë.

Ballafaqimi ynë me bukurinë, pothuaj të pakapshme, të sakrificës së Jezusit na detyron që ta rishikojmë vendin tonë në botë, të heqim dorë nga vetëkeqardhja, të gjejmë liri në dashuri dhe përmes Frymës së Tij të gjejmë falje dhe dashuri, madje edhe për ata që na kanë shkaktuar dëme të rënda. Një shoku im, Stiveni, e krahason këtë gjë me “fitimin e një lotarie frymërore”. Stiveni reflekton kështu: “Dikur, kur isha fëmijë, ëndërroja që të fitoja lotarinë, me qëllim që të shpaguaja të gjitha të këqijat që kisha bërë. Mirëpo, në Jezusin jam falur, mëkatet e mia janë shpaguear, dhe megjithëse nuk mund t’ua kthej borxhet që u kam njerëzve, mund të lutem për frymët e tyre dhe të shpresoj se një ditë ata do të gjejnë atë që unë kam.”

Ky është Jezusi për të cilin kanë nevojë të varfrit: një Shpengues i gjallë, i Cili të pastron nga mëkatet, kryen shlyerjen për ne dhe mbart mëkatet tona. Një krisht që vetëm sa na afirmon ashtu siç jemi, është një shpëtimtar që nuk na shpëton aspak prej asgjëje.

4. Përgjigja

Duhet të punojmë fort dhe me ngulm për ta shpjeguar pendimin e vërtetë dhe biblik kur shërbejmë mes të varfërve (ose mes gjithkujt tjetër për atë punë). Të të vijë keq për mëkatet e tua dhe të pendohesh për to janë dy veprime krejt të kun-

dërta që prodhojnë dy pasoja të ndryshme afatgjata në jetën e njerëzve.

Mëkati është një krim i rëndë kundër Perëndisë dhe na ndan prej Tij. Pendimi është *t'i kthesh krahët* mëkatit. Vështirësia për ne si shërbëtorë të Perëndisë qëndron në faktin se pendimi shfaqet shumë ndryshe kur ke të bësh me jetë të thyera dhe kaotike.

Le të marrim rastin e Inosensas për shembull, një vajzë rrugësh trembëdhjetëvjeçare nga Brazili i Veriut. Ajo e kishte kaluar në rrugë pjesën më të madhe të jetës së saj të njomë. Prindërit e kishin braktisur që në moshën pesëvjeçare dhe qysh prej moshës gjashtëvjeçare e tutje ajo prostituohej për të siguruar bukën e përditshme dhe për të paguar për zamkën që përdorte për të shuar varësinë e saj ndaj kësaj substance. Kur ajo ra në kontakt me ne, ajo ishte për të qarë hallin. Njërin prej krahëve e kishte të gjymtuar për shkak të një të rrahure të fortë, që kishte pësuar prej një klienti në rrugë, të gjitha dhëmbët i kishin rënë dhe qe përdhunuar pa fund.

Një ditë, kur ajo dëgjoi për të vërtetën jetëndryshuese rreth Perëndisë, për gjendjen e saj mëkatore përpara Tij dhe lajmin e mirë të asaj që Perëndia kishte bërë për të, ajo deshi të pendohet për mëkatet e saj sa hap e mbyll sytë. Ne u lutëm me të dhe besuam se ajo kishte bërë një rrëfim të përnjëmendtë besimi.

Disa ditë më pas e gjetëm Inosensian pothuajse pa ndjenja në rrugë dhe te këmbët kishte një pako me substanca kimike (glue) (meqë ra fjala, kjo lloj substance është një helm tej mase më vdekjeprurës sesa heroina). Brazilianëve që punonin me mua, iu prenë krahët fare dhe ishin mjaft të indinjuar, sepse pendimi i saj na qe dukur të gjithëve kaq i përnjëmendtë!

E ngritëm në këmbë dhe e çuam te qendra jonë ku e pastruam dhe i folëm për angazhimin që ajo kishte marrë ndaj Krishit. “Oh, pastor Mez,” më tha ajo, “Unë e dua Jezusin. I kam kthyer krahët mëkatit. Mbrëmë e refuzova një klient dhe tani

po konsumoj vetëm gjashtë pako substanca në vend të dhjetë që konsumoja më parë.” Ajo më buzëqeshi me krenari, ndërsa unë u ndjeva sikur të më kishin qortuar. Vallë, si mund të prisja që ajo të ishte një produkt i përfunduar në ditën e parë pas kthimit në besim?

Pendimi në skemat e strehimit të Skocisë nuk dallon shumë prej këtij rasti, megjithëse nuk është edhe aq ekstrem. Çfarë të themi për një burrë që vjen te Krishti dhe që ka tri fëmijë me dy gra të ndryshme, dhe që dëshiron t'i kthejë krahët të kaluarës së tij mëkatore dhe abuzive dhe të jetë një baba i mirë për fëmijët e tij? Si shfaqet pendimi në rastin e tij? E po, sido që të jetë puna, nuk do të jetë një gjë e thjeshtë edhe e prerë me thikë. Për njerëzit që ndjekin një mënyrë të çrregullt jetese, pendimi do të sjellë për pasojë marrjen e vendimeve të vështira dhe ballafaqimin me pasojat e një stili jetese egoist dhe mëkatar.

Sharoni ishte një grua në të tridhjetat, e cila vinte prej një situatë të tmerrshme jetësore. Ajo kishte katër fëmijë, të cilët ia kishin marrë autoritetet lokale. Kishte vuajtur dënime të panumërta heqje lirie për shkak të vjedhjeve të vogla dhe krimeve lidhur me drogat. Ajo fliste me zë të lartë dhe kishte një sjellje arrogante, si dhe ishte kryetarja e një bande hajdutësh dyqanesh, që vepronte në qendër të qytetit të saj. Ajo erdhi në qendrën sociale ku unë shërbeja si vullnetar dhe më dëgjoi tek ia shpjegoja ungjillin, duke i folur për atë që kishte bërë Krishti në jetën time. Ajo erdhi tek unë me lot në sy dhe më tha: “Edhe unë dua ta kem Jezusin në jetën time. Edhe unë dua të ndryshoj, ashtu siç ke ndryshuar ti.” U preka thellë tek i dëgjoja fjalët e saj.

E vështrova dhe thashë: “Ta dish se duhet të paguash një çmim të madh për këtë. Mua m’u desh që t’i ktheja krahët gjithçkaje që njihja, përfshirë këtu shokëve të mi dhe disa prej anëtarëve të familjes, me qëllim që vërtet të rritesha si i krishterë. Nëse jam kështu si më sheh ti sot, ki parasysh që ky është rezultati i dhjetë vjetëve rritje të dhimbshme. Nuk është një

gjë që ndodh brenda natës. Jezusi na bën thirrje që ta llogarisim çmimin që duhet paguar përpara se të biem dakord që ta ndjekim Atë. Ai nuk do që të gënjehemi duke menduar se jeta jonë do të bëhet më e lehtë. Faktikisht mund të ndodhë që të bëhet edhe më e vështirë, kur shokët të na hedhin poshtë apo t'i keqkuptojnë arsyet tona se përse iu futëm kësaj jete të re. Përse nuk shkon tani që të mendohesh në lidhje me çfarë të thashë edhe kthehu nesër dhe flasim prapë? Në qoftë se mendon se Perëndia vërtet po të thërret që të pendohesh dhe t'i kthesh krahët mëkatit, atëherë hajde edhe më tako këtu në zyrën time nesër, në orën 10 paradite.” Ajo nuk u bë më e gjallë as të nesërmen dhe as më pas.

A bëra gjënë e duhur? Mendoj se po. E kam bërë të njëjtën gjë edhe shumë herë të tjera. Kur punon me njerëz me probleme emocionale, është e lehtë të tundohesh që t'i shtysh ata drejt një forme angazhimi duke shfrytëzuar gjendjen e tyre të brishtë emocionale. Është një gjë që bëhet lehtë dhe të varfrit mund të manipulohen lehtësisht që ta ndjekin Jezusin për një varg arsyes. Mirëpo, pendimi i vërtetë është vepra e Frymës së Perëndisë dhe njerëzve u shkaktojmë një dëm shumë të madh, në qoftë se nuk ua paraqesim atyre saktë çmimin e të ndjekurit të Jezu Krishtit.

Një prej pyetjeve që më pëlqen t'ua bëj shpërndarësve të drogës që vijnë në zyrën time dhe më pyesin se çfarë duhet të bëjnë për “t'u shpëtuar”, është: “Cilat janë gjërat prej të cilave je gati të heqësh dorë, me qëllim që të ndjekësh Jezu Krishtin?” Në qoftë se përgjigjja nuk është “gjithçka”, atëherë ata nuk janë gati dhe nuk e kanë kuptuar mesazhin e ungjillit. Përgjigjja e tyre e zakonshme është: “Mez, unë jam gati të bëj çfarëdo që të duhet.” Atëherë unë u përgjigjem atyre: “Çfarëdo që të duhet? A je i sigurt? Në rregull, atëherë ma jep celularin tënd që të fshij prej tij dhe prej kartës SIM numrat e shpërndarësit tënd të drogës.” Nëntëdhjetë e nëntë për qind të rasteve ata ngrihen

dhe dalin nga zyra ime pa fjalë. Në qoftë se nuk e paguajnë dot atë çmim, atëherë nuk mundën të paguajnë çmimin e të ndjekurit të Krishtit.

Pesë arsye se përse të kuptuarit e ungjillit si duhet është caq i rëndësishëm

Ungjilli është lajmi i mirë, madje faktikisht lajmi më i mirë në botë. Është thelbësore që ta ruajmë saktësinë e mesazhit dhe po ashtu ta mbajmë atë në vendin e duhur. Në qoftë se e kuptojmë gabim mesazhin, është njëlloj sikur të merrnim barna të prishura: nuk kanë për të na shëruar kurrë. Në qoftë se vëmë gjëra të tjera në vendin kryesor, që i takon ungjillit, është njëlloj sikur të blinim një unazë fejeje me gur të çmuar, por pa gurin e çmuar. Kjo sepse do të kishim një unazë, e cila shfaq shumë bukur... asgjë prej gjëje. Duhet të jemi gati që të përdorim gjithë kohën e nevojshme për ta kuptuar mesazhin e Tij si duhet dhe për ta komunikuar atë besnikërisht. Më poshtë do të rendis pesë arsye përse kjo është e rëndësishme:

1. Sepse përjetësia është gjëja më e rëndësishme

Ungjilli ka të bëjë me çdo aspekt të jetës, qoftë ato të jetës tokësore, ashtu edhe ato të jetës së përjetshme. Shumë të rinj që dëshirojnë të shërbejnë për periudha afatshkurtra pranë Kishës Komunitare të Nidrit, digjen nga dëshira për t'u shërbyer të varfërve, duke shfaqur një zell të madh për të qenë “misionalë” dhe për t'i “thyer barrierat”. Mirëpo, fatkeqësisht, pa e kuptuar as ata vetë, ndodh shpesh që e vënë theksin në gjërat e gabuara: pajtimi racial, drejtësia shoqërore apo ripërtëritja kulturore. Mesazhi i ungjillit nuk ka të bëjë vetëm me faktin që Perëndia të do apo që Perëndia dëshiron të të çlirojë prej vështirësive të momentit.

Siç e thamë më lart, nevoja më e madhe që kanë banorët e skemave të strehimit, nuk ka të bëjë me zgjidhjen e probleme-

ve sociale apo ekonomike. Problemi më i madh që ndeshin banorët e skemave të strehimit, është se ata janë në armiqësi me Perëndinë e shenjtë, për shkak se kutërbimi i mëkatit është një fyerje e vërtetë për Të. Kështu që, banorët e skemave të strehimit kanë nevojë për një Zot dhe Shpëtimtar të vërtetë, i Cili vdiq dhe u ringjall për ta, me qëllim që t'i hiqte mëkatet e tyre dhe t'i zëvendësonte zemrat e tyre idhujtare prej guri në zemra adhuruese prej mishi. Nuk ka mesazh tjetër që të bëjë punë në ndonjë fare mënyre.

Le ta bëjmë të qartë se ne nuk jemi kundër ndihmës që u duhet dhënë njerëzve për problemet e tyre të përditshme fizike. Ka situata kur do të ishte një gjë mjaft e mbrapshtë për një kishë që mos të ndihmonte dikë, i cili është vërtet në nevojë. Mirëpo, i duhet dhënë përherë përparësi mesazhit të ungjillit, pra, ai duhet të jetë gjithmonë në bash të vendit. Varfëria, dhuna, dhe padrejtësitë janë probleme reale qoftë për individët, ashtu edhe për mbarë shoqërinë. Mirëpo, ato janë simptomat e sëmundjes frymërore, nga e cila vuajmë që të gjithë. Trajtimi i simptomave është një gjë e mirë dhe fisnike, por pa kurën e ungjillit, pacienti herët a vonë do të vdesë. Kur i hyjmë ungjillëzimit dhe kontakteve me njerëz në skemat tona të strehimit të mbushura me nevojtarë, e bëjmë këtë duke pasur këtë mendësi brenda nesh.

Xhejms Montgomeri Bois (James Montgomery Boice) e shprehu kështu këtë gjë:

Ungjilli nuk është thjesht një mundësi e re për të pasur gëzim dhe mbushulli në këtë jetë, siç thonë disa. Nuk është thjesht zgjidhja për ato që më parë qenë probleme shqetësuese e pezmatuese. Është një gjë mjaft më e thellë që është bërë, diçka e lidhur me Perëndinë, në bazë të së cilës dhe vetëm për shkak të së cilës pasojnë këto bekime shtesë të shpëtimit. Pakeri (J.I. Packer) thotë: “Ungjilli na jep zgjidhjen e këtyre problemeve, por e bën këtë duke zgjidhur më së pari... problemin më të thellë ndër problemet njerëzore,

pra, problemin e marrëdhënies së njeriut me Krijuesin e Tij; dhe po qe se nuk e bëjmë të qartë se zgjidhja e këtyre problemeve të para varet nga zgjidhja e problemit të dytë, ne jemi duke e shtrembëruar mesazhin dhe duke dhënë dëshmi të rreme për Perëndinë.”²

2. Për shkak se nuk ka mënyrë tjetër për shpëtimin e njeriut

Te Veprat e Apostujve 4:12 lexojmë fjalët e mëposhtme: “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohemi.” Në qoftë se kjo është e vërtetë, njerëzit duhet të besojnë ungjillin e vërtetë, me qëllim që të shpëtohen dhe të sillen në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë. Askush tjetër nuk e siguron shpëtimin, nuk ekziston asnjë “Plan B” për ta arritur atë. E kanë shumë gabim ata që mendojnë se vizita pranë një skeme strehimi, e shoqëruar me mbledhjen e plehrave dhe pastrimin e saj apo me punimin e kopshteve të banorëve të saj, do të bëjë që e vërteta e ungjillit t’iu transmetohet banorëve të saj si me një lloj osmoze frymërore.

Besimi vjen përmes të dëgjuarit (Romakëve 10:17), kështu që ne e shpallim hapur veprën zëvendësuese që Jezusi kreu për llogari të mëkatarëve, në vend që t’u ofrojmë atyre një program për ndihmën e vetes. Veprat e mira, sikurse përkujdesja për të varfrit, janë një shenjë e fuqishme për jobesimtarët (1 e Pjetrit 2:12), por te libri i Veprave të Apostujve ishte pikërisht Fjala e Perëndisë që u përhap dhe shkaktoi rritjen shpërthyesë të kishës së hershme (për shembull, Veprat e Apostujve 6:7). Natyrisht, besimtarët e shekullit I pas Krishtit kryenin vepra të mira duke ushqyer të varfrit, duke u kujdesur për vejshat dhe duke ndihmuar të moshuarit. Mirëpo, të gjitha këto vepra ishin nënproduktet e një jete të jetuar për lavdinë e ungjillit,

² James Montgomery Boice, *Foundations of the Christian Faith: A Comprehensive and Readable Theology* (Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1986), 319.

por nuk ishin vetë ungjilli. Banorët e skemave tona të strehimit do të shpëtohen vetëm nëse fjala e ungjillit iu shpallet atyre në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Nuk ekziston asnjë mënyrë tjetër.

3. Për shkak se, përndryshe, puna jonë do të përfundojë shumë keq

Në qoftë se nuk e kuptojmë ungjillin si duhet, atëherë le ta dimë mirë se nuk kemi për të realizuar kurrë një vepër serioze kishëmbjelljeje nëpër skemat e strehimit. Duhet ta dimë mirë se çfarë kemi ardhur të bëjmë dhe po aq mirë duhet ta njohim gjendjen e njerëzve, të cilëve do t'iu shërbejmë. Nuk mund ta lëmë veten të befasohemi dhe shkurajohemi prej prishjes së thellë njerëzore, me të cilën do të ballafaqohemi. Ata që jetojnë në skemat e strehimit, nuk e fshehin shthurjen e tyre aq mirë sa banorët e periferive të pasura. Po ashtu, nuk mund t'ia lejojmë vetes dëshpërimin, duke menduar nëse kanë zgjidhje problemet, me të cilat ata ballafaqohen. Kemi nevojë për ungjillin e plotë, i cili na flet për të vërtetën e tmerrshme lidhur me mëkatin tonë dhe shpresën e lavdishme që kemi në Krishtin. Në qoftë se e ndryshojmë, e shtrembërojmë apo ua shesim ungjillin njerëzve, apostulli Pal na konsideron të mallkuar (Galatasve 1:8) dhe nuk kemi pse presim që puna jonë ta gëzojë favorin e Perëndisë.

4. Për shkak se njerëz si ti dhe unë po përfundojnë në ferr

Te Hebrenjve 9:27 lexojmë: “Është caktuar që njerëzit të vdesin një herë dhe pastaj vjen gjyqi.” Duke qëndruar në të njëjtën linjë mendimi, kur e pyetën për një kullë që ra duke vrrarë tetëmbëdhjetë veta, Vetë Jezusi u bëri thirrje njerëzve që të pendoheshin, ose përndryshe edhe ata do të humbnin për shkak të mëkateve të tyre (Luka 13:5). Kjo mund të mos duket si një përgjigje prej bariu të kujdesshëm ndaj pyetjes për sa i përket fatit të njerëzve që kishin vdekur në mënyrë tragjike, por për Jezusin, shpirtat

e dëgjuesve të Tij ishin një gjë aq e shtrenjtë, sa Ai nuk donte që t'i binte rrotull bisedës. Po të flasim në mënyrë biblike, ekziston diçka që është edhe më e keqe sesa varfëria dhe vetëvlerësimi i ulët, dhe ky është ferri. Është i vërtetë dhe i përjetshëm, pra, një realitet që ne e përjetojmë me gjithë qenien tonë. Po ashtu, kemi për detyrë që ta shpallim atë me guxim dhe me shumë ankth.

Gjendja natyrore e njerëzve është që ata janë nën mëkat dhe bij të zemërimit (Romakëve 3:9; Efesianëve 2:3). Fakti që keni pasur një jetë të vështirë, nuk e zbut këtë realitet, as edhe një milimetër. Në një epokë kur qëndrimi mbizotërues i krishterë ndaj të varfërve ka të bëjë me të dashurin e tyre dhe fuqizimin e vetëvlerësimit të tyre, për shumë njerëz ferri mund të duket si një gjë që nuk ia vlen të përmendet. Sa shpesh ndodh që njerëzit vijjnë në skemat e strehimit duke menduar se gjithçka njerëzit kanë nevojë është që t'i duan ose më keq akoma, të mësojnë se si të duan veten! Në qoftë se kjo është diagnoza juaj e problemit, atëherë kurrë nuk keni për t'u treguar njerëzve për realitetin e gjykimit dhe ndëshkimit të përjetshëm. Tekefundit, kjo nuk të bën punë as për të rritur vetëvlerësimin!

Mirëpo, në qoftë se Bibla është e saktë, atëherë duhet të besosh se po të mbeten në gjendjen e tyre natyrore, burrat dhe gratë e kanë vendin në ferr. Hebrenjve 9:27 është ose e saktë ose jo, pra, njerëzit ose do të dalin përpara gjyqit të Perëndisë ose jo. Nuk ekziston zhonglim hermeneutik që mund të nxjerrë një të mesme mes këtyre dy realiteteve. Duke pasur parasysh gjithë sa thashë, gjëja më me dashuri që mund të bëjmë për ta është që t'i paralajmërojmë për fatin e tyre të përjetshëm.

Disa njerëz që vizitojnë skemat e strehimit, përdorin shprehjen “ferri mbi tokë” për ta përshkruar realitetin që gjejnë atje, mirëpo faktikisht kjo tregon se nuk e kanë fare idenë se çfarë është ferri. Pa lexoni pak vargjet e mëposhtme të Shkrimit:

Atje do të ketë të qara dhe kërcëllim dhëmbësh. (Mateu 8:12)

Atëherë do t'u thotë edhe atyre që do të jenë në të majtë: "Largohuni nga unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij." (Mateu 25:41)

Por frikakakët dhe të pabesët, dhe të neveritshmit dhe vrasësit, dhe kurvëruesit, dhe magjistarët, dhe idhujtarët, dhe gjithë gënjeshtarët, do të kenë pjesën e tyre në liqenin që digjet me zjarr e me squfur, që është vdekja e dytë. (Zbulesa 21:8)

Çdo jetë njeriu është e përjetshme. Më e rëndësishmja është se ku do të kalohet ajo. Druhem se letargjia ungjillzuese e kishës ka të bëjë me faktin se nuk e marrim doktrinën e ferrit edhe aq seriozisht, sa ta vrasim mendjen për të. Veprimi me më shumë dashuri, që mund të kryejmë për banorët e skemave, nuk është që t'i ndihmojmë ata me paratë për të paguar faturën e dritave, apo t'u gjejmë punë, apo t'i detoksifikojmë ata, apo t'u japim atyre një shtrat, apo t'i ndihmojmë që të çlirohen nga varësia e drogave. Veprimi me më shumë dashuri, që mund të bëjmë për ta, është që t'u shpallim atyre të vërtetën dhe tmerrin e ferrit, pavarësisht se çfarë do të mendojnë ata paskëtaj për ne. Ky është një veprim dashurie vetëmohuese.

Po t'i tregojmë pjesërisht të vërtetat rreth Perëndisë, nuk do t'u bëjmë mirë atyre. Bibla e përshkruan Perëndinë në shumë mënyra: Ai është i zemëruar me mëkatin, i do mëkatarët, urren, qan dhe gëzohet. Ai e gjykon mëkatin dhe mëkatarët, por gjithashtu fal dhe shfajëson ata që pendohen me të vërtetë. Nuk predikojmë një Perëndi që është vetëm i zemëruar, ashtu siç nuk duhet të predikojmë një Perëndi që është Plaku kozmik i Vitit të Ri. Ne predikojmë ungjillin e plotë, jo sepse njerëzit e meritojnë atë, por sepse vepra kozmike, shenjtëruese, drejtësuese, dashuruese dhe sublime e hirit të Krishtit, e meriton që ne ta bëjmë këtë. Ne u predikojmë atyre, sepse e duam Atë që na deshi i pari.

5. Për lavdi të Perëndisë

Mbi të gjitha, ungjilli ka të bëjë me lavdinë e Perëndisë (vini re se te 2 e Korintasve 4:4 Pali e quan atë “ungjilli i lavdisë së Krishtit”). Perëndia zgjodhi t’i shpëtonte mëkatarët në një mënyrë të tillë që të shfaqte qoftë drejtësinë, ashtu dhe faljen e Tij (Romakëve 3:26). Ai zgjodhi që t’i shpengonte të Vetët në një mënyrë të tillë që do të nxiste lavdërimin e përjetshëm në zemrat e tyre (Zbulesa 5:12). Ai zgjodhi që ta realizonte gjithë këtë në një mënyrë që do të madhëronte urtësinë e Tij, duke zhbërë apo duke provokuar të ashtuquajturën urtësi të fuqive të botës, që patën ngritur krye kundër Tij (1 e Korintasve 1:21).

A mos vallë mendojmë se dimë më mirë sesa Perëndia? A mos vallë kemi një ungjill më të mirë dhe më përlëvdues, sesa ai që Perëndia planifikoi që nga përjetësia dhe realizoi në kohën e duhur? Ungjilli që ka në qendër njeriun (Perëndia të do shumë ty, të lutem pse nuk e pranon atë në zemrën tënde?), përlëvdon mëkatarët. Pa mesazhin e gjykimit, Perëndia na duket i padrejtë dhe tolerant, pra, jo i lavdishëm. Pa thirrjen për pendim dhe shenjtëri, Jezusi shpallet si një shpëtimtar, i cili nuk ka fuqi që ta mposhtë mëkatin në jetën e njerëzve të Tij (ndryshe nga 1 e Gjonit 3:8). Perëndia dëshiron t’i shpëtojë mëkatarët në skemat e strehimit të Skocisë dhe në lagjet e emigrantëve të Virxhinias së Veriut. Kjo është bindja që qëndron në themel të secilës faqeje të këtij libri. Mirëpo, Ai nuk do ta bëjë këtë me ndonjë mjet tjetër përveç ungjillit të lavdishëm të Birit të Tij. Ai nuk do ta ndajë lavdinë e Tij, kështu që nuk na bën punë asnjë gjysmëungjill dhe asnjë mesazh i zbutur.

Përfundim

Katërbëdhjetë vjet më parë një grup i vogël të rinjsh të krishterë erdhi në një qendër komuniteti në rrugët e Suindonit dhe më tha se kisha marrë rrugën për në ferr. Pastaj, ata më thanë se çfarë duhet të bëja që të mos përfundoja në ferr. Dëgjo lajmin

e mirë, më thanë, pranoje atë, pendohu, beso dhe pagëzohu. Në fillim nuk doja ta dëgjoja atë, por katër vjet më pas, pasi kisha përjetuar shumë dhimbje, zemërim dhe më pas pendimin e vërtetë, unë u shpëtova prej hirit të mëshirshëm të Perëndisë. I shkruaj këto fjalë si pastor sot, sepse ata të krishterë atë ditë ma shpallën ungjillin pa iu dridhur qerpiku dhe pa i bërë atij asnjë ndryshim. Pikërisht këtë kërkon Perëndia prej nesh. Kjo është detyra jonë kryesore nëse dëshirojmë të arrijmë dhe të ndihmojmë njerëzit në nevojë.

A është e rëndësishme doktrina?

Disa vjet më parë, Unë (Majku) u ula një ditë për kafe me një shokun tim të universitetit dhe po e dëgjoja, teksa më shpjegonte se pikëpamja e tij për shërbesën kishte ndryshuar qysh prej kohës kur ishim studentë. Ai drejtonte një shërbesë universitare, e cila përfshinte një numër kampusesh universitare, dhe po më shpjegonte vendimin e tyre për të mos qenë edhe aq “me kryqin në qendër”, (këto ishin fjalët e tij), sa kishim qenë pesëmbëdhjetë vjet më parë: “E di Majk, ne preferojmë të mos jemi edhe aq... *doktrinorë*. Nuk ka dyshim që kryqi është i rëndësishëm. Mirëpo, nuk duam të mbetemi peng të argumenteve mbi shlyerjen në shekullin e XVI. Tekefundit, Jezusi përdori shëmbëlltyra të tjera për ta shpjeguar shpëtimin e Tij, gjëra të tilla si fara e mustardës që rritet derisa bëhet pemë e madhe. Duam ta përhapim mbretërinë e Perëndisë duke u shpallur lajmin e mirë të varfërve dhe çlirimin të burgosurve. Kemi shumë vepra të mira për të bërë, kështu që nuk mund t’ia lejojmë vetes që të na bllokojë teologjia.”

Le ta lëmë mënjanë për një çast faktin nëse apostulli Pal do të binte dakord me përparësitë e shokut tim apo jo, (meqenëse e shpalli qartë përpara korintasve se ai donte të mos dinte tjetër ndër ta përveç mbretërisë së Perëndisë që përhapet si një farë mustarde... pa prit pak, sikur e tha ndryshe ai [1 e Korintasve 2:2]), çfarë mund të themi për thelbin e fjalëve të tij? Nuk mund të thuash se po ia fut kot fare.

Le ta zëmë, për shembull, se gjendeni në një anije që po lundron drejt një qyteti të largët për t'i njoftuar banorët e tij në lidhje me një fatkeqësi që po iu afrohet. Në qoftë se nuk mbërrini në kohë, të gjithë banorët e qytetit kanë për të vdekur. Kuptohet që ju dëshironi që anija juaj të lundrojë me shpejtësi rrufeje. Kështu që i hiqni të gjitha ngarkesat, të cilat e rëndojnë anijen dhe e bëjnë atë më të ngadalshme. Nuk harxhoni kohë për t'u kujdesur që të pastrohet kuverta dhe pjesët e tjera të anijes. Detyra urgjente që keni marrë, ju detyron që të vepëroni me efikasitet duke i kufizuar në maksimum veprimet e parëndësishme.

Njerëzit si puna e shokut tim pretendojnë se nevoja urgjente për misionin e krishterë duhet të na bëjë që t'i zvogëlojmë velat tona teologjike dhe t'i flakim në det ngarkesat e rënda të saktësisë doktrinare. Këto pesha shkaktajnë vetëm grindje dhe përçarje mes njerëzve që duhet të bashkëpunonin. Në qoftë se njerëzit po vuajnë, të varfrit shtypen dhe numri i skllëverve sa vjen e shtohet, pse të shkruajmë libra dhe të mbajmë konferenca dhe të debatojmë pa fund në lidhje me kuptimin e disa fjalëve?

Këto fjalë kanë njëfarë të drejte. Mbase kisha do të ishte në një gjendje më të mirë sikur të krishterët të kalonin më pak kohë duke u zënë në internet rreth infralapsarianizmit dhe më shumë kohë duke u dëshmuar fqinjëve të tyre për Jezusin. Mirëpo kjo nuk do të thotë se kishat që përpiqen të arrijnë të varfrit dhe nevojtarët, duhet t'i flakin tutje bindjet dhe diskutimet rreth teologjisë.

Doktrina nuk është ngarkesa e anijes, por është trangu dhe direku i saj.

Doktrina e kishës përcakton natyrën dhe cilësinë e dëshmisë së saj. Teologjia e saj përcakton qëllimet e saj dhe mënyrën se si ajo përpiqet që t'i arrijë ato. Le të shohim pak fjalët e Jezusit drejtuar dishepujve të Tij, kur u dha Porosinë e Madhe:

Dhe Jezusi u afrua dhe u foli atyre duke thënë: “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj të gjitha kombet duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, duke i mësuar të mbajnë të gjitha sa ju kam urdhëruar. Dhe ja, Unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës”. (Mateu 28: 18–20)

Jezusi i urdhëroi dishepujt që të shkojnë e të bëjnë të tjerë si vetja, dhe kjo porosi përbëhet prej dy hapave:

- Së pari, ata duhet t'i pagëzojnë njerëzit e kombeve në emër të Atit, Birit dhe Frymës së Shenjtë. Të qenët dishepull fillon me burrat dhe gratë që pendohen për mëkatet e tyre dhe besojnë në Zotin Jezus përmes shpalljes së ungjillit. Pagëzimi është pika kulmore e kësaj faze të bërjes së dishepujve.
- Së dyti, ata duhet t'i mësojnë dishepujt e rinj që të mbajnë të gjitha sa Ai ka urdhëruar.

Ky është një proces i vazhdueshëm dishepullimi, i cili ndodh, teksa i kthyeri në besim, i pagëzuar rishtas, mëson se çfarë do të thotë që të jetosh një jetë që e kënaq Perëndinë.

Kështu që, në këtë kapitull lind pyetja: Duke pasur këto dy aspekte të dishepullimit, a është e nevojshme që kisha ta njohë dhe mësojë doktrinën? A mund t'i arrijmë këto dy qëllime binjake thjesht duke shfaqur dashurinë e Krishtit dhe duke punuar për ripërtëritjen e komuniteteve tona përmes veprave

të shërbimit? Pa ngurruar aspak them se duket e pamundur që kjo të ndodhë.

Përkundrazi, ajo që shohim në Dhiatën e Re është se teologjia është thelbësore në çdo aspekt të jetës së kishës. Le të shqyrtojmë katër aspekte të jetës së kishës, që e provojnë këtë: shpëtimi, shenjtërimi, udhëheqja dhe ungjillëzimi.

Doktrina është e nevojshme për shpëtimin

Kritikët e domosdoshmërisë së doktrinës thonë me tallje se Perëndia nuk ka për t'i hapur trutë e njerëzve në ditën e fundit për t'u siguruar që kanë formulimet e duhura doktrinale në mendje. Jo, mbase nuk ka për të ndodhur kështu. Mirëpo, Ai do t'iu bëjë atyre një pyetje të tillë: “A besonit në *Mua*? Në Atë që Unë vërtet jam dhe jo në një version të shpikur e të sajuar Timin?” Thënë ndryshe, Perëndia është mjaft i interesuar që ne të besojmë në disa të vërteta të caktuara, sepse për Perëndinë e vërteta doktrinale është e vërtetë personale.

Me qëllim që ta përjetojë shpëtimin e Krishtit, dikush duhet të besojë dhe t'i zërë besë të vërtetave për Perëndinë e *përnjëmendte*, të cilat i përvijojm në kapitullin e mëparshëm:

- Që Ai është Krijuesi, të cilit i detyrohemi për jetët tona (Zanafilla 1:26–28).
- Që Ai është i shenjtë dhe i drejtë dhe duhet ta ndëshkojë mëkatin tonë përmes dënimit në ferr (Romakëve 3:23).
- Që Ai është aq i mëshirshëm dhe i dhembshur, sa që dërgoi Jezusin, Perëndinë-njeri, që të vdiste në kryq për mëkatin dhe të ringjallej sërish nga të vdekurit (Romakëve 3:21–26; 4:25).
- Që Ai na thërret për t'ua kthyer krahët mëkateve tona dhe për të besuar në Krishtin (Gjoni 3:16; Veprat e Apostujve 17:30).

Thënë thjesht, në qoftë se dikush nuk kthehet me gjithë zemër

te Perëndia dhe nuk u zë besë këtyre të vërtetave të lavdishme rreth Perëndisë, ai ose ajo nuk mund të shpëtohet (Romakëve 10:13–17). Doktrina është e nevojshme për shpëtimin!¹

Kjo është arsyeja se përse kur shkonin për të bërë dishepuj, apostujt nuk i shmangeshin predikimit të mesazheve doktrinore. Hidhuni një sy të gjitha temave doktrinore, për të cilat ata folën, kur u drejtoheshin turmave të jobesimtarëve në librin e Veprave të Apostujve:²

- Fryma e Shenjtë (2:14–21)
- Provania sovrane e Perëndisë (2:23; 17:26)
- Ringjallja e Krishtit (2:24–32; 3:15)
- Kryqëzimi i Krishtit (8:32–35; 13:28–29)
- Çfarë thotë Dhiata e Vjetër për Jezu Krishtin (3:22–24; 7:2–53; 28:23)
- Vërtetësia e gjykimit të ardhshëm (10:42; 17:31; 24:25)
- Krishti, e vetmja rrugë shpëtimi (4:12; 19:26)
- Perëndia Krijues (14:15–17; 17:24)
- Vetëmjaftueshmëria e Perëndisë (17:24–25)
- Mbretëria e Perëndisë (19:8; 28:23)

Apostujt ishin të vetëdijshëm për faktin që për t’u penduar për mëkatet e tyre dhe për të besuar te Krishti, jobesimtarët duhet të kuptonin disa të vërteta rreth Perëndisë dhe shpëtimit që Ai ofron në Krishtin.

Faktikisht, kur Jezusi iu shfaq Palit të shkurajuar dhe të mërzhitur në ëndërr, Ai i tha atij: “Kurajë, Pal, sepse sikurse ke dhënë dëshmi për *faktet në lidhje me* Mua në Jerusalem, ashtu duhet të dëshmosh edhe në Romë” (Veprat e Apostujve 23:11). Jezusi e përmbledh gjithë shërbesën ungjillëzuese të Palit ndaj

1 Për një trajtim më të hollësishtëm të nevojës për të besuar në doktrinën e vërtetë për shpëtim, shih kapitullin 3 të librit të Majkut *Am I Really a Christian* (Wheaton, IL: Crossway, 2011).

2 Ne kemi cituar vetëm një përzgjedhje citimesh të mundshme nga libri i Veprave të Apostujve. Në qoftë se kërkonti për të, doktrina gjendet në çdo qoshe të predikimeve ungjillëzuese të apostujve dhe drejtuesve të parë të kishës.

judenjve dhe johebrenjve, si të dëshmuarit për faktet në lidhje me Të. Kjo ishte ajo që bënte Pali; ai shkonte nga qyteti në qytet duke shpallur faktet në lidhje me personin dhe bëmat e Jezusit.

Vështirë se mund të pajtohet ky përshkrim i detyrës ungjilëzuese të kishës me pretendimin se ne duhet të dëshmojmë kryesisht përmes veprave të dashurisë dhe mëshirës në të mirë të të varfërve. E vërteta është se bota mund t'i shohë të krishterët duke u shpërndarë supë të varfërve apo duke lyer muret e shëmtuara nga pikturat murale edhe për një mijë vjet të tjera po deshën, ama kurrë nuk kanë për të ardhur në përfundimin se Jezusi vdiq për mëkatet e tyre dhe u ringjall prej së vdekurish. Ne duhet t'i hapim gojët tona dhe t'i tregojmë botës për ungjillin, ose në të kundërt askush nuk ka për t'u shpëtuar.

Doktrina është e nevojshme për shenjtërimin

Disa mund të tundohen që të besojnë se një personi i nevojitet një sasi bazë doktrine për t'u bërë i krishterë, por ama shumica e asaj që ne e quajmë “teologji” apo “doktrinë” është e panevojshme për t'u rritur si i krishterë. Natyrisht, kushdo që për nga natyra ka dëshirë të studiojë koncepte të ndërlikuara dhe të debatojë në mediat sociale me njerëz, të cilët nuk i njeh aspak, mund të vazhdojë të gërmojë më thellë. Mirëpo, shumica prej nesh nuk kemi kohë që të merremi me këto gjëra, sepse duhet të jetojmë si Jezusi nëpër komunitetet tona.

Mirëpo, ja që na del se autorët e Shkrimit nuk janë të një mendjeje me ne. Libër pas libri ne e shohim Biblën që t'i rrënjosë veprimet, sjelljet dhe qëndrimet e duhura të njerëzve të Perëndisë të doktrina e duhur. Pa t'i shohim pak shembujt e mëposhtëm:

- *Dhjetë Urdhërimet*. Kjo është Lista Madhështore e asaj se si duhet të jetojmë dhe shembulli më i shkëlqyer i asaj që thashë më lart. Mirëpo, çfarë vjen para këtyre udhë-

zimeve për një jetë të perëndishme? Një copë teologjie: “Unë jam ZOTI, Perëndia yt, që të nxori nga vendi i Egjiptit, nga shtëpia e skllavërisë” (Eksodi 20:2). Përse vallë izraelitët nuk duhet të kishin zota të tjerë? Sepse Zoti i kishte çliruar ata nga skllavëria.

- *Duajini armiq të tuaj.* Ja ku kemi një urdhëresë që i bën lëngjet e shndërrimit ungjillor të rrjedhin pa fre! Mirëpo, vini re se Jezusi e rrënjos këtë dashuri të gjallë në teologji: “Duajini armiq të tuaj, bekojini ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin, që të bëheni bij të Atit tuaj, që është në qiej, sepse Ai bën të lindë diellin e Tij mbi të këqijtë dhe mbi të mirët, dhe bën të bjerë shi mbi të drejtët dhe të padrejtët” (Mateu 5:44–45). Përse duhet t’i duam armiq të tanë? Sepse Perëndia, Ati ynë, është një Perëndi që i do armiq të!
- *Jini të shenjtë.* Të krishterët duhet të jenë të shenjtë. Përse vallë? Edhe në këtë rast një apostull tjetër na çon prapë te doktrina: “Si bij të bindur, mos iu përshtatni lakmive të mëparshme kur ishit në padijen tuaj, por ashtu si është i shenjtë Ai që ju thirri, jini edhe ju të shenjtë në gjithë sjelljen tuaj” (1 e Pjetrit 1:14–15). Për shkak të shenjtërisë së Perëndisë, ne nuk i përshtatemi pasioneve që dikur sundonin mbi ne.
- *Letrat e Palit.* Së fundi, struktura e letrave të Palit i rrënjos urdhërimet mbi të vërtetat përkatëse. Pali dëshiron që marrësit e letrave të tij, t’i paraqesin trupat e tyre si fli të gjalla (Romakëve 12:1), të veshin natyrën e re (Efezianëve 4:24), si dhe të ecin në Krishtin Jezus (Kolosianëve 2:6). Mirëpo, këto urdhërime vijnë pas ligjëratave të gjata rreth doktrinës. Pali u jep mësim të vyera këtyre kishave në lidhje me tema të tilla si drejtësi dhe përlëvdimi, tipologjia dhe kreu federal (Romakëve 5:12–17;

8:30), zgjedhja dhe paracaktimi (Efesianëve 1:4–6), prishja tërësore e njeriut (Efesianëve 2:1–3), si dhe doktrina e Krishtit (Kolosianëve 1:15–20).

Bindja e krishterë, përfshirë këtu përkujdesin sakrifikues ndaj skamnorëve, duhet të themelohet në natyrën dhe veprimtarinë e Perëndisë, si dhe të nxitet prej saj. Hiqeni këtë themel dhe ngrehina juaj do të rrënohet brenda një kohe të shkurtër. Veprimtaria sakrifikuese që përmendëm më lart, do të reshtë shumë shpejt.

Sa më shumë që të dimë për Perëndinë, aq më shumë do t'i bindemi Atij. Sa e sa njerëz e kanë bërë lutjen e famshme në një kishë ose sallë misioni, pa u rritur aspak në besim më pas, për shkak se nuk iu dha mishi i doktrinës së krishterë? Sa e sa të krishterë kanë ngecur në një mënyrë jetese të karakterizuar prej egoizmit, përtacisë dhe mëkatit, për shkak se nuk u sfiduan që ta njihnin gjithnjë e më thellë natyrën e Perëndisë dhe pasojat që ajo sjell në jetën e tyre?

Pa ndalimi pak...

Një kundërshtim që dëgjoj kohë pas kohe, është se banorët e lagjeve të varfra nuk kanë mundësi të arsimohen si duhet, ndaj për pasojë këta njerëz nuk i zotërojnë instrumentet e nevojshme për të mësuar doktrinën. Në qoftë se njerëzit jetojnë në një vend ku mbizotëron analfabetizmi dhe ku leximi dhe studimi nuk janë gjëra të zakonshme për ta, vështirë se mund t'u japësh mësim për sa i përket koncepteve të ndërlikuara teologjike. Në qoftë se do të përpiqeni ta bëni këtë, do të flisni për gjëra që ata nuk i kuptojnë dhe do të humbisni interesin e tyre.

Me thënë të drejtën, qëndrime të tilla më duken paternaliste dhe fodulle. Të varfrit janë të varfër, por nuk janë budallenj. Ata janë po aq të aftë që të kuptojnë natyrën dhe rrugët e Perëndisë, sa gjithkush tjetër. Pali nuk ia shkroi letrat e tij profesorëve të

një seminari teologjik. Lexuesit e tij përgjithësisht nuk ishin të pasur, të privilegjuar ose të mirëarsimuar. Po ashtu, izraelitët që po dilnin nga Egjipti, nuk zotëronin diploma të avancuara në teologji, por Perëndia nuk ngurroi t'u fliste atyre për lloj-lloj gjërash të ndërlikuara dhe të thella rreth Vetes së Tij.

Të varfrit mund t'i kuptojnë të vërtetat e thella. E kam vënë re këtë gjë në kishën ku shërbej në Shtetet e Bashkuara, dhe po ashtu edhe në mjedisin ku Mezi shërben në Edinburg të Skocisë.

Po ju jap shembullin e Gordonit. Ai është në fillim të të dyzetave. Ai nuk ia kishte dalë ta mbaronte gjimnazin dhe kurrë nuk kishte lexuar një libër përpara se të kthehej në besim. Ai nuk kishte pasur përvoja të mëparshme me kishën dhe me krishterimin. Gordoni mund të lexonte, por vetëm aq sa të mbaronte gazetën. Kur erdhi për herë të parë te kisha ku shërben Mezi, ai tha se mësimi që dëgjoi aty, që i vështirë për t'u kuptuar. Po ju lë të lexoni fjalët e tij:

Përpara se të shpëtohesha, e kisha të pamundur që ta kuptoja se çfarë thoshte Bibla. Tani më duket sikur më thërret me emër dhe sikur më tërheq te vetja. Mendoj se kjo është vepra e Frymës së Shenjtë. E gjej veten duke menduar për çështjet e thella të jetës në një mënyrë që nuk më kishte ndodhur kurrë më parë. Dëshiroj të lexoj gjatë gjithë kohës. Edhe pse fillimisht e kisha të vështirë t'i kuptoja disa prej termave hijerëndë teologjikë, e ndava mendjen që herët a vonë do ta kuptoja domethënien e tyre. Dëshiroja ta doja edhe më fort Perëndinë. Dëshiroja ta njihja edhe më fort Atë. Çfarë më ndihmoi gjatë këtij procesi, ishte fakti që më rrethonin njerëz të mirë, të cilët më shpjeguan gjithçka pa më trajtuar me fjalë të bukura. Kur isha në shkollë, nëse një gjë ishte shumë e vështirë, unë thjesht e lija pa mësuar atë. Tani kur mësoj, edhe pse disa prej këtyre gjërave më bëjnë me dhimbje koke, ia kam dalë të bëhem ngulmues dhe të jem i durueshëm me veten.

Përpara se të besonte te Krishti, Gordoni nuk e mbante dot një punë me kohë të plotë. Ai vuante nga varësia ndaj drogave të forta dhe jetonte një jetë kaotike. Ai thotë se nuk qëndronte dot pa lëvizur më tepër se dy minuta. Tani ai ulet dhe dëgjon një predikim prej 40 minutash pa asnjë problem, dhe sa herë që i jepet mundësia, e gjen duke studiuar Biblën.

Nuk duhet t'i nënvleftësojmë njerëzit, se nuk janë edhe aq të arsimuar apo se nuk kanë lexuar aq libra sa duhet. Natyrisht që duhet t'i përshtatësh metodat pedagogjike, kur po punon me njerëz që janë analfabetë apo me probleme mendore. Mirëpo, mësuesit e mirë e përshtatin materialin me nivelin e dëgjuesve të tyre. Në vite e vite përvojë, nuk na ka ndodhur që të ndeshim një doktrinë që është shumë e ndërlikuar për t'u kuptuar prej nevojtarëve. Në qoftë se e mësoni doktrinën qartë dhe mirë, duke u mbështetur në Frymën e Shenjtë, populli i Perëndisë do të dëshirojë ta mësojë atë dhe të rritet falë saj.

Doktrina është e nevojshme për udhëheqjen

Dhiata e Re mëson qartë se nevojitet njëfarë zotërimi i doktrinës për të qenë drejtues kisha. Drejtuesit janë të detyruar që ta mbrojnë bashkësinë e besimtarëve nga doktrina e rreme dhe gabimet teologjike.

- Pali thotë se një plak kisha e “mban fort fjalën besnike siç i është mësuar, që të jetë në gjendje me doktrinën e shëndoshë të nxisë dhe të bindë ata që flasin kundër” (Titi 1:9).
- Timoteu, tha ai, duhet “të qëndronte në Efes për t'i porositur disa që të mos japin mësim tjetër, dhe të mos u vënë veshin përrallave dhe gjenealogjive që s'kanë të sosur, të cilat shkaktojnë grindje më tepër sesa ndërtim në besimin ndaj Perëndisë” (1 e Timoteut 1:3–4).
- Jo vetëm Timoteu por edhe udhëheqësit e kishës: “Sepse shërbëtori i Zotit nuk duhet të grindet, por duhet të jetë

i butë me të gjithë, i aftë për të mësuar të tjerët dhe që duron të keqen, duke i mësuar me zemërbutësi kundërshtarët, me shpresë se Perëndia ua jep atyre të pendohen, që të njohin të vërtetën, dhe të vijnë në vete, jashtë nga laku i djallit, që i ka zënë robër për vullnetin e Tij” (2 e Timoteut 2:24–26).

Doktrina e vërtetë është jetëdhënëse dhe shenjtëruese; mësimet e rreme e shkatërrojnë shpirtin (shih Zbulesa 2:20–23). Kështu Pali i paralajmëroi pleqtë e Efesit që brenda tufës do të futeshin “ujq grabitqarë” dhe do të flisnin “gjëra të çoroditura”. Ja pse, Pali i udhëzoi ata: “Kini kujdes, pra, për veten tuaj dhe për gjithë tufën, në të cilën Fryma e Shenjtë ju ka vënë juve mbikëqyrës që të kullotni kishën e Perëndisë, të cilën Ai e ka fituar me gjakun e Vet” (Veprat e Apostujve 20:28). Një kishë së cilës i mungojnë drejtuesit që t’i mësojnë asaj doktrinën e shëndoshë, është si një antilopë e plagosur, që mbetet pas tufës. Do të dalë një grabitqar frymëror dhe do ta përpijë atë.

Ne lutemi për një lëvizje pastorësh dhe kishëmbjellësish, të cilët do të punojnë në vende të vështira. Mirëpo, shumë lehtë mund të të rrëmbejë pasioni dhe energjia e fillimit të një gjëje të re apo bërja e një gjëje mjaft sfiduese. Njerëzit në zona të varfra dhe nevojtare nuk kanë nevojë për drejtues që janë sipërmarrës të mirë apo me aftësi të shprehura krijuese; përkundrazi, ata kanë nevojë për drejtues kishë që ia kushtojnë veten të mësuarit të besimit që iu qe transmetuar shenjtorëve një herë e përgjithmonë (Juda 3).

Doktrina është e nevojshme për ungjillëzimin

Doktrina përbën përmbajtjen e ungjillëzimit tonë. Mirëpo, doktrina po ashtu paraqet motivet dhe metodat për përhapjen e ungjillit. Si Mezi, ashtu edhe unë jemi kalvinistë të bindur. Ne besojmë se Perëndia në mënyrë të hirshme e planifikon dhe e

realizon shpëtimin e njerëzve, të cilët përndryshe nuk mund dhe nuk do ta zgjidhnin kurrë Atë. Megjithëse disa njerëz pretendojnë se “doktrinat e hirit” e shkatërrojnë çdo lloj nxitjeje për të ungjillëzuar (sepse në qoftë se Perëndia zgjedh dhe shpëton, përse vallë duhet të lodhemi për ta përhapur ungjillin?), ne kemi zbuluar se e kundërta është e vërtetë. Tekefundit, do të përpiqeshit me forcat tuaja për ta bindur një person frymërisht të vdekur që të ngjallet, apo do të mbështeteshit te Zoti, i Cili i ngjall njerëzit e Tij me Krishtin (Efesianëve 2:1–10)? Kjo është edhe arsyeja përse Pali i paraprin Romakëve 10, kapitullit të tij të madh rreth përhapjes së ungjillit, me Romakëve 9, kapitullin e tij po aq të madh rreth sovranitetit të Perëndisë në shpëtimin e njeriut. Ne nuk mund të jemi dot as aq të zgjuar, as aq të qartë dhe as bindës sa duhet që t’i thërrasim në jetë njerëzit frymërisht të vdekur. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk duhet ta predikojmë ungjillin. Shpallja e ungjillit nga ana jonë është asgjë më pak sesa mjeti i caktuar nga Perëndia për shpëtimin e mëkatarëve.

Pa mendoni për këtë: kur ju hyni në një skemë strehimi ose në një takim bande dhe shpallni ungjillin, a do të shpresonit që të bindnit dikë për të besuar te Jezusi, apo do t’ju pëlqente ta dinit se Perëndia do t’i shpëtojë pa dështuar disa apo të gjithë njerëzit e Tij që gjenden aty? Kur Pali kishte nevojë për inkurajim që të vazhdonte për të predikuar ungjillin, Zoti i premtoi se kishte shumë njerëz në qytetin e Korintit, të cilët ishin “populli i Tij” (Veprat e Apostujve 18:9–10). Është e njëjta shpresë që i motivon shërbesat tona, sepse ne shpresojmë dhe besojmë dhe lutemi se Perëndia që shpëton, ka shumë nga populli i Tij edhe në Nidri edhe në Stërlling Park.

Përfundim

Vallë, a e pengon përhapjen e ungjillit në vende të vështira angazhimi ndaj të mësuarit dhe të besuarit të doktrinës? Nuk e pengon aspak. Faktikisht, thirrja jonë për të bërë dishepuj dhe

për t'u mësuar atyre që të zbatojnë mësimet e Zotit Jezus nuk mund të realizohet pa këtë angazhim. Nuk mjafton vetëm që t'i japim prova të dashurisë së Jezusit një lagjeje të varfër. Nuk mjafton që t'i riparojmë dhe ripërtërijmë strukturat sociale në atë vend. Duhet të shpallim të vërtetat e rëndësishme të ungjillit, sepse përndryshe do t'i japim vetëm lavdi vetes dhe do t'i lëmë ata në mëkatin dhe fajin e tyre.

Pjesa 2

**KISHA NË
VENDE TË VËSHTIRA**

Problemi i organizatave parakishtare

Vite më parë, (unë Mezi), gjendesha në Kejptaun të Afrikës së Jugut, duke vizituar një të ri që quhej Andi. Andi shërbente pranë një organizate parakishtare, shërbesa e së cilës kishte në qendër bandat e rrugës.¹ Ai kishte shërbyer më herët si stazhier pranë Kishës së Nidrit dhe së fundi më kishte kërkuar që ta vizitoja në terren, me qëllim që të siguroja llogaridhënie frymërore për të. Një mbrëmje dolëm për darkë me shokë dhe kolegë të tij te të njëzetat. Ata ishin të rinj e të kapadirsur, si dhe aktivistë të suksesshëm, të cilët gjendeshin në Afrikën e Jugut për t'i shërbyer Zotit mes të varfërve dhe nevojtarëve.

Mirëpo, teksa dëgjoja bisedën e këtyre misionarëve të rinj, mbeta më se i habitur nga përbuzja e tyre e thellë për institucionin e kishës lokale. Kur i pyeta se ku adhuronin të dielën,

¹ Për ta sqaruar një herë e mirë këtë çështje, lejomëni të jap përkufizimin tim të fjalës organizatë parakishtare. Sipas mendimit tim, një organizatë parakishtare është rëndom një strukturë, e cila angazhohet në fushat e ndihmës sociale dhe ungjillëzimit pa e lidhur punën e saj me një kishë apo me një grup të caktuar kishash. Qëllimi i deklaruar i shumë prej këtyre organizatave është që të shërbejnë krahas kishave për t'i ndihmuar ato që të realizojnë një aspekt të caktuar të punës së tyre.

përgjigjja e tyre ishte e njëzëshme: “Ne adhurojmë së bashku, si një grup shokësh. Tekefundit, kudo ku dy a tri mblidhen në emër të Tij, Jezusi është mes tyre.” Pas kësaj vinte fjalja tjetër: “Kishat lokale nuk po e bëjnë punën e tyre, kështu që ne po e çojmë kishën te njerëzit.” Duke marrë zemër nga këto fjalë, një vajzë e re më tha me krenari që ajo nuk kishte nevojë që të ishte pjesë e një kisha lokale për të demonstruar dashurinë e saj për Jezusin. (Fatkeqësisht, ajo u kthye më vonë në shtëpi dhe tashmë nuk e adhuron Jezusin në asnjë kishë).

Faktikisht, çfarë këta të rinj kishin bërë, ishte që e kishin zëvendësuar familjen e kishës lokale me shërbesën e krishterë për të cilën punonin. Në këtë familje të re gjithkush dukej një-lloj, fliste një-lloj, mendonte një-lloj, si dhe kultivonte dhe luftonte për të njëjtat pasione (të varfrit, nevojtarët dhe në rastin e tyre anëtarët e bandave). Kjo gjë i shkante për shtat dhe e mbështeste mendësinë e tyre “ne kundër gjithë botës”.

Mirëpo, kjo gjë është frymërisht e rrezikshme. Ja, ku ishin ata, në fund të botës, në Afrikën e Jugut, me një llogaridhënie frymërore të kufizuar, duke pasur mbi vete vetëm një menaxher që i qe caktuar nga organizata. Ata ishin të vetmit të krishterë në atë zonë, një grup shokësh frymërisht të papjekur, të cilët me shumë gjasë i mbështetnin pa asnjë mëdyshje pikëpamjet e njëri-tjetrit rreth jetës, Perëndisë dhe kishës lokale. Kur një vajzë të re i vura në dukje se shërbesa e saj nuk e kishte në fokus rëndësinë e kishës lokale, shokët e saj nënqeshën me mua. Ajo më tha një fjalë që nuk do ta harroj kurrë: “Të varfrit kanë më shumë nevojë për Jezusin sesa për kishën lokale.” Shokët e saj e lavdëruan për këtë fjalë, sipas tyre të mirëmenduar, dhe më pas biseda vazhdoi, ndërsa mua më hipi aq keq gjaku në kokë sa qeshë gati t’i merrja me shpulla të gjithë të ulurit në tavolinë.

Mbeta i shushatur: ja ku kisha përpara meje gjymtyrë dhe organe të shëndosha e plot jetë të trupit të gjerë të Krishtit, të cilat as që kishin dëshirën më të vogël për të kontribuar në

jetën e trupit lokal të Krishtit! Ata nuk e kuptonin problemin, për të cilin Pali foli qartazi te 1 e Korintasve 12:18–21: “Por tani Perëndia ka vënë çdo gjymtyrë të trupit ashtu si deshi. Po të ishin të gjitha gjymtyrët një gjymtyrë e vetme, ku do të ishte trupi? Tani, pra, janë shumë gjymtyrë, por një trup i vetëm. Dhe syri nuk mund t’i thotë dorës: ‘Unë nuk kam nevojë për ty’; dhe po ashtu koka nuk mund t’u thotë këmbëve: ‘Unë nuk kam nevojë për ju.’” Këto gjymtyrë të reja po endeshin sa andej këndej të shkëputura prej trupit dhe nuk e kuptonin as rrezikun dhe as dëmin e të vepruarit në këtë mënyrë.

Mendova edhe më tej në lidhje me këtë gjë, teksa fluturoja për në shtëpi. A mos vallë faji për qëndrimin e këtyre të rinjve ndaj kishës lokale u përket vetëm atyre? Apo mos vallë për këtë e ka fajin edhe dishepullimi i dobët dhe mësimet jocilësore që këta kishin marrë në kishën e tyre lokale? A mos vallë fajin për këtë e ka organizata parakishtarë, që i punësoi ata? Isha i sigurt që përgjigjja e kësaj pyetjeje përfshinte një numër faktorësh. Mirëpo, sado gabim që ta kishin këta të rinj, ata nuk ishin edhe aq të këqij, madje disa prej tyre nxiteshin prej motiveve që kishin për synim ta nderonin Perëndinë. Andi është shembulli parësor për këtë që thashë. Ai thotë këto fjalë në lidhje me kohën e kaluar në Afrikën e Jugut: “Kur bëja plane për vajtjen time në Afrikën e Jugut, e kisha ndarë mendjen që të isha sa më radikal që të mundesha. Shkova atje me një shok, me mendimin që do ta ndryshonim një qytezë të tërë për Jezusin.” Ky ishte një i ri i perëndishëm dhe i ndërgjegjshëm për detyrën e vet. Ai nuk ishte i etur as për famë dhe as për para. Ai thjesht dëshironte t’i shërbente Zotit dhe Shpëtimtarit të Tij mes të varfërve. Mirëpo, në vend që ta konsideronte kishën lokale si një mjet për ambicien e vet, atij i kujtohet se për të ajo qe “një pengesë për gjërat që ai dëshironte të bënte”.

Andi i konsideronte agjencitë misionare të krishtera, me të cilat shërbente, si një alternativë të besueshme të kishës lokale.

Tekefundit, ai kishte lexuar biografitë e njerëzve të mëdhenj të besimit sikurse Çarls Tomas Stad (C.T. Studd) dhe Hadson Tejlor (Hudson Taylor), të cilët kishin bërë gjëra të mëdha për kombet pa pasur ndonjë ndihmë të madhe nga kisha lokale. Ai e kishte ndarë mendjen se do t'i shërbente Perëndisë në një mënyrë më të efektshme mes të varfërve duke qenë pjesë e një organizate të krishterë, e cila dukej se ishte më e përgatitur për ta bërë këtë punë sesa kisha, të cilën ai e përshkruante si një “sërë mbledhjesh të mërzitshme dhe burokratike”.

Problemet e kishave i bëjnë tërheqëse organizatat parakishtare

Andi dhe shokët e tij nuk janë të vetmit punëtorë të krishterë që kam takuar, të cilët nuk e ndiejnë nevojën për kishën lokale. Disa vjet më parë, pas një vizitës sime në Afrikën e Jugut, u përpoqa të organizoja një takim me pastorë dhe drejtues kishash, që shërbenin në skemat e strehimit anembanë Skocisë. U dërgova ftesa një numri kishash, si dhe e përhapa lajmin për këtë organizim nëpër rrethet ungjillore. Një miku im madje na e ofroi shtëpinë e vet në fshat, që ta përdornim për takimin. Edhe pse disa njerëz qenë të pranishëm, vetëm njëri prej tyre qe pastor. Faktikisht, edhe ky zotëria qe një misionar që po përpiqej të mbillte një kishë në një skemë strehimi (kishte shumë vjet që i qe futur kësaj pune), pa pasur ndonjë të kthyer në besim. Gjithë të tjerët punonin për organizata të krishtera, madje shumica syresh ishin punëtorë të rinjsh dhe fëmijësh.

Gjatë takimit, vura re se ajo që unë prisja të ishte një shkëmbim idesh dhe burimesh, u kthye në një sesion të stërzgjatur këshillimi. Punëtorët e të rinjve dhe fëmijëve kishin rënë në depresion. Kryesisht ata shërbenin jashtë sferës së veprimit të kishave lokale, shumica prej të cilave ishin të paimteresuara për punën e tyre ose të paaftha që të trajtonin të rinjtë dhe fëmijët

problematikë, mes të cilëve ata po punonin. Veç kësaj, ata po shërbenin duke pasur shumë pak ose aspak llogaridhënie për sa i përket jetës së tyre personale dhe frymërore.

Për pasojë, shumica e këtyre punëtorëve të krishterë mposhten nga madhësia apo vështirësia e shërbesës, në të cilën janë angazhuar. Doli që një prej drejtuesve të të rinjve që i përfshirë në lloj-lloj mëkatesh, përfshirë këtu përdorimin e vazhdueshëm të pornografisë. Në fund të kohës që kaluam së bashku, m'u krijua një bindje e fortë brenda vetes se ai që i parilindur. Kjo përvojë që kalova, më bëri të shkurajohem dhe të frikësohem për sa i përket të ardhmes së krishterimit nëpër skemat e strehimit të Skocisë. M'u duk sikur po përpiqeshim ta shuanim një zjarr pylli me pistoleta uji. Si do t'i vinte filli kësaj punës sonë, vallë?

Në qoftë se drejtuesit e kishave dëshirojnë të kenë një diskutim serioz rreth këtyre çështjeve, atëherë duhet të ballafaqohemi me disa të vërteta të vështira. E vërteta është se në Skoci dhe anembanë Shteteve të Bashkuara, tani që po shkruaj, shumë prej komuniteteve më të varfra nuk e kanë një kishë ungjilli të gjallë, të fortë edhe të lidhur organikisht me mjedisin rrethues. Shumica dërrmuese e kishave që gjenden në terren, janë ose kisha të vdekura liberale që predikojnë një mesazh pa Krishtin, ose kisha doktrindrejta në plakje e sipër me një mesazh ungjilli, të cilin nuk e dëgjon njeri. Kishat po bëjnë shumë pak për sa i përket çuarjes së ungjillit te lagjet dhe pjesët më të varfra dhe më të nëpërkëmbura të qyteteve të tyre.

Në qoftë se jemi të ndershëm duhet ta pranojmë se shumë kisha nuk i kanë as planet, edhe as burimet për t'i arritur të varfrit që gjenden te dera ngjitur, edhe nëse i kanë fort për zemër ata. Shumë pak kisha dinë se si të ungjillëzojnë në mënyrë të efektshme nëpër komunitetet e varfra dhe madje edhe më pak akoma kanë një plan veprimi se si t'i dishepulllojnë njerëzit që mund të vijnë te Krishti. Veç kësaj, sasia e kohës, përpjekjeve,

fuqisë punëtore dhe parave që nevojiten për të lënë gjurmë në zonat e varfra, është kaq e pamasë, saqë duket si një mal i lartë për t'u ngjitur nga kisha lokale standarde, e cila në më të shumtën e rasteve lufton për mbijetesë. Si rezultat, shumë pak kisha, të cilat përpiqen t'i arrijnë këto zona dhe kategori njerëzish, ia dalin të ngrihen mbi nivelin e ungjillëzimit të rastësishëm apo të shërbesave të tilla për menaxhimin e krizave, si kurse qendrat për shpërndarjen e ushqimeve apo kuzhinat sociale. Për pasojë, shumica e kishave ngre supet në shenjë dorëzimi dhe i lë rrugë të lirë personelit të specializuar të organizatave parakishtarë, që të kryejë shumicën e punës.

Pra, a është për t'u habitur që besimtarët e shqetësuar dhe sipërmarrësit frymërorë e kanë shquar këtë mungesë dhe janë përpjekur që ta mbushin atë me shërbesa të specializuara? Kjo është arsyeja përse nëpër skema strehimi dhe në shumë zona të tjera të varfra në mbarë botën ndeshim një mori organizatash të krishtera rinore dhe për fëmijë, qendra për shpërndarjen e ushqimeve, qendra për shpërndarjen e rrobave, klube mëngjesi dhe streha të pastrehësh. Me thënë të drejtën, zor se mund të kritikohen vëllezërit dhe motrat qëllimmirë, që po përpiqen me çdo mjet e mënyrë për ta mbushur këtë boshllëk duke plotësuar nevoja që përndryshe do të mbeteshin të paplotësuara. Ndryshe nga shërbesat e specializuara nëpër zona të varfra, të cilat në shumicën e rasteve i ngjasojnë një koshereje bletësh për nga gjallëria e veprimtaria, kishat që gjenden në këto zona, po varrosin më tepër njerëz, sesa po pagëzojnë.

Le të vendosim përballë tyre veprimtarinë e një organizate parakishtarë të specializuar, e cila ka pas vetes lekë të paparë, si rezultat i strategjive të sofistikuar të marketingut, një departament që merret gjatë gjithë kohës me mbledhjen e fondeve, një prani të mençur multimediale në mediat sociale, duke ofruar ndërkohë mundësi ngazëlluese për të rinjtë që të shërbejnë në vende vërtet të vështira. Atëherë kuptohet që nuk mund

të bëhet asnjë krahasim mes të dy këtyre entiteteve. Andi e përmblodhi në mënyrë të përkryer këtë të vërtetë duke më thënë: “Përse vallë të punoj për një kishë? Nëse e zgjedh kishën, me shumë gjasë do të më pengojnë strukturat dhe autoritetet e saj, si dhe kundërradikalizmi i saj. Kur lexoj Dhiatën e Re, shoh jetë dhe dinamizëm, nuk shoh tradita të lodhura e të mërzitshme. Nuk desha që ta harxhoj jetën time me këto të fundit.”

Normalisht që nuk është aspak e vështirë të ndiesh simpati për ata që kanë më shumë qejf që të flasin rreth “të qenët kisha”, sesa t’i bashkohen një të tillë. Nuk duhet t’i fajësojmë shërbesat e specializuara që vijnë te skemat e strehimit, banesat sociale apo te lagjet famëkeqe, kur kishat i kanë lënë pas dore detyrat e tyre apo thjesht nuk ekzistojnë në to. Në mungesë të kishave të shëndosha, nuk mund t’i fajësojmë të rinjtë tanë që shkojnë pas këtyre organizatave të krishtera, që shërbejnë përtej caqeve të kishave lokale. Ashtu siç i pret krahëhapur flaka fluturat e natës, edhe organizatat e krishtera i presin ata krahëhapur dhe shpesh pa i vënë aspak në provë.

Tekefundit, përse duhet që botëndryshuesit e rinj e plot energji të mbeten peng i një kishë plot me të moshuar, të cilët kapen fort pas traditave të tyre të panevojshme, kur një botë plot me adrenalinë dhe angazhim shërbesë i pret ata jashtë dyerve të saj? Përse vallë duhet të përpiqen që t’ia paraqesin idetë e tyre novatore kishës lokale, kur shumë shpesh ndodh që drejtuesit e saj nuk i afrojnë ata, apo kanë humbur çdo lidhje me botën që i rrethon, apo e kanë mendjen vetëm si e si të ruajnë pushtetin e vet personal? Kush do që të udhëhiqet prej një grupi fosilesh, të cilët përherë zgjedhin rrugën më të lehtë, si dhe e mbysin çdo gjë të re që në embrion? Siç kujton Andi: “Unë kërkoja më tepër nga jeta dhe mendoja se një organizatë e specializuar do t’i anashkalonte të gjitha këto struktura dhe kështu do të mund të filloja një gjë ndryshe që do të ishte më radikale dhe më biblike.”

Ky lloj qëndrimi ngre një sërë pyetjesh:

- Çfarë duhet bërë kur kishat nuk kanë as dëshirën dhe as aftësinë për t'u lidhur në mënyrë efikase me komunitetet e varfra ngjitur me to?
- A është e vërtetë që kishat nuk i lënë të rinjtë dhe të rejtat si Andi dhe shokët e shoqet e tij që të arrijnë vendet e vështira anembanë globit?
- A duhet bërë ndonjë gjë për t'i penguar të rinjtë si Andi që ta braktisin anijen e kishës lokale për t'u hedhur në atë të organizatave të specializuara, me qëllim që të shërbejnë në komunitetet e varfra?
- A mos janë vallë shërbesat e specializuara më të afta për t'u kujdesur për të varfrit dhe nevojtarët? A janë ato zgjidhja e problemit?

Të metat e organizatave parakishtare

Disa vjet më parë, unë dhe familja ime kaluam pesë javë në qytetin e Nju Jorkut. Ishte një vend që e kishim parë në televizor, për të cilin kishim lexuar nëpër revista dhe që kishim ëndërruar shumë herë që ta vizitonim, duke mos menduar që kjo ditë do të vinte ndonjëherë. Kur morëm vesh që do të shkonim atje, vetëm mendimi për udhëtimin e pritshëm e bënte Edinburgun që të dukej edhe më gri dhe më të zymtë sesa zakonisht. Falë imagjinatës, ai vend erdhi në jetë në mendjet tona dhe nuk na zinte vendi derisa ta vizitonim atë. Kur mbërritëm, nuk u zhgënjyem aspak nga qyteti që u shfaq përpara syve tanë. Ishte një qytet i pafund dhe plot jetë në krahasim me kryeqytetin e Skocisë. Ishte një qytet plot lëvizje dhe energji, si dhe plot zhurma e ngjyra. U dashuruam pas atij vendi dhe ai ia tejkaloi çdo pritshmërie që kishim.

Mirëpo, pasi kishin kaluar nja dy javë dhe kishim udhëtuar disa herë në metronë e famshme në mbarë botën, filluam të

dallonim se çfarë fshihej pas fasadës së madhe e plot nxitim të qytetit. Ndërkohë që po prisnim që të vinte treni një ditë, vajza ime më e vogël numëroi mbi njëzet minj që po kërkonin për ushqim në shinat poshtë nesh. Po ashtu, megjithëse Parku Qendror (Central Park) ishte një vend shumë i bukur, zbuluam që brenda tij gjendeshin të pastrehë dhe lypës të panumërt. Poshtë artit, arkitekturës dhe shkëlqimit të qytetit fshiheshin sasi të mëdha mëkati, vesesh dhe vuajtjesh. Jo çdo gjë që shkëlqente atje, qe ar. Natyrisht, ne nuk qemë aq naivë sa ta mendonim Nju Jorkun si një parajsë të pamëkat, mirëpo përvojat tona në atë qytet na kujtuan se gjithçka përreth nesh është e prishur. Shumë gjëra duken të mira në sipërfaqe, por duhet të futesh pak më thellë për ta kuptuar se çfarë fshihet poshtë tyre.

Në një mënyrë të ngjashme, kisha është një shënjestër e lehtë kritikash. Nuk ka dyshim që dobësitë e të metat e saj mund të jenë të panumërta. Mirëpo, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për shërbesat parakishtarë, posaçërisht kur bëhet fjalë për punën e tyre në komunitetet e varfra.

Një nga pretendimet kryesore të atyre që mbështesin shërbesat parakishtarë, e në veçanti ato syresh që shërbejnë mes të varfërve, është se mund të realizojnë me mjaft efikasitet një veper që kisha e ka të pamundur ta bëjë. Kjo është e vërtetë deri diku. Qindra mijëra njerëz në Skoci janë pa dyshim falënderues për pakot ushqimore, që marrin qysh prej krizës mbarëbotërore ekonomike. Mirëpo, tek i hedhim një vështrim skemave skoceze të strehimit të shekullit XXI dhe historisë së gjatë të përfshirjes së organizatave parakishtarë në to, me të drejtë lind pyetja se ç'fryt frymëror afatgjatë kanë prodhuar dekada të tëra angazhimi parakishtar? Ku i kanë të kthyerit në besim, që vijnë nga skemat? Ku i kanë kishat lokale të shëndosha që duhet të ishin ngritur? Sipas asaj që shoh unë, nuk ka asnjë të tillë. Faktikisht, shoh më pak kisha në zona të tilla, në vend që të shihja më shumë të tilla.

Kjo që sapo thashë, mund të duket e ashpër, por duhet të ballafaqohemi me të vërtetën, e cila është vërtet e hidhur. Siç tha njëherë Karl Trumani (Carl Trueman): “Organizatave parakishtare ekzistojnë thjesht dhe vetëm për t’i shërbyer kishës nën varësinë e saj dhe pa i dhënë rëndësi vetes.”² Mbase ky eksperimenti madhështor me organizatat parakishtare nuk e ka ndihmuar aspak kishën lokale. Edhe pse mund ta thoni me zë të ulët, mbase në disa zona organizatat parakishtare e kanë dobësuar mbretërinë e Perëndisë, në vend që ta ndihmonin atë të përparonte, dhe as e kanë fuqizuar nusen e Krishtit. Kështu, për shembull, unë kam anëtarë në kishën time, të cilët janë të detyruar që të humbasin tre nga katër shërbesa në muaj, për shkak se “janë në punë” në organizatën e tyre parakishtare. A adhurojnë ata diku me një grup besimtarësh? Askund. Ata i kanë mësuar që besnikëria ndaj organizatës së tyre është adhurimi më sublim, që mund të ofrojnë.

Pa dyshim që dëgjojmë shumë histori dhe lexojmë letra lajmesh tërheqëse, që na flasin për të rinj që “kanë pranuar Krishtin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tyre” ose që janë ndihmuar në shumë mënyra të ndryshme, por më pas çfarë ndodh? Në qoftë se duhet t’i bëjmë pyetje të vështira kishës, pse të mos ia drejtojmë ato edhe organizatave parakishtare:

- Pas një dekade, ku janë të gjithë ata njerëz që e pranuan Krishtin si Zotin e tyre? Pjesë e cilës kishë janë ata? Çfarë dishepullimi kanë përfituar?
- Ku janë udhëheqësit dhe drejtuesit vendas të këtyre organizatave që kanë ungjillëzuar, dishepulluar dhe rritur besimtarë nga kthimi në besim e më tej?
- A i kemi shqyrtuar si duhet të metat e ungjillëzimit pa një lidhje domethënëse me kishën lokale? Ç’kuptim ka

² “How Parachurch Ministries Go Off the Rails”, *9Marks*, 1 Mars 2011, <https://www.9marks.org/article/journalhow-parachurch-ministries-go-rails/>.

t'i japësh një kupë ujë në shkretëtirë dikujt, kur burimet e ujit janë me dhjetëra kilometra larg?

Druhem se në vend që ta ndihmojnë kishën lokale, shumë shërbesa parakishtare janë kthyer drejtpërdrejt në konkurrentët e saj. Për shembull, disa vjet më parë kisha jonë vendosi të sponsorizonte realizimin e një studimi njëvjeçar rreth kishëmbjelljes në një skemë strehimi. Ne i paguam rrogën një familjeje të re që u zhvendos në atë zonë, me qëllim që të realizonte një studim fizibiliteti. Nuk ishim edhe aq të bindur për sa i përket nevojës që kishte ajo zonë për kishëmbjellje, kështu që dëshironim të krijojmë një ide më të qartë duke pasur dikë që të jetonte atje. Pak kohë pasi familja e re u vendos në atë zonë, më kontaktoi një nga drejtuesit e një organizate parakishtare kombëtare. Ajo ishte indinjuar fort nga fakti që ne nuk kishim kërkuar lejen e tyre për t'u vendosur në atë zonë, dhe donte të dinte përse grupi i organizatës së saj, që shërbente atje, nuk qe informuar paraprakisht.

Iu përgjigja se ne po bënim një studim të zonës dhe se personat që qenë dërguar në terren, do të ishin në kontakt me ne, do të bënë vëzhgimet e nevojshme, do të hartonin një raport dhe do t'ia paraqitnin atë pleqve të kishës për diskutim dhe lutje. Në fund të studimit doli që zor se mund të realizohej një kishëmbjellje në atë zonë. Kështu që, në vend që të vazhdonim më tej, vendosëm që të mbështetnim një çift tjetër të ri nga një grupim tjetër kishitar dhe që tashmë e kishin filluar veprën kishëmbjellëse në atë zonë. Mirëpo, reagimi i organizatës parakishtare ndaj “kërcënimit” të shërbesës sonë ishte që të punësonin një punëtor komuniteti me kohë të plotë për atë zonë, me qëllim që banorët lokalë t'i qëndronin besnikë asaj organizate.

Tani, duhet ta kuptoni se kjo organizatë ankohej për mungesën e një kisha lokale në atë komunitet. Ata e përshkruanin publikisht veten sikur po kërkonin një partneritet domethënës

me një kishë lokale. Mirëpo, në realitet, sipas tyre, një kishë lokale funksionale do ta dëmtonte shërbesën e tyre (edhe mbledhjen e fondeve nga ana e tyre), kështu që ata bënë gjithçka mundeshin për të mos na lënë ne që të futeshim në pjesën e tyre të tregut.

Pra, çfarë mund të themi për sa i përket dështimeve të kishave në lidhje me të varfrit? Një gjë është e sigurt se përgjigjja e kësaj pyetjeje nuk është e lidhur me themelimin e organizatave të tjera parakishtare. Pavarësisht gjithë magjepsjes që ngjallin shumë organizata parakishtare dhe shkëlqimit të tyre, ato nuk janë themeluar nga Perëndia në të njëjtën mënyrë si kisha lokale. Përkundër dështimeve dhe dobësisë së kishës lokale, ajo mbetet i vetmi institucion mbi tokë i themeluar dhe i sanksionuar nga Perëndia për të kryer veprën e shërbesës së ungjillit, qoftë në vendet e vështira, qoftë gjetkë. Do ta shqyrtojmë rolin e kishës në kapitullin vijues.

Zgjidhja e kishës lokale

“Në qoftë se nuk e preferojmë Kishën mbi të gjitha objektet e tjera të përkujdesjes sonë, ne nuk jemi të denjë për t’u numëruar mes anëtarëve të saj.

Gjon Kalvini (John Calvin), *Komentari i librit të Psalmeve (Commentary on the book of Psalms)*

Disa herë bota të bën që ta urresh me gjithë shpirt. Pikaçu ishte rreth 10 vjeç kur unë (Mezi) e takova atë. Ishte një djalosh shumë i pashëm dhe shumë i shoqërueshëm dhe jetonte në një shkurrishte të mbuluar prej një cope të pisët me ngjyrë të verdhë bashkë me një grup prej dhjetë fëmijësh të tjerë. Ai ishte më i madhi ndër ta dhe e mbronnte me vendosmëri *familjen* e tij të vogël. Unë sapo kisha filluar një shërbesë, e cila kishte të bënte me shpërndarjen e lëngjeve të frutave dhe bukës nëpër rrugë, në një përpjekje për të kontaktuar bandat e rrugëve në Sao Luis të Brazilit, dhe u bëra sa hap e mbyll sytë shok me të.

E mësova përmendsh fytyrën e tij, e cila ndërkohë u mplak dhe nisi të shfaqte gjithnjë e më tepër shenja lodhjeje, gjatë atyre pak viteve që e njoha atë. Ai më përqaftonte fort, sa herë

më shihte, dhe pastaj ulej për të ngrënë e për të pirë, teksa unë ndaja shpresën e Jezusit me të dhe me fëmijët e tjerë. Ai më dëgjonte me vëmendje dhe më kërkonte shpesh që të lutesha për të. Disa herë këndonim edhe nja dy strofa të ndonjë kënge. Një ditë e pyeta prej nga ishte dhe ai më tregoi. Kur e pyeta nëse e kishte marrë malli për familjen, ai më tha “po”. Me shumë ngurrim pranoi që të më shoqëronte në një vizitë te familja e tij në përpjekje për t’u bashkuar me ta, sepse shpresoja se kështu do t’i largohej rrugës dhe do të kthehej në shkollë.

Pas shumë përpjekjesh e gjetëm vendin ku ata jetonin, i cili gjendej në skaj të një vendgrumbullimi plehrash. “Shtëpia” e familjes që ngritur prej arkash druri, hunjsh të vjetër gardhi, pjesësh makinash dhe plehrash. Era e keqe që vinte nga ujërat e zeza, që rridhnin mes për mes dyshemesë së shtëpisë, ishte mbytëse. Njëmbëdhjetë njerëz jetonin brenda kësaj dhome që nuk ishte më e madhe sesa banjat nëpër shtëpitë tona. Ishte një tmerr i vërtetë të jetoje atje. Nuk është aspak për t’u habitur që Pikaçu e konsideronte të jetuarit rrugëve si një opsion më të mirë.

Mendoja se djalin do ta mirëprisnin në shtëpi, pak a shumë ashtu siç i ndodhi djalit plëngprishës. Mirëpo, sapo e ëma e pa, ajo filloi t’i jepte gjuhës me fjalë të ndyra dhe më bërtiste që ta largoja të birin prej andej. Pak më vonë më ofroi që të ma shiste të birin. Nuk kaloi shumë edhe një plak doli nga shtëpia dhe filloi ta godiste djalin pa qenë aspak i provokuar prej tij. Ne ia mbathëm me të katra dhe më pas mora vesh se e ëma po i thoshte të shporrej duke e mallkuar që ta hante mortja, ndërsa plaku ishte gjyshi i tij, i cili e kishte abuzuar atë seksualisht që kur ishte foshnjë.

E mbaj mend si tani kur po largohesha prej asaj lagjeje barakash dhe shihja qindra foshnja dhe motakë që luanin nëpër rrugë. Aty e kuptova se kisha rënë në kontakt me fidanishten ku po rritej brezi i ardhshëm i Pikaçuve. Zieja nga urrejtja e zemërimi dhe ndihesha shumë i pashpresë. Copa e bukës dhe kupa me lëng frutash, dhe historia e bukur nga Bibla që i tre-

goja herë pas here më dukeshin krejt të panevojshme duke pasur parasysh realitetin tronditës ku ai jetonte. Shpeshherë më dukej sikur nevojitej edhe diçka tjetër dhe duhet ta pranoj që asokohe nuk e dija se çfarë ishte ajo.

Bëra gjithçka mundesha për fëmijët si puna e Pikaçusë, me aq mundësi të kufizuara sa kisha, por realiteti i ashpër me të cilin ballafaqohesha, ishte se shërbesa ime nëpër rrugë nuk po sillte ndonjë ndryshim të madh në jetët e atyre të rinjve. Gjëja më e mirë që mund të bëja, ishte që të ndërhyja për zbutjen e krizave, por nuk kishte asnjë shpresë apo ndryshim të qëndrueshëm tek ta. Fëmijët që i vendosnim nëpër familje kujdestare, shpesh largoheshin prej tyre brenda pak ditësh duke u kthyer në rrugë për të lypur dhe për ta shitur trupin në këmbim të drogave. Ndodhi që shumë të mitur u bënë “frekuentues të rregullt” të qendrave tona sociale. Një personi që vinte nga jashtë, ne i dukeshim shumë të zënë me punë (sepse vërtetë ishim të zënë me punë) dhe për mbështetësit tanë në Botën e Parë kjo donte të thoshte mundësi të mira për të bërë fotografi dhe se kishin të bënë me një shërbesë të suksesshme. Mirëpo, unë po e përjetoja të vërtetën ditë pas dite. Me thënë të drejtën, kisha rënë në depresion për shkak të faktit që puna më ngjante si një karusel që nuk pushonte kurrë së rrotulluari.

Atëherë kur nuk e prisja, situata arriti një pikë që nuk mund ta lija pa i dhënë zgjidhje. Shkova te vendi ku zakonisht rrinte Pikaçu, dhe gjeta atje më shumë fëmijë sesa ditët e tjera. Tek po i afrohesha vendit, dëgjova të qarat e një foshnjeje, të cilën po e mbante në dorë një fëmijë dymbëdhjetë a trembëdhjetëvjeçar. Doli që ajo fëmijë është nëna e foshnjës dhe sapo e kishte lindur atë. Kur e pyeta se ku e kishte të ëmën *e saj*, ajo më tha se edhe gjyshja e foshnjës ishte për vete një fëmijë rruge, që tashmë ishte në mes të të njëzetave dhe që jetonte në një anë tjetër të qytetit. Aty e kuptova natyrën ndërbreznore, institucionale dhe shoqërore të problemit me të cilin po ballafaqohesha.

Teksa po i bluaja këto gjëra në mendje, Pikaçu mu afrua me një fytyrë të qeshur dhe më prezantoi me *irmën* (motrën) e tij. Ajo ishte një fëmijë shumë tërheqëse me lëkurë të artë dhe sy ngjyrë gështenjë prej këlyshi. Kur e pyeta Pikaçunë se çfarë bënte aty me të, ai m'u përgjigj: "Ajo ka ardhur të jetojë me ne pastor. Edhe këta të tjerët po ashtu. Ata kanë dëgjuar për pastorin që na ushqen dhe na do, kështu që na janë bashkuar neve." I zgjati krahët për të përfshirë gjithë bandën e tij të vogël, e cila tashmë i kishte nja njëzet fëmijë.

Mbeta pa fjalë. Shërbesa ime supozohej që t'i nxirrte fëmijët nga rruga dhe t'i kthente ata nëpër shtëpitë e tyre, por pa dashje ajo po sillte efektin e kundërt: pra, po i tërhiqte fëmijët drejt rrugës dhe larg prej familjeve (pavarësisht se si ishin ato) dhe komuniteteve të tyre. Unë e kisha parë me sytë e mi se në çfarë vendesh mizerje dhe me çfarë familjesh abuzuese ata jetonin, mirëpo këto fakte nuk mund ta justifikonin situatën e porsakrijuar. Disa shokë të mi e kishin zgjidhur këtë problem duke hapur shtëpi pritjeje për fëmijët. Mirëpo, shumica e këtyre shtëpive, megjithëse po bënë një punë të mrekullueshme, ishin në vetvete dyer rrotulluese, sepse fëmijët vinin në to dhe largoheshin prej tyre me një shpeshtësi alarmuese. Kështu që m'u desh të rivlerësoja gjithçka që kisha bërë deri në atë ditë.

Një zgjidhje që ka në qendër kishën lokale

Në një përpjekje për të shkuar te burimi i problemit të fëmijëve të rrugës në qytetin ku jetoja, fillova të identifikoja vendin prej nga vinin të gjithë këta fëmijë. Arrita ta dalloj se shumica e tyre vinin nga po e njëjta lagje e varfër, që gjendej në periferi të qytetit. Kështu që, një ditë vajta në atë lagje me disa bashkëpunëtorë brazilianë dhe filluam të flisnim për mundësinë e mbjelljes së një kisce në mes të atij komuniteti. Brenda pak muajve blemë një parcelë toke dhe ndërtuam aty një qendër komuniteti, një shkollë të vogël dhe një fushë futbollit dhe kështu lindi Kisha Lajmi i Mirë.

Filluam të mblidheshim për studim Bible me një grup të vogël brazilianësh dhe për një shërbesë të vogël mëngjesin e së dielës në ndërtesën tonë të re. Nuk kaloi shumë kohë dhe vendasit erdhën, dëgjuan ungjillin dhe u shpëtuan. Në kuadrin e procesit të dishepullimit ne i trajnuam ata për punë, arsimuam fëmijët e tyre, si dhe ofruam edhe veprimtari sportive dhe klube për fëmijë.

Ndryshimi që mbresëlënës. Gjatë atyre dy viteve që punova me fëmijët e rrugës, nuk ia kisha dalë që ta shpëtoja qoftë edhe një fëmijë prej asaj mënyre jetese. Përkundër kushteve të tmerrshme dhe të rrezikshme ku jetonin, shumica prej tyre nuk donin ta ndryshonin mënyrën e jetesës, megjithëse i merrnim në shtëpi dhe i ushqenim e i vishnim ata. Ata ishin mësuar me stilin e tyre të jetesës dhe lirinë që ai iu ofronte. Mirëpo, gjatë kohës sime me Kishën Lajmi i Mirë (por edhe gjatë gjithë këtyre viteve pas largimit tim) fëmijë të panumërt janë shpëtuar prej kthetrave të kësaj bote. E gjitha kjo ndodhi falë një ndryshimi të thjeshtë strategjie, pra, kaluam nga puna për parandalimin e krizave në atë për mbjelljen e një kisha ungjill-predikuese, e cila i mirëpret të varfrit dhe përpiket t'u shërbejë atyre duke u përqendruar tek të gjitha aspektet e jetës së tyre. Ishte një punë më e ngadaltë. Kishte një çmim më të lartë për t'u paguar qoftë nga pikëpamja financiare, ashtu edhe nga ajo personale. Mirëpo, jam njëqind për qind i sigurt për sa i përket avantazheve të saj në luftën për të shpëtuar jetët e fëmijëve të rrugës në Brazil.

A është vërtetë kaq e rëndësishme kisha lokale?¹

Me një fjalë të vetme them: Po. Përkundër gjithë fjalëve që thamë më lart rreth të metave e dështimeve të kishës lokale dhe

¹ Mak Stajls (J. Mack Stiles) ka dhënë një përkufizim të dobishëm të kishës lokale: "Kisha është asambleja lokale e caktuar nga Perëndia, asambleja e besimtarëve, të cilët kanë marrë zotime ndaj njëri-tjetrit. Ata mblidhen rregullisht, predikojnë Fjalën, kremtojnë Darkën e Zotit dhe kryejnë pagëzime, disiplinajnë bashkanëtarët, vendosin një strukturë biblike drejtimi, si dhe luten dhe mbledhin oferta së bashku," "Nine Marks of a Healthy Parachurch Ministry," 1 mars 2011, 9Marks, <https://www.9marks.org/article/journalnine-marks-healthy-parachurch-ministry/>.

joshjes relative të shumë prej shërbesave parakishtare, Majku dhe unë besojmë se kishat lokale të shëndetshme dhe me në qendër ungjillin janë mjeti i caktuar nga Perëndia për të shërbyer në vende të vështira. Disa mund të mendojnë se nuk ka rëndësi se kush e kryen punën, për sa kohë që Jezusi bëhet i njohur. Mirëpo, ne mendojmë se kisha lokale është e rëndësishme për një sërë arsyesh.

1. Kisha lokale është mjeti me anë të të cilit

Perëndia synon ta realizojë misionin e Tij në botë

Perëndia dëshiron që ta bëjë Vetën të njohur kryesisht përmes kishës. Kisha lokale është strategjia kryesore e Perëndisë për ungjillëzimin. Kështu, për shembull, kur apostulli Pal reflektoi në lidhje me strategjinë e tij të shërbesës, ai shkroi: “...prej Jerusalemit e përçark gjer në Iliri, kam përmbushur shpalljen e ungjillit të Krishtit, dhe kështu, duke pasur nder të ungjillëzoj atje ku nuk ishte i njohur emri i Krishtit, që të mos ndërtoj mbi themelin e tjetërkujt” (Romakëve 15:19–20).

Pali besonte se e kishte shpërndarë ungjillin në gjithë rajonin nga Jerusalemi e deri në Iliri (zona që ne e njohim si gadi-shulli i Ballkanit). Shërbesa e ungjillit që “përmbushur” në këtë rajon. A mos kishte ndodhur kjo falë faktit që Pali e kishte predikuar ungjillin në çdo komunitet dhe shtëpi të atij rajoni të gjerë? Pa dyshim që jo. Përkundrazi, Pali mund ta konsideronte të përmbushur misionin për përhapjen e ungjillit në këtë rajon, sepse *e dinte që kishte kisha anëmbanë tij*. Pali e dinte se kishat e atjeshme ishin mjetet për përhapjen e ungjillit në lagje e mëhalla. Kishat lokale ungjillëzojnë në mënyrë lokale.

Kisha gjendet në zemër të planit të Perëndisë për misionin. Kjo është arsyeja pse kur apostulli Pal dërgoi njerëz si Titi dhe Timoteu për t'i inkurajuar besimtarët, ai e bëri këtë për të ndërtuar edhe më tej bashkësitë lokale dhe jo për të themeluar organizata parakishtare të pavarura. Faktikisht, pothuajse

të gjitha Letrat e Dhiatës së Re u shkruan (edhe ende gjejnë zbatim) duke pasur si marrës kisha të caktuara. Me pak fjalë. Perëndia e zgjodhi kishën lokale, dhe asnjë organizatë tjetër, që të shërbejë si përfaqësuesi i mbretërisë së Tij në botë.

2. Kisha lokale duhet të jetë e rëndësishme për ne, sepse është e rëndësishme për Perëndinë

Apostulli Pal i shkroi kishës në Efes, duke i thënë: “dhe vuri gjithçka nën këmbët e Tij, edhe përmbi çdo gjë ia dha për krye kishës, e cila është trupi i Tij, plotësia e Atij që mbush gjithçka, në të gjitha” (Efesianëve 1:22–23). Kisha është trupi i Jezusit këtu në tokë. Kisha universale përbëhet prej lloj-lloj njerëzish nga të gjitha shtresat e shoqërisë: judenj dhe grekë, burra dhe gra, të shkolluar e të pashkolluar, skllevër dhe të lirë. E njëjta e vërtetë vlen për të gjitha kishat, pavarësisht se ndodhen në Nidri apo në zonat rurale të SHBA-ve. Në qoftë se e ndjekim Jezusin, ne jemi të gjithë një në Të, pavarësisht nëse jetojmë në Uashington apo në Edinburg. Së bashku ne e përfaqësojmë Krishtin këtu në tokë përmes trupit tonë lokal të besimtarëve. Për pasojë, kisha luan një rol qendror në synimet e Perëndisë dhe i sjell dobi botës përreth nesh, madje edhe sot kur jetojmë në një kulturë gjithnjë e më shumë armiqësore.

Perëndia e ka projektuar kishën kryesisht për lavdi të Tij. Efesianëve 3:10 na thotë se pikërisht përmes kishës Perëndia e bën të njohur urtësinë e Tij të shumëfishtë. Pavarësisht nga dështimet dhe të metat e kishave, çdo kishë është vitrina ku shfaqet lavdia dhe urtësia e pafund e Perëndisë. Bibla na mëson se kisha luan një rol qendror në vetë qëllimet e Perëndisë. Për pasojë ajo duhet të jetë një gjë e rëndësishme në jetën e çdo të krishterit të vërtetë. Pali thotë: “Ju burra, duajini gratë tuaja, sikurse edhe Krishti deshi kishën dhe dha veten e Tij për të... Sepse askush nuk e urreu kurrë mishin e vet, por e ushqen dhe kujdeset me ngrohtësi për të, sikurse edhe Zoti bën me kishën” (Efesianëve 5:25, 29).

Jezusi e do kishën e Vet pavarësisht të metave të saj të shumta dhe parëndësisë së saj në sytë e botës vëzhguese. Kisha është nusja e Tij dhe Ai nuk ka asnjë plan të marrë një tjetër përveç saj. Te Veprat e Apostujve 20:28 ne lexojmë se Krishti e ka ndërtuar kishën mbi gjakun e Vet. Kisha është ndërtuar për Jezusin, nga Jezusi dhe mbi Jezusin. Kështu që është një gjë thjesht e pakonceptueshme që të ndahet Jezusi nga kisha lokale. Në qoftë se ungjilli është diamanti mbi planin madhështor shpëtues të Perëndisë, atëherë kisha është kapësja dhe mbajtësja e tij, duke e shfaqur atë me shkëlqim rrëzëllues që ta shohë gjithë bota.

3. Kisha lokale është vendi ku rriten besimtarët

Kisha lokale po ashtu luan një rol të rëndësishëm në jetën e secilit besimtar të vërtetë, sepse është vendi ku mësojmë doktrinën, marrim qortime dhe ushtrohemi në drejtësi. Pali e kujton kishën në Efes se vetë Krishti i dha asaj “disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë, të tjerë si barinj e mësues, për ndreqjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit, derisa të arrijmë të gjithë tek uniteti i besimit dhe i njohjes së Birit të Perëndisë, te një burrë i përsosur, në masën e moshës së plotësisë së Krishtit” (Efesianëve 4:11–13).

Në një skemë strehimi si puna e Nidrit, njerëzit kanë nevojë për kohën dhe përpjekjet e përbashkëta, që vetëm një kishë lokale mund t’i sigurojnë. Shumë shpesh njerëzit trokasin në derën e kishës sonë pasi e kanë dëgjuar ungjillin nga ndonjë shërbesë parakishtarë. Prapëseprapë, shumë shpesh duket se ata kanë boshllëqe të mëdha në njohjen e tyre të Biblës dhe në sjelljen e tyre të krishterë. Pa një kishë lokale që të jetë e angazhuar për t’i mësuar dhe trajnuar ata me durim, këta njerëz do të vazhdojnë të kenë probleme në jetën e tyre të krishterë.

Roni është një shembull i qartë i këtij problemi. Bëhet fjalë

për një të ri që erdhi te ne pasi kaloi ca kohë me një organizatë të krishterë, që e ndihmoi të shpëtonte nga varësitë e tij. Gjatë kësaj kohe, ai besoi në Jezusin dhe bënte përpjekje për të jetuar si i krishterë pas daljes së tij nga programi i rehabilitimit. Roni kishte një Bibël dhe qasje në internet, por kishte pasur shumë pak raste që ta përjetonte përbashkësinë e krishterë brenda një kisha lokale.

Për pasojë, të gjithë besimtarët e vërtetë që ai njihte, ishin njerëz që sapo kishin dalë nga varësitë, dhe e gjithë përvoja e tij e krishterë kishte në qendër varësinë. Ai kurrë nuk kishte pasur përbashkësi me dikë që nuk kishte qenë pjesë e këtij botëkuptimi dhe nuk ishte rritur përtej sloganit: “Eja te Jezusi dhe përpigu të qëndrosh i pastër.” Ai ishte një besimtar i vërtetë, por frymërisht që kequshqyer në kuptimin e njohjes së Fjalës dhe shijimit të bashkësisë së kishës.

Roni gjendej në një vend të rrezikshëm nga pikëpamja frymërore, por e vetmja mënyrë se si mund të dilte prej andej, ishte që ta merrnim për dore edhe ta afronim dalëngadalë. Ai që hedhur nga dega në degë, duke marrë copëza teologjie e doktrine prej një numri kishash. Për shkak se nuk që rritur me një dietë frymërore të shëndetshme, ai u trondit thellë kur filluam ta ushqenim, madje edhe me të vërtetat më të thjeshta biblike.

Kështu që, na u desh ta mëkonim pak nga pak me të vërtetat bazë rreth shenjtërisë së Perëndisë, mëkatit dhe pendesës biblike. Ky që një ushqim i pasur për frymën e tij, megjithëse fillimisht e pati të vështirë që ta treste si duhet. Faktikisht, ai hodhi shqelma dhe i kundërshtoi shumë gjëra fillimisht, të cilat ne të kishës ungjillore i marrim si të mirëqena, si për shembull fakti që të gjithë njerëzit kanë lindur nën zemërimin e drejtë të Perëndisë. Organizata që e kishte ndihmuar të zgjidhte problemin e tij kryesor, pra, varësinë e tij, nuk e kishte trajnuar Ronin për ta ndihmuar që të rritej dhe të bëhej një besimtar i krishterë i formuar nga të gjitha anët.

Kur erdhi në kishën tonë, ai takoi njerëz të ngjashëm me të (shumë të rëndësishëm) dhe njerëz të ndryshëm prej tij (po aq të rëndësishëm sa edhe të parët). Ama ishte interesante të vëzhgoje se si po e përpunonte informacionin e marrë dhe se si po përleshej me të në gjirin e komunitetit. A ishte e vërtetë vallë që njerëzit kishin lindur në mëkat? A ishte e gjithë bota me të vërtetë nën zemërimin e Perëndisë pa Jezusin? Roni kishte nevojë për njerëzit përreth tij që ta ndihmonin t'i përpunonte këto pyetje. Ai kishte nevojë për njerëz që vinin nga e njëjta e kaluar e vështirë, por që ishin përleshur me të njëjtat pyetje duke ia dalë që të ballafaqoheshin me sukses me to. Po ashtu ai kishte nevojë për njerëz që vinin nga një mjedis më normal dhe që përballeshin me çështje të ndryshme teologjike. Roni duhet të ballafaqohej me këshillën e plotë të Perëndisë dhe të mbështetej tek ajo si e vetmja e vërtetë sublime për të, duke mos u bazuar më te ndjenjat e tij. Edhe pse Roni nuk e kuptonte gjithë këtë tërësi faktesh, të gjitha ato u kthyen në përbërësit e përvojës së tij të rritjes (si dhe e rritjes së atyre përreth tij).

Pas vështirësive të fillimit, ai u pagëzua dhe u anëtarësua në kishën tonë. Tashmë ai kishte një rrjet të tërë marrëdhëniesh me njerëz nga të gjitha shtresat shoqërore. Nuk kishte më shokë të ngjashëm me veten. Nuk rrethohej më prej një pellgu padijeje, kur vinte fjala për çështje frymërore. Mirëpo, çka është edhe më e rëndësishme, Roni zuri ta kuptonte rëndësinë e kishës lokale. Rritja e njohurisë së tij biblike u shoqërua me forcimin e besimit. Ditët e para qenë një luftë e vërtetë, por ai i bëri ballë (ashtu siç bëme edhe ne), dhe sot Roni vazhdon të rritet si besimtar i krishterë, teksa po studion për t'u bërë një specialist ndërtimi. Vetëm kur Roni u ndesh me besimtarë të tjerë që po pendoheshin për mëkatet e tyre, mëkatet e tij dolën në shesh, dhe vetëm kur ua rrëfeu këto vështirësi dhe mëkate vëllezërve më të pjekur në besim, ai ia doli që t'i kuptonte koncepte të tilla si pendimi, shenjterimi dhe ngulmimi i shenjtorëve. Me pak

fjalë, qe pikërisht kisha ajo që e ndihmoi atë që të bënte lidhjen mes Shkrimeve dhe jetës së tij. Siç thotë vetë Roni: “Vuajta ca, por tekefundit kisha lokale ma shpëtoi jetën.”

4. Kisha lokale është vendi ku besimtarët duhet t'i nënshtrohen autoritetit frymëror

Banorët e skemave të strehimit në Skoci kanë një problem me autoritetin. Të gjitha figurat me autoritet shihen me dyshim ose me tallje. E shoh këtë gjë në çdo pore të kulturës së skemës së strehimit në Nidri, duke filluar nga përbuzja që të gjithë ushqejnë ndaj policisë, e duke mbaruar me sjelljen e lojtarëve në ekipin tonë të futbollit. Çdo javë ne punojmë me të rinjtë, duke i trajnuar ata për të luajtur futboll.² Fakti është që ata nuk i pranojnë kurrë kritikën ose vërejtjet që i bëhen prej dikujt që e konsiderojnë si figurë me autoritet.

Kur këta njerëz vijnë te Krishti, ky qëndrim i tyre duhet luftuar menjëherë. Perëndia i nxit të krishterët që t'u nënshtrohen drejtuesve frymërorë dhe vendi më i mirë dhe më i sigurt që ata ta bëjnë këtë, është një trup lokal, funksional, besimtarësh. Autori i Letrës drejtuar Hebrenjve e bën të qartë këtë: “Dëgjoni udhëheqësit tuaj dhe bindjuni, sepse ata rrinë syhapur mbi shpirtrat tuaj, si ata që duhet të japin llogari; që ta bëjnë këtë me gëzim dhe jo me psherëtima, sepse kjo nuk do t'ju sillte dobi” (Hebrenjve 13:17).

Pleqtë janë thirrur nga Perëndia për të mbikëqyrur asamblenë e besimtarëve: “Kini kujdes, pra, për veten tuaj dhe për gjithë tufën, në të cilën Fryma e Shenjtë ju ka vënë juve mbikëqyrës të kullotni kishën e Perëndisë, të cilën Ai e ka fituar me gjakun e Vet” (Veprat e Apostujve 20:28). Për pasojë të gjithë besimtarët duhet të jenë anëtarë të kishës lokale dhe nën përkujdesjen dhe mbikëqyrjen e pleqve. Thënë shkurt, besimtarët që nuk bëjnë

² Shënimi i Majkut: fatkeqësisht, Mezi nuk e ka fjalën për futbollin e vërtetë, i cili është ai amerikan, por për topkëmbën.

pjesë në një kishë lokale, nuk po i binden Perëndisë. Faktikisht, ata po mëkatojnë kundër Tij. Xhonatan Limen (Jonathan Leeman) e shpreh kështu këtë koncept: “Të krishterët nuk i bashkohen kishës. Ata thjesht i nënshtrohen asaj.”³

Një kulturë që përçmon çdo lloj autoriteti, lipset të shohë modele të shëndosha udhëheqjeje dhe nënshttrimi. Vendi më i mirë për t’u parë ky model nga njerëzit është kisha lokale.

5. Kisha lokale është vendi më i mirë për llogaridhënie frymërore

Shumë vite më parë kalova ca kohë me një punëtor të një organizate parakishtarë. Ai njihej si një person me shumë karizëm. Organizata e tij ishte krenare për të. Ai bënte punë të mrekullueshme me fëmijët që vinin nga një jetë e vështirë dhe me probleme. Ata mblidheshin si qengja përreth tij dhe fotoja e tij gjendej në fletëpalosjet reklamuese shumëngjyrëshe të organizatës.

Mirëpo, po ta njihje nga afër, do të zbuloje se ai qe për të qarë hallin. Ai më rrëfeu se kishte vite që nuk e lexonte Biblën. Ai vuante nga varësia e shikimit të videove pornografike në internet. Ai shkonte shpesh për të pirë pije alkoolike me shokët e tij jo të krishterë. Mirëpo, për sa kohë që ai e bënte punën e vet dhe i plotësonte orët e klubeve për fëmijë, duke siguruar edhe mundësi të mira fotografish për donatorët, organizata e tij qe e kënaqur me të dhe nuk i thoshte asgjë. Të gjithë qenë të zënë me punë dhe nuk kishin kohë për një shqyrtim më të thellë veçse për takimet mujore të ekipit dhe vlerësimin vjetor të arritjeve në punë.

Për shkak se ky njeri nuk jepte llogari askund në mënyrë serioze, ai qe prishur frymërisht përgjatë viteve. Ai nuk bënte pjesë në asnjë kishë lokale; madje kur qëllonte që shkonte në kishë, asnjëherë nuk shkonte në të njëjtën kishë dy javë rresht.

³ *Church Membership* (Wheaton, IL: Crossway, 2012), 30.

Kjo mënyrë frekuentimi e kishave mjaftonte për t'i kënaqur drejtuesit e organizatës së tij, por edhe i jepte atij mundësinë për të qenë një frekuentues i paemër i kishave.

A është vallë ky person një shembull shumë ekstrem? Mbase është kështu. Mirëpo, druhem se pak a shumë kështu veprojnë edhe shumë të tjerë që punojnë për organizata parakishtarë. Unë kam takuar dhe këshilluar shumë të tjerë që gjendeshin në situata të ngjashme, që të gënjehem aq sa të mendoj se ky është një rast i izoluar.

Të gjithë të krishterët kanë nevojë për llogaridhënien dhe disiplinën frymërore që sjell për pasojë anëtarësia në kishën lokale. Nuk na lë që të prishemi. Na ofron strukturën e nevojshme për inkurajim dhe qortim. Na siguron një komunitet ku e nxisim njëri-tjetrin drejt dashurisë dhe veprave të mira. Disa njerëz pretendojnë se shërbesa parakishtarë ku punojnë apo rrethi i miqve të tyre është komuniteti, për të cilin kanë nevojë. Mirëpo, llogaridhënia nuk është një bisedë miqësore me shokët tanë, përkundrazi, është nënshtrimi plot përulje ndaj drejtuesve dhe anëtarëve të tjerë të kishës ku bëjmë pjesë.

6. Kisha lokale është vendi ku administrohet disiplina në një mënyrë biblike

Nuk ka kuptim që të ankohe mi për sa i përket mungesës së disiplinës në organizatat parakishtarë. Kjo nuk është detyra e tyre. Detyra e disiplinimit të besimtarëve haptazi të mëkatshëm apo të pabindur i përket kishës lokale (Mateu 18:15–17; 1 e Korintasve 5:1–13; 2 e Thesalonikasve 3:6; Titi 3:10).

Le të marrim për shembull rastin e Rabbit. Pasi u shpëtua prej një stili jetese si pijanec, ai iu bashkua kishës sonë, u pagëzua dhe po shënonte përparime të mëdha derisa një ditë mori kot dhe shkoi e u deh. Pastaj vendosi që të frekuentonte një kishë tjetër, e cila nuk do t'i kërkonte llogari atij. E morëm në telefon. Folëm me prindërit e tij. U lutëm për të.

Si përfundim, kur pamë se asgjë nuk po funksiononte vendosëm ta përfshinim në listën e përkujdesjes së shtuar. Kjo do të thotë që thirrëm takimin e anëtarësisë dhe i treguam bashkësisë për rastin e tij. Në atë takim i njoftuam anëtarët që kishin një muaj kohë që t'i shkruanin, t'i nisinin e-mail-e apo t'i telefononin Rabit për ta inkurajuar që të kthehej te Zoti dhe në kishë. Ky proces nuk funksionon përherë, por në rastin e Rabit funksionoi. Brenda një jave ai u pendua për mëkatet e tij dhe u kthye në kishë. Nuk e keni idenë se çfarë dëshmie qe kjo për kishën dhe për komunitetin përreth!

Në qoftë se e lexoni Biblën, do ta gjeni kishën pothuaj në çdo faqe të saj, por nuk do t'i gjeni askund organizatat parakishtare. Dua ta bëj të qartë se unë dhe Majku mendojmë se shumë shërbesa parakishtare janë fantastike. Ne thjesht u kundërvihemi shërbesave parakishtare që konkurrojnë me kishën lokale ose e zëvendësojnë atë, pavarësisht nëse e bëjnë këtë qëllimisht ose jo. Përkundrazi, ato duhet ta shohin rolin e tyre të lidhur me fuqizimin dhe përhapjen e ungjillit *përmes* bashkësive të besimtarëve që gjenden në komunitetin ku ato shërbejnë.

Vepra e ungjillëzimit

Skemat e strehimit të Skocisë e kanë punën pisk. Bazuar në bisedat e mia (Mezit) me vëllezërit në Shtetet e Bashkuara do të thosha të njëjtën gjë për parqet e kamperave dhe për lagjet e varfra pranë qendrave të qyteteve në Amerikë. Kishat në këto zona janë në rënie dhe kanë qenë në këtë situatë për një varg dekadash. Mirëpo, këto zona janë plot e për plot me shërbesa të krishtera: kuzhina sociale, klube mëngjesi dhe shumë shërbesa për të rinj, por shumë pak punë ungjillëzuese që të jetë e lidhur me një kishë të shëndoshë lokale.

Në Skoci, pesëdhjetë vjet më parë sallat e misionit lulëzonin në skemat e strehimit nëpër qytetet më të mëdha të vendit. Kishat e qendrës së qytetit shpesh i shihnin sallat e misionit si një vend të mirë për predikuesit e rinj që të ushtronin thirrjen e tyre. Fatkeqësisht, këto kisha nuk i nxitën të rinjtë që të qëndronin në ato vende dhe të themelonin atje kisha lokale. Kështu që, njerëzit u kthyen në besim falë predikimit të tyre, por këta të kthyer në besim nuk u mblodhën nëpër kisha lokale. Përkundrazi, të kthyerit në besim ia mbathën larg skemave me t'iu dhënë mundësia më e parë.

Për pasojë, situata e ungjillit në këto vende sot paraqitet shumë problematike. Predikuesit e ungjillit të begatisë, organizatat parakishtare të keqpajisura dhe agjencitë sociale qeveritare përpiqen ta mbushin këtë boshllëk. Kishat e mbetura, të cilat janë përpjekur për pastërti doktrimore në kurriz të angazhimit në komunitet, tashmë e gjejnë veten në skajet e shoqërisë, duke pasur bashkësi besimtarësh të mplakur, të cilat po vdesin pak nga pak. Ata e kanë ungjillin, por nuk kanë se kujt t'ia predikojnë atë. Ndërkaq, kishat që i janë përshtatur kulturës dhe që angazhohen në komunitet në kurriz të të vërtetave biblike, kanë prirje që të jenë të ndjeshme ndaj mjedisit përreth, por është ironik fakti që edhe ato kanë një anëtarësi të mplakur dhe janë në vdekje e sipër. Të gjithë i shohin ato si asgjë më tepër sesa qendra sociale.

Ja se si duken gjërat në praktikë:

- Xhimi e ka frekuentuar sallën e vogël të misionit që gjendet në skemën e tij të strehimit për plot pesëdhjetë vjet. Ai i kujton me mall ditët kur ajo mbushej plot e për plot me njerëz dhe kur shërbesat e fëmijëve i ndiqnin qindra të tillë. Tashmë kanë mbetur vetëm gjashtë veta që e frekuentojnë atë, gjithë të tjerët ose kanë vdekur ose janë larguar nga skema e strehimit. Dikur kisha trokiste nëpër dyer për të shpërndarë trakte ungjillëzuese, si dhe fronte predikues nga kisha të tjera. Mirëpo, ato ditë tashmë i përkasin së kaluarës.
- Ana frekuenton kishën e famullisë lokale. Aty nuk predikohet ungjilli dhe vijnë shumë pak njerëz të dielave, mirëpo asaj i pëlqen kisha, ndërsa homilitë (predikimet e shkurttra) çdo të diel përbëjnë një moment të mirë relaksi në fundjavë. Asaj kurrë nuk i ka vajtur mendja që t'i ftojë në kishë fqinjët e saj indianë, sepse vikari i famullisë i ka thënë asaj se jemi që të gjithë fëmijë të Perëndisë, megjithëse mund ta adhurojmë Atë në mënyra të ndryshme.

- Geri është në fund të të njëzetave dhe ka një dëshirë të madhe për t'i arritur të humburit. Ai punon për një organizatë humanitare të krishterë si një specialist çështjesh për disa prej klientëve të tyre. Geri njih shumë banorë të skemës së strehimit përmes klientëve të tij dhe disa prej tyre e dinë se ai është i krishterë, por asnjë prej tyre nuk e kupton se çfarë do të thotë kjo. Geri lejohet që ta ndajë besimin e tij në qoftë se e pyesin njerëzit, por jo që të bëjë prozelitë. Është më e lehtë kur e mbajmë që të gjithë gojën mbyllur. Tekefundit, ai është një dëshmitar i mirë thjesht duke qenë i pranishëm në jetën e klientëve të organizatës, apo jo?

Çfarë do të ndodhte nëse do t'i vendosnim të tre këta njerëz në një dhomë? Xhimi mund ta gjykonte Anën për faktin se kisha e tyre nuk shqetësohet aspak për destinacionin e përjetshëm të njerëzve. Nga ana e saj, Ana do ta shihte Xhimin me përbuzje. Si mund të vazhdosh të besosh në ditët e sotme në ferrin e zjarrtë dhe plot squfur? Geri me shumë gjasa do t'i shihte nga lart poshtë që të dy, duke menduar gjithë kohës se përse të dy ata nuk ia dalin që të merren vesh me njëri-tjetrin. Mirëpo, realiteti i trishtueshëm i fakteve është që të tre ata kanë rënë në një vorbull që i tërheq poshtë e më poshtë. Si mund të përhapet ungjilli, në qoftë se kishat e kanë humbur atë? Si mund të lulëzojë krishterimi, kur të bërit mirë i ka zënë vendin së vërtetës së ungjillit? Krishterimi është në rënie si pasojë e të tria qëndrimeve të mësipërme. Duhet ta rimendojmë metodën tonë të ungjillëzimit.

Përkufizimi i ungjillëzimit biblik

Duhet thënë se vërehet një interes tej mase i shtuar mes ungjillorëve për t'u angazhuar në shërbesa mëshire. Fatkeqësisht, shumica prej tyre frymëzohen prej një teologjie të pamenduar

mirë. Ndodh shpesh që t'i dëgjosh njerëzit që të thonë fjalitë e mëposhtme në lidhje me ungjillëzimin:

- Predikojë ungjillin në çdo kohë, po qe e nevojshme përdor edhe fjalë.
- Ungjillëzimi ka të bëjë me veprat që kryejmë, po aq sa edhe me fjalët që themi.
- Në fokus të kishës sonë është dashuria për njerëzit dhe jo rekrutimi i tyre.
- Njerëzit duhet ta përjetojnë dashurinë e Perëndisë dhe jo të dëgjojnë për zemërimin e Tij.
- Në një dorë Biblën dhe në tjetrën bukën.

Mirëpo, a e pasqyrojnë vallë këto fjali qëndrimin e duhur që duhet mbajtur ndaj detyrës së ungjillëzimit? Në qoftë se dëshirojmë që njerëzit të shpëtohen nga ungjilli i Jezu Krishtit duhet ta kuptojmë si duhet veprën e ungjillëzimit. Mak Stajlsi, në librin e tij të shkëlqyer *Ungjillëzimi: Si flet e gjithë kisha për Jezusin*, e përkufizon ungjillëzimin si *të mësuarit e ungjillit të tjerëve me qëllimin për t'i bindur*.¹ Sipas këtij përkufizimi të thjeshtë, ungjillëzimi biblik ka të bëjë me mësimdhënien dhe bindjen e të tjerëve.

1. Ungjillëzimi ka të bëjë me të mësuarit e njerëzve

Kur e dëgjova për herë të parë ungjillin e Jezu Krishtit, nuk kishte asgjë mbresëlënëse në paraqitjen e tij. Nuk kishte makineri tymprodhuese, muzikë në sfond, apo thirrje për të bërë lutjen e shpëtimit, unë thjesht dëgjova urdhërimin për t'u penduar në një sallë misioni të ftohtë në jug të Anglisë. Dëshmitarë besnikë ma mësuan lajmin e mirë, burra dhe gra që e hapën Biblën bashkë me mua dhe ma shpjeguan atë fill e për pe.

Ungjilli është një mesazh me një përmbajtje objektive dhe njerëzit duhet ta kuptojnë atë përmbajtje, në qoftë se do të vijnë

¹ (Wheaton, IL: Crossway, 2014), 26.

për shpëtim të Krishti. Njerëzit që nuk e kanë ungjillin, kanë nevojë për dikë që t'u mësojë të vërtetën, ndërsa njerëzit që kanë ungjillin e rremë, kanë nevojë për dikë që t'i ndreqë dhe t'i shpëtojë prej besimeve të tyre false. Në thelb, të ungjillëzosh do të thotë t'u mësosh njerëzve të vërtetën rreth gjendjes së tyre të rrezikshme frymërore pa Jezusin dhe pastaj t'u japësh lajmin e mirë se ka një mënyrë se si t'i shpëtosh këtij rreziku. Pavarësisht nga gjërat e tjera që mund të bëjmë në vendet e vështira, synimi ynë parësor është që t'u mësojmë burrave, grave dhe fëmijëve mesazhin e Biblës.

Nuk ekzistojnë as rrugë të shkurtra për ta mësuar ungjillin edhe as zëvendësues të tij. Njerëzit si puna e Xhimit duhet ta dinë se ungjillëzimi biblik nuk është thjesht të shpërndash broshura dhe pastaj të vazhdosh rrugën. Duhet të bësh diçka më tepër, sesa ta ftosh tjetrin të shërbesa e së dielës. Ana duhet ta kuptojë se ungjillëzimi shkon përtej sjelljes së mirë dhe të qenët pjesë e komiteteve të ndihmës. Shkrimi i shenjtë duhet hapur dhe duhet shpjeguar. Geri duhet ta dijë se të varfrit kanë nevojë më tepër për mësuës Bible sesa për këshillim financiar. Shërbesa më popullore dhe më e efektshme që kemi në Nidri, është “Studiimi serioz i të mërkurës mbrëma”. Ulemi së bashku për një dy orë dhe punojmë mbi Biblën duke e shqyrtuar atë varg për varg.

2. Ungjillëzimi ka të bëjë me të bindurit e njerëzve

Te Veprat e Apostujve 17:2–4 lexojmë:

Dhe Pali, sipas zakonit të tij, hyri tek ata dhe tri shabate me radhë fliste me ta prej Shkrimeve, duke u hapur atyre dhe duke u treguar se Krishti duhej të vuante dhe të ringjallet prej së vdekurish dhe duke thënë: “Ky Jezusi që unë ju shpall është Krishti”. Disa nga ata u bindën dhe u bashkuan me Palin dhe Silën, si dhe një numër i madh grekësh të perëndishëm dhe jo pak gra nga shtresa e lartë.

Kthimi në besim është vepra e Frymës së Perëndisë nga fillimi deri në fund, por prapëseprapë duhet të punojmë që të bindim njerëzit. Në të mësuarin tonë duhet të jemi gati që t'i japim përgjigje gjithkujt që na pyet (1 e Pjetrit 3:15). Përpiqja ime e parë për të bindur dikë ndodhi në një varrezë, nja dy javë pasi qeshë kthyer në besim. Po përpiqesha të bindja shoqen time se jeta është e shkurtër dhe duhet bërë shumë kujdes për frymën tonë. Unë nuk dija edhe aq shumë rreth besimit, përveç faktit që Jezusi kishte vdekur në kryq. Po ashtu nuk kisha argumente teologjike të mençura apo teza apologjetike mendjempërhta. Dija vetëm që Krishti ishte i vërtetë dhe se diçka brenda meje kishte ndryshuar një herë e përgjithmonë. Kështu që, i shtyrë nga pezmatimi për paaftësinë time, e mora shoqen time me vete te një varrezë, e çova te varri më i afërt dhe i thashë se nëse nuk pendohej për mëkatet e saj, ajo do të vdiste, do ta varrosnin dhe do të harrohej, ndërkohë që do të digjej në ferr për gjithë përjetësinë. Ajo ra në gjunjë e përlotur dhe u lutëm bashkë.

Me shumë kënaqësi po ju them se jam penduar edhe nuk e përdor më këtë metodë për bindjen e dikujt. Duam t'i bindim njerëzit dhe jo t'i manipulojmë ata me anë të frikës apo të premtimeve për gjëra të mira. Sidoqoftë, nxitja e frikës gjatë ungjillëzimit nëpër skema dështon në çdo rast. Jetët e njerëzve janë të zhytura në mjerim, kështu që asgjë nuk i tmerron ata. Mirëpo, malli që shitet më lehtë, është të ofruarit e shpresës për një të ardhme më të mirë, sepse këtë duan njerëzit; ja pse predikuesit e ungjillit të begatisë kanë gjithnjë sukses në to.

Përkundrazi, ne dëshirojmë t'i bindim njerëzit duke u shpallur haptazi të vërtetën (2 e Korintasve 4:2) që konfirmohet prej një jete tërheqëse. Duhet të jetojmë në një mënyrë të tillë që njerëzit të detyrohen të na pyesin për besimin tonë. Ne nuk i shndërrojmë dot mëkatarët; ne vetëm mund t'i mësojmë ata dhe t'i bindim për të vërtetën e ungjillit siç është zbuluar në

Bibël. Gjithçka tjetër varet nga lutja dhe hiri sovran dhe zgjedhës i Frymës së Shenjtë të Perëndisë.

Ungjillëzimi ngrihet mbi themelin e zgjedhjes

Ungjillëzimi është karburanti që vë në lëvizje kishën e krishterë, sepse nxit rritjen e kishës dhe mban ndezur dashurinë për Perëndinë. Mirëpo, disa thonë se doktrina është si ai zjarrfikësi që e shuan zjarrin me pompë uji. Përmendja e doktrinës në një bisedë rreth ungjillëzimit është njëllor sikur të ftosh një zjarrfikës pasi ke ndezur një zjarr të madh. Ka për ta bllokuar fare bisedën!

Mirëpo, në realitet mënyra se si ungjillëzojmë përherë pasqyrojnë angazhimet tona doktrino-re. Nuk mund t'i ndajmë metodat ungjillëzuese nga gjërat që besojmë rreth Perëndisë dhe shpëtimit. Në qoftë se besoj se mëkatarët e zgjedhin lirisht Perëndinë, atëherë do të përpiqem t'i bind njerëzit në përputhje me këtë. Edhe në qoftë se besoj se të gjithë shkojnë në qiell, pavarësisht se çfarë besojnë, sërish ky supozim do të ndikojë në mënyrën se si do t'i qasem (apo nuk do t'i qasem) njerëzve.

Meqenëse gjithë ungjillëzimi ngrihet mbi themele doktrino-re, duhet ta themelojmë atë në të kuptuarin e Biblës të zgjedhjes sovra-ne të mëkatarëve për shpëtim. Xhon Pajper (John Piper) e përkufizon si më poshtë zgjedhjen e pakushtëzuar: “Zgjedhja e pakushtëzuar është zgjedhja e lirë e Perëndisë përpara krijimit, duke mos qenë e bazuar në besimin e parashikueshëm, se cilëve tradhtarë do t'iu jepte besim dhe pendim, duke i falur ata, si dhe duke i birësuar në familjen e Tij të përjetshme të gëzimit.”²

Perëndia ka zgjedhur dhe po thërret një popull për vete nga çdo vend mbi tokë. Të pasurit dhe të varfrit do të shpëtohen përmes Jezu Krishtit dhe do të mbahen të sigurt përjetësisht në familjen e Tij. Në vend që ta shuajë ungjillëzimin, kjo doktrinë

2 “Pesë arsye për të përqafuar zgjedhjen e pakushtëzuar”, [desiringGod.org](http://www.desiringgod.org/articles/five-reasons-to-embrace-unconditional-election/), 9 korrik 2013, <http://www.desiringgod.org/articles/five-reasons-to-embrace-unconditional-election/>.

jo vetëm që e ndez edhe më fort zjarrin e ungjillëzimit, por e mban atë ndezur në vazhdimësi.

E vetmja mënyrë se si bandat e rrugëve të Brazilit apo imigrantët e paligjshëm të Virxhinias Veriore do të ungjillëzohen, është përmes predikimit të ungjillit të Jezusit. Nuk ekziston asnjë metodë njerëzore se si mund t'i bindim njerëzit që ta ndjekin Jezusin, vetëm Perëndia mund ta bëjë atë punë. Në qoftë se Perëndia nuk i shpëton mëkatarët në mënyrë sovrane, të gjithë këta njerëz do të përfundojnë në ferr. Është një ngushëllim i madh ta dimë se Fryma e Shenjtë do ta bëjë punën e Tij, duke u zbuluar të vërtetën mëkatarëve të humbur, duke i tërhequr ata në një marrëdhënie me Perëndinë Atë, si dhe duke i mbajtur ata të sigurt për jetë e mot. Kjo e vërtetë e bukur trinitariane është i gjithë karburanti që na nevojitet për ta mbajtur ndezur zjarrin e predikimit ungjillëzues.

Po ju them ndershëmrisht se nuk do të kisha ngulmuar kurrë në këtë lloj pune po të mos besoja se Perëndia *do* t'i shpëtojë njerëzit. Dikur predikoja në një burg të rinjsh në skaj të xhunglës së Amazonës. Ishte një vend vërtet i urryer. Nxehtësia, era e ndyrë dhe zhurmat ishin mbytëse, ndërsa fëmijët dhe të miturit që gjendeshin atje, ishin vrasës të thekur. Po ju them ndershëmrisht se askush nuk ia fali jetën e vet Jezu Krishtit me gjithë vizitat e mia në atë vend. Nuk pati asnjë që të shpallte besimin në Jezu Krishtin. Ishte një situatë shumë ligështuese edhe dëshpëruese, por jo çdo gjë shkoi kot. Më inkurajonin fjalët e Palit:

Sepse, ata që Ai i ka njohur që më parë, edhe i ka paracaktuar që të jenë njësoj me shëmbëllimin e Birit të Tij, kështu që Ai të jetë i parëlinduri në mes të shumë vëllezërve. Por ata që i paracaktoi, ata Ai edhe i thirri; dhe ata që i thirri, ata edhe i drejtësoi; dhe ata që i drejtësoi, ata Ai edhe i përlëvdoi. Çfarë të themi, pra, për këto? Në qoftë se Perëndia është me ne, kush mund të jetë kundër nesh? (Romakëve 8:29–31)

Fakti që unë nuk pashë ndonjë rezultat të punës sime në burg, nuk do të thotë se nuk pati të tilla. Është një ngushëllim i vërtetë kur e di se Perëndia po i realizon planet e Tij të mrekullueshme dhe se ne lejohe mi të luajmë një rol në planin e Tij të madh e kozmik. Unë nuk e di se kush janë të zgjedhurit e Tij, nuk më takon mua që ta di këtë. Mua më takon që të predikoj me besnikëri dhe të ngulmoj deri në fund. Është Ai që punon në burgjet e fëmijëve të Amazonës dhe në sallat e kishave të Edinburgut. Është Ai që punon në parqet e kamperave të Amerikës dhe në lagjet e varfra të Indisë. Ai ka thirrur, ka drejtësuar dhe ka përlëvduar. Ne ngulmojmë në njohurinë se për shkak se Zoti është sovran, munda ynë nuk shkon kot.

Ungjillëzimi duhet të ndodhë në kontekstin e kishës

Sot në një numër komunitetesh ungjillore flitet shumë për “të jetuarin me një mendësi misioni”. Në qoftë se ky term nënkupton të jetosh me synimin për ta përhapur ungjillin në jetën e përditshme, atëherë unë jam plotësisht në favor të tij. Një stil i tillë jetese do të ndihmojë për të hapur shtigje të reja në skemat tona të strehimit pranë qendrës së qytetit. Do t’i tregojë botës se çfarë është një *stil jetese ungjillëzues*.

Të jetuarit me një mendësi misioni paraqitet si një alternativë e shkëlqyer ndaj qasjes së “modelit tërheqës” në ungjillëzim, e cila ka dominuar mjediset ungjillore gjatë dekadave të fundit. Në vend që ta fshëhim ungjillin pas sigurisë së ndërtesave tona, na ofrohet mundësia që t’u shërbejmë komuniteteve tona në një sërë mënyrash, sikurse mund të përmendim përmes organizatave vullnetare lokale, apo nëpër shkolla, apo në zyrën ku punojmë. Sa herë që një qendër shërbimesh komunitare mbyllet në Nidri, kisha jonë përpiqet që të gjejë mënyrën e duhur se si ta mbushë boshllëkun që u krijua, për të ndërtuar marrëdhënie me në qendër ungjillin.

Sipas mendimit tim, “të jetuarit me një mendësi misioni” nuk ka të bëjë thjesht me zhvendosjen në një lagje të varfër. Nuk ka të bëjë thjesht me gjetjen e një strehe të pastrehësh apo të një qendre rehabilitimi nga drogat për ata që kanë nevojë për to. Përkundrazi, ka të bëjë me përfshirjen personale në marrëdhënie të trazuara. Ka të bëjë me dhënien e ndihmës për probleme të lidhura me kujdesin për fëmijët apo me kriza martesore, apo me ndihmën që i duhet dhënë një të sapokthyeri në besim që të ballafaqohet me pasojat e mëkateve të së kaluarës, si për shembull rrëfimi i krimeve që mund të ketë kryer. Lajmi i mirë është që nuk ju duhet të dini gjithçka për jetën në një skemë strehimi apo kompleks banesash sociale, sepse njerëzit që i kanë për zemër të tjerët, mund t’i ndihmojnë ata. Njerëzit që janë gati të sakrifikojnë gjithçka për Jezusin, janë pikërisht njerëzit që sjellin ndryshimin më të madh. Unë jam i bindur se të jetuarit e ungjillit me mirëfilltësi në përditshmëri përherë sjell krijimin e mundësive për ta ndarë ungjillin. Atëherë kur ungjilli i Krishtit të shpallet qartësisht, Fryma e Shenjtë do t’i sjellë njerëzit në shpëtim.

Mjedisi më i mirë për këtë lloj ungjillëzimi është në jetën e një kishe lokale të shëndetshme, e cila ka ungjillin në qendër. Kisha i pajis besimtarët, duke u siguruar që ata ta kuptojnë ungjillin dhe të kenë motive biblike. Kisha është vendi ku besimtarët luten për përhapjen e ungjillit dhe ku ata pranojnë, pagëzojnë dhe dishepullojnë besimtarë të rinj.

Historikisht, skemat e Skocisë qenë të mbushura me salla misioni, të cilat shërbenin si stacione ungjillëzimi. Kishat dërgonin vullnetarë që të ndihmonin nëpër klubet që zhvilloheshin aty, apo që të predikonin herë pas here, por këtyre sallave u mungonte një eklesiologji e qartë. Ato drejtoheshin prej komiteteve në vend të pleqve dhe nuk kishin procedura anëtarësimi apo disipline. Ungjillëzimi ishte një veprimtari në të cilën ti ftoje fqinjët e tu pasi trokisje nëpër dyert e tyre: ejani dhe dëgjoni folësin e ftuar!

Beteja që patëm në ditët e para që morëm përsipër Kishën Komunitare të Nidrit, që që t'i ndihmonim njerëzit ta shihnin ungjillëzimin si një mënyrë të natyrshme jetese dhe si një varg bisedash të përditshme. Fillimisht disa anëtarëve të kishës kjo gjë nuk i pëlqeu. Kur reshtëm së shpërndari broshura, së trokituri nëpër dyer dhe së kënduari këngë krishtlindjesh nëpër rrugë, disa prej tyre që ishin kritikët më të zëshëm, më akuzuan se po vrisja ungjillëzimin. Mirëpo, kur i nxita të njëjtët besimtarë që të hynin në kontakt me banorët vendas, të zbulonin se çfarë pyetjesh po bënin këta të fundit, të përfshiheshin në jetën e këtyre të fundit, si dhe ta ndanin besimin e tyre me ta në mënyrë të natyrshme, këta më trajtuan si të më kishte zënë lebra. Problemi është se për ungjillëzimin dhe dishepullimin lipset shumë kohë dhe përpjekje, shumë më tepër sesa shumica e besimtarëve janë të gatshëm që të shpenzojnë për këtë qëllim. Po ashtu, lipset që t'i duam njerëzit me durim, duke e përsëritur të njëjtin material studimi sa e sa herë.

Ungjillëzimi duhet të ndodhë në kuadër të jetës së përditshme

Në Nidri kemi parë që shumica e ungjillëzimit dhe dishepullimit zhvillohet teksa e çojmë dikë me makinë deri në shtëpi, në supermarket apo në zyrën postare. Ndodh edhe gjatë një daljeje dhjetëminutëshe jashtë kafenesë për të pirë një cigare. Ndodh edhe në palestër. Pra, bëhet fjalë për një gjë që shkon përtej mbajtjes së një veprimtarie apo dhënies së një broshure; përkundrazi, kërkon që të hysh në marrëdhënie reale me njerëzit dhe të përfshihesh në rrëmujën e jetëve të tyre.

Mirëpo, sa për qind e krishterimit perëndimor funksionon në mënyrë të tillë? Sa njerëz nëpër kishat tona kanë kohë madje që të mbajnë marrëdhënie të gjalla me njerëz që nuk janë pjesë e agjendës të mbingarkuar të ditës së tyre normale? Kohët e fundit mora pjesë në një takim në vendin tim (Skoci), ku më

pyetën përse kishat nuk bëhen më aktive nëpër skemat e strehimit. Përgjigjja ime ishte që kishte një sërë arsyesh për këtë, një prej të cilave mbase ishte frika. Një person reagoi me nervozizëm ndaj përgjigjes sime. “Unë nuk kam pikë frike”, e ngriti ai zërin. “Unë punoj tetëdhjetë orë në javë. Jam shumë i zënë me punë!” Fatkeqësisht, ai dukej shumë krenar për përgjigjen e tij.

Ungjillëzimi nuk fillon me kryerjen e disa veprimeve të caktuara, por përkundrazi fillon me atë se kush jemi dhe si e jetojmë jetën. Ka të bëjë me shfrytëzimin e rasteve për t’i mësuar dhe bindur njerëzit për të vërtetat e ungjillit në mes të rrjedhës të përditshmërisë dhe punëve të rëndomta të saj. Në vend që të presim që njerëzit të hyjnë në komunitetin e krishterë, ne duhet të dalim jashtë dhe të angazhohemi në zonën përreth. Politika në kishën tonë ka qenë që të mos fillojmë të ofrojmë diçka, e cila ofrohet tashmë në komunitetin tonë. Ka më shumë kuptim që të krishterët t’i bashkëngjiten grupeve ekzistuese për të dëshmuar në to, sesa të presin që jobesimtarët të vijnë në grupet tona. Kemi vërejtur se më shumë njerëz kanë ardhur në besim në saje të kësaj qasjeje sesa përmes organizimit të veprimtarive tona.

Përdorini veprimtaritë për miqësi dhe jo thjesht për ungjillëzim

Kjo nuk do të thotë se ne nuk zhvillojmë veprimtari për të tërhequr njerëz. Kisha jonë lokale në Nidri organizon ngjarje sociale, të cilat frekuentohen prej dhjetëra qindra njerëzve. Ne zhvillojmë konkurse këndimi, mbrëmje bingoje, si dhe konkurse me çmime, por kurrë nuk i përdorim ato për të predikuar. Përkundrazi, i përdorim ato për të forcuar miqësitë dhe për t’u siguruar që ndërtesa jonë të shihet si një burim për komunitetin, si dhe si shtëpi adhurimi. Dëshirojmë që njerëzit të ndihen si në shtëpi mes nesh dhe të mos u duket se po i rrëmbejmë sa herë që vijnë në ndërtesën e kishës. Ne organizojmë dy veprimtari në

vit, të cilat kanë për synim ungjillëzimin e njerëzve: Mbrëmjen e Konkursit dhe Kerrit për Krishtlindje dhe Piknikun e Pashkës (i cili është një mëngjes i plotë britanik, i shoqëruar me një paraqitje të shkurtër të ungjillit). Të dyja këto veprimtari ndiqen gjerësisht dhe pjesëmarrësit në to janë kryesisht shokët që kemi zënë nëpër aktivitetet e tjera dhe gjatë jetës sonë të përditshme. Ungjillëzimi biblik mund të zhvillohet në mënyrë formale dhe joformale. Nuk është e nevojshme që këto forma ungjillëzimi të vendosen njëra kundër tjetrës.

Luani lojën afatgjatë

Thelbi i kësaj që po them, është se shërbesa ungjillëzuese nëpër skema është proces i ngadaltë dhe afatgjatë. Le të marrim për shembull rastin e Xhekut, i cili kishte qenë përdorues dhe shpërndarës droge për më se dy dekada. Ai e tradhtonte partneren e vet, me të cilën qe i lidhur që herët (për pasojë edhe tre fëmijët që kishte me të), si dhe kishte një nam të keq në skemën tonë. Ai kishte rënë në kontakt me kishën për shkak të të vëllait. Xheku ishte i zhurmshëm, agresiv dhe i kundërvihë gjithçkaje që kishte të bënte me Perëndinë dhe Biblën. Ai vinte në shërbesën e së dielës i droguar, duke bërëtitur dhe duke vënë në dyshim gjithçka që thuhej nga katedra e predikimit. Ai nuk dëgjonte askënd dhe prishte pothuajse çdo takim ku merrte pjesë. Xheku ishte për të qarë hallin, jetonte një jetë të ndërtuar mbi gënjeshtër, si dhe e mohonte katërçipërisht gjendjen e keqe të jetës së tij.

Hapëm Biblën me të dhe i mësuam ungjillin. Iu përgjigjëm pyetjeve të tij në lidhje me besimin dhe jetën. U përpoqëm ta bindnim për sa i përket të vërtetës së tmerrshme të gjendjes së tij të rrezikshme përpara një Perëndie të Shenjtë. Disa herë dëgjonte dhe largohej i qortuar. Herë të tjera kthehej dhe na kërcënonte. Mirëpo, ne ngulmuam deri në fund në lidhje me të. U lutëm për të dhe për familjen e tij. Patëm shumë takime me të

dhe dëgjua historitë e tij të trishtuara. Qemë të ndershëm me të dhe i thamë të vërtetën në lidhje me jetën e tij, sa herë që na jepej rasti. Ai takohej me mua pothuajse përditë, por ai takohej edhe me të krishterë të tjerë me më shumë përvojë se ai, të cilët kalonin kohë me të ditë për ditë. Xheku shkonte në shtëpitë e anëtarëve të kishës për të ngrënë me ta. Ai u përfshi edhe në kafenenë e kishës. Ne e ftuam atë në jetën tonë dhe Perëndia, përmes Frymës së Tij, pak nga pak ia hapi Xhekut sytë për të parë të vërtetën e ungjillit të Jezusit. Një ditë, pasi kishte munguar për muaj të tërë, ai hyri në ndërtesën tonë dhe na tha se donte t'ia dorëzonte jetën Krishtit.

Përkundër skepticizmit fillestar me të cilin reaguam ndaj fjalëve të tij, filluam ta dishepullonim, dhe Xheku nisi të rritej. Ai e shkëmbeu jetën dhe shokët e vjetër me një jetë të re dhe një rreth të ri shokësh. Nuk kaloi shumë kohë dhe partnerja e tij e pa se ai kishte ndryshuar, kështu që erdhi edhe ajo në kishë dhe u shpëtua. Gjashtë muaj pas shpëtimit të tij, ai u pagëzua dhe pastaj u martua me të dashurën e zemrës përpara tre fëmijëve të tyre dhe familjes së tij, të cilët nuk u besonin dot syve për atë që po shihnin. Ka ende shumë rrugë për të bërë, por është e sigurt se ai po ecën në drejtimin e duhur.

Jemi duke vrapuar në një maratonë. Nuk mund të presim nga njerëzit që një muaj pasi u blejmë një biçikletë, ata të fitojnë xhiron çiklistike të Francës – Tour de France. Duhet të jemi të durueshëm edhe të kemi nerva të çelikta me ta. Do të na duhet të përsërisim të njëjtat gjëra sa e sa herë. Vendi më i mirë se ku mund të ndodhë kjo, është një komunitet lokal ngulmues dashuruesish të ungjillit, të cilët i jetojnë jetët e tyre individuale dhe komunitare me synimin për t'u mësuar të tjerëve të vërtetat e Biblës dhe për t'i bindur ata në lidhje me to.

Roli i predikimit

Lejomëni t'ju tregoj për një predikim që unë (Majku) e predikova një të diel paradite në kishën time. Herë pas here ndodh që një predikues e kupton se “ka shënuar gol” nëpërmjet predikimit të tij. Hyrja është tërheqëse, shpjegimi i tekstit është bindës, ilustrimet e përdorura janë vërtet ndriçuese dhe zbatimet e shpërndan peshën e tekstit mbi bashkësinë e besimtarëve. Fryma e Shenjtë sjell një qetësi të thellë mbi bashkësinë e besimtarëve. Çaste të tilla e kthejnë predikimin në një kënaqësi të vërtetë.

Mirëpo, atë të diel predikimi im *nuk* ishte aspak i tillë. Mua, për vete, m'u duk një rrëmujë e madhe. Gjendesha në gjysmën e dytë të një serie nga libri i Jeremisë. Për të qenë i ndershëm me ju, nuk e kisha planifikuar mirë serinë. Pasazhet ishin vërtet të gjata. Temat e tyre po ktheheshin në një refren përsëritës. Po ashtu, druhesha se predikimet nuk po e ndihmonin bashkësinë që ta kuptonte strukturën e librit si duhet. Nga gjysma e këtij predikimi, nisa të përjetoja të kundërtën e dukurisë të “të shënuarit gol”. Njerëzit nuk po rrinin rehat dhe po kolliteshin. Vetëm ata më të përkushtuarit po i mbanin sytë tek unë. Ilustrimet e mia duket se çalonin. Pikat e predikimit ishin të para-

shikueshme dhe nuk zgjonin ndonjë interes te njerëzit. Në vend që të shënoja gol, e ndieja se e kisha gjuajtur topin aq keq, sa që po shkonte drejt tribunës duke kaluar lart mbi portë.

Së fundi dhe për të mirën time, predikimi ngeci në parkim. Kënduam një këngë të fundit, teksa kthehesha në karrigen time me supe të rëna dhe pastaj e mbyllëm shërbesën. Teksa njerëzit kalonin përpara meje për të dalë nga ndërtesa e kishës, e shikoja se me zor po gjenin një fjalë të mirë, që të ishte edhe e vërtetë, për të ma thënë.

Ishte një grua që po qëndronte në fund të turmës edhe që po priste të fliste me mua. Ajo m'u prezantua si një mama e vetme nga Kolumbia. Me sa duket një shoqe e kishte ftuar atë në kishë, pas një nate të kaluar duke pirë e duke kërcyer. Kur e pyeta se çfarë mund të bëja për të, ajo foli me të shpejtë: "Te predikimi ti fole për të ndjekurin e Jezusit. Unë dua ta ndjek Atë. A mund të më tregosh më shumë në lidhje me këtë gjë?"

Mbeta pa fjalë. Po, është e vërtetë se ungjillin e kisha bërë të qartë në predikim (të paktën e bëra një gjë të saktë), por që prezantuar brenda një predikimi që nuk që aspak bindës. Mirëpo, ja ku kisha përpara një grua të bindur për mëkatën e saj dhe për nevojën e saj për Jezusin!

Pa dyshim, nuk dua që ta bëj rrugë të predikuarin e predikimeve të mërzitshme dhe të keqhartuara. Mirëpo, kjo ndodhi më kujtoi fuqinë e madhe të predikimit të përjavshëm të kishës. Kështu që, tek mendojmë për mënyrat se si një kishë mund t'i arrijë lagjet e varfra me ungjillin, duhet ta kemi parasysh se të gjitha strategjitë dhe planet tona nuk e zëvendësojnë dot predikimin besnik të Biblës. Faktikisht, kjo është ajo gjëja më e rëndësishme që ne bëjmë.

Prediko Biblën

Puna e kishës në vende të varfra mund të jetë sfiduese. Siç kemi thënë përgjatë gjithë librit, sfidat e kësaj lloji shërbese janë të

panumërta dhe progresi në të është shpesh i ngadaltë. Megjithëse strategjitë dhe metodat për t'i arritur këto komunitete në dukjen e tyre mund të ndryshojnë nga vendi në vend, unë dhe Mezi jemi të bindur se gjëja për të cilën njerëzit në vendet e varfra kanë më së shumti nevojë, është Fjala Perëndisë. Nevojat e njerëzve që banojnë në këto zona mund të përfshijnë çlirimin e tyre nga varësia e drogave dhe alkoolit, një arsim më cilësor, më tepër ushqim për të mbushur barkun dhe vende pune për ta, por asnjëra prej tyre nuk është aq urgjente sa nevoja e tyre për Biblën.

Tekefundit, Bibla është mjeti i caktuar nga Perëndia për t'u dhënë jetë frymërore njerëzve. Duke filluar nga Perëndia që krijoi gjithësinë me anë të fjalës, te thirrja e Abrahamit nga ana e Tij, te “kështu thotë Zoti” e profetëve, është Fjala e Perëndisë që krijon, i jep formë dhe jetë njerëzve të Tij. Jo më kot Jezusi erdhi si Fjala në mish, duke qenë komunikimi më sublim i Perëndisë me njerëzit e Tij (Hebrenjve 1:1–2). Përmes Biblës, Perëndia zbulon se kush është, çfarë ka bërë dhe si duhet të reagojmë ndaj Tij. Po ashtu, Fjala e Perëndisë është mënyra se si Perëndia i sjell njerëzit te Vetja (Romakëve 10:17).

Natyrisht, kjo mund të duket si një qasje e çuditshme. Çfarë të mire mund të sjellë një libër i vjetër përballë varfërisë ndër-breznore, cikleve të abuzimit, varësisë nga drogat dhe mungesës së gjithmbarshme të shpresës? Mirëpo, pa shikoni pak se çfarë thotë Bibla në lidhje me fuqinë e Fjalës së Perëndisë:

- Pali u flet pleqve të Efesit: “Dhe tani, o vëllezër, unë po ju lë te Perëndia dhe te fjala e hirit të Tij, që është në gjendje t’ju ndërtojë dhe t’ju japë trashëgimin në mes të të gjithë të shenjtëruarve” (Veprat e Apostujve 20:32).
- Pali i flet kishës së Romës: “Sepse, unë nuk kam turp për ungjillin e Krishtit, sepse ai është fuqia e Perëndisë për shpëtimin e cilitdo që beson, më parë judeun e pastaj grekun” (Romakëve 1:16).

- Sërish asaj: “Si do ta thërrasin, pra, atë, të cilit nuk i besuan? Dhe si do të besojnë tek ai për të cilin nuk kanë dëgjuar? Dhe si do të dëgjojnë, pa predikues?... Besimi, pra, vjen nga dëgjimi, dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë” (Romakëve 10:14, 17).

Autori i Hebrenjve na thotë: “Sepse fjala e Perëndisë është e gjallë dhe vepruese, më e mprehtë se çdo shpatë me dy tehe dhe depërton deri në ndarjen e shpirtit dhe të frymës, të nyjave dhe të palcës, dhe është në gjendje të gjykojë mendimet dhe dëshirat e zemrës” (Hebrenjve 4:12).

Shumë kisha nuk bëjnë asnjë përpjekje për të shërbyer mes të varfërve, sepse mendojnë se kjo është një luftë që ata nuk janë të pajisur për ta fituar. Të tjerët i qasen me zor kësaj beteje, por kur hyjnë në të, e bëjnë këtë me armët e gabuara. Ata shkojnë te lagjet e varfra me ndihma ushqimore, veshje dhe me programe sociale, por kjo nuk sjell ndonjë ndryshim të madh jetësor apo ndonjë fryt të dukshëm. Mirëpo, Fjala e Perëndisë është një shpatë me dy tehe. Është në gjendje të çajë të gjitha zemrat. Bibla është vendi ku gjejmë mesazhin e ungjillit, fuqinë e Perëndisë për shpëtim. Në qoftë se kemi Fjalën e Perëndisë që vihet në lëvizje nga Fryma e Perëndisë, i kemi të gjitha burimet që na nevojiten për të shërbyer në çdo lloj komuniteti.

Prediko gjithë Biblën

Në disa mënyra, ajo çfarë po themi, del kundër një qëndrimi të gjerëpërhapur në lidhje me të mësuarin e Fjalës së Perëndisë njerëzve të paarsimuar apo me njohje të kufizuar të Biblës. Ky qëndrim përpiqet që t’i joshë njerëzit me rrjedhën tregimtare të Biblës, duke i përdorur historitë e Biblës për të ngërthyer përfytyrimin e lexuesit, si dhe për t’i dhënë formë me anë të tyre historisë së jetës që ata po jetojnë. Sipas kësaj pikëpamjeje, historitë janë ato që e fitojnë më lehtësisht vëmendjen e njerëzve,

kështu që mënyra më e mirë për ta shpjeguar mesazhin e Biblës është të treguarit e historive të shkurtra, prej të cilave përbëhet historia më e madhe e krijimit, rënies, shpengimit dhe e përmbushjes. Thuhet se kjo metodë është veçanërisht e përshtatshme për ata që nuk janë mësuar që të qëndrojnë ulur dhe të dëgjojnë predikime didaktike, të cilat kanë një numër të madh pohimesh dhe përkufizimesh.

Kur një qëndrim i tillë prodhon vepra të arrira (siç ndodhi në rastin e burimeve të Historisë së Perëndisë [Story of God] të botuara nga Bashkësitë Soma në Takoma të shtetit të Uashingtonit), ato mund të kthehen në një instrument të efektshëm për ndarjen e ungjillit dhe për ta bërë edhe më të prekshme nevojën për të besuar te Krishti. Kur kjo gjë bëhet në një mënyrë jo-cilësore (ashtu siç ndodh zakonisht), atëherë ajo kthehet në një redaktim të mesazhit të Biblës dhe për pasojë e zvetënon mesazhin e plotë të ungjillit dhe fuqinë e tij. Mirëpo “rrëfimi i historive të ungjillit” nuk mund të kthehet (dhe me thënë të drejtën përkrahësit më të përgjegjshëm të kësaj metode nuk thonë të kundërtën) në zëvendësuesin e mesazhit të të gjithë Biblës. Fjala e Perëndisë nuk është më pak sesa një histori, por nuk është thjesht një histori.

Perëndia ka vendosur që ta zbulojë Vetën përmes zhanreve të ndryshme të letërsisë. Bibla përmban një numër të madh historish, por në të gjenden edhe ligje, predikime, letra, gjenealogji, poema, fjalë të urta, reflektime filozofike, profeci dhe letërsi apokaliptike. Në qoftë se do të shërbeni mes të varfërve, do t’ju duhet të vendosni nëse mendoni se këto komunitete kanë nevojë që ta njohin gjithë Biblën apo vetëm historitë e saj. Vallë, a kanë nevojë banorët e strehës së të pastrehëve në lagjen time për librin e Psalmeve? Vallë, a kanë nevojë fëmijët imigrantë të shkollës së mesme në zonën time për librin e Predikuesit? Vallë, a kanë nevojë banorët e burgut lokal që ta njohin përmbajtjen e Letrës së Parë të Apostullit Pjetër? Ne e dimë se cila do të ishte përg-

jigjja e apostullit Pal, sepse ai e mbrojti shërbesën e tij në Efes duke thënë: “Prandaj sot po ju jap dëshmi se unë jam i pastër nga gjaku i të gjithëve; sepse nuk u tërhoqa për të mos ju treguar gjithë këshillën e Perëndisë” (Veprat e Apostujve 20:26–27).

Në qoftë se jeni një person i arsimuar, duhet të bëni kujdes që të mos mendoni se njerëzit e pashkollë janë shumë budallenj për ta kuptuar Biblën. Përvoja ime më thotë se mungesa e shkollimit nuk ka të bëjë me zgjuarsinë sesa me faktorët e mjedisit jetësor, si për shembull mungesa e mundësive reale dhe zgjedhjet (e gabuara) personale. Mirëpo, Bibla nuk u shkrua për profesorët e Harvardit; përkundrazi u shkrua për “gjërat jofisnike të botës dhe gjërat e përçmuara” (1 e Korintasve 1:28). Ndonëse pa dyshim, kur zgjedhim mënyrën se si i mësojmë librat e Biblës, ne duhet ta bëjmë këtë me zgjuarsi, (sepse mbase është më mirë të fillojmë me një Ungjill, sesa t’ia nisim nga libri i Levitikut), përkushtimi ynë duhet të jetë që ta japim mësim gjithë mesazhin e Shkrimit të shenjtë (përfshirë këtu edhe librin e Levitikut). Nuk duhet ta redaktojmë apo ta përmbledhim Biblën duke dhënë mësim vetëm pjesët që sipas mendimit *tonë* do të jenë më të dobishme për të varfrit.

Prediko mirë gjithë Biblën

Njerëzit promovojnë modele të ndryshme të të komunikuarit të Biblës. Disa parapëlqejnë që të dialogojnë me bashkësinë apo që t’u tregojnë atyre histori që kanë një mësim kryesor. Mirëpo, unë jam i bindur se ushqimi parësor i kishës duhet të jetë Fjala e Perëndisë, e komunikuar prej predikuesit. Jetojmë në një botë ku autoritetit nuk i zihet besë dhe ku ai denigrohet, kështu që në këtë botë, ajo për të cilën kanë nevojë njerëzit mëkatarë, nuk është një bisedë miqësore mes të barabartësh, por shpallja e së vërtetës së Perëndisë në formë monologu.

Natyrisht që në jetën e gjithmbarshme të kishës duhet të ketë vend për dialog dhe pyetje dhe shkëmbim pikëpamjesh.

Mirëpo duhet ta pranojmë se predikimi pasqyron mënyrën se si Perëndia i flet popullit të Tij. Moisiu ia shpalli Ligjin e Perëndisë izraelitëve. Profetët e Dhiatës së Vjetër thoshin përherë: “Kështu thotë Zoti.” Jezusi erdhi duke thënë: “Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them.” Pjetri qëndroi te portiku i Salomonit kur i ballafaqoi dëgjuesit e tij me kërkesat e Perëndisë. Nuk keni për ta parë kurrë Perëndinë që të kërkojë një bashkëbisedim me popullin e Tij. Atyre iu bëhet thirrje që ta përlëvdojnë Zotin si përgjigje ndaj Fjalës së Tij dhe t’i binden asaj Fjale, por ata nuk kanë të drejtë që t’i shtojnë Fjalës së Tij apo që të japin mendimin e tyre në lidhje me të, sikur ky mendim të kishte ndonjë peshë a autoritet.

Kur predikuesi del përpara bashkësisë, ai flet me autoritetin e Perëndisë, për sa kohë që e shtjellon, shpjegon dhe zbaton Biblën me besnikëri. Kjo nuk ndodh për shkak se ai vetë është i pagabueshëm dhe me autoritet, por sepse Bibla është e tillë. Deri në pikën që predikuesi e shpall Fjalën e Perëndisë saktësisht, fjalët e tij janë fjalët e Perëndisë dhe njerëzit duhet ta mbyllin gojën dhe të dëgjojnë. Ai nuk duhet të turpërohet prej autoritetit të vet dhe as t’i shmanget atij, meqenëse është mënyra se si Perëndia komunikon dhe i jep jetë popullit të Tij. Disa njerëz mund të fyhen dhe ta marrin shpalljen e njëanshme të Fjalës së Perëndisë nga predikuesi si një shenjë arrogance, por është pikërisht e kundërta: lipset përulësi për t’ia vënë veshin Perëndisë. Fryma e Shenjtë do të flasë, me qëllim që populli i Perëndisë ta dëgjojë zërin e Tij në predikimin e Fjalës (Gjoni 18:37).

Pa shikoni se sa serioz është apostulli Pal kur e ngarkon Timoteun me detyrën për të predikuar Fjalën e Perëndisë:

Unë po të përbej, pra, përpara Perëndisë dhe Zotit Jezu Krisht, që ka për të gjykuar të gjallë e të vdekur, në dukjen e Tij dhe në mbretërinë e Tij: prediko fjalën, ngul këmbë me kohë e pa kohë, bind dhe qorto, këshillo me çdo zemër-

gjerësi e mësim. Sepse do të vijë koha kur njerëzit nuk do ta durojnë doktrinën e shëndoshë, por, sipas, ëndjeve të veta, do të mbledhin grumbull mësues për të gudulisur veshët dhe do t'i largojnë veshët nga e vërteta e do t'i kthejnë drejt përrallave. (2 e Timoteut 4:1–4)

Pali e përben Timoteun që “të predikojë” duke pasur parasysh kthimin e shpejtë të Krishtit dhe destinacionin e përjetshëm të dëgjuesve të Timoteut. Folja urdhërore në greqisht, që Pali përdor, na përcjell kuptimin e një kasneci që shpall vullnetin e sovranit të tij. Nuk është një këshillë, por një shpallje e asaj se çfarë ka bërë Perëndia. Shtojini predikimit urdhëresat për të bindur, qortuar e këshilluar dhe në këtë mënyrë keni përfutur tablonë e një veprimtarie, e cila nuk ka për synim që të përfshijë mendimet dhe komentet e të tjerëve.

Prediko *mirë* gjithë Biblën

Tani, ju lutem të mos më keqkuptoni. Pavarësisht nga fakti që Fjala e Perëndisë është e fuqishme dhe se Perëndia mund ta përdorë edhe një predikim të dobët, ne duhet të punojmë fort me qëllim që ta predikojmë Biblën mirë, në një mënyrë e cila krijon lidhje me jetën dhe situatat e njerëzve. Së pari, kjo do të thotë se predikimi ynë duhet të jetë *i ndjeshëm ndaj kontekstit tonë*, pra, duhet ta njohim në majë të gishtave audiencën tonë. Pavarësisht nëse dëgjuesit tuaj janë të pasur, të varfër, shtresë e mesme, apo një përzierje e të tria këtyre shtresave, duhet ta njihni mirë jetën e përditshme të secilit prej tyre.

Në qoftë se kisha juaj është plot e për plot me njerëz të shtresës së mesme dhe të gjitha ilustrimet që ju përdorni kanë të bëjnë me ta, të varfrit nuk kanë për t'u ndier edhe aq të mirëpritur në mesin tuaj. A e merr ti vallë si të mirëqenë në ilustrimet e tua se gjithsecili ka qasje në kompjuter? Se gjithsecili ka qenë në universitet? Se gjithsecili vjen nga një familje normale? Se

gjithsecili shkon për pushime vit për vit? Nuk ka asgjë të keqe të flasësh në lidhje me këto gjëra, por bëje këtë në një mënyrë të tillë që e qartëson se të mësipërmet nuk janë të arritshme për të gjithë.

Predikuesi duhet t'i njohë vlerat kulturore të vendit ku shërben. Kur pata privilegjin të predikoja në Kishën Komunitare të Nidrit një të diel, e kapa në ajër që ishte një vend shumë i vështirë. Bashkësia e besimtarëve të atjeshëm nuk do ta kishte pritur mirë predikimin tim sikur të kisha shkuar i veshur me kostum dhe kollare dhe t'u kisha folur atyre si një anglez i shekullit XVII. Po ashtu, nuk do t'u kisha bërë mirë atyre po të kisha shkuar atje si një amerikan i ngarkuar tej mase me emocione, i cili do të përpiqej që t'i ndihmonte ata që të lidheshin me ndjenjat e tyre. Përkundrazi, ata më respekuan kur u fola thjesht, dhe i pritën mirë sfidat që ua bëra atyre haptazi.

Së dyti, predikimi i mirë është zakonisht ai *ekspozuesi*. Kjo do të thotë se predikimi i mirë bazohet në një pasazh të Biblës, dhe pastaj përpiqet t'ia shpjegojë dëgjuesve domethënien e tekstit. Nuk do të zgjatem shumë në lidhje me këtë pikë, meqë kam folur më herët për rëndësinë e të mësuarit të Biblës, mirëpo për vete besoj se është më mirë që Bibla të jepet mësim në mënyrë ekspozuese, duke i marrë me radhë zhanret e Shkrimit. Kjo qasje i mëson njerëzit që ta lexojnë Biblën për veten e vet. Po ashtu, e lë Biblën që ta vendosë rendin e ditës, në vend që ta vendosë predikuesi se çfarë teme duhet mbuluar javë pas jave. Me thënë të drejtën nëse ju duhet që të kapërceni një kufi kulturor për të punuar mes të varfërve (siç bëj unë kur punoj me latino-amerikanët në lagjen time), nuk e keni fort idenë se për çfarë kanë nevojë dëgjuesit tuaj. Duke qenë se e *dini* se ata kanë nevojë për Biblën, është më mirë t'u flisni atyre Fjalën e Perëndisë duke e dhënë Biblën mësim në mënyrë ekspozuese.

Së treti, predikimi i mirë është *praktik*. Predikimi ekspozues duhet të ndryshojë si nata me ditën nga stereotipi (megjithëse

shpeshherë i saktë) i një leksioni të thatë e plot pluhur rreth një pike të doktrinës të padëgjuar më parë. Nuk mjafton vetëm të shpjegosh se çfarë thotë Bibla, por duhet të bëhet lidhja që ekziston mes kësaj dhe tundimeve apo sfidave, apo besimeve të rreme që trazojnë bashkësinë e besimtarëve. Predikimi i mirë ka për qëllim të ndryshojë jetën, kështu që predikuesi duhet të ndërtojë një urë mes tekstit antik dhe botës së dëgjuesve të tij (po huazoj në këtë pikë metaforën e Xhon Stotit në lidhje me predikimin¹). Në qoftë se do ta jepni mësim Biblën në një bashkësi të varfër, duhet ta zbatoni Fjalën e Perëndisë në jetët e njerëzve dhe ta bëni këtë në lutje dhe plot mençuri.

Çfarë lloj kishe dëshironi të jeni?

Nuk jam duke bërë thirrje për një qasje shërbese të llojit “po e predikove, ata do të vijnë”. Predikimi nuk mund të jetë e vetmja gjë në rendin tonë të ditës. Në qoftë se nuk ka njerëz, atëherë askush nuk do ta dëgjojë predikimin tuaj. Vetëm predikimi ekspozues nuk ka për ta themeluar kishën në një komunitet ku nuk ka një të tillë. Së pari, lipsen burra dhe gra që janë të gatshëm për të investuar shumë kohë dhe energji duke ndarë ungjillin dhe jetët e tyre me njerëzit e zonës së shërbesës. Pasi (me shpresë) Perëndia t’i ketë shpëtuar njerëzit dhe t’i ketë thirrur ata për të qenë një kishë, atëherë predikimi do të luajë një rol të rëndësishëm në dishepullimin e besimtarëve dhe në ungjillëzimin e lagjes përreth.

Mirëpo, nëse dëshironi të rijetësoni ose të mbillni një kishë në një lagje të varfër, ju duhet ta pranoni përparësinë e predikimit. Kisha do të ndërtohet vetëm nëpërmjet shpalljes së Fjalës së Perëndisë. Në qoftë se nuk jeni predikues, por dëshironi të bëheni pjesë e një skuadre që bën punë kishe mes të varfërve, atëherë sigurohuni që kjo është pikërisht ajo çfarë po përpiqeni

¹ *Between Two Worlds: The Art of Preaching in the Twentieth Century* (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1982), 137.

të themeloni. Teksa ndihmoni për t'i dhënë formë kishës që po mbillet, mbajeni predikimin e Fjalës së Perëndisë në qendër të pritshmërive tuaja. Ky është pikërisht ai lloj kishe që doni të jeni.

Rëndësia e anëtarësisë dhe disiplinës

Ma do mendja se kur e hapët librin, nuk prisnit që një kapitull i tij të fliste për anëtarësinë dhe disiplinën e kishës. Unë (Majku) nuk mendoj se kam ndeshur ndonjëherë një konferencë ku të rekomandohen praktikat e anëtarësisë dhe disiplinës serioze kishtarë për kishat në lagjet e varfra. Ose, a ju ka qëlluar të lexoni ndonjë artikull blogu ku thuhet se në qoftë se kisha juaj dëshiron të arrijë nevojtarët, ajo duhet të mbajë një listë të anëtarëve të saj? Mendoj që nuk ju ka qëlluar ta lexoni një artikull të tillë.

E kemi thënë më herët se lagjet e varfra kanë nevojë për bashkësi të forta lokale (në vend të një numri më të madh shërbesash parakishtarë). Mirëpo, ja ku e keni një të dhënë thelbësore: si unë dhe Mezi jemi të bindur se praktikat e anëtarësisë dhe disiplinës serioze kishtarë janë thelbësore për një bashkësi të shëndetshme dhe të frytshme.

Përkundër asaj që thonë kritikët, praktika e anëtarësisë së kishës nuk është një qasje e vjetruar ndaj jetës së kishës, e frymë-

zuar nga “modelet e biznesit” të mesit të shekullit XX. Përkundrazi, Shkrimi i shenjtë i paraqet qartë të tijat argumente në mbështetje të faktit që kisha lokale duhet të jetë shumë e qartë për sa i përket asaj se kush është brenda bashkësisë dhe kush është jashtë saj. Në këtë kapitull, do të përpiqem të paraqes pikërisht argumentet në mbështetje të anëtarësisë së kishës dhe më pas të them disa fjalë rreth mënyrës se si anëtarësia dhe disiplina serioze kishtarë ndikon mbi shërbesën në lagjet e varfra.

Të brendshmit dhe të jashtmit

Gjithë harku i narrativës së Biblës mund të përshkruhet si rrëfimi i dashurisë së Perëndisë për popullin e Tij dhe i zemërimit të Tij kundër armiqve të Vet. Ekziston një ndryshim i dukshëm mes të qenët mik i Perëndisë dhe armik i Tij. Për pasojë, nuk është për t’u habitur fakti që përgjatë gjithë Biblës, nga krijimi e deri përmbushja, Perëndia heq një vijë të qartë ndarëse mes atyre që janë populli i Vet dhe atyre që nuk janë pjesë e tij.

Fillimisht, në kopshtin e Edenit, njerëzit e Perëndisë jetonin në përbashkësi me Hyjin. Pas rebelimit të Adamit dhe Evës, Zoti i dha fund përbashkësisë së drejtpërdrejtë me ta duke i përzënë nga kopshti. Vendosi një gardh mbrojtës përreth kopshtit dhe një engjell roje për t’i mbajtur njerëzit jashtë tij. Për sa kohë që mbeteshin të drejtë, ata ishin “brenda”; kur mëkatonin, ata nxirreshin “jashtë”.

Pastaj Perëndia iu shfaq Abrahamit te Zanafilla 12 me premtimin e hirshëm për të krijuar prej pasardhësve të tij një popull të ri që i përkiste Zotit, një racë të re “të brendshme”. Ai e konfirmoi këtë premtim te kapitulli 17: “Dhe do të caktoj besëlidhjen Time midis meje dhe teje, si dhe me pasardhjen tënde, nga një brez në një brez tjetër, kjo do të jetë një besëlidhje e përrjetshme, me të cilën Unë do të marr përsipër të jem Perëndia yt dhe i pasardhjes sate pas teje... do jem Perëndia i tyre” (Zanafilla 17:7–8). Bëhet fjalë për premtimin për një

marrëdhënie të qëndrueshme mes pasardhësve të Abrahamit dhe Zotit, një marrëdhënie kjo që do të dallonte nga çdo marrëdhënie tjetër e Zotit me qeniet e tjera njerëzore. Që këtej e tutje do të ekzistonin dy grupe njerëzish: ata që ishin “populli i Perëndisë” dhe ata që nuk ishin pjesë e tij. Një premtime që i qe bërë më herët Abrahamit, e bënte këtë vijë ndarëse edhe më të qartë: “Dhe Unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë, dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë” (Zanafilla 12:3).

Për ta bërë këtë realitet frymëror fizikisht të dukshëm, Perëndia i dha Abrahamit shenjën e rrethprerjes si një rit të fillimit dhe pranimit, pra, si një rrugë hyrëse për të shënuar anëtarësinë në popullin e Perëndisë. Kaq e rëndësishme ishte kjo shenjë, sa që individët nga kombet e tjera mund të përfshiheshin në gjirin e popullit të Perëndisë falë rrethprerjes (Zanafilla 17:27), ndërsa pasardhësit fizikë të Abrahamit mund të përjashtoheshin nga populli i Perëndisë për shkak se e refuzonin atë (vargu 14). Perëndia tashmë kishte siguruar një vijë të qartë ndarëse: të rrethprerët gjendeshin brenda, kurse gjithë të tjerët mbeteshin jashtë.

Ligji levitik e përcaktoi edhe kodifikoi edhe më tej këtë vijë ndarëse. Në këtë mënyrë, pasardhësit e Abrahamit u bënë edhe më të dallueshëm nga pjesa tjetër e botës. Perëndia dëshironte që populli i Tij të ishte i dëlirë dhe i shenjtë, tërësisht i dallueshëm prej të tjerëve, duke filluar nga rrobat e tyre e duke vazhduar me ushqimin dhe me adhurimin e tyre. Tashmë kishte edhe një mënyrë tjetër për të bërë dallimin mes popullit të Perëndisë dhe armiqve të Tij: të gjithë ata që e zbatonin ligjin, gjendeshin brenda, kurse gjithë të tjerët mbeteshin jashtë.

Kjo është arsyeja përse Moisiu (dhe më pas Jozueu) i thanë sa e sa herë Izraelit që të qëndronte i ndarë prej kombeve të tjera dhe të ruante dëlirësinë e vet, teksa po pushtonte tokën e Kanaanit. Ashtu si duhet të jetonin brenda kufijve *fizikë* të tokës së tyre, ata duhet të jetonin edhe brenda kufijve *frymërorë* të ligjit levitik dhe kodit të shenjtërisë. Jozueu i paralajmëroi kështu:

Tregoni, pra, kujdes të madh... për ta dashur ZOTIN, Perëndinë tuaj. Por në rast se i shmangeni dhe bashkoheni me mbetjen e këtyre kombeve që kanë mbetur midis jush dhe bashkoheni me anë martesash me ta dhe përziheni me ta dhe ata me ju, dijeni me siguri që ZOTI, Perëndia juaj, nuk ka për të vazhduar t'i dëbojë këto kombe para jush; por ata do të bëhen për ju një kurth, një kamxhik në ijët tuaja dhe hala në sytë tuaj, derisa ju të zhdukeni nga ky vend i mirë që ZOTI, Perëndia juaj, ju ka dhënë. (Jozueu 23:11–13)

Në shumë mënyra, historia e Izraelit është historia e dështimit të tyre për ta ruajtur këtë dallim. Duke filluar nga libri i Gjyqtarëve, historitë e Dhiatës së Vjetër na përshkruajnë se si idhujtaria dhe ndërmartësat i bënë izraelitët të padallueshëm prej kombeve përreth tyre. Në sytë e fqinjëve të tyre, të qenët izraelit ishte një gjë gjithnjë e më pak e rëndësishme. Në kohën e mërgimit të Izraelit, vetëm një mbetje njerëzish kishin mbetur besnikë. Meqenëse Izraeli jetonte dhe adhuronte si një komb pagan, Perëndia i dërgoi ata që të jetonin mes kombeve pagane. Meqenëse kufijtë frymërorë qenë zhdukur ndërkohë, Ai i hoqi edhe kufijtë fizikë të tokës. Nuk ishte më e qartë se kush ishin të brendshmit dhe kush të jashtmit.

Kur i kthehemi Dhiatës së Re, shohim se Perëndia e dërgoi Birin e Tij për të krijuar një popull të ri për Vete, popull i cili është kisha. Për shkak të veprës së Krishtit, tashmë si judenjtë ashtu edhe johebrejntë, janë të ftuar që të bëhen populli i Perëndisë përmes besimit. Ata që *dikur nuk ishin një popull* janë bërë *tashmë populli i Perëndisë* (1 e Pjetrit 2:10). Ata që dikur gjendeshin jashtë, tani kanë hyrë brenda.

Në vend të rrethprerjes fizike apo të etnisë, ndjekësit e Krishtit tani e demonstrojnë se janë bërë pjesë e popullit të Perëndisë përmes pagëzimit (Veprat e Apostujve 2:41). Ky pagëzim simbolizon identifikimin e tyre me Krishtin e kryqëzuar dhe të ri-

ngjallur. Ashtu siç shkroi apostulli Pal: “A nuk e dini se ne të gjithë që u pagëzuam në Jezu Krishtin, u pagëzuam në vdekjen e Tij? U varrosëm, pra, me anë të pagëzimit në vdekje, që, ashtu si Krishti u ringjall prej së vdekurish me anë të lavdisë së Atit, kështu edhe ne të ecim në risinë e jetës” (Romakëve 6:3–4).

Ardhja e Krishtit dhe vepra e Tij e përfunduar mbi kryq shkaktuan disa pavazhdimësi mes popullit të Perëndisë në Dhiatën e Vjetër dhe në atë të Re. Izraeli i Dhiatës së Vjetër ishte një komunitet i përzier, i cili përbëhej prej pasardhësve fizikë dhe frymërorë të Abrahamit (Romakëve 9:6–8). E megjithatë, Zoti premtoi përmes profetit Jeremia një besëlidhje të re: “jo si besëlidhja që kam vendosur me etërit e tyre”, por një besëlidhje në të cilën “të gjithë do të më njohin, nga më i vogli e deri te më i madhi” (Jeremia 31:31–34). Trupi i Krishtit është projektuar që të përbëhet vetëm prej atyre që përmes besimit janë bashkuar me Të. Sipas fjalëve të profecisë, *të gjithë* e njohin Zotin.

Ky element pavazhdimësie mes Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re do të bëhet edhe më domethënës kur të shohim saktësisht se kush është brenda dhe kush mbetet jashtë popullit të Perëndisë të Dhiatës së Re. Mirëpo, duhet të vërejmë vazhdimësinë mes popullit të Perëndisë në të dyja Dhiatat: Perëndia *vazhdon* që të bëjë një dallim mes atyre që gjenden brenda dhe atyre që mbeten jashtë. Nga një anë qëndrojnë të gjithë ata që janë pagëzuar në Jezusin, dhe nga ana tjetër gjithë të tjerët. Jezusi madje e krahasoi kishën me një vathë dhensh, dera e së cilës është Ai, dora vetë (Gjoni 10:7). Vatha e dhenve është e rrethuar me gardh. Jezusi po ashtu tha se Ai i njihnte delet e Tij dhe se ato e njihnin Atë (vargu 14).

Ky model përfshirjeje dhe përjashtimi do të arrijë pikën e tij kulmore në fund të historisë. Në fund të kohërave, Perëndia do të bëjë një ndarje të qartë e përfundimtare. Mbarë njerëzimi do ta shohë qartë në atë ditë solemne se kush janë njerëzit e Perëndisë dhe kush nuk janë të tillë. Delet do të ndahen nga

dhitë (Mateu 25:31–33). Ata të cilët i kanë emrat e shkruar në Librin e Jetës së Qengjit, do të hyjnë në lavdi, ndërsa ata, emrat e të cilëve nuk gjenden të shkruara në libër, do të hidhen tutje (Zbulesa 21:27).

Anëtarësia në Kishën e Dhiatës së Re

Kur i shqyrtojmë me vëmendje shkrimet e Dhiatës së Re, shikojmë qartë se kisha e parë e krishterë praktikonte një anëtarësi formale. Edhe pse asnjë nga këto pasazhe nuk është plotësisht bindëse në vetvete, të marra së bashku ato formojnë një argument mjaft bindës. Le të shohim pesë pasazhe të Dhiatës së Re ku dëshmohet për praktikën e anëtarësisë kishtare në kishën e hershme.

1. Ata që nuk guxonin “t’i bashkoheshin” kishës

Te Veprat e Apostujve 5:12–13 na thuhet: “Dhe shumë shenja dhe mrekulli bëheshin në mes të popullit nëpërmjet duarve të apostujve. Dhe të gjithë me një mendje të vetme mblidheshin nën Portikun e Salomonit. Dhe asnjëri nga të tjerët nuk guxonin të bashkohej me ta; por populli i lartësonte.”

Frika i mbërtheu qoftë besimtarët e kishës, ashtu dhe jobesimtarët që dëgjuan për rrethanat e vdekjes së Ananisë dhe Safirës.

Shqetësimi ishte i tillë që shumë njerëz nuk guxonin “t’i bashkoheshin” kishës, mbase për shkak të frikës se do të vuanin të njëjtin fat.

Fjala greke e përkthyer si “të bashkohesh” do të thotë “të lidhesh ngushtë”, “të mblidhesh së bashku”, dhe “të bëhesh bashkë”. E njëjta fjalë përdoret edhe te 1 e Korintasve 6:17 në lidhje me bashkimin mes një besimtari dhe Krishtit. Më e pakta që mund të themi, është se fjala “t’i bashkohej” te Veprat e Apostujve 5:13 bën fjalë për një gjë më të madhe, sesa *të frekuentosh një grup njerëzish herë pas here*, si për shembull

sikur të thoshim “iu bashkuam darkës kur erdhi koha e ëmbël-sirës”. Kjo fjalë dëshmon për ekzistencën e një lidhjeje formale, pra, njëlloj si të bëheshe anëtar i një klubi të caktuar.

2. Lista e vejushave

Te 1 e Timoteut 5:9–12, Pali i jep Timoteut një varg udhëzimesh për regjistrimin e vejushave në listën e atyre që marrin mbështetje nga kisha. Ai shkruan: “Një e ve të regjistrohet në listën e vejushave, po të jetë jo më e re se gjashtëdhjetë vjeçe, të ketë qenë graujta e një burri të vetëm, dhe të ketë dëshminë për vepra të mira... Po refuzo vejushat më të reja...”

Folja e përkthyer si “regjistroj” mund të ketë ose një kuptim të veçantë (“ta shënosh emrin në një listë”) ose një kuptim më të përgjithshëm (“ta konsiderosh si pjesëtar të një grupi të caktuar”). Kuptimi i parë do të thotë qartë se kisha mbante një listë të anëtareve të saj, që ishin vejusha. Mirëpo, edhe kuptimi i dytë nuk do të thotë gjë tjetër veçse që kisha po bënte një dallim mes njerëzve, në një mënyrë që përputhej me praktikën e anëtarësisë kishtarë.

Përse vallë të përmendej lista e vejushave? Vështirë se mund të përfytyrohet fakti që një kishë që mbante listën e vejushave, nuk mbante edhe një listë emrash të anëtarëve të saj. Në qoftë se nuk e mbante listën e dytë, atëherë si do t’ia bënte të përcaktonte se cilat vejusha duhet të përfshiheshin në të parën? Çdo vejushë e gjithë qytetit të Efesit? Apo një vejushë që erdhi ca herë disa vjet më parë? Natyrisht që jo, sepse kisha duhet të kishte një grup njerëzish prej të cilit përzgjidheshin vejushat.

3. Ndëshkimi i shumicës

Te 2 e Korintasve 2:6, Pali flet për disiplinën kishtarë të ushtruar mbi një individ duke e përshkruar atë si “ndëshkimi që iu bë nga shumica”. Do të flasim më tepër rreth disiplinës kishtarë pak më poshtë, por tani duhet theksuar se ekzistenca e një

“shumice” do të thotë se ekzistonte një grup i caktuar njerëzish, prej të cilëve krijohej një shumicë. Nuk mund të flitet për shumicë kur kemi të bëjmë me një grup të papërcaktuar njerëzish; sa herë që flasim për shumicën duhet të jetë e lidhur me një sasi të përcaktuar njerëzish.

A ishte kjo shumica e njerëzve që qëlluan të ishin të prani-shëm ditën kur u hodh vota? A mund të votonin jo të krishterët asokohe? A mund të votonin të krishterët që vinin nga një qytet tjetër dhe që nuk ishin në brendësi të çështjes? Supozimi më i natyrshëm që mund të bëjmë në këtë rast, është të pranojmë se Pali e kishte fjalën për shumicën e anëtarësisë së njohur të kishës.

4. Llogaridhënia ndaj udhëheqësve të kishës

Në Dhiatën e Re drejtuesit e kishës paralajmërohen që t’i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre mbikëqyrëse me zell e përkujdesje. Te Veprat e Apostujve 20:28, apostulli Pal i udhëzon pleqtë e Efesit: “Kini kujdes, pra, për veten tuaj dhe *për gjithë tufën.*” Te Hebrejve 13:17, kishës i thuhet që t’i dëgjojë pleqtë dhe t’u bindet atyre, sepse: “ata rrinë syhapur mbi shpirtat tuaj, si ata që duhet të japin llogari.”

Prej kujt përbëhet tufa mbi të cilën rrinë syhapur pleqtë? Për kë duhet të japin llogari drejtuesit e kishës? Për banorët e qytetit të tyre? Për këdo që e frekuenton kishën e tyre? Natyrisht që nuk është kështu. Ata duhet të japin llogari për anëtarët e kishës së tyre, pra, për të gjithë ata që të gjithë i njohin si njerëzit nën përkujdesjen e drejtuesve. Drejtuesit e kishës nuk i ushtrojnë dot detyrat e tyre si duhet në mungesë të anëtarësisë kishtarë.

5. Metaforat për Kishën

Dhiata e Re përdor metafora të larmishme për të përshkruar bashkësinë lokale të besimtarëve. E pamë te Veprat e Apostujve 20:28 se kisha quhet tufë. Te 1 e Korintasve 12:12 krahasohet me një trup. Te 1 e Pjetrit 2:5 kisha përshkruhet si një ndërtesë.

Secila prej këtyre metaforave demonstroi një marrëdhënie të dukshme mes individëve dhe bashkësisë në tërësi. Një besimtar i krishterë është një gjymtyrë e trupit dhe një dele e tufës. Besimtari është sipas fjalëve të Pjetrit “një gur i gjallë” brenda një shtëpie frymërore.

Secila prej këtyre fjalëve përshkruese, të cilat janë në vetvete thelbësore për të kuptuarin tonë të kishës, e bëjnë të nevojshëm për secilin individ pjesëtar një angazhim më të madh sesa ai rastësor ndaj kishës lokale. Ata nuk janë gurë të lidhur në mënyrë rastësore për të formuar një ndërtesë. Nuk ka asnjë dyshim se ata janë të lidhur me njëri-tjetrin me llaç e çimento. Delet nuk kalojnë nga tufa në tufë, përkundrazi, bariu e di saktësisht se sa dele ka nën përkujdesjen e vet. Gjymtyrët e trupit nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën në një mënyrë rastësore; por, përkundrazi, janë të lidhura në një mënyrë mjaft të ndërlikuar dhe janë në varësi të plotë ndaj njëra-tjetrës. Natyrisht, i pasqyrojmë më qartë këto metafora kur i bashkohemi zyrtarisht një bashkësie lokale besimtarësh.

Duke qenë të nxjerra prej një morie dëshmish, këto pesë shembuj na lënë të kuptojmë se pjesëmarrja në jetën e kishës lokale nuk është një gjë rastësore apo lehtësisht e zgjidhshme. Përkundrazi, është një marrëdhënie në të cilën dikush hyn (i bashkohet komunitetit) dhe që sjell për pasojë përgjegjësi (vendosjen e disiplinës, nënshtrimin ndaj drejtuesve) dhe privilegje (mbështetje për vejëshat, pjesëmarrje në popullin e Perëndisë). Vështirë se mund të përfytyrohet se si arrihej kjo pa një kuptim të qartë të anëtarësisë kishtare.

Pse lagjet e varfra kanë nevojë për anëtarësinë kishtare

Shpresojmë se ju kemi bindur për faktin se një element përbërës i përshkrimit biblik të jetës së kishës është të kuptuarit e qartë dhe të përcaktuar të faktit se kush i përket bashkësisë së

besimtarëve. Mirëpo, dëshiroj ta çoj argumentin një hap më tej, duke thënë se anëtarësia kishtare është jo vetëm biblikisht e nevojshme (një fakt që, nëse je i krishterë, është një arsye e mjaftueshme për të bërë këtë edhe më tepër), por është edhe mjaft e dobishme për të krijuar atë lloj bashkësie të shëndetshme besimtarësh që është në gjendje që t'i arrijë lagjet e varfra (shih kapitullin 5).

1. Anëtarësia parandalon shfaqjen e “sindromës së qytetarëve të kategorisë së dytë”

Brenda kishës mund të zhvillohet një sistem gati-gati i padukshëm kastash. Njerëzit e pasur dhe të mirëarsimuar mund të shfaqin prirjen për t'i parë me përçmim apo për t'i skajuar besimtarët e varfër (shih Jakobi 2:1–6). Në qoftë se një kishë shpreson që t'i shohë banorët e lagjeve të varfra që të vijnë te Krishti, ajo duhet të sigurohet që këtyre njerëzve t'u garantohet pjesëmarrja me të drejta të plota në jetën e bashkësisë.

Anëtarësia serioze ka një “efekt rrafshues” të mrekullueshëm mbi kishën lokale. Anëtarësia e kishës e bën të qartë se të gjithë të krishterët kanë të njëjtin status përpara Perëndisë, pra, që nuk jemi gjë tjetër veçse gjymtyrë të trupit të Krishtit. Një bashkësi që dëshiron të arrijë një lagje të varfër, duhet ta përvetësojë këtë të vërtetë biblike. Kur banorët e lagjeve të varfra vijnë te Krishti, ata duhen pagëzuar dhe duhen pranuar si anëtarë të kishës. Kjo gjë e bën të qartë në sytë e tyre se ata janë plotësisht të pranuar dhe gjymtyrë tërësisht funksionale të trupit të Krishtit.

2. Anëtarësia forcon llogaridhënien dhe lidhjet mes anëtarëve

Vendosja e anëtarësisë kishtare forcon llogaridhënien mes vetë pjesëtarëve të bashkësisë dhe mes bashkësisë dhe drejtuesve të saj. Për anëtarësinë lipset angazhim, dhe ajo e përkufizon në mënyrë biblike se çfarë do të thotë të bësh pjesë në kishë.

Kur njerëzit bëhen anëtarë të një bashkësie, ata zotohen që t'i duan të gjithë të tjerët brenda kishës, si dhe që të përkujdesen e të luten për ta dhe të japin llogari përpara tyre. Kjo do të thotë se të gjithë anëtarët e kishës, qofshin këta të pasur, të varfër apo shtresë e mesme, janë të thirrur që ta duan njëri-tjetrin. Në bashkësinë tonë, jo vetëm që duam që të pastrehët dhe imigrantët e sapoardhur të vijnë te Krishti, por edhe që ata të bëhen anëtarë plotësisht të integruar e funksionalë të kishës.

3. Anëtarësia (por edhe disiplina kishtare)

e bën të qartë nëse dikush është një besimtar i vërtetë

Te 1 e Korintasve 5, Pali e udhëzon kishën se si të veprojë me një njeri që jeton në mëkat të hapur e skandaloz. Për të ruajtur shëndetin e kishës, bashkësia nxitet që të ushtrojë disiplinën kishtare kundër këtij personi duke “e dorëzuar atë në duart e Satanit”. Në vargun 2, ai u thotë atyre se në vend që ta lënë në mes tyre, ata duhet ta largojnë nga gjiri i tyre personin që ka kryer një punë të tillë. Duhet të vëmë re disa elemente të këtij pasazhi.

Së pari, ndëshkimi përshkruhet te vargu 2 si largimi nga “mesi” i tyre. Pasoja e disiplinës kishtare është largimi i mëkatarit nga bashkësia. Kjo gjë nënkupton domosdoshmërisht praninë e anëtarësisë zyrtare. Përndryshe, si mund ta heqësh dikë, i cili zyrtarisht nuk bën pjesë në bashkësi? Lejomëni që ta dëshmoj me anë shembujsh pikëpamjen time. Nuk mund të më heqin nga Shoqata e Lojtarëve Mëngjarashë të Golfit të Kalifornisë Veriore (SHLMGKV), sepse nuk kam qenë kurrë pjesë e kësaj organizate. Sipas faqes së tyre të internetit, SHLMGKV *i heq* anëtarët e saj për arsye të ndryshme (mbase kur dikush është dorëdjathtë?). Mirëpo, unë nuk rrezikoj që ta pësoj një masë të tillë, sepse askush nuk mund të përjashtohet nga një organizatë ku nuk ka qenë kurrë anëtar.

Së dyti, disiplina kishtare duhet të ndodhë atëherë kur kisha të jetë “e mbledhur” (vargu 4). Duke pasur parasysh temën që

po trajtojmë, vëreni se zhvilloheshin takime zyrtare dhe të përcaktuara të kishës dhe se njerëzit e dinin se kush do të ishte i pranishëm kur të mblidhej bashkësia. Po ashtu, duhet pasur parasysh se kjo gjë nënkupton anëtarësinë serioze kishtare.

Së treti, sipas Palit, kisha duhet të disiplinojë vetëm ata që janë “brenda” kishës (vargu 12). Apostulli nuk po i thotë kishës që të mbikëqyrë si polic botën dhe moralin e saj. Pa dyshim, kisha e dinte se kush ishin të brendshmit dhe kush të jashtmit. Disiplina e duhur kishtare nuk mund të realizohet pa e përcaktuar më parë se kush janë anëtarët e kishës.

Së katërti, disiplina kishtare është për të mirën e kishës, por edhe për dobi të personit që po disjelinohet (vargu 5). Pali këmbëngul që kisha ta përjashtojë nga anëtarësia e saj personin imoral, me qëllim që fryma e tij të shpëtohet ditën e fundit. Për disa nga ne, disiplina kishtare mund të jetë një gjë e neveritshme dhe e ashpër, por për apostullin ajo qe qartësisht një vepër dashurie ndaj mëkatarit. Kur dikush është në pozitë të mirë përpara bashkësisë, ai ose ajo ka siguri për shpëtimin e vet, sepse një autoritet i jashtëm e ka shqyrtuar rrëfimin e tij ose të saj të besimit duke e konfirmuar atë.

Mirëpo, kur kisha e heq atë konfirmim përmes disiplinës kishtare, ky veprim shërben si zile alarmi për personin që jeton në mëkat. Dëshmia e tij ose e saj e besimit vihet në dyshim nga refuzimi për t’u penduar për mëkatet, dhe personi në fjalë duhet të ballafaqohet me të vërtetën se fryma e tij ose e saj është në rrezik. Natyrisht, jo gjithkush që përjashtohet nga kisha pendohet me kalimin e kohës dhe kthehet në të. Mirëpo, shpeshherë ndodh që falë hirit të Perëndisë ata kthehen, ashtu siç ndodhi në rastin e Rabbit, historinë e të cilit e lexuam te kapitulli 5.

Së pesti, disiplina kishtare i tregon botës se si duket një i krishterë. Imoraliteti i atij personit në Korint ishte i atillë sa të skandalizonte edhe banorët paganë të qytetit (vargu 1). Në

qoftë se kisha nuk do të kishte bërë gjë, atëherë bota përreth saj do të nxirrte përfundimin se të krishterët janë tej mase të shthurur. Mirëpo, duke e përjashtuar personin nga kisha, bashkësia e besimtarëve ia bëri të qartë botës se mëkati sjell pasoja negative dhe se imoralët e papënduar nuk janë të krishterë të vërtetë.

4. Ungjillëzimi i kishës varet prej dallueshmërisë së saj nga bota

Të krishterët në ditët e sotme mendojnë shpesh se fuqia jonë ungjillëzuese varet nga të dëshmuarit përpara botës se sa të ngjashëm jemi me ta. Mirëpo, sfida me të cilën ballafaqohet kisha është e njëjtë me atë që u ballafaqua edhe Izraeli i lashtë, kur u tundua që të shkonte pas perëndive të kombeve, pra, që të jemi të dallueshëm prej botës. Për çfarë është e mirë kripa nëse e humb shijen e saj të kripur? Atëherë bëhet për t'u hedhur, apo jo? Ose për çfarë është e mirë drita nëse mbulohet me babune? Janë pikërisht jetët tona të dallueshme, që i japin botës një arsye për ta përlëvdur Perëndinë (Mateu 5:13–16; shih gjithashtu 1 e Pjetrit 2:9–12).

Praktikat e shëndetshme të anëtarësisë dhe disiplinës kishtare luajnë një rol të rëndësishëm në kultivimin dhe mbrojtjen e dallueshmërisë së një kisha. Ato nuk janë *shkak* parësor për këto jetë të ndryshuara, sepse ky shkak është Fjala e predikuar. Mirëpo, praktikat e anëtarësisë dhe disiplinës i mbrojnë këto jetë, i qartësojnë ato dhe i bëjnë të dukshme për të gjithë. Sipas mendimit tuaj, sa shpresëdhënës është për një vend të vështirë fakti që njerëzit mund të vështrojnë ditë për ditë një fortesë pararojë të mbretërisë së Perëndisë? Apo për njerëzit që të shohin ditë për ditë një grup bashkëqytetarësh të tyre që kanë ndryshuar dhe po ndryshojnë në mënyrë të mbinatyrshme?

Nga ana tjetër, sa i madh është dëmi i shkaktuar ndaj dëshmisë ungjillëzuese të kishës në Perëndim, vetëm e vetëm se

shumë anëtarë të kishës jetojnë njëlloj si pjesa tjetër e botës (1 e Korintasve 5)—dhe as udhëheqësit e kishës dhe as bashkëbesimtarët e tyre nuk i qortojnë ata për këtë?

Kur teoria vihet në praktikë

Të punosh mes skamnorëve do të thotë që të bëhesh pjesë e jetëve që janë të rrëmujshme. Natyrisht, edhe njerëzit që nuk janë të varfër, jetojnë jetë të rrëmujshme, por varfëria i acaron problemet edhe më tej dhe shërben si pikënisje për një gamë të gjerë mëkatesh që e bëjnë jetën edhe më të ndërlikuar. Kjo do të thotë se në përpjekje për të vendosur dhe mbajtur anëtarësinë kishtarë do të ballafaqohemi me situata të ndërlikuara:

- A mundet një imigrant i paligjshëm të bëhet anëtar i kishës? Deri sa thellë duhet të futet kisha kur e pyet një imigrant në lidhje me statusin e tij gjatë procesit të anëtarësimit?
- A mund të bëhet anëtar i kishës një person që merr meta-don me recetë mjeku?
- Po në qoftë se dikush vjen te Krishti pasi ka bashkëjetuar për plot dy dekada me të dashurin apo të dashurën e vet? Sa kohë pas kthimit në besim ai ose ajo duhet të martohet? Po në qoftë se ka edhe fëmijë me bashkëjetuesin ose bashkëjetuesen? Po në qoftë se secili prej tyre është i martuar me dikë tjetër në vendin e origjinës, por ata kanë dekada me radhë pa folur me këta persona?

Nuk mund të presim që njerëzit t'i sistemojnë plotësisht jetët e tyre përpara se t'i pranojmë si anëtarë kishë, por duhet të jemi në gjendje të pohojmë se kemi dëshmuar shpallje të besueshme pendimi dhe besimi. Një person që jeton me të dashurën e tij, duhet ta ndërpresë bashkëjetesën. Një shpërndarës droge duhet t'i japë fund profesionit të tij. Mirëpo ne nuk kërkojmë që njerëzit që i bashkohen kishave tona, të jenë të përsosur. Ama u

kërkojmë atyre që ta intensifikojnë luftën kundër mëkatit, pra, që të pendohen.

Për t'u dhënë zgjidhje këtyre çështjeve, pleqtë e kishave tona i intervistojnë kandidatët për anëtarësim, u shpjegojnë atyre deklaratën e besimit tonë, flasin në lidhje me përgjegjësitë e anëtarëve dhe të drejtuesve, si dhe sigurohen që këta persona të kenë një të kuptuar të saktë të ungjillit dhe të asaj se çfarë do të thotë të jetosh një jetë bindjeje të perëndishme. Kujdesemi që kandidatët të japin dëshminë e vet përpara bashkësisë një ose dy javë përpara takimit të bashkësisë dhe i nxisim anëtarët e kishës që të shprehin rezervat apo pyetjet e tyre në lidhje me personin në fjalë.

I gjithë ky proces udhëhiqet nga dëshira për të qenë të kujdesshëm me gjërat. Mirëpo, synimi i këtyre procedurave është edhe që të shfaqim përkujdesjen e nevojshme baritore ndaj kujt do që i bashkohet kishës, sepse duam që ata (1) të shohin se sa serioz është pohimi se janë ndjekës të Jezusit; (2) të bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e familjes kishtarë; (3) t'i nënshtrohen udhëheqjes dhe llogaridhënies së perëndishme; dhe (4) të shohin ndryshimin mes kishës dhe botës dhe ta dinë se për cilët njerëz ata kanë përgjegjësi si bashkanëtarë të tyre.

Mirëpo, ruajtja e një vije të qartë ndarëse mes kishës dhe botës është e dobishme jo vetëm për kishën, por edhe për botën. Kishën e Mezit e frekuentonte një burrë, i cili pretendonte se ishte i krishterë, por nga ana tjetër shpërndante drogë, shiste filma pornografikë dhe bënte seks me burra dhe gra të lagjes. Banorët e lagjes nisën t'i flisnin Mezit në lidhje me këtë burrë, çka i dha mundësi Mezit që të shprehte përkujdesjen dhe dashurinë e tij për të, por edhe të shpjegonte se personi në fjalë ishte thjesht frekuentues i kishës, por jo një anëtar i saj. Pasi një diskutim i mirë me këta “banorë të shqetësuar”, gjatë të cilit Mezi iu shpjegonte atyre se *përse* personi në fjalë nuk ishte anëtar i kishës dhe se çfarë donte të thoshte të ishte një

anëtar kishe. Me pak fjalë, ruajtja e një vije të qartë anëtarësie i jepte mundësi Kishës Komunitare të Nidrit t'ia hapte derën këtij personi pa dalë dorëzanë për besimin e tij dhe pa i thënë botës se ai i përket Jezusit. Thënë shkurt, koncepti i qartë i anëtarësisë bënte të mundur që dëshmia e kishës në komunitet të mos njollosej prej një personi që thjesht e frekuentonte atë, por edhe që kisha të demonstronte dashurinë e saj ndaj një personi të tillë.

Edhe veprimet e disiplinës kishtare e bëjnë këtë gjithashtu. Një stazhier kishe e la me barrë një grua të lagjes, çka shkaktoi një valë thashethemesh në zonën tonë. Disiplina kishtare që u ndërмор ndaj këtij personi, e la pa fjalë komunitetin, për mirë, pra! Shkishërimi i dikujt tjetër bëri që gjithë anëtarët e familjes së këtij personi të ungjillëzoheshin. Edhe ata e vlerësuan pozitivisht qëndrimin e fortë të kishës dhe besueshmëria jonë u rrit pa masë në sytë e tyre.

Përfundimi

Anëtarësia kishtare mund të duket si një mall luksi për shumë kisha misionare. Mbase sa herë flitet për të, në mendjen e tyre krijohet përfytyrimi i një bashkësie besimtarësh nazelinj dhe shumë striktë, të cilët janë më të interesuar për t'u përkujdesur për kopshtin e tyre të vogël, sesa për ta çuar ungjillin tek të humburit. Mbase disa kisha kanë rënë pre e këtij gabimi. Mirëpo, le të mos e hedhim foshnjën bashkë me ujin, me të cilin u la. Nuk mund ta zbehim vijën ndarëse mes kishës dhe botës dhe as të bashkojmë dritën me errësirën (shih 2 e Korintasve 6:14–7:1). Lagjet e varfra nuk kanë nevojë për një “qendër komunitare” tjetër, e cila merret me projekte në “ndihmë të lagjes” apo mban trajnime se si të jemi prindër të përgjegjshëm. Ata kanë nevojë për fortësa pararojë të mbretërisë së Perëndisë, që janë aq të dallueshme sa kripa, dhe që ndriçojnë përreth si fenerë të vendosur mbi kodra.

Pjesa 3

**VEPRA KISHËMBJELLËSE
NË VENDE TË VËSHTIRA**

Përgatituni

Pastorët, studentët e shkollave teologjike dhe kishëmbjellësit e ardhshëm më drejtohen mua (Mezit) pothuajse me të njëjtën mori pyetjesh në lidhje me shërbesën tonë në Nidri. Si mund ta arrijmë lagjen e varfër, që gjendet pranë selisë së kishës sonë? A duhet të mbjellim një kishë të re apo të përpiqemi të rijetësojmë një kishë ekzistuese? Si mund ta dimë nëse jemi të prerë për këtë lloj shërbese? A duhet të zhvendosemi në një zonë të varfër apo jo?

Nuk kemi kohë që t'u përgjigjemi të gjitha pyetjeve në këtë kapitull, por dëshiroj të ndaj me ju disa prej mësimëve më të rëndësishme që kam marrë gjatë rrugës.

1. Pranoni realitetin e vështirë

Pak kohë përpara se të vendosesha në Nidri në vitin 2007, dikush më dërgoi një kopje të gazetës *The Scotsman* (Skocezi), e cila është një nga të përditshmet më në zë të vendit tim, dhe kishte një artikull me titullin e mëposhtëm në lidhje me kishën që unë shpejt do të filloja ta drejtoja: “Kisha e re detyrohet të përqafojë një mendësi fortëse pas akteve vandale.” Artikulli fillonte me këto fjalë:

Një kishë e ndërtuar tërësisht falë dhurimeve të një bashkësie të Nju Taunit është detyruar që të harxhojë plot 10,000 sterlina për “t’u fortifikuar” pas sulmit që pësoi prej një grup vandalësh që i shkaktuan asaj dëme me vlerë mijëra sterlinash. Anëtarët e kishës “Charlotte Baptist Chapel” në rrugën “Rose Street” mblodhën më se 700,000 sterlina, me qëllim që të ndërtohej një bashkësi e re besimtarësh në Nidri. Mirëpo brenda pak javësh nga përrurimi i ndërtesës së re të kishës, ajo kishte rënë disa herë pre e akteve vandale, të cilat kishin sjellë për pasojë thyerjen e xhamave të dritareve dhe të tubave të ngrohjes qendrore.¹

Sapo kisha ardhur nga puna me bandat e rrugës në Brazil, kështu që e kisha njëfarë përvoje me realitetin e ashpër të të shërbyerit nëpër lagje të varfra pranë qendrës së qytetit. Mirëpo, Skocia ndryshon shumë nga Brazili. Ndonëse të dhunshëm dhe të varfër, amerikano-jugorët ende e kanë frikën e Perëndisë dhe e ruajnë njëfarë respekti për kishën. Kur mbërrita në Nidri, u bë menjëherë e qartë se megjithëse njerëzit me fjalë bënë gjoja sikur e nderonin Perëndinë, ata nuk kishin asnjë fije respekti për kishën e Tij, dhe aq më pak për kredencialet e mia si shërbëtor i Tij.

Trashëgova një ndërtesë kishe që sulmohej vazhdimisht nga fëmijët dhe të rinjtë e zonës. Dritaret tona thyheshin shpesh, makinave u vihej zjarri, ndërsa anëtarët e kishës sulmoheshin tek ecnin në rrugë. Çfarë e bënte situatën edhe më të keqe, ishte se këto abuzime kishin vite që vazhdonin, aq sa, t’i shkaktoje dëme ndërtesës, ishte kthyer në një rit kalimi nga fëmijëria në rini për të rinjtë e zonës. Të krishterët brenda ndërtesës, shumica prej të cilëve jetonin jashtë lagjes dhe vinin pikërisht për të ndjekur shërbesat, ishin shënjestra të lehta për t’u goditur.

Grupi i vogël i besimtarëve që trashëgova, ishin njerëz të

¹ Versioni online i gazetës *The Scotsman*, 18 mars 2006, <http://www.scotsman.com/news/new-church-forced-into-fortress-mentality-after-vandals-attack-1-974347/>.

ndërgjegjshëm e qëllimshëm dhe kishin një dashuri të përnjëmendte për Nidrin. Problemi ishte se ata po përpqeshin të ndalonin dekada të tëra përkeqësimi duke mbetur nga pikëpamja kulturore si mish i huaj për atë skemë strehimi. I vetmi kontakt që ata kishin me komunitetin, qenë shërbesat e së dielës dhe ndonjë fushatë rastësore e shpërndarjes së broshurave nëpër rrugë apo duke trokitur në dyert e shtëpive të lagjes. Madje edhe mënyra se si organizoheshin dhe realizoheshin shërbesat e kishës që e lidhur me kulturën e një kishe të përbërë nga profesionistë të qendrës së qytetit dhe jo me atë të një kishe që gjendej në një lagje të varfër.

Kur kisha doli për të kërkuar një pastor të ri, ata donin një person që të bëhej pjesë e kishës dhe të vazhdonte t'i bënte gjërat në të njëjtën mënyrë si edhe më parë. Nuk do shumë për ta kuptuar që muajt e parë qenë tej mase të vështirë për mua. Anëtarët e kishës e kishin mendjen vetëm te programet kishtarë. Një ditë mora një e-mail nga një anëtar i pakënaqur, i cili më qortoi ashpër, sepse kisha hequr dyzet e shtatë lloje broshurash ungjillëzuese nga kafeneja e kishës (faktikisht, ishte e-mail-i i dytë i këtij lloji). Sipas tij, unë po mbysja ungjillëzimin. Pak sekonda më pas, më erdhi një e-mail tjetër, dërguesi i të cilit donte të dinte se përse nuk doja ta nxisja korin e kishës që të dilte nëpër rrugë për të kënduar këngë krishtlindjeje. Një anëtar tjetër kishe donte të dinte nëse do të bëja shfaqje drame nga katedra e predikimit, sepse në të kundërt ai do të largohej nga kisha.

Nga ana tjetër, lagja e Nidrit kishte halle të tjera, të ndryshme nga tonat. Një ditë përpara se t'i merrja këto e-mail-e, kalova disa orë duke folur me një të ri që qe përdhunuar prej ungjërve të tij që fëmijë dhe që tani bënte prostitutën në qytet për të siguruar të hollat me të cilat do të blinte kokainën kristallore, nga e cila që i varur. Një gruajë tjetër i kishin prerë dritat, sepse nuk kishte me se të paguante faturat. Gjatë natës, disa

fëmijë kishin vjedhur tubat e ulluqeve dhe kishin shkatërruar me shkopinj golfi shkallët hyrëse për në ndërtesën e kishës.

Me pak fjalë, kishte një mungesë të plotë lidhjeje mes njerëzve që mblihdeshin në atë ndërtesë dhe jetëve të atyre që gjendeshin jashtë saj.

Teksa qëndroja ulur atë mëngjes të ftohtë vetëm me veten time, u zhyta në mendime duke e vrarë mendjen se si do t’ia dilja ta ndryshoja për mirë situatën në atë kishë. Kur mbolla kishën në Brazili, e bëra këtë duke ia nisur nga A-ja. Kjo do të thotë se ishte e lehtë që ta injektoja ADN-në e unguillit në atë krijesë të re. Kurse këtu ku isha tani, luhej një lojë krejt tjetër. Si do t’ia dilja që t’i bashkoja këto dy botë të ndryshme? Ndershmërisht e them se në ato çaste qeshë gati të largohe-sha. Mirëpo, në fund fare vendosa të qëndroj, duke e pranuar kështu deri në palcë faktin që kisha një punë shumë të vështirë përpara. Kishat që ekzistojnë në lagje të varfra po vdesin për një numër arsyesh dhe të gjitha këto arsye janë të lidhura me vështirësitë me të cilat përballen. Si mbjellja e kishave ashtu edhe rijetësimi i tyre janë punë të vështira. Zor se keni për të gjetur ndonjë element romantik në një punë të tillë.

2. Kupto motivet e tua

Në kishën tonë, pra, në Kishën Komunitare të Nidrit, vijnë shpesh vizitorë, të cilët preken nga shërbesa jonë dhe pastaj thonë një gjë të tillë: “E kam shumë për zemër këtë veper shërbese. Do të dëshiroja të kthehesha sërish dhe të shërbeja këtu.” Në çdo rast i inkurajoj këta njerëz që të mendojnë për motivet që i shtyjnë ata. Nuk mjafton vetëm lidhja emocionale me një veper shërbese. Natyrisht këta njerëz e duan Jezusin. E megjithatë, brenda pak javësh nga kthimi i tyre në shtëpi, ndjenjat shpesh zhduken dhe ata i kthehen jetës së tyre të përditshme. Bibla na mëson se edhe besimtarët fetarë shtyhen disa herë prej motiveve plot dritëhije (Mateu 6:1–6; Marku 9:34; 12:38–40).

E ndeshnim të njëjtin problem edhe në Brazil. Shërbëtorët vinin dhe iknin brenda pak muajve, duke përfunduar me “motor të djegur” për shkak të intensitetit dërrmues të shërbesës. Gjërat që duken aq magjepsëse gjatë një prezantimi prekës në një sallë misioni ose mjaft tërheqëse në faqet e një libri, nuk janë aspak të tilla në jetën reale. T’i hyni shërbesës duke u mbështetur në fuqinë e ndjenjave personale apo në idenë romantike të dashurisë për të varfrit është njësoj si t’ia hapni derën një fatkeqësie të madhe në jetën tuaj. Po, t’i keni për zemër njerëzit dhe t’i doni të nëpërkëmburit janë gjëra të nevojshme, por nuk mjaftojnë që t’u mbijetoni me sukses vështirësive të jetës së përditshme në terren.

Cilat janë motivet e duhura për t’i hyrë kësaj pune? E pranoj ndershmërisht se një i droguar mashtrues dhe kutërbues nuk më frymëzon edhe aq, sa ta jap jetën time për të. Vetëm dashuria ime për Jezusin më bën aq të aftë, sa t’i dua ata qelbanikë. Vetëm të kuptuarit e duhur të hirit të Perëndisë në Jezu Krishtin dhe të faktit që Krishti vdiq për një qelbanik si puna ime, i ndërthurur me vlerësimin e lartë për ungjillin, më bën të aftë që t’u shërbej njerëzve të tillë me gëzim, përkundër moskokëçarjes dhe qëndrimit të tyre armiqësor ndaj ndihmës sime. Tekefundit, nuk po e bëj këtë për t’i kënaqur ata, por sepse i shërbej plot dashuri një Shpëtimtari që *më* ka nxjerrë nga e njëjta gropë gjirizi.

Një psikiatër ka shkruar këto fjalë:

Siç ndodh me të tjerët që i hyjnë një profesioni ndihmues, disa herë motivi që i shtyn njerëzit për t’i hyrë shërbesës është që të fitojnë vlerësimin, vëmendjen dhe pranimin që atyre iu nevojitet, por që nuk po e përfitojnë askund tjetër. Shpeshherë është dëshira e pavetëdijshme për t’i sunduar të tjerët dhe për rrjedhojë për t’u shndërruar në papë të vegjël, qëllim i cili është lehtësisht i realizueshëm kur u shërben njerëzve të papjekur. Shumë pastorë kënaqen jashtëzako-

nisht, në mënyrë të pavetëdijshme, nga mundësia që u ofrohet për t'i udhëhequr njerëzit dhe për t'i rregulluar ata.²

Mendoj se i ka rënë pikës.

Kështu që, edhe ju duhet ta pyesni veten: Përse vallë dëshironi të shërbeni mes të varfërve? Çfarë motivi ju shtyn për ta bërë këtë? Drejtësia sociale dhe shërbesat e mëshirës përbëjnë refrenin e botës ungjillore në ditët e sotme. Mirëpo, siç e pamë më lart, realiteti mund të jetë shumë ndryshe nga idetë romantike, që shumë njerëz kanë në lidhje me këtë lloj shërbese. Duhet të jemi të vetëdijshëm për motivet që na shtyjnë, sepse do të na godasin si një bumerang, në qoftë se nuk i mendojmë mirë gjërat përpara se të angazhohemi në ndonjë lloj shërbese.

3. Shtresa shoqërore, së cilës i përkasim, nuk është e rëndësishme

Shumë të rinj e të reja e shohin me mjaft interes shërbesën e 20Skemave. Shumë prej tyre vijnë nga familje normale, dhe janë të mirëarsimuar. Pyetja e parë që më bën pothuajse gjithsecili prej tyre, është: A jam shumë i pasur për të shërbyer nëpër skema? Është një pyetje e mirë. Pavarësisht pretendimeve (të cilat i shprehin ata që janë në pushtet) se çështja e ndarjes në klasa mbivlerësohet, prapëseprapë ekziston një ndarje kulturore mes klasave në Mbretërinë e Bashkuar. Njerëzit e ndiejnë, e prekin dhe e shfaqin këtë ndarje në mënyrën se si ecin, flasin dhe vishen.

Tani, të rinjtë në fjalë, po të ishin në kushte të tjera, nuk do ta konsideronin veten e tyre si të pasur. Me shumë gjasë do ta konsideronin veten si njerëz normalë. Mirëpo, ata shqetësohen se njerëzit e shtresës së ulët/klasës punëtore do ta bëjnë këtë dallim. Tekefundit, ne “të varfrit e qyteteve” jo vetëm që mezi presim të shpërthejmë ndaj atyre që mund të na përbuzin qoftë edhe një

² Basil Jackson “Psychology, Psychiatry, and the Pastor: Part II: Maturity in the Pastor and Parishioner” *Bibliotheca Sacra* 135 (prill 1975): fq. 111–12.

grimë, por kur e bëjmë këtë, shpërthimi i vullkanit as që ka të krahasuar! Për ne, të jesh “i pasur” do të thotë që të të pëlqejë humusi, që të dy prindërit i ke ende të martuar me njëri-tjetrin dhe që mbase në darkë luani lojëra tavoline së bashku. Neve na pëlqen të porosisim ushqim fast-food-i dhe të shohim shfaqje të tilla televizive si Big Brother dhe The Voice of Albania. Njerëzve të pasur u pëlqen kërcimi artistik, të shohin shfaqje teatrale dhe të pinë një gotë verë të kuqe në shoqërinë e miqve.

Përgjigjja ime e zakonshme për pyetjen e tyre është kjo: “A mendon se njerëzit do të përfundojnë në ferr po qe se nuk kthehen nga mëkatet e tyre dhe nuk i zënë besë vetëm Krishtit për shpëtimin e tyre?” Në qoftë se përgjigjen po, atëherë vazhdon bashkëpunimi me ta. Në qoftë se skuqen dhe zënë e belbëzojnë dhe duket qartë se nuk ndihen aspak rehat, kjo për ne është një shenjë se me shumë gjasë nuk bëjnë për shërbesë në mjedisin tonë. Ne të skemave të strehimit presim përgjigje të drejtpërdrejta për pyetjet tona të drejtpërdrejta.

Natyrisht, ndarja klasore ndihet deri në njëfarë pike. Ndihe mëspastorit tim i pëlqen të shohë seriale të ambientuara nga shekujt e kaluar përkundër përpjekjeve të mia për ta shpëtuar atë. Ai madje mban një çantë burrash tek ecën rrugëve të Nidrit dhe shpesh më duhet të duroj talljet dhe turpërimin, për shkak se jam duke ecur bashkë me të, ndërsa e mban çantën. Ama, a e dini një gjë? Pa të Nidri nuk do të ishte edhe aq interesant. Pa të jeta ime nuk do të ishte edhe aq e pasur sa është. Përndryshe kush do të tallej me sjelljet e tij prej të pasuri? Tani le të flasim seriozisht, atë njeri e njeh edhe e do nga më i vogli te më i madhi në skemën tonë, sepse është një njeri i vërtetë, që i do njerëzit edhe është përherë gati t’iu flasë atyre në mënyrë “të drejtpërdrejtë”.

Pyetjet e tjera që u bëj punëtorëve të ardhshëm janë: A e njeh dhe a do Jezu Krishtin? A i do njerëzit aq fort sa t’u flasësh atyre për gjendjen e tyre mëkatore? A e do kishën lokale? A je gati të përfshihesh thellë në jetë të rrëmujshme për një periudhë

afatgjatë? Në qoftë se je gati, atëherë gjërat e tjera nuk kanë aspak rëndësi. Nuk të duhet ta hedhësh as çantën tënde për burra dhe as kutinë e setit *Dasma Mbretërore (Royal Wedding)* edicioni special (të cilin e mban në një nga sirtarët e komosë tënde, kuptohet).

Pa dyshim, për ata që nuk janë mësuar me të, jeta nëpër skema është fillimisht paksa tronditëse. Është e vështirë që t'i përshtatesh mendësisë që mbizotëron atje, por jo e pamundur. Pali ishte judeu i judenjve, ama e çoi ungjillin te johebrenjtë dhe për ta bërë këtë iu desh të kapërcente një rrëmujë të tërë vështirësish kulturore. Ç'rëndësi ka nëse njerëzit që po ia çojnë ungjillin të varfërve, pinë makiato me bazë çaji të zi? Njerëzit po vdesin pa Krishtin, kjo është çka ka vërtet rëndësi për ne. Në fund të fundit, gjëja më e rëndësishme është që të jesh një person i brumosur mirë, që e do Jezusin dhe njerëzit. Mund të duhet ca kohë derisa të përshtatesh, por këmbëngulja, të qenët vetvetja dhe i mësueshëm të ndihmojnë shumë që banorët e skemave të të pranojnë.

4. Duhet të keni mbështetjen e familjes suaj

Shërbesa në lagjet e varfra pranë qendrës së qytetit mund të jetë për ju një punë monotone, që nuk ju fal shumë kënaqësi, e hidhur, përsëritëse, e ngadalshme, shkurajuese, pezmatuese dhe e lodhshme. Mund të jeni vazhdimisht objekt shpifjesh dhe thashethemesh. Për pasojë, jeta juaj familjare është një përbërës thelbësor për një shërbesë ungjilli të shëndetshme. Pa gruan time në krahun tim, e cila më mbështet, lutet për mua, më kritikon kur duhet, dhe më do, zor se do të kisha zgjatur kaq shumë në shërbesën ku jemi të angazhuar. Shërbesa në një lagje të varfër ndikon mbi familjen time. Unë sjell të huaj të çdo lloji në shtëpi për të ngrënë me ne, për të bërë një dush dhe për të ndërruar rrobat dhe shpesh e njoftoj gruan për këtë gjë vetëm disa minuta përpara se të arrij në shtëpi. Gruas sime asnjëherë

nuk i dridhet qerpiku. Ajo ka një dhunti hyjnore për mikpritje dhe është pafundësisht e durueshme, madje edhe me mysafirët më llafazanë. Kemi kaluar net të tëra me njerëz që po e linin po atë natë varësinë e tyre. Na kanë ardhur njerëz që nuk i njihnim për drekën e Krishtlindjes. Edhe në pushimet tona si familje na janë bashkëngjitur të ftuar nga më të ndryshmit. E megjithatë, përkundër të gjitha këtyre gjërave, ia kemi dalë ta ruajmë dashurinë tonë për njëri-tjetrin dhe një vlerësim të thellë për rolet tona të ndryshme brenda shërbesës sonë të përbashkët.

Shtëpia ime, megjithëse gati përherë e mbushur me njerëz, është një oazë paqeje edhe në kohët më të stuhishme. Gruaja ime nuk i kundërvihet shërbesës sime dhe as mua. Ne dalim së bashku si çift. Dalim së bashku si familje. Lutemi së bashku. Mirëpo, kur paraqitet një rast urgjent apo kur problemet e lidhura me drejtimin e kishës bëhen mal, ajo nuk ma vështirëson më tej jetën duke u ankuar apo duke u përpjekur të më tërheqë vëmendjen me gjërat e saj. Kjo lloj shërbese të përfshin kokë e këmbë. Në qoftë se jeni lloji i personit që e ndan kohën e vet në ngastra me emërtimet “koha për shërbesë”, “koha për argëtim” apo “koha për veten”, kjo shërbesë nuk bën për ju. Nuk duhet që të jeni domosdoshmërisht i martuar që të keni sukses në shërbesë, mirëpo nëse jeni çift, atëherë lipset një martesë e lumtur dhe e sigurt dhe një bashkëshorte që është pafundësisht mbështetëse. Në qoftë se ju mungojnë këto gjëra, dilni me të shpejtë nga shërbesa. Në qoftë se kam mbijetuar kaq gjatë, kjo ka ndodhur se Perëndia është i mirë, dhe sepse gruaja ime përpigjet gjatë gjithë kohës që shtëpia jonë të jetë një liman përherë i mbrojtur nga stuhitë e shërbesës, edhe pse unë vazhdimisht sjell çikla balte në shtëpi.

5. Duhet të keni mbështetjen e pleqve të kishës suaj

Kohë pas kohe në derën e kishës sime trokasnin njerëz që kanë dëgjuar për shërbesën tonë dhe për ne. Zakonisht ata vijnë,

sepse po lënë bashkësinë e tyre për t'u bashkuar me tonën, meqë janë të interesuar për të shërbyer mes të varfërve (janë të shumtë edhe ata që thjesht dëshirojnë t'i bashkohen kishës sonë). Pa asnjë përjashtim, i pyes ata për kishën prej nga vijnë. Kë kishit pastor? A kishte pleq ajo kishë? Çfarë thonë ata në lidhje me planet tuaja?

Shpeshherë, pyetjet e mia ngjallin hutim tek ata. Qëndrimi që ata mbajnë zakonisht, është: “Ç’hyjnë ata në këtë mes? Unë bëj çfarë të dua.” Ose më thonë: “Ata nuk më kuptojnë mua. Perëndia më ka folur mua për këtë edhe atë gjë, dhe ata as që i kapin fare këto gjëra.” Ata e marrin si të mirëqenë faktin që unë do ta kuptoj vizionin e tyre për sa i përket veprës së shërbesës mes të varfërve më mirë sesa pleqtë e kishës së tyre. Mirëpo, ata e kanë shumë gabim.

Autori i Letrës drejtuar Hebrenjve na kujton se duhet t'i: “Dëgjoni udhëheqësit tuaj dhe bindjuni, sepse ata rrinë syhapur mbi shpirtrat tuaj, si ata që duhet të japin llogari; që ta bëjnë këtë me gëzim dhe jo me psherëtima, sepse kjo nuk do t’ju sillte dobi” (13:17). Njerëzit kanë të drejtë ta ndiejnë se janë thirrur për çfarëdolloj shërbese, por ata duhet që këtë thirrje ta konfirmojnë prej atyre që ushtrojnë mbikëqyrje frymërore mbi ta.

Një gjë është e sigurt: në qoftë se ju nuk i nënshtroheni dot drejtuesve tuaj frymërorë, atëherë nuk duhet t'i hyni një shërbese ku lipset që njerëzit t'i nënshtrohen udhëheqjes suaj. Në qoftë se pleqtë dhe drejtuesit e kishës suaj nuk ju mbështesin, e vë dorën në zjarr se ju nuk jeni gati për shërbesë në këtë pikë të jetës suaj. Në qoftë se doni të angazhoheni në punë kisha mes të varfërve, flisni me pleqtë ose drejtuesit e kishës suaj dhe kërkoni atyre që të lutën për ju dhe t’ju këshillojnë.

6. Duhet të luteni

Kur e fillova shërbesën në Sao Luis, askush tjetër nuk po bënte

gjë për të arritur fëmijët e rrugës. Fillova të lutem për një skuadër dhe për mundësinë që të arrija fëmijët. Brenda disa javëve kisha takuar një grua në moshë që quhej Otaselia, dhe kisha filluar të mbledhja një skuadër të vogël brazilianësh të interesuar. Përpara se të fillonim veprën e shërbesës, ramë dakord që të takoheshim ditë për të ditë për të studiuar Biblën dhe për t'u lutur së bashku. Çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje zhvillonim një takim lutjeje përpara se të dilnim nëpër rrugë. E vazhduam këtë praktikë gjatë gjithë qëndrimit tim në Brazil.

Kur erdha fillimisht në Kishën Komunitare të Nidrit, e hapja ndërtesën e kishës herët në mëngjes për t'u lutur për bashkësinë dhe për lagjen përreth. Ndërkohë që e njoha më mirë atë zonë dhe zura të mësoj emrat e banorëve të saj, nisa të lutem edhe për ata gjithashtu. Teksa njerëzit shpëtoheshin, zura të lutem edhe për familjet e tyre. Nisa të lutem edhe për anëtarë të rinj për skuadrën time. Dhe pastaj diçka ndodhi: Perëndia iu përgjigj lutjeve të mia. Kjo kohë lutjeje, e cila filloi shtatë vjet më parë, vazhdon pothuajse çdo mëngjes edhe sot e kësaj dite.

Lutja luan absolutisht një rol kyç *përpara, gjatë* dhe *pas* shërbesës. Tekefundit gjendemi në një luftë frymërore. Pali i kujton Kishës në Korint se “perëndia i kësaj bote ua verboi mendimet e atyre që nuk besojnë, që drita e ungjillit të lavdisë së Krishtit, që është shëmbëllimi i Perëndisë, të mos ndriçojë tek ata” (2 e Korintasve 4:4). Armiku ynë nuk do të mposhtet edhe aq lehtë. Ai do të përdorë çdo hile në dispozicion të tij për ta penguar veprën e shërbesës së ungjillit. Ai do të sulmojë familjen, miqtë, kishën dhe fqinjët tuaj. Djalli, bota dhe mishi janë armiqtë tanë më të përbetuar në këtë botë dhe armiqtësia e tyre intensifikohet pikërisht atëherë kur gjendemi në vijën e parë të frontit të shërbesës së ungjillit.

Vini re lidhjen mes luftës frymërore dhe lutjes në udhëzimet që i jep apostulli Pal kishës në Efes:

Vishni gjithë armatimin e Perëndisë që të mund të qëndroni kundër dredhive të djallit, sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të përbotshëm të errësirës të kësaj jete, kundër frymërave të liga në vendet qiellore. Prandaj merrni të gjithë armatimin e Perëndisë, që të mund të rezistoni në ditën e ligë dhe të qëndroni në këmbë pasi të keni kryer çdo gjë. Qëndroni, pra, të fortë, duke ngjeshur mesin tuaj me të vërtetën, të veshur me parzmoren e drejtësisë, dhe duke mbathur këmbët me gatishmërinë e ungjillit të paqes, mbi të gjitha duke marrë mburojën e besimit, me të cilën mund të shuani të gjitha shigjetat e zjarra të të ligut. Merrni përkrenaren e shpëtimit dhe shpatën e Frymës, që është Fjala e Perëndisë, duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lutje dhe përgjërime në Frymë dhe, duke ndenjur zgjuar për këtë me çdo këmbëngulje dhe përgjërime për të gjithë shenjtorët. (Efesianëve 6:11–18)

Lutuni për skemën e strehimit, banesat sociale, parkun e ri-morkiove apo lagjen e varfër pranë kishës suaj. Lutuni fort dhe shpesh. Lutuni për kthime në besim. Shpeshherë nuk marrim, sepse nuk lutemi. Çfarëdo mendimesh që të keni në këtë çast rreth përfshirjes në veprën e ungjillit mes të varfërve, lëshojeni këtë libër nga dora në çast, uluni në gjunjë dhe lutjuni Perëndisë, Shumë të Lartit. Kjo është gjëja më e mirë dhe më e rëndësishme që mund të bëni.

7. Duhet të njihni mirë lagjen tuaj

Përshtypja që kemi për lagjet pranë qendrës së qytetit, sikurse skemat e strehimit dhe banesat sociale në Mbretërinë Bashkuar apo ekuivalentët e tyre në Shtetet e Bashkuara, është kryesisht negative. Kur dëgjojmë për Bronksin apo për pjesën lindore të Glasgout, gjëja e parë që na vjen ndër mend, janë shpërndarësit

e drogës që rrinë qosheve, dhe ekzekutimet mafioze. Kjo përshlytje negative i ka pak a shumë rrënjët e saj në realitet. Këto janë vende të botës me statistika të tmerrshme krimi, vdekje të parakohshme, krime droge dhe shifra të larta të vdekshmërisë foshnjore.

Mirëpo, kjo nuk është gjithçka që e përbën një lagje. Në ofhtë se zhvendoseni në një lagje të caktuar dhe zhyteni në jetën e saj të përditshme, duke jetuar, duke punuar dhe duke lidhur miqësi me vendasit, do të zbuloni një strukturë të pasur jete dhe kulture. Problemi është që shumica e mendimeve dhe shkrimeve rreth shërbesës mes të varfërve kanë për autorë njerëz që janë të mirëarsimuar dhe që i përkasin shtresës së mesme. Kjo nuk është domosdoshmërisht një gjë e gabuar. Nuk duhet të kesh lindur në një vend të caktuar për të shërbyer atje. Siç e thashë më lart, gjëja që ka më shumë rëndësi sesa gjithçka tjetër, është që të duash Jezusin dhe njerëzit. Mirëpo, kjo dashuri do të shfaqet edhe në faktin që nuk do t'i lini supozimet tuaja kulturore që t'ju çojnë në rrugë të gabuar. Shumë vepra ungjillëzuese në lagjet e varfra mbeten pa fryt, sepse njerëzit që angazhohen në shërbesë nuk e kuptojnë dot kulturën dhe përbërjen e zonës së caktuar, në të cilën shërbejnë, dhe as përpiqen me dashuri për ta kuptuar atë zonë.

Kështu që, nëse mendoni që ta arrini zonën pranë jush, apo nëse sapo jeni zhvendosur në një zonë të vështirë, ja ku i keni disa pyetje që duhet të filloni t'ia bëni vetes dhe të tjerëve (mirëpo bëni kujdes që të mos bëni shumë pyetje, sepse njerëzit mund të fillojnë të mendojnë se punoni për policinë!):

- Cili është vizioni juaj për kishën në këtë lagje?
- Cilët janë njerëzit kyç që duhet të përfshini në këtë vepër?
Ç'dhunti kanë ata?
- Kë dëshironi të arrini? Si do t'i arrini ata në një mënyrë të efektshme?

- A ka grupe të tjera që veprojnë në këtë komunitet (shekullare ose jo)? Sa të efektshme janë ato?
- Kush mund t'ju ndihmojë për të mësuar më tepër rreth lagjes suaj?
- A është dikush në këtë lagje që do t'ju hapë rrugën për t'u integruar më shpejt në të?
- Çfarë lloj njerëzish e keni të lehtë që t'i bëni për vete? A gjenden këta njerëz në lagjen tuaj?
- Banorëve të lagjes suaj, çfarë iu pëlqen të bëjnë?
- Kë duhet të rekrutoni me qëllim që të bëni për vete njerëzit që ju nuk i arrini dot në mënyrë të natyrshme?
- Si i ndërtoni marrëdhëniet e qëllimshme brenda komunitetit tuaj? Vetëm? Si çift? Si një grup i vogël?
- Ç'plan keni për ungjillëzimin dhe dishepullimin?

Në qoftë se zhvendoseni në një lagje të varfër, lutuni rregullisht për të dhe studiojeni atë sa më thellë që të mundeni. Pranojeni që ka shumë gjëra që ju nuk i kuptoni dhe se do t'ju duhet shumë kohë, përpjekje dhe dashuri derisa t'i kuptoni ato. Mirëpo, në qoftë se do të punoni me njerëzit në mjedisin e tyre rrethues, gradualisht, por me siguri, do të filloni të përftoni një njohje më të mirë të komunitetit. Kjo do të jetë një gjë që do t'ju shërbejë pa masë në vitet që do të vijnë.

Përgatit punën

Unë (Mezi) i kalova dymbëdhjetë muajt e parë shërbesës sime baritore duke vëzhguar Kishën Komunitare të Nidrit dhe duke u përpjekur që të njihja besimtarët e saj. Teksa i dalloja një nga një pikat e forta dhe të dobëta të kësaj bashkësie, kuptova që na nevojitej një qasje e re për sa i përket shërbesës në terren. Ballafaqoheshim me një mori problemesh:

- Na nevojiteshin më tepër pleq kishë, por edhe duhet ta kuptonim si duhet rolin e tyre.
- Ekzistonte një mendësi “predikojë ungjillin dhe ata do të vijnë” në lidhje me ungjillëzimin. Nuk është për t’u habitur që askush nga të lagjes nuk vinte.
- Njerëzit prisnin që pastori të kryente shumicën e veprës së përditshme të shërbesës.
- Kur u kërkova anëtarëve të bashkësisë që të më shpjegonin misionin dhe qëllimin e kishës, mora po aq përgjigje sa anëtarë kishte kisha.
- Lagjja kryesisht armiqësore përreth nesh e konsideronte kishën dhe ata brenda saj si një mish të huaj.

- Shumë prej anëtarëve të bashkësisë nuk i shfrytëzonin dhuntitë e tyre për të mirën e trupit të gjerë të kishës.

Ne duhet të përparonim. Mirëpo, nga t'ia fillonim? Si ia dalin kishëmbjellësit, kishat në skajet e lagjeve të varfra apo ato bashkësi, të cilave iu duket se nuk kanë asnjë lidhje me lagjet e varfra, që të hedhin hapa pozitivë dhe praktikë drejt ndërtimit të kishave të shëndosha?

Ndërtoni dhe fuqizoni drejtuesit e perëndishëm

Gjatë javëve të mia të para në Kishën Komunitare të Nidrit, dikush më pyeti se ç'model kapaku dëshiroja për furrën e kishës. Më pyetën, pra, për një gjë e cila nuk më interesonte aspak. Pastaj fillova t'i mësoj bashkësisë se pastori nuk duhet të merrte pjesë në të gjitha takimet e kishës dhe as duhet të merrte çdo vendim në lidhje me të. Mikromenaxhimi (menaxhimi i hollësive më të vogla) nuk shërben për pajisjen e njerëzve dhe as për ndërtimin e një skuadre; këtë e bën delegimi i pushtetit. Pa shqyrtoni pak vargjet e mëposhtme nga Bibla:

- “Pastaj Ai i thirri pranë Vetes të Dymbëdhjetët dhe filloi t'i dërgojë dy nga dy; dhe u dha pushtet mbi frymët e ndyra.” (Marku 6:7)
- “Pas këtyre Zoti caktoi shtatëdhjetë të tjerë dhe i nisi dy e nga dy përpara Tij, në çdo qytet dhe vend, ku Ai do të shkonte.” (Luka 10:1)
- “Dy vlejné më mirë se një i vetëm, sepse kanë një shpërblim të mirë për mundin e tyre. Në fakt nëse rrëzohen, njëri ngre tjetrin; por mjerë ai që është vetëm dhe rrëzohet, sepse nuk ka njeri që ta ngrejë!” (Predik. 4:9–10).

1. Identifikoni dhe trajtoni pleqtë e kishës

Kisha kishte drejtues, mirëpo dy prej tyre po plakeshin dhe dukej që për njerëzit nuk ishte e qartë se cilat ishin kriteret për

këto poste drejtuese. Për t'u rritur në mënyrë të shëndetshme, na duhej një pleqësi e fortë dhe që e njihte mirë Shkrimin për të bërë hapa përpara. Kështu që, gjatë dy vjetëve pasues ndër-mora hapat e mëposhtëm:

- Gjatë vitit tim të parë u takova individualisht me burrat e kishës për të mësuar më tepër rreth tyre.
- Fillova t'u jap disave prej tyre mundësinë për të drejtuar shërbesën e së dielës dhe takimin e lutjes së mesjavës.
- I sfidova të mendonin për gjendjen e shpirtit të tyre dhe për ecjen e tyre me Jezusin (çka përbënte një risi për shumë prej tyre).
- I vëzhgoja me kujdes ata që e përballonin me sukses sfidën e të drejtuarit, apo që me lutjet e tyre drejtonin takimin e mesjavës, apo që vizitonin rregullisht pleqtë a të sëmurët.
- Burrave u dhashë që të lexonin materiale në lidhje me çështje nga më të ndryshmet, sikurse doktrina e kishës, ungjilli, udhëheqja, gratë në shërbesë, si dhe nxita një debat të shëndoshë e të mirëmenduar në lidhje me to.
- Një herë a dy herë në muaj dilnim së bashku, herë dy nga dy e herë të tjera në grupe. Desha të shihja se si do të bashkëvepronin burrat me njëri-tjetrin.
- Lutesha që Zoti të më jepte urtësi për të ecur përpara.

Pas dy vjetësh, mora me vete një grup të vogël burrash për ta kaluar gjithë ditën me ta. Ata nuk ishin të një moshe (shkonin nga të njëzetat deri te të gjashtëdhjetat) dhe zotëronin një larmi të madhe dhuntish. Kaluam një ditë të plotë së bashku duke u lutur dhe duke folur për një varg çështjesh doktrimore dhe teologjike. E studiuam Shkrimin dhe ndamë dëshmitë tona se si na kishte shpëtuar Zoti dhe se si na kishte sjellë aty ku ishim. Diskutuam çështjet e mëposhtme:

- Rolin e pleqve

- Gjendjen aktuale dhe të ardhmen e Kishës Komunitare të Nidrit
- Ungjillëzimin
- Dishepullimin
- Formën e organizimit të kishës
- Trajnimin e drejtuesve të ardhshëm

Ishte një mundësi fantastike për mua që t'i shihja këta burra se si bashkëvepronin, por çka është më e rëndësishme, ishte t'i shihja ata se si ndryshonin në mendime nga njëri-tjetri dhe se si i zgjidhnin mosmarrëveshjet e tyre në një mënyrë të pjekur e biblike. Disa qenë më të fortë nga pikëpamja teologjike sesa të tjerët. Disa qenë më të fortë nga pikëpamja baritore sesa të tjerët. Disa të tjerëve u mungonte aftësia për ta diskutuar doktrinën në thellësi, por ishin nxënës të përlulur. Të gjithë ata i përmbushnin kriteret e të qenët plak kishë sipas 1 e Timoteut 3 dhe Titit 1. Koha që kaluam së bashku, që e mrekullueshme, dhe pasi ia kaluam çështjen e konfirmimit të tyre bashkësisë, shumica prej tyre u shuguruan si pleq të kishës.

Mënyra se si zhvillohej takimi i pleqve ndryshoi në mënyrë rrënjësore. Kaluam nga trajtimi i problemeve të tilla si rregullimi i dyerve të dëmtuara apo fatura e dritave të ballafaqimi me çështje të lidhura me përkujdesjen baritore, lutjen dhe studimin e Biblës së bashku. Lexonim së bashku libra të dobishëm në lidhje me udhëheqjen e kishës dhe pleqësinë.¹

Mbase për ne, pika kyç e kthesës që në vitin 2012, kur si pleqësi vajtëm në Uashington DC për të ndjekur një veprimtari të organizuar nga shërbesa 9Marks, e cila quhej “Konferenca e fundjavës”. Me bekimin e bashkësisë udhëtuam për në Shtetet e Bashkuara dhe kaluam plot katër ditë duke vëzhguar praktikën e Kishës Baptiste Capitol Hill në Uashington DC. Secili prej

¹ Dy libra shumë të dobishëm që na ndihmuan për të menduar rreth këtij roli brenda kishës, qenë librat e Alexander Strauch *Biblical Eldership* (Colorado Springs: Lewis & Roth, 2003) dhe ai i Mark Dever dhe Paul Alexander *Deliberate Church* (Wheaton, IL: Crossway, 2005).

nesh ndiqte seminare të ndryshme gjatë ditës dhe në mbrëmje mbledheshim së bashku për t'i mbledhur njohuritë e grumbulluara, si dhe për të vendosur se cilat ishin gjërat që mund të jepnin fryt edhe në realitetin e shërbesës sonë. Kjo përvojë na afroi edhe më shumë me njëri-tjetrin si vëllezër në Krishtin dhe si nënbarinj të popullit të Perëndisë në Nidri. Edhe pse Kisha Baptiste Capitol Hill dhe Kisha Komunitare e Nidrit dallonin si nata me ditën nga njëra-tjetra, si për nga vendndodhja e tyre gjeografike, ashtu dhe nga kultura, parimet që mësuam gjatë atyre ditëve, patën një ndikim të thellë mbi mënyrën se si e drejtojmë tani kishën. Dobitë që ka pasur kisha prej asaj konference, kanë qenë të pamasa.

- Takimet e pleqësisë i kthyem në të përjavshme nga të përmuajshme, që i kishim.
- Një takim në muaj e kemi lënë për studim personal dhe për komunikim baritor mes nesh si drejtues. Lutemi vetëm për njëri-tjetrin dhe për familjet tona.
- Lutemi për anëtarët e kishës dy herë në muaj.
- Filluam të jepnim mësim jo vetëm për nevojën e anëtarësisë, por edhe për natyrën e saj. Cilat janë përgjegjësitë e drejtuesve? Po ato të anëtarëve?
- I shpeshtuam takimet e anëtarësisë nga një herë në vit në një në çdo tre muaj.
- Hartuam dhe e bëmë të detyrueshme për kishën një strategji për disiplinën kishtarë, të cilën e kemi vënë në zbatim sa e sa herë.

Tashmë kemi një grup pleqsh që po rriten së bashku, duke mësuar së bashku, duke e mbajtur njëri-tjetrin përgjegjës nga pikëpamja frymërore dhe duke e çuar kishën përpara nën drejtimin e Perëndisë dhe të Fjalës së Tij.

Do të flasim pak më tepër në lidhje me përgatitjen e drejtuesve në kapitullin vijues.

2. *Krijoni një skuadër shërbese*

Në ditët e para, shumica e anëtarëve të kishës jetonin dhe punonin jashtë skemës së strehimit. Fillimisht nuk ia dilja dot t'i dishepulloja vetë besimtarët e rinj dhe t'u përgjigjesha të gjitha pyetjeve që më bënin njerëzit e interesuar për të ditur më tepër rreth besimit. Skamnorët po i afroreshin kishës dhe po interesoheshin për të. Më nevojitej ndihmë, por nuk kishte mjaft të krishterë që banonin brenda skemës, apo të krishterë vendas që të ishin aq të pjekur, sa për ta kryer këtë punë.

Kështu që fillova të rekrutoj njerëz nga jashtë skemave, *të huaj për kulturën e skemave*. Këta ishin të rinj të krishterë ose gra të krishtera nga jashtë skemave, që dëshironin të mësonin në lidhje me këtë lloj shërbese, por nuk kishin pasur mundësi për t'u përfshirë më herët në të. Mendova se ata që ishin rekrutë të mundshëm për t'u shërbyer të varfërve në një organizatë parakishitare, do të bënin më mirë sikur të vinin e të mësonin se si ta bënin këtë në Kishën Komunitare të Nidrit. Natyrisht, duhet t'u jepja atyre vizionin e një kisha lokale që do të ungjillëzonte, dishepullonte dhe do t'i pajiste drejtuesit vendas dhe jo thjesht do t'i përdorte dhe shfrytëzonte ata si dado dhe drejtues të rinjsh të mbivlerësuar. Duhet t'i siguroja ata që do të kishin zë në vendimmarrje, për sa i përket nismave të reja për shërbesë. Thënë ndryshe, pleqtë nuk do ta mbysin çdo ide të re që në embrion dhe as do ta ngadalësonin progresin, të shtyrë nga frika që ngjall ndryshimi. Natyrisht, pleqtë do të vazhdonin të mbikëqyrnin gjithçka, por ne ramë dakord që t'i linim liri veprimi skuadrës sonë të shërbesës duke u dhënë mundësi anëtarëve të saj që të merrnin vendime të atypëratyshme në terren pa shumë ndërhyrje nga ana jonë.

Së dyti, rekrutova dhe trajnova *gra* për të shërbyer si *punëtore shërbese*. Në lagjet e varfra të Skocisë, 52% e banorëve janë prindër të vetëm, shumica dërrmuese e të cilëve janë gra. Gratë nëpër skema strehimi vuajnë në përpjesëtim të

madh prej problemeve të vazhdueshme shëndetësore, paafësive dhe dhunës në familje. Këto janë gra delikate dhe nevojtare me probleme të ndërlikuara fizike, mendore dhe frymërore dhe shumë prej tyre ulen në karriget e kishave tona.

Këto probleme nuk ndreqen me anë të takimeve të përjavshme për kafe. Për t'i ndihmuar këto gra nevojitet një përkushtim jetësor me gjithë zemër për të ecur krah për krah me to. Ndonëse është një e vërtetë e gjithëditur, nuk është as gjë e mençur dhe as e përshtatshme për një burrë që të këshillojë një grua apo të kalojë shumë kohë me të. Nëpër skema strehimi, çdo formë zemërbutësie nga ana e një burri mund të keqinterpretohet seksualisht, sepse nuk ka afrodisiak më të fuqishëm për gratë, sesa një burrë që di t'i dëgjojë ato.

Sigurisht që gratë kanë nevojë që të rrethohen prej shembujve të burrave dhe etërve të perëndishëm. Mirëpo, ai lloj mbështetjeje, miqësie, drejtimi frymëror, intimiteti në lutje, këshillimi dhe përkujdesjeje për të cilin shumë gra në kishë kanë nevojë, duhet të vijë prej grave të pjekura edhe të rrënjosura në Shkrimin e shenjtë, të cilat përfshihen në jetën e motrave të tyre për një periudhë afatgjatë. Për pasojë, duhet të rekrutojmë dhe trajnojmë gra, me qëllim që këto të përfshihen aktivisht nëpër shërbesa.

Së treti, rekrutova vetëm *njerëz që qenë të gatshëm për një angazhim afatgjatë*. Si unë dhe Majku e kemi mësuar se shërbesa në vende të vështira funksionon vetëm kur jemi të gatshëm për të hedhur rrënjë në ato vende. Secili prej anëtarëve të skuadrës drejtuese të Kishës Komunitare të Nidrit zotohet që të shërbejë për një periudhë prej dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjetësh. Para pak kohësh, njëri prej kishëmbjellësve të mi më tha se kur po mendohej a të angazhohej në shërbesë pranë kishës tonë apo jo, i bëri një pyetje vetes nëse ishte gati që të vinte dhe të kalonte gjithë jetën derisa të vdiste në atë skemë strehimi. Mbjellja dhe ripërtëritja e kishave nuk është një punë afatshkurtër. Kjo është një punë që jep fryt shumë ngadalë.

Kemi shtatë vjet që e kemi nisur këtë shërbesë dhe vetëm tani po fillojmë të shohim frytet e para. Do të vazhdojmë të merremi me të për një periudhë afatgjatë. Në ditët e para të kësaj shërbesë na u desh që të rrezikonim shumë. Disa prej këtyre risqeve na u shpërblyen, disa të tjera jo (do të flasim më poshtë për këtë). Mirëpo, të rinjtë tërhiqen vazhdimisht prej këtij vizioni. Vizioni i ndihmon njerëzit që të përfytyrojnë mundësi që askush nuk i kishte përfytyruar më herët. Na u deshën ca vjet, por më në fund gjërat po fillojnë të lëvizin. Kup-tohet që është një ndryshim i madh të kalosh nga dhjetë njerëz që jetonin në Nidri në tridhjetë njerëz që jetojnë në të sot.

Mos u mposhtni përpara se të filloni

Shumë kishëmbjellës dhe pastorë me përvojë gjithmonë e pyesin veten se si do t'ia nisin punës kur punojnë vetëm ose kur kanë shumë pak burime në dispozicion. Shumë njerëz vijnë te Kisha Komunitare e Nidrit dhe na thonë se është më e lehtë për ne, ngaqë punojmë si skuadër. Mirëpo, kur u shpërngula në Nidri askush tjetër përveç meje nuk shërbente me kohë të plotë atje. Niseni punën me lëndën e parë që keni në dispozicion dhe ndërtoni mbi të. Në qoftë se jeni vetëm dhe po ia nisni nga zeroja, atëherë lutuni që edhe të tjerë të bashkohen me ju. Mos u nxitoni. Zgjidhni anëtarët e skuadrës me kujdes dhe sigurohuni që ata ta kuptojnë vizionin dhe drejtimin tuaj. Në qoftë se jeni një pastor me përvojë, atëherë ofroni periudha stazhi për anëtarët ekzistues ose rekrutoni studentë seminaresh ose anëtarë nga kisha të tjera. Mbase nuk kemi, sepse nuk i kemi kërkuar Atit tonë qiellor. Një gjë është e sigurt: nuk do të ndodhë asnjë ndryshim, në qoftë se nuk jeni gati për të hedhur hapa besimi përpara.

Mos u kapni pas një modeli të vetëm

Disa njerëz janë shumë të dhënë pas një modeli të caktuar për

mbjelljen dhe rijetësimin e kishave, sikur kjo punë të kryhej më së miri duke përdorur të njëjtën metodë në çdo rast e rrethanë. Mirëpo, sipas përvojës sime, ekzistojnë disa metoda shumë të mira për ta realizuar këtë:

- Në Brazil ia nisa punës me një grup prej tetë grash dhe burrash. Vitin e parë takoheshim ditë përditë për studim dhe lutje, si dhe për të ngrënë e për të shërbyer bashkë nëpër rrugë. Kur erdhi koha për t'ia nisur veprës kishëmbjellëse në favelën tonë, e njihnim njëri-tjetrin shumë mirë dhe puna ecte me një ritëm shumë të lartë. Kisha u rrit shumë shpejt paskëtaj.
- Në Nidri unë trashëgova një grup të gatshëm, kështu që m'u desh që t'i reformoja ata kryesisht përmes shërbesës së predikimit. Investova më tepër tek ata, dhe pashë që e kapën të parët vizionin e ri për shërbesë. Kjo ishte një metodë tjetër e të ndërtuarit të kishës, metodë e cila pak nga pak po jep frytet e veta.
- Në Dandi, shërbesa 20Skemat ka ndihmuar një kishëmbjellës që të vendoset në një ndërtesë të vjetër të një kisha, që i kishte mbyllur dyert rreth dy dekada më parë. Duke qenë se gjendet në një lagje të varfër me një popullsi prej 18,000 banorësh, ndërtesa përdorej prej shërbesave për të rinj e fëmijë gjatë dekadës së fundit. Për këtë veper lipset një drejtues që ka aftësinë për t'i tërhequr dhe mbledhur njerëzit së bashku, si dhe për të formësuar një vizion të gjithëmbarshtëm.
- Në një skemë strehimi në Edinburg, me emrin Grejsmaunt, shërbesa 20Skemat ka vendosur një çift të ri, të cilët po përpiqen të fillojnë një kishë të re nga zeroja. Atje ata kanë kontakte përmes një shërbesë lokale parakishtare, por drejtuesit të asaj vepre i nevojiten dhunti sipërmarrjeje, aftësi ungjillëzuese dhe një skuadër e fortë për të çarë përpara. Kjo do të jetë një shërbesë me djegie të ngadaltë.

- Në Glasgou, dy çifte të reja janë shpërngulur në një skemë strehimi pasi kanë punuar atje si drejtues të rinjsh për plot pesë vjet. Atyre do t'u duhet ndihmë, udhëheqje dhe mbështetje prej një kisha ekzistuese, ku edhe do të japin llogari për punën e tyre, teksa përpiqen të mbjellin një kishë lokale, me ungjillin në qendër, në atë skemë strehimi.
- Kisha e Majkut ka pasur përvoja të ngjashme. Ata kanë rijetësuar kisha, kanë mbjellë bashkësi të reja nga zeroja, kanë dërguar skuadra me një numër të mirë anëtarësh dhe kanë filluar kisha për folësit e një gjuhe tjetër duke përdorur studime biblike ungjillëzuese.

Thelbi i fjalëve të mia është se nuk ekziston një mënyrë e përsosur për të mbjellë dhe rijetësuar kisha. Çdo vendndodhje ndryshon nga tjetra dhe ofron mundësi të ndryshme. Për një park rimorkiosh mund të nevojitet një strategji që ndryshon prej asaj që përdoret në një projekt banesash sociale, por edhe që të dyja këto situata mund të ndryshojnë si nata me ditën nga një projekt kishëmbjellës në një periferi qyteti. Në qoftë se jeni të fiksuar pas një modeli të caktuar, mbase po humbni mundësi të mira. Në qoftë se e eksportoni një model të caktuar në një vend tjetër pa marrë parasysh kulturën dhe nevojat e tij, keni për të mbjellë breshër e për të korrur stuhi.

Jini realistë për kostot financiare

Dy të rinj erdhën për të më takuar një ditë në zyrë, sepse dëshironin të më tregonin për vizionin e tyre rreth punës me bandat në Afrikën e Jugut. Kur i pyeta se sa para shpresonin që të mblidhnin, ata më dhanë një përgjigje naive për një shumë të vogël. Me sa duket ata donin të jetonin me shumë pak para, pa i llogaritur aspak shpenzimet që do të kishin, si për shembull pagesa e qerasë, makina, karburanti, pagesat për një fond pensioni, kos-

toja e biletave për t'u kthyer në atdhe, shpenzimet mjekësore dhe një vogëlsirë luksi, siç është buka e përditshme. Ata nuk ia kishin aspak idenë se sa shkonte kostoja totale e ndërmarrjes së tyre misionare. Shumë kisha dhe kishëmbjellës nuk janë edhe aq naivë, por megjithatë nuk e kanë idenë se sa shkojnë kostot për mbjelljen apo rijetësimin e kishës në lagje të varfra.

Një strategji e zakonshme kishëmbjellëse në Perëndim planifikon që kisha ta arrijë pavarësinë e saj financiare brenda tre ose pesë vjetësh. Ky është një objektiv aspak realist për lagjet e varfra ku për të arritur pavarësinë financiare mund të duhet të paktën një dekadë ose edhe më tepër. Për shërbesat e reja mes skamnorëve lipset një ndërmarrje serioze misionare dhe financim afatgjatë. Llogaritja e kujdesshme e kostove financiare ndihmon për ta ruajtur kishëmbjellësin nga shqetësimet, merakut dhe ankthi.

Vështirësitë për financimin e kishave që gjenden në lagje të varfra, janë arsyeja numër një se përse kishat duhet të përipiqen të bashkohen me njëra-tjetrën apo të krijojnë një rrjet të ngushtë bashkëpunimi. Së bashku, ato mund ta mbështesin frymërisht dhe financiarisht veprën kishëmbjellëse në lagje të varfra. Në qoftë se bëni pjesë në një kishë të pasur, e cila dëshiron të ndihmojë me përhapjen e ungjillit mes të varfërve, mbase mënyra më e efektshme se si mund ta bëni këtë është duke ofruar mbështetje financiare. Po ashtu, duhet të kultivojmë dhurues individual, të cilët e njohin dhe e vlerësojnë kontekstin e shërbesës tonë. Fatkeqësisht, këta lloj njerëzish janë shumë të pakët në një botë si kjo e jona, së cilës i pëlqejnë rezultatet e shpejta dhe letrat e lajmeve plot me statistika dhe histori të mrekullueshme kthimesh në besim. Duke e pasur parasysh këtë fakt, strategjia jonë për shërbesën mes të varfërve e konsideron atë si një ndërmarrje misionare afatgjatë. I nxisim punëtorët tanë që të mbledhin mbështetjen e nevojshme financiare, me qëllim që të sigurojnë qëndrueshmëri.

Vendosni qëllime dhe pritshmëri realiste

Mбай mend që një herë merrja pjesë në një takim në Nju Jork ku dëgjova një kishëmbjellës që po thoshte se nëse veprat kishëmbjellëse nuk arrinin të mblidhnin të paktën 200 njerëz në vitin e tretë të tyre, atëherë për ne që i drejtonim ato, do të ishte më mirë që ta vinim në dyshim thirrjen tonë. Një kishëmbjellës tjetër na tha se po hidhte një hap besimi dhe po zhvendosej në një zonë të re me një skuadër prej 150 anëtarësh. Mбай mend që një të diel na erdhën disa kishëmbjellës amerikane për vizitë në Kishën e Nidrit, ku gjetën jo më shumë se shtatëdhjetë e pesë veta në shërbesën e adhurimit. Gjatë drekës së organizuar pas shërbesës, njëri prej tyre na tha se do të arrinim më shumë njerëz nëse do të gjenim muzikantë më të mirë dhe do të vendosnim ca drita skene. U thashë se për standardet e skemave të strehimit, ne jemi një megakishë! Duket se Evropa dhe Shtetet e Bashkuara shpesh kanë standarde të ndryshme, kur vjen puna për vlerësimin e frytshmërisë dhe suksesit.

Kur dëgjoj për kishat që tërheqin me qindra njerëz në shërbesën e tyre përruruese, menjëherë mendoj se shumica e pjesëmarrësve në atë shërbesë janë njerëz që më parë shkonin në kisha të tjera në po atë zonë. Kisha që gjendet në një lagje të varfër, zor se ka në dispozicion të saj një rezervë të madhe të krishterësh, prej së cilës të tërheqë njerëz. Me shumë gjasë do të rritet më ngadalë, sepse do t'i duhet të rritet përmes kthimeve në besim. Patjetër që Perëndia mund të shkaktojë një rizgjim dhe të na bekojë me mijëra të kthyer në besim. Përveçse po të ndodhte një mrekulli, unë do të isha i kënaqur sikur të shihja grupe prej njëzet-dyzet besimtarësh në një varg skemash strehimi pas një periudhe dhjetëvjeçare. Për mua ky do të ishte një sukses i madh, megjithëse për disa të tjerë këto mund të dukeshin si grupe bërthamë! Me thënë të drejtën, ushtrojmë presion të panevojshëm mbi kishëmbjellësit dhe kishërijetësuesit, duke u vënë atyre synime dhe objektiva të porealizueshme.

Përfundim

Të gjithë të kthyerit në besim dhe anëtarët e bashkësisë, pavarësisht nga shtresa shoqërore së cilës i përkasin, duhet të marrin mësim rreth përgjegjësisë së tyre ndaj trupit lokal të Krishtit. Disa prej tyre do të kthehen në anëtarë shumë të vlefshëm të skuadrave të shërbesës. Disa prej tyre do të bëhen dhjakë shumë të zotë. Disa të tjerë do të shndërrohen në pleq të perëndishëm.

Mirëpo dhuntitë e tyre do të dalin në dritë vetëm në qoftë se atyre iu jepet mundësia e duhur që të sprovohen në provën e zjarrit të shërbesës. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për gratë tona. Shumë gra të perëndishme dhe biblikisht të pjekura ulen në karriget e kishave tona, pa u përdorur aspak për shërbesë, kur për to mund të ketë shumë nevojë nëpër vende të vështira.

Në fund të fundit, të gjitha kishat nëpër vende të vështira, ashtu si gjithë tjerat, duhet të kultivojnë një kulturë dishepullimi dhe shërbesë, ku anëtarët, drejtuesit dhe ata që dëshirojnë të bëhen drejtues mësojnë se si ta dishepullojnë njëri-tjetrin dhe e shohin këtë veprimtari si një përbërës bazë të të qenët i krishterë. Në këtë mënyrë ata mësojnë se si të shërbejnë, si të dështojnë, falin, inkurajojnë dhe të nxënë nga njëri-tjetri.

Përgatitu që të ndryshosh mendim

Përfytyroni pak sikur, një ditë të bukur, një i ri të hyjë në kishën tuaj dhe të kërkojë të flasë me pastorin. Ai ka pasur probleme me ligjin që kur ishte fëmijë, dhe sapo ka dalë nga burgu ku vuajti një dënim me heqje lirie për grabitje dhe sulm të rëndë. Djaloshi duket i shqetësuar dhe del jashtë ndërtese për të pirë një cigare, teksa ju shkoni për të gjetur pastorin. Ai mban erë sikur ka kohë që nuk lahet, dhe petkat e tij duken të lira dhe të vjetruara.

Del që ky i ri nuk ka shumë kohë që ka besuar në Krishtin dhe megjithëse nuk e ka lexuar asnjëherë Biblën në jetën e vet, ai dëshiron të frekuentojë kishën tuaj për të mësuar më shumë rreth Jezusit. Ai jeton aktualisht në një strehë për të pastrehët, që gjendet në qytet, dhe e pranon se vazhdon të marrë drogë, megjithëse po ashtu thotë se po përpiqet ta lërë atë. Sjellja e tij është agresive dhe duket qartë se nuk i pëlqen t'u përgjigjet pyetjeve të shumta.

Çfarë ju erdhi ndër mend, teksa ky i ri po largohej? A mos vallë zutë të shpresonit fshehurazi se ai nuk do të kthehet më?

A mos vallë e pyetët veten se kush do ta mbajë atë nën vëzhgim dhe kontroll nëse vjen të dielën? A po mendoni se si ta ndihmoni atë që të dalë nga streha e të pastrehëve dhe të lërë drogën? A po mendoni vallë që ky tipi, po nuk u dishepullua, do të përfundojë vërtet shumë keq?

Sipas mendimit tim (Mezit), ky i ri mund të kthehet në një drejtues të ardhshëm. Në qoftë se do të shërbeni mes të varfërve, duhet të arrini ta dalloni potencialin që ka ky djalosh agresiv dhe i pisët, por edhe analfabet për sa i përket Biblës, për t'u shndërruar në një pastor apo drejtues të ardhshëm kishe. Pyetja që shtrohet është: a ka kisha juaj një udhërrëfyes të qartë dishepullimi për të tillë të rinj e të reja? Apo këtyre lloj njerëzve u bëjmë lëshime derisa ata të kthehen në të vjellat e tyre dhe pastaj secili prej nesh brenda vetes merr frymë i lehtësuar se e hoqëm qafe edhe këtë?

Problemi nëpër kishat tona

E vërteta është se shumë kishave u mungon një kulturë dishepullimi për të kthyerit në besim, që vijnë nga shtresat e varfra. Vërtet i mirëpresim këta njerëz në bashkësitë tona, por përgjithësisht nuk i marrim parasysh kur vjen puna për identifikimin dhe trajnimin e drejtuesve të ardhshëm. Ky nuk është një problem i ngritur rishtazi: Besëlidhja e Lozanës e theksonte të njëjtin problem edhe dyzet vjet më parë:

Po ashtu, e pranojmë që disa prej misionëve tona kanë qenë shumë të ngadalta për të përgatitur dhe nxitur drejtuesit kombëtarë që të marrin përgjegjësitë e tyre përkatëse. Sidoqoftë, ne jemi të përkushtuar ndaj parimeve vendase dhe dëshirojmë që çdo kishë të ketë drejtues vendas, të cilët shfaqin një stil udhëheqjeje të krishterë që nuk karakterizohet nga sundimi por nga shërbesa. Ne e pranojmë se ekziston një nevojë e madhe për përmirësimin e arsimit teolog-

jik, sidomos për drejtuesit e kishave. Në çdo komb dhe kulturë duhet të ketë programe efikase përgatitjeje për pastorët dhe besimtarët në përgjithësi, për sa i përket doktrinës, dishepullimit, ungjillëzimit, rritjes dhe shërbesës. Këto programe trajnimi nuk duhet të bazohen në metodologji shabllone, por duhet të hartohen falë nismave lokale krijuese në përputhje me standardet biblike.

Problemi që po trajtonin autorët e Besëlidhjes së Lozanës, ishte prirja e misionarëve perëndimorë për t'i paralizuar kishat vendase duke penguar krijimin e një udhëheqjeje lokale në një mënyrë që shfaq ndjeshmëri ndaj kulturës lokale. Në një mënyrë të ngjashme, edhe kishat në perëndim e kanë shumë të lehtë që të mbeten pas, për sa i përket trajnimit të drejtuesve që vijnë nga radhët e skamnorëve. Në qoftë se nuk më besoni, lexoni njoftimet për stazhierë që botohen në shtypin e krishterë dhe do të zbuloni se ato vlejné vetëm për njerëz të arsimuar. Fakti është që drejtimi i kishës mbetet ekskluzivisht në duart e atyre që kanë arsim të mirë dhe janë profesionistë të kualifikuar.

Drejtesit zyrtarë mund ta përcjellin lehtësisht te besimtarët e tjerë ndjesinë se vetëm ata kanë aftësitë dhe njohurinë e nevojshme për udhëheqje. Në mënyrë të nënkuptuar mund të përcjellim idenë se vetëm njerëzit mbresëlënës dhe të pastër nga varësitë i përmbushin kriteret për të qenë drejtues të krishterë. Natyrisht që një plak kishë duhet të jetë “i aftë të japë mësim”, por arsimi i lartë dhe aftësitë administruese nuk janë kualifikime për udhëheqjen e krishterë (shih 1 e Timoteut 3:1–13). E vërteta është se modelet e udhëheqjes së krishterë duhet të dallojnë nga modelet përkatëse të botës, sepse Perëndia i vlerëson gjërat ndryshe nga bota (1 e Korintasve 1:26–29). Kishat dhe udhëheqësit e tyre duhet të reshtin së shpërfilluri ata të cilëve iu mungojné kualifikimet profesionale ose që nuk bëjnë pjesë në rrethin e tyre shoqëror.

Një qasje e re

Lipset që ta rikonceptojmë mënyrën se si shërbehet në vendet e vështira të qyteteve dhe qytezave tona. T'i kesh për zemër të varfrit dhe të nëpërkëmburit është një gjë shumë e mirë, por duhet të bëjmë kujdes që të mos biem pre e dhënies së ndihmës paaftësuese, e cila nuk i lë pa bukë banorët e lagjeve të varfra, por që kurrë nuk u jep atyre shtytjen e duhur për t'u bërë dishepuj të pjekur të Krishtit.

Po ju jap një shembull për këtë. Në një diskutim që u mbajt kohët e fundit në lidhje me shërbesën ndër të varfrit, fola dhe unë duke thënë se një prej problemeve të shërbesave të mëshirës ishte se nuk arrinte të ndihmonte rritjen e drejtuesve vendas mes të varfërve. Një burrë që ishte aty më kundërshtoi, duke më thënë se kuzhina e tyre sociale e kishte transformuar për mirë lagjen e tyre. Kur diskutuam më hollësisht për këtë, zbuluam që shumicën e përfitimeve prej asaj shërbesë i kishte përjetuar kisha lokale. Anëtarët që rrinin në periferi me kishën, kishin zbuluar që shpërndarja e ushqimit që një mënyrë e lehtë për t'u përfshirë në shërbesë kishtarë. Kjo është një gjë e mirë, pa dyshim. Mirëpo, personi në fjalë e pranoi gjithashtu se pas gjithë asaj kohe që qenë marrë me këtë shërbesë, ende nuk kishte kthime në besim dhe askush nuk po dishepullohej. Edhe më keq akoma, ata nuk kishin asnjë plan veprimi për dikë që mund të bëhej i krishterë.

Shërbesa e mëshirës është fantastike kur zhvillohet në kuadrin e një plani më të madh, por nuk mund të jetë e vetmja gjë që marrin përfituesit e ndihmës. Atëherë si *dubet* vazhduar më tej? Kishat që shërbejnë mes të varfërve, duhet ta përfshijnë trajnimin e drejtuesve vendas në ADN-në e tyre.

Atëherë si t'ia bëjmë që të kalojmë nga situata e vështirë që kemi sot në terren tek idealet e ardhshme të udhëheqjes vendase? Në skemat e strehimit të Skocisë, e kemi pranuar faktin se fillimisht duhet të na ndihmojnë ata që ne i quajmë të huajt për

kulturën vendase. Nuk kemi edhe aq lëndë të parë për momentin, që t'i jepte shtytje të fortë gjenerimit të drejtuesve vendas. Kështu që na duhet t'i trajnojmë “të huajt” që të identifikojnë dhe kultivojnë “të brendshmit” që do të shërbejnë si udhëheqës të ardhshëm. Mbase brenda një brezi do të shohim një lëvizje të vërtetë për të pasur kisha nëpër skemat e strehimit që udhëhiqen prej banorëve të skemave, që janë kthyer në besim. Për ta arritur këtë qëllim, lexoni më poshtë dhjetë këshilla që mishërojnë përvojën që kam mbledhur gjatë trajnimit të burrave dhe grave për udhëheqje në lagjet e varfra:

1. Jepuni sa më shpejt që të jetë e mundur përgjegjësi të kthyerve të rinj në besim

Ndodh shpesh që kishat e lagjeve me banorë të shtresës së mesme presin njëfarë kohe, me qëllim që të kthyerit e rinj në besim ta provojnë veten përpara se t'u jepen role drejtuese. Në të kishave të skemave të strehimit kemi parë që është më mirë që t'u japim njerëzve përgjegjësi dhe t'i lëmë ata që t'i ushtrojnë ato, derisa ta provojnë veten se nuk janë të aftë për t'i mbajtur. Thënë ndryshe, është mirë që t'i veshim me përgjegjësi të kthyerit në besim sa më shpejt që të jetë e mundur, duke u ofruar atyre mundësinë që të shërbejnë dhe të japin mësim. Nuk po them që t'i bëjmë ata pleq kishe, por as t'i lëmë që të mbledhin karriget në fund të shërbesës. Po ashtu, pajisja e tyre nuk kufizohet vetëm me leksionet që ua japim nga balli i sallës. Duhet të ecim përkrah tyre ditë për ditë, në çdo hap të veprës së shërbesës. Tekefundit, kjo është mënyra se si Jezusi i trajnoi dishepujt e Tij; ata jetuan së bashku dhe Ai i mësoi ata përgjatë rrugës.

Në Kishën Komunitare të Nidrit, kemi një punëtore të re, e cila u kthye në besim pak kohë më parë. Ajo është një banore e skemës, e cila erdhi te ne pa pasur asnjë njohuri paraprake rreth Biblës. Dy muaj pas kthimit të saj në besim, vendosëm

ta angazhojmë atë me kohë të pjesshme për të arritur të rinjtë e zonës. Nuk kaloi shumë kohë dhe ajo filloi një studim Bible me pesë shokë të saj. Ajo nuk dinte asgjë tjetër veç Ungjillit, por brenda pak javëve disa prej shokëve të saj nisën të ndiqnin shërbesat dhe nja dy prej tyre u kthyen në besim. Ajo arriti të bënte më shumë progres në zonën tonë brenda gjashtë muajve, sesa ia kishim dalë të bënim ne të tjerët në plot gjashtë vjet! Ama bëme një gjë fare të thjeshtë: i thamë një gruaje të krishterë, besimtare e pjekur, që të bëhej pjesë e grupit të vajzës, me qëllim që t'i ofronte asaj këshillë dhe ndihmë sa herë që ajo ngecte. Falë kësaj kulture të karakterizuar nga liria, ajo ka filluar disa shërbesa të tjera në lagjen tonë, duke iu nënshtruar njëkohësisht trajnimeve përmes programit trajnues që kemi ngritur si kishë.

2. Komunikoni në përputhje me kulturën lokale

Komunikimi është i lidhur ngushtë me kontekstin, në të cilin ndodh. Për shembull, nëpër skemat e strehimit na pëlqen të folurit e drejtpërdrejtë dhe kjo është një shenjë respekti në marrëdhëniet tona. Ata të shtresës së mesme kanë prirje që të bëjnë shumë kujdes si e si të mos fyejnë dikë tjetër, sepse mënyra se si komunikojnë me njëri-tjetrin demonstroi rëndësinë që ata i japin një marrëdhënieje. Për pasojë, njëra palë duket e paedukatë dhe agresive para tjetrës, kurse pala tjetër duket e shpëlarë dhe sipërfaqësore në sytë e të parës.

Duhet të bëjmë kujdes që të kuptojmë se si flasim dhe veprojmë njerëzit përpara se të vëmë në dyshim motivet ose karakterin e tyre. Shumë të kthyer në besim nga skemat e strehimit shpërfillen kur vjen puna për t'u përfshirë në udhëheqje, sepse mund të duken të pataktë, të paedukatë dhe agresivë në krahasim me vëllezërit dhe motrat e tyre të shtresës së mesme. Njohja e kulturës së lagjes suaj natyrisht që ju ndihmon që ta kuptoni këtë situatë edhe ta interpretoni si duhet atë. Naty-

risht, duhet ta sfidojmë sjelljen mëkatore pavarësisht nga kultura jonë, mirëpo druhem se shumë drejtues të mundshëm nuk arrijnë të bëhen udhëheqës për shkak të keqkuptimeve rreth mënyrës se si komunikojnë njerëz nga kultura të ndryshme.

3. Konsiderojini dështimet si mundësi

Shpeshherë mbushemi kaq shumë me krenari, sa që mendojmë se kur një person që po e dishepullojmë, dështon apo i kthehet mënyrës së vjetër të jetesës, kjo është një njollë e zezë mbi ne apo shërbesën tonë. Mirëpo, e vërteta është se po nuk dështuam, nuk rritemi. Sigurisht që do të bëjmë gabime, kur vjen puna tek udhëheqja.

Jezusi u la dishepujve të Vet hapësirë që të dështonin. Shpeshherë ata nxorën mësim të vlefshme në mes të luftës. Kështu që, edhe ne duhet t'i lëshojmë pak frerët dhe ta luftojmë frikën se dishepujt tanë nuk janë ende gati për shërbesë. Ajo lloj frike është jashtëzakonisht e dëmshme në fushën e misionit, sepse e bllokton fare shërbesën. Ka një kohë për të qenë të kujdesshëm dhe një kohë për të ndërmarrë risqe.

4. Kërkoni drejtues aty ku nuk ua pret mendja

Disave prej nesh u mungon besimi në fuqinë e ungjillit dhe të Frymës së Shenjtë për të shndërruar edhe njerëzit më të vështirë. Hidhini një sy tjetër atij diamantit të papërpunuar, i cili është ai anëtar i bashkësisë suaj, që duket sikur nuk ka as edhe një cilësi për t'u bërë drejtues. Investoni një pjesë të kohës suaj me të dhe keni për ta parë që Perëndia mund t'ju habisë. Mirëpo, një gjë për të cilën duhet të jemi të sigurt është se, nëse do të presim për të pasur drejtues në lagjet e varfra, që ngajjnë si të krishterë të respektuar që vijnë nga shtresa e mesme, atëherë kemi për të pritur shumë gjatë.

Kam dëgjuar histori të mahnitshme për njerëz që i kthyen në jetë kishat që po vdisnin, dhe tani ato kisha kanë me mijëra

anëtarë. Kam mbetur pa fjalë kur dëgjoj për kishëmbjellës në Indi që mbollën një duzinë kishash pa i mbushur të tridhjetat. Mirëpo, me thënë të drejtën jam po aq i interesuar që të njoh njerëz që kanë bërë përpjekje dhe kanë dështuar.

E takova një të ri të tillë pak vjet më parë. Erdhi te kisha ime dhe mora vesh se kishte qenë pjesë e një skuadre kishëmbjellëse ndërkombëtare në Azi. Dhjetë njerëz qenë bërë bashkë për të mbjellë një kishë ndërkombëtare dhe një nga një ata kishin hequr dorë dhe qenë kthyer në shtëpi. Ai qe i fundit që mbeti nga skuadra në atë vend aziatik. Kur e takova, ai ishte paksa i mposhtur dhe i drobitur. Pasi ma rrëfeu historinë e tij, i thashë sakaq që të vinte e të punonte në Kishën e Nidrit.

Dështimi është terreni pjellor ku rritet përulësia. Shumë kishëmbjellës të rinj janë luftarakë dhe krenarë, sepse nuk janë goditur kurrë nga dështimi. Mua më bëri përshtypje fakti që ky djalë ishte personi i fundit i skuadrës, që mbeti në atë vend aziatik. Kjo gjë më thoshte gjithçka që më nevojitej në lidhje me natyrën e tij ngulmuese. Pasi u trajnua me mua për plot një vit, besimi i tij u ripërtëri dhe besimsiguria iu kthye. Ai po ashtu i mësoi skuadrës sime disa mësimet të paçmueshme.

Disa prej bisedave më të frytshme që kam pasur, kanë qenë ato me njerëzit që përlëshen me vështirësitë (apo që po dështojnë) në vende të vështira. Njoh njerëz që u përpoqën disa herë që të mbillnin apo rijetësonin kisha përpara se të prodhonin fryte të qëndrueshme. Njoh po ashtu të tjerë që hoqën dorë, dhe iu kthyen botës së punës. Unë i kërkoj këta njerëz qëllimisht, sepse gabimet e tyre dhe mësimet që ata nxorën, kanë vlerë të madhe për mua.

Ndërkohë që mendoni se si të rekrutoni skuadrën tuaj, mos kërkonin ata tipat e porsadiplomuar nga seminari dhe që janë fryrë nga krenaria dhe duken super-të-aftë, por kërkonin njerëz që i kanë marrë ca dacka në jetë. Janë pikërisht këta që kthehen në anëtarët më cilësorë të skuadrës.

5. Trajtojeni atë si një shërbesë ndërkulturore

Në qoftë se jeni një person i jashtëm që shkon të shërbejë mes të varfërve, duhet ta pranoni faktin që po përfshihen në një vepër ndërkulturore. Mos bëni gabim të mendoni se ju ndani të njëjtat vlera kulturore me dikë thjesht sepse jeni bashkëkombës dhe flisni të njëjtën gjuhë. Faktikisht, mendoj se përpara se t'ju lindë ideja për të shërbyer në një skemë strehimi apo projekt banesash sociale, duhet të fitoni përvojë ndërkulturore. Kjo gjë do t'ju detyrojë që t'i bëni pyetje të vështira vetes për sa i përket natyrës suaj dhe preferencave tuaja, si dhe mund t'ju bëjë të kuptoni ato dobësi që ju nuk arrini ende t'i dalloni. Kuptohet që kjo duhet t'ju shtyjë që të kërkoni përgjigje biblike, teksa shërbeni jashtë habitatit tuaj të natyrshëm.

Njerëzit dhe vendet nuk janë gjëra që duhen rregulluar me çdo kusht. Në qoftë se shkoni në një lagje të varfër me asgjë tjetër veç dashurisë dhe vlerësimit, keni për t'u mbytur përpara se të filloni. Dëmtimet dhe vështirësitë e atij vendi mund t'ju duken të ndryshme nga dëmtimet dhe vështirësitë e vendit tuaj, por çdo kulturë ka gjëra të tilla. Ne thjesht i shohim problemet e tjetrit më qartë sesa tonat. Nuk është detyra juaj që të rregulloni kulturën mbarë, por të ndani lajmin e mirë me ata që Perëndia po i tërheq te Vetja, si dhe t'i dishepulloni ata. Duhet të ruhemi prej asaj bindjes që fshihet brenda nesh se kultura jonë është më e mirë, sesa ajo e vendit ku kemi shkuar për të shërbyer.

Gjithashtu duhet të punoni fort për ta njohur e zotëruar kulturën ku po zhvendoseni. Apostulli Pal kaloi kohë duke shëtitur nëpër Athinë përpara se t'u predikonte njerëzve në Aeropag. Në të njëjtën mënyrë edhe ju duhet ta vëzhgoni me shumë kujdes kulturën përreth, sepse nuk mund ta merrni të mirëqenë se keni kuptuar gjithçka. Duhet të keni në majë të gjuhës pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë disa nga pikat e forta dhe të dobëta të kulturës që keni përballë?

- Cilat janë pikat tuaja të forta dhe të dobëta?
- Cilat parime biblike i tejkalojnë të dyja kulturat?

6. Përqafojeni konfliktin si një mundësi

Shumë njerëzve nuk iu pëlqen konflikti dhe kjo është një gjë mjaft e kuptueshme. Tensionet, pezmatimi dhe fjalët e ashpra ia heqin kënaqësinë jetës së përditshme. Mirëpo, po filluat t'i jepni formë skuadrës tuaj me synimin për të shmangur konfliktet, po i hapni vetes probleme. Larmia e pikëpamjeve, aftësive dhe prejardhjeve të njerëzve që karakterizojnë një skuadër të efektshme, natyrisht që krijojnë një mjedis ku njerëzit do të kenë prirje për t'u keqkuptuar dhe për të pasur mosmarrëveshje. Mirëpo, nuk duhet ta vlerësoni qetësinë deri në atë pikë, saqë të bëni pjesë të skuadrës vetëm ata që thonë “po” gjithë kohës. Nevojiten mendimtarë të lirë e të qëndrueshëm, të cilët tekefundit i nënshtrohen autoritetit, por ama që e çojnë përpara skuadrën dhe shërbesën.

Duke qenë se skuadrat përbëhen nga qenie njerëzore mëkatore, është e pamundur të mos keni konflikte brenda tyre. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur përzihen personat jashtë dhe brenda një kulture të caktuar. Çdo javë në zyrën time vijnë anëtarët e skuadrës për t'u ankuar për probleme nga më të ndryshmet, sepse e kanë keqkuptuar njëri-tjetrin dhe i kanë komunikuar ndjenjat dhe qëllimet e tyre në mënyrë të mangët. Kjo është një gjë normale, e cila nuk ka përse të mënjanohet. Përkundrazi, duhet të përdoret si një mundësi për të zgjidhur problemet dhe për të hulumtuar problemet e zemrës, që fshihen poshtë sipërfaqes.

Të gjithë përfitojnë kur konfliktet mes anëtarëve të skuadrës zgjidhen ashtu si duhet. Problemet marrin zgjidhje, në vend që të fshihen poshtë qilimit, të krishterët e pjekur rriten në durim, ndërsa të krishterët e rinj mësojnë se si t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në një mënyrë konstruktive dhe të perëndishme. Që të gjithë pa përjashtim bekohen nga procesi i shenjtërimit.

7. Zhvillimi modele trajnimi teologjik në përputhje me kulturën e zonës suaj

Shumica e kishave mendojnë se trajnimi teologjik duhet kryer vetëm nëpër Seminare Teologjike apo Shkolla Bible. Mirëpo, sado i dobishëm që të jetë ky sistem arsimor, ai është shpesh i paarritshëm prej atyre që vijnë nga shtresat e varfra. Shumica prej tyre nuk kanë për t'u pranuar në to, ndërsa shumë të tjerë nuk do të dëshironin ose nuk do të kishin burime financiare që t'i ndiqnin ato shkolla, edhe sikur të pranoheshin në to.

Kështu që, në vend të tyre duhet projektuar një sistem arsimit teologjik për të gjitha shtresat, i cili drejtohet nga kisha lokale dhe përshtatet deri në detaj me nevojat konkrete. Në qoftë se kishat e pranojnë këtë përgjegjësi, atyre iu ofrohet një mundësi e artë për ta ndërthurrur arsimin doktrinor me zbatimin e tij në praktikën e misionit dhe me zhvillimin e karakterit të krishterë te besimtarët. Ne duhet të angazhohemi për zhvillimin e një arsimit teologjik që u përshtatet nevojave konkrete dhe që është i dobishëm për anëtarësinë e kishës, por edhe në pronësi të kishës, duke qenë i qeverisur dhe i vlerësuar në terren prej kishës lokale.

8. Themeloni skuadra shumëkulturore

Duke pasur parasysh pamjen në ndryshim e sipër të shoqërive perëndimore, tashmë në shumë vende vështirë se mund të gjeni një bërthamë kulturore homogjene. Një lagje e varfër ka një popullsi heterogjene, e cila është një përzierje njerëzish nga shtresa e varfër e përjetshme, te shtresa e mesme, që përpiqen ta përmirësojnë shoqërisht lagjen, shto këtu klasën punëtore dhe një komunitet imigrantësh në rritje. Shumë lagje janë në vetvete një mishmash interesant njerëzish.

Kështu që, për të arritur vende të larmishme duhet të themelojmë skuadra shumëkulturore. Këto lloj skuadrash mund të kenë pikat e tyre të dobëta (shih më sipër pjesën në lidhje me konfliktin), mirëpo ato do të jenë më të forta dhe më efikase

në periudhën afatgjatë. Skuadrat shumëkulturore kanë më pak dobësi të padallueshme dhe një gamë më të gjerë përvojash, pritshmëri dhe karakteresh njerëzore. Ato mund të krijojnë lidhje të natyrshme me një numër më të madh banorësh të lagjes ku vepron. Na pëlqen ose jo, ata që ndajnë shumëçka mes tyre, e tërheqin njëri-tjetrin, dhe nuk ka asgjë më të fortë sesa një skuadër e përbërë nga lloje të ndryshme njerëzish me karaktere të larmishme, që punojnë së bashku për lavdi të ungjillit.

9. Jini të vetëdijshëm për anësitë tuaja në lidhje me sjelljen njerëzore

Duhet të bëjmë kujdes që zhvillimi ynë i drejtuesve t'i vërë kufijtë aty ku i vë edhe Bibla. Në qoftë se një i ri ose e re kthehet në besim nga një stil jetese i përshkruar nga imoraliteti dhe abuzimi me drogat dhe pastaj përparon drejt udhëheqjes së shërbesave, çfarë pritshmëri realiste duhet të kemi për sjelljen e tyre?

- A është në rregull për ata që të vijnë në takimet e kishës të veshur me tuta?
- A duhet ta lënë duhanin?
- A duhet të flasin si persona të edukuar?
- A duhet ta lavdërojnë Perëndinë vetëm në një mënyrë të caktuar?

Duhet të fillojmë ta veçojmë atë që thotë Bibla nga preferencat tona kulturore personale. Duhanpirja është një budallallëk me okë, por nuk jam i sigurt nëse është mëkat në çdo rast e rrethanë. Po të shohim fotografitë e trupave pedagogjike të seminareve teologjike në vitet '40 të shekullit të kaluar, do të zbulojmë se gati të gjithë profesorët e pinin cigaren. Mirëpo, shumë njerëz të shtresës së mesme i dënojnë ata që harxhojnë paratë me cigare, kur për vete e harxhojnë një shumë të mirë muaj për muaj duke pirë kafe të shtrenjtë. Duhet të mundohemi fort që të sigurohemi se skuadrat tona ndërtohen mbi ungjillin dhe jo

mbi ligjin apo mbi idealet e kulturës sonë. Natyrisht, mëkati duhet sfiduar, por duhet t'i besojmë Frymës së Shenjtë që të sjellë bindje të vërtetë për mëkat në jetën e dikujt. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë, atëherë do të biem pre e frymës së gjykimit, mosbesimit dhe mungesës së dashurisë, mirëkuptimit dhe durimit mes nesh.

10. Jini të ndershëm për sa i përket çmimit

Kishat në lagje të varfra nuk mund t'ia lejojnë vetes që të ekzistojnë vetëm të dielën në mëngjes. Të kthehesh i krishterë në një skemë strehimi është një gjë me çmim të lartë, madje mund të themi që është një lloj si kthimi në besim i dikujt që më parë ishte mysliman. Anëtarët e familjes dhe shokët e të kthyerit në besim mund të mos i thonë gjë atij ose asaj fillimisht, duke menduar se kjo puna e besimit mund të jetë një emocion i çastit. Mirëpo, me kalimin e kohës do të ngrihet një stuhi kundërshtimesh kundër personit dhe kishës. Një shitësi droge apo një prostitute që kthehen te Krishti, mund t'iu rrezikohet edhe vetë jeta. Tutorët e prostitutave, anëtarët e bandave dhe partnerët abuzues nuk reagojnë butë ndaj humbjes së personave që u kanë shërbyer qëllimeve të tyre.

Kështu që, besimtarët e rinj kanë nevojë më tepër sesa për një takim të përjavshëm. Ata kanë nevojë për një familje të re. Ata duhet të kalojnë kohë me ne, të na pyesin dhe të lutën me ne ditë për ditë. Ata do të përjetojnë sulme të ashpra frymërore nga Satani dhe do të kenë shumë nevojë për vëllezërit dhe motrat e tyre që t'i kenë pranë në çastet e tyre më të errëta. Dishepullimi pa krijimin e miqësive të forta është një lloj si pjesëmarrja në një klub social.

Përfundim

Pavarësisht nëse jemi të angazhuar në mbjellje apo rjetësim kishash apo në udhëheqje kishtare në vende të vështira, na nevo-

jiten pleq kishash biblike me ungjillin në qendër, të cilët kanë për detyrë që të modelojnë rritjen dhe shëndoshjen frymërore të bashkësisë. Pa dyshim, që kjo vështirë se mund të realizohet nëse bashkësia juaj nuk ka pleq ose i bën rezistencë udhëheqjes së tyre. Megjithatë, sa më shpejt që të keni mundësi, kaloni në drejtimin e kishës me pleqësi.

Për shembull, Jani, një kishëmbjellës në një vend të vështirë të Anglisë, udhëheq një grup të krishterësh të rinj që po përpiqen të mbjellin një kishë lokale. Për shkak se atij i mungojnë të krishterë të pjekur meshkuj, ai ka vendosur një partneritet mes grupit të vet dhe Kishës Komunitare të Nidrit, duke e vendosur vullnetarisht veten nën llogaridhënien e pleqësisë sonë derisa të bëhet i aftë që të rrisë, dishepullojë dhe trajnojë pleqësinë e kishës së vet. Kjo është një gjë e mirë për të, sepse (1) i ofron atij mbështetje dhe inkurajim të ndërsjellë nga vëllezër të perëndishëm e plot përvojë dhe (2) e mbron grupin e papërvojë të drejtuar prej tij nga sundimi i këtij të fundit, qoftë si person, ashtu edhe nga pikëpamjet e tij. Kështu që, përpara se të marrë i vetëm ndonjë vendim të rëndësishëm, ai mund ta testojë vlefshmërinë e tij me një grup burrash që shërben si bankëprovë. Gjëja më e rëndësishme është se kjo e mbron grupin e besimtarëve nga të qenët tërësisht i varur prej tij dhe e ndihmon Janin që të fitojë kohën e nevojshme për të konceptuar zhvillimin e trajnimit dishepullues dhe përgatitjen e drejtuesve të ardhshëm, ndërsa njerëzit i përgjigjen thirrjes së Krishtit në jetët e tyre.

Unë dhe Majku jemi të vetëdijshëm për faktin që ajo që themi ne, nuk është e vërteta absolute. Menduam që mund t'ju ndihmonim sadopak duke ndarë me ju disa prej gabimeve që kemi bërë, përvojave që kemi mbledhur dhe mësimet që kemi nxjerrë gjatë rrugës. Mirëpo, e pranojmë se praktika shpesh nuk i pasqyron si duhet parimet dhe, të paktën në këtë anë të qiellit, realiteti kurrë nuk do të përkojë njëqind për qind me

idealin që kemi në mendje. Është më e lehtë të shkruash për këto gjëra, sesa të ballafaqohesh ditë për ditë me to. Mirëpo, shpresa jonë është se pavarësisht se cilat janë dhuntitë, përvojat dhe mundësitë tuaja, ju do të bëheni pjesë e veprës për përhapjen e ungjillit përmes kishave lokale në vende të vështira.

Përgatitu për shërbesën e mëshirës?

E them ndershmërisht që nuk deshëm ta shkruanim fare këtë kapitull. Sa herë që shumica e ungjillorëve mendojnë për shërbesën ndër të varfrit, biseda fillon dhe mbaron me veprat e shërbesës praktike dhe të bamirësisë. Në qoftë se një kishë kryen një shërbesë mëshire, duke ofruar gjëra të tilla si një kuzhinë sociale, pika shpërndarjesh për veshje, apo çanta me ushqim për nxënësit e shkollave fillore, anëtarët e saj supozojnë se kjo është mënyra më e mirë e mundshme për t'i arritur të varfrit.

Një nga synimet tona kur e shkruam këtë libër, ishte pikërisht që t'i nxirrnim shërbesat e mëshirës nga qendra e vëmendjes. Dëshirojmë që ungjilli dhe kisha lokale të vihen në qendër të vëmendjes, sepse mendojmë se ky është vendi që iu takon atyre në planin e Biblës për ta arritur botën për Krishtin. Kështu që, fryma e kundërshtimit brenda nesh na nxiste që ta bënim këtë duke i mos i përmendur fare shërbesat e mëshirës. Mirëpo, nga ana tjetër e ndiejmë që veprat e organizuara mirë të përkujdes-

jes praktike mund ta ndihmojnë një kishë që përpiket të arrijë një lagje të varfër, prandaj, edhe pse rrezikojmë të largohemi nga qëllimi ynë kryesor, po ju rendisim më poshtë disa gjëra me të cilat duhet të ballafaqoheni përpara se të hapni një kuzhinë sociale pranë kishës suaj.

Kisha e ka një mision

Krishti i ringjallur i ka dhënë popullit të Tij një mision: në fuqinë e Frymës së Shenjtë, ata duhet të predikojnë Ungjillin dhe të themelojnë kisha të përbëra prej besimtarëve të rinj. Te Mateu 28:19–20, Jezusi i dërgon dishepujt e Tij që të bëjnë dishepuj nëpër kombet e botës dhe t’u mësojnë atyre se si t’i binden Atij (shih kapitullin 3 për më shumë në lidhje me këtë). Te Veprat e Apostujve 1:8, Ai u thotë të Vetëve që do të shërbejnë si dëshmitarët e Tij deri në skajet e dheut. Kështu që, edhe pse një kishë mund të kryejë veprimtari të larmishme në mbështetje të këtij misioni, gjithçka që ajo bën, duhet të orientohet drejt këtyre qëllimeve sublime: shpallja e ungjillit dhe të ndihmuarit e njerëzve për t’u rritur në bindjen e tyre ndaj Perëndisë. “Starbucks” shet kafe, “Listerine” prodhon lëng për pastrimin e gojës, ndërsa kisha shpërndan ungjillin dhe i trajnon njerëzit se si të binden duke kryer veprën e shërbesës. Po nuk e bëmë ne këtë punë, nuk ka për ta bërë askush tjetër. Në qoftë se bëjmë diçka tjetër, atëherë kemi dalë nga rruga e duhur.¹

Shërbesat e mëshirës mund t’i shërbejnë misionit të kishës

Shërbesat e mëshirës mund të jenë një mënyrë e dobishme që një bashkësi e caktuar ta përmbushë këtë mision. Për shembull,

¹ Për një mbrojtje të plotë të kësaj ideje (së bashku me një dozë të shëndetshme të të mirave dhe arritjeve të kapitalizmit të tregut të lirë) shihni librin e Kevin DeYoung dhe Greg Gilbert *What Is the Mission of the Church? Making Sense of Social Justice, Shalom, and the Great Commission* (Wheaton, IL: Crossway, 2011).

ato mund të sigurojnë mundësi që njerëzit t'i binden Jezusit në një mënyrë praktike. Teksa zemrat e njerëzve pushtohen prej dhembshurisë së Krishtit, një pjesë e rritjes së tyre në perëndishmëri mund të karakterizohet nga një kujdes i shtuar për barrët fizike dhe emocionale të njerëzve nevojtarë. Tekefundit, Bibla është e mbushur me udhëzime për të krishterët që të jenë njerëz të dhembshur, bujarë dhe të mëshirshëm. Në këtë kuptim, një shërbesë për ushqyerjen e të varfërve apo një program për rehabilitimin e tyre nga drogat dhe alkooli mund të jenë fryti i një kisha të mbushur me të krishterë që i binden Jezusit.

Veprat e mëshirës mund të shfaqin edhe fuqinë ndryshuese të ungjillit. Kur i ndihmojmë fqinjët tanë, japim prova se mesazhi ynë është i vërtetë. Në qoftë se pretendojmë se ungjilli ka fuqinë për t'i ndryshuar njerëzit, atëherë mëshira jonë është një nga gjërat që e provon këtë. Në një botë ku shumica e njerëzve e kanë mendjen vetëm te vetja e tyre dhe kujdesen vetëm për të vetët, të krishterët kanë një mundësi shumë të mirë për t'i habitur të tjerët me dashurinë e tyre të pashpjegueshme dhe shërbesën vetëmohuese.

Kur i ndihmojmë të tjerët në mënyra praktike, shpallim se Perëndia na krijoi si qenie fizike. Gjendja e trupit tonë ka një ndikim të madh mbi jetën tonë. Jeta bëhet më e vështirë kur jemi të uritur, në të ftohtë, të dehur, të sëmurë apo në rrezik. Kështu që, shpallja e ungjillit që nuk i merr parasysh faktorët fizikë që karakterizojnë jetët e dëgjuesve të këtij mesazhi, rrezikon që të jetë e shurdhër dhe e pandjeshme ndaj nevojave njerëzore. Duhet ta pranojmë se ekziston një rend për nevojat tona, dhe se disa herë nevojat tona më të mëdha nuk janë nevojat tona më të menjëhershme. Kështu që mund të themi me siguri të plotë se nevoja më e madhe për çdo qenie njerëzore është që të pajtohet me Perëndinë përmes besimit në Krishtin. Mirëpo, nëse dikush të troket në derë me një plagë të rëndë në kokë, edhe ajo nevojë, megjithëse më e vogël sesa ajo e lartpërmen-

dura, duhet përmbushur gjithashtu. Së pari duhet t'i kuroni plagën që ka në kokë, dhe pastaj duhet të ndani ungjillin me të.

Po ashtu duhet ta pranojmë se shërbesat e mëshirës krijojnë mundësi të mira për shpalljen e ungjillit. Të gjithëve na pëlqen të qëndrojmë pranë njerëzve që tregohen të mirë me ne, të cilët interesohen për jetën tonë dhe shfaqin një dëshirë për të na ndihmuar. Kështu që përkujdesja praktike ndaj të tjerëve është një mënyrë e lehtë për të ndërtuar ura mes jush dhe lagjes suaj. Më poshtë do të gjeni disa shembuj nga kisha e Majkut:

- Një kishëmbjellës që shërben mes klasës punëtore, i merr ca çanta me ushqim me vete kur shkon të vizitojë njerëzit në shtëpitë e tyre. Dhurata është mjaft e dobishme për forcimin e miqësive, me qëllim që më vonë t'u shpallë atyre ungjillin.
- Anëtarët e kishës ndihmojnë fëmijët shumë të varfër në një shkollë fillore të lagjes. Anëtarët e kishës ndërtojnë marrëdhënie me nxënësit dhe familjet e tyre dhe i ftojnë ata që të bëhen pjesë e një veprë kishëmbjellëse në lagjen e tyre.
- Kisha mirëpret një grup adoleshentësh në rrezik në mënyrë të përjavshme. Ata hanë një vakt së bashku, kanë mundësi që të kalojnë kohë me moshatarët e tyre në një mjedis të sigurt dhe që të ndërtojnë marrëdhënie me të rritur, të cilët u ofrojnë atyre shembuj pozitivë për t'u ndjekur në jetën e tyre. Çdo javë ata dëgjojnë një mësim nga Bibla, që e rrënjos ungjillin në zemrën dhe jetën e tyre.

Sigurisht që ne të gjithë duhet ta ndajmë Krishtin me njerëzit që natyrshëm hyjnë në jetën tonë, sikurse fqinjët, shokët ose bashkëpunëtorët tanë. Mirëpo arritja e njerëzve nevojtarë me vepra mëshire na siguron mundësi për të ndërtuar marrëdhënie me njerëz, me të cilët zor se do të binim në kontakt ndryshe.

Shërbesat e mëshirës janë të rrezikshme

Pas kësaj që thamë, nuk u zëmë shumë besë mënyrës se si një numër kishash u qasen shërbesave të tyre të mëshirës. Me thënë të drejtën, shumica e kishave që i hyjnë përpjekjes për t'i ndihmuar të varfrit në mënyrë praktike, në fund fare shkaktojnë më shumë dëme, sesa bëjnë mirë. Edhe pse nuk ndodh kështu në çdo rast e rrethanë, ja ku janë disa gjëra që i kemi parë në terren dhe që duhet të na bëjnë që të reflektojmë:

1. *Shërbesat e mëshirës janë lehtësisht të abuzueshme.* Unë (Mezi) e kalova adoleshencën time dhe të njëzetat e hershme duke jetuar në rrugë. Gjithmonë e gjeja një vend ku të haja mëngjesin dhe të merrja ushqim shtesë, ku të më jepnin rroba të pastra dhe ku të bëja një dush. Ata si puna ime, që jetonin brenda kësaj nënkulture të padukshme në pjesën më të madhe të saj, dinin se si ta manipulonin sistemin. E dinim se çfarë duhet të thoshim dhe të bënim, në mënyrë që të merrnim gjërat që donim, pa u lodhur aspak për këtë. Kishat janë shënjestra të lehta për këta lloj njerëzish, sepse anëtarët e tyre përgjithësisht janë njerëz të mirë, ata sillen me dashamirësi me tipat siç isha unë atëherë; po ashtu ata nuk janë edhe aq të mprehtë, sa zyrtarët e agjencive qeveritare, dhe gjithçka që duhet të bënim, ishte që të dëgjonim dikë që na fliste për Perëndinë dhe mbase të merrnim edhe një broshurë. Pastaj vazhdonim rrugën. Breshëria e pyetjeve që na bënin ata të kishës në fillim, ishte një gjë e mërzitshme, por me të kuptuar se cilat ishin përgjigjet që ata dëshironin të dëgjonim, e kishim më të lehtë që t'ua mbyllnim gojën. Ata do të thoshin fjalët e tyre në lidhje me Perëndinë dhe do të tregoheshin të mirë me një të varfër, kurse ne do të merrnim atë çka dëshironim. Ajo që dukej si një shërbesë mëshire e lulëzuar, në realitet ishte një mundësi mashtrimi për njerëz egoistë.

2. *Shërbesat e mëshirës mbështesin mëkatin.* Megjithëse kjo nuk është e vërtetë për të gjithë, duhet ta pranojmë me sinqe-

ritet faktin se një pjesë e madhe e njerëzve që përfitojnë prej shërbesave të mëshirës të kishës, jetojnë në mëkat. Ta mbash me ushqim një përtac, nuk bën asgjë tjetër, veçse e nxit atë që të vazhdojë të mëkatojë dhe t'u shmanget pasojave të veprimeve të tij. Të dhënit e rrobave një të droguari nuk është gjë tjetër, veçse sigurimi i sendeve që ai mund t'i shesë për të siguruar dozën tjetër. Të siguruarit e strehës për një të pastrehë mund t'i heqë atij dëshirën për t'u pajtuar me familjen.

Po t'i jepni dikujt një peshk, jo vetëm që ai do të kthehet ditën tjetër për të kërkuar më shumë peshq, por madje rrezikoni që të përforconi pikërisht ato probleme që e detyruan atë të vijë e të kërkojë një dorë ndihmash në fillim. Me fjalë të tjera, është një gjë t'i japësh për të ngrënë një personi që punon (ose që dëshiron të punojë, por është i paaftë) dhe që duket se po ngordh urie, dhe një gjë krejt tjetër t'i japësh ushqim një personi, mëkati i të cilit jo vetëm që *nuk* e lë atë të punojë, por madje e shtyn atë që të kërkojë ndihma në ushqime a sende të tjera, ngaqë mendon se i meriton ato. Në rastin e dytë, ju rrezikoni që të mbështesni dhe lehtësoni njerëzit në mëkatin e tyre, për pasojë pa dashje do t'i nxisni ata që të ngulmojnë në shkeljet dhe paudhësitë e tyre.

3. *Shërbesat e mëshirës mund të kthehen në një mjet tutele dhe vetëkënaqjeje.* Po të flasim me sinqeritet, duhet pranuar se shumica e shërbesave të mëshirës nuk arrin ndonjë gjë më të madhe, sesa t'i bëjë njerëzit që i kryejnë ato, që të ndihen mirë për veten e tyre. Shumica e shërbesave kishtarë të mëshirës realizohen prej njerëzve të shtresës së mesme, të cilët e duan Jezusin dhe shumë shpesh i hyjnë kësaj shërbese të shtyrë nga një përzierje qëllimesh të perëndishme me një ndjenjë të gabuar faji. Në vend që vërtet t'i ndihmojnë njerëzit, shumë shërbesa mëshire mjaftohen me kryerjen e veprave që i ndihmojnë ata vetëm në dukje. Produkti përfundimtar i tyre është një program që i bën njerëzit të varur nga ndihma në ushqime, e cila

u sigurohet prej njerëzve që qëndrojnë “më lart” sesa ata në shkallën e hierarkisë shoqërore. Këto shërbesa nuk prodhojnë ndonjë fryt të qëndrueshëm, por askujt nuk i bën zemra që t’i ndërpresë ato, për shkak se kështu shfaqen si të pandjeshëm ndaj nevojave të të varfërve.

Nik Soll (Nick Saul), një aktivist kanadez i angazhuar në luftën kundër varfërisë, ngjalli një debat mbarëbotëror, kur tha fjalët e mëposhtme për ato që njihen si bankat e ushqimit. Ai i kritikoi ato për faktin se ishin një mjet, me anë të të cilit “të privilegjuarit ndihmonin të paprivilegjuarit, duke përjetësuar një mjedis ne-dhe-ata”². Niku beson se bankat tradicionale të ushqimit realisht nuk i ndihmojnë nevojtarët. Ushqimi që ato sigurojnë, është shpesh i një cilësie të ulët dhe ky proces nuk bën asgjë për ta forcuar dinjitetin ose vetërespektin e përfituesve, për t’i nxitur ata që të gjejnë një punë, për t’i ndihmuar që të dalin nga dara e varfërisë, apo për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Ato vërtet e shuajnë urinë fizike të njerëzve, por kjo nuk zgjat. Pa shikoni pak se çfarë fjalësh të ashpra përdor ai në lidhje me shumicën e bankave të ushqimit: “I vetmi person që nuk përfiton prej tyre, është personi, në ndihmë të të cilit ato u themeluan. Shumë njerëz, të cilëve iu është dashur që t’i vizitojnë bankat e ushqimit, thonë se ato janë një vend ku ndodh vdekja e ngadaltë dhe e dhimbshme e shpirtit.”³

Pak gjëra janë më të trishta në këtë botë, sesa të shohësh një person që i frekuenton rregullisht kuzhinat sociale. Është një parodi e vërtetë. Shumë shpesh ndodh që njerëzit nuk nxiten që të ngrihen në nivelin e përkujdesjes dinjitoze për veten, pra, ata realisht nuk marrin asnjë ndihmë. Ata as sfidohen dhe as pajisen që ta ndihmojnë vetveten. Kështu që duhet t’i shtrojmë këtë

2 Patrik Batler, “Food Banks Are ‘a Slow Death of the Soul.’” *theguardian*, 25 shtator 2013. <http://www.theguardian.com/society/2013/sep/25/food-banks-slow-death-soul/>.

3 Po aty.

pyetje vetes: në qoftë se këto shërbesa mëshire nuk plotësojnë nevojat e të varfërve, atëherë nevojat e kujt po përmbushin ato?

4. *Shërbesat e mëshirës ngjallin përbuzje ndaj misionit.* Mbase rreziku më i madh është se shërbesat e mëshirës mund t'ia heqin vëmendjen kishës nga misioni i saj kryesor. Shërbesat e mëshirës janë mundësi tërheqëse shërbesë për të krishterët. Me shumë gjasë, kur bëni thirrje për një ditë pune pranë kuzhinës sociale, do të keni dyfish më tepër besimtarë, sesa kur i ftoni ata për një trajnim ungjillëzimi. Tekefundit, bota do të na duartrokasë, kur i ushqejmë të varfrit. Ushqyerja e të varfërve na bën që të ndihemi mirë për veten; mbase (po të jemi të ndershëm deri në fund) do të na bëjë të ndihemi sikur jemi më të mirë sesa gjithë njerëzit e tjerë, që nuk erdhën për të ndihmuar. Mirëpo, ungjillëzimi dhe dishepullimi nuk ngjallin të njëjtën kënaqësi. Në shumë raste ato karakterizohen nga refuzimi dhe bisedat e çuditshme. Ekziston një tundim real që të kënaqemi vetëm me përmbushjen e nevojave fizike. Mirëpo, po ta bëjmë këtë, është njëlloj sikur ta vëmë qerren përpara buajve.

Gjëja për të cilën të varfrit kanë më së shumti nevojë, është ungjilli i Jezu Krishtit (shih kapitulli 1) dhe kisha është mjeti, përmes të cilit shpallet ungjilli. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë, atëherë nuk ka për të ndodhur. Prandaj, çdo kishë që vepron në lagje të varfra, duhet të bëjë shumë kujdes që të mos e lërë pas dore veprën e ungjillit për shkak të shërbesës së saj të mëshirës.

Mbarëvajtja e shërbesave të mëshirës është mjaft e vështirë dhe ha kohë

Siç e thamë më lart, ne nuk jemi kundër shërbesave të mëshirës. Thjesht po ju themi se për t'i realizuar si duhet, ato duhen kryer në një mënyrë që shkon në dobi të misionit të kishës. Mirëpo, nëse vërtet duhet t'i kryejmë ato, atëherë duhet të jemi gati që të harxhojmë shumë kohë dhe energji në funksion të tyre.

Shërbesat e mëshirës duhet të realizohen në një kontekst marrëdhëniesh dhe llogaridhënieje. Nuk ka strukturë llogaridhënëse të përsosur për këtë lloj shërbese, sepse gjithmonë do të ketë njerëz që e mashtrojnë sistemin. Nuk po themi se duhet të prisni për fillimin e një shërbese mëshire derisa të siguroheni njëqind për qind se nuk do të ketë njerëz që do ta shfrytëzojnë atë. Mirëpo, nëse ka një ndryshim mes versioneve të kishës dhe të shtetit në lidhje me ndihmat ushqimore, është që kisha i shpërndan ndihmat e saj në kontekstin e marrëdhënieve mes të krishterëve.

Kjo gjë do të funksionojë ndryshe nga konteksti në kontekst, por edhe do të ndryshojë sipas periudhave kohore në jetën e familjes suaj. Mirëpo, sido që të jetë puna, kjo do të thotë se të krishterëve do t'u duhet të sakrifikojnë kohën e tyre, sepse marrëdhëniet janë kohëharxhuese. Normalisht gjëja më e thjeshtë është të dhuroni ushqime të konservuara dhe të ndiheni mirë për veten tuaj, apo jo? Por ne jemi thirrur që të dhurojmë edhe kohën tonë gjithashtu. Në jetën time (Majku po flet), kjo gjë më ka detyruar që të organizoj një darkë të përjavshme, të shoqëruar prej një studimi biblik për të pastrehët, si dhe që të luaj kalçeto me adoleshentët latino-amerikanë.

Kur Zoti i bekon përpjekjet tona dhe e shohim ndërmarrjen tonë ungjillëzuese të japë fryt, ne duhet të jemi gati që t'i dishepullojmë të porsakthyerit në besim dhe t'i ndihmojmë ata që të angazhohen plotësisht në jetën dhe në shërbesat e bashkësisë. Mirëpo, nëse kemi nisur një shërbesë mëshire, e cila nuk ka asnjë plan për fazat e mëtejshme pas menaxhimit të krizës, atëherë kurrë nuk do ta tejkalojmë abëcënë e dishepullimit me një person nevojtar. Kështu që, kishat duhet t'i mendojnë mirë të gjithë përbërësit e shërbesës së tyre ndaj të varfërve. Duhet të mendojmë po ashtu se çfarë do të bëjmë me dikë që vjen në besim përmes një shërbese mëshire. Ç'strategji dishepullimi do të ndjekim në rastin e tyre? Kush do të përkujdeset për

ta? Kush do t'i mbajë ata përgjegjës? Si do t'i ndihmojmë ata që të përparojnë në ecjen e tyre me Jezusin? Si do t'i përgatisim ata për veprat e shërbesës, në të cilat i ka thirrur Perëndia pas shpëtimit të tyre? Si do t'i identifikojmë dhe trajnojmë ish-shpërndarësit e drogës, ish-të pastrehët dhe ish-grabitqarët seksualë, që Zoti po i thërret në shërbesë me kohë të plotë?

Në Kishën Komunitare të Nidrit, Fryma e Shenjtë e Perëndisë është në veprim për t'i sjellë shumë veta në besim nga lagjja përreth nesh. Struktura e kishës sonë ka një shteg të qartë nga ungjillëzimi deri te dishepullimi i hershëm dhe pastaj më tej te shërbesa që e nderon Perëndinë për të mbërritur në vendin e punës ose në shërbesën me kohë të plotë. Kemi njerëz në programin e trajnimit për stazhierët, të cilët mund të jenë abuzuar seksualisht, janë braktisur, kanë pasur varësi nga drogat, ose që i kanë lëçitur si të sëmurë mendorë; të tjerët vijnë nga mjedise të qëndrueshme dhe familje plot dashuri. Dy të tretat e gjithë anëtarëve të kishës së Mezit, që po i nënshtrohen trajnimit teologjik, vijnë nga situata të varësisë ndaj alkoolit dhe drogave, të qenët të pastrehë, të vuajturit nga sëmundjet mendore ose abuzimi.⁴ E vërteta është se edhe vetë Mezi është produkti i një kisha lokale, e cila investoi fuqishëm tek ai, pasi e gjeti tek jetonte në rrugë dhe pas një kohe të kaluar pas hekurave.

Ky është edhe thelbi i çështjes. A na jep kënaqësi të ushqyerit e të uriturve? Kjo është një gjë e mirë, por është vetëm një pjesë e dashurisë së plotë të krishterë. A na jep kënaqësi të ndarit e ungjillit me njerëzit e tjerë? Kjo është një gjë edhe më e mirë, sesa të ushqyerit e të uriturve, por puna jonë nuk mbaron këtu. Jo, dashuria e krishterë dëshiron që të shohë në jetët e njerëzve të njëjtën gjë që dëshiron ta shohë në to edhe Perëndia: bindje të përnjëmendte, besnike e të frytshme ndaj Krishtit. Kështu që llogaritni çmimin. Në qoftë se nuk jeni të gatshëm të

⁴ Për më shumë nga ana praktike, vizitoni faqen e internetit 20Schemes.com.

investoni kohë të mjaftueshme për ta çuar punën deri në fund, atëherë mbase bëni mirë të mos e filloni një shërbesë mëshire.

Përfundim

Ekzistojnë lloje nga më të ndryshmet të “vendeve të vështira” dhe kishat duhet ta njohin mirë vendin e tyre specifik. Në një shtet si Skocia, ku ekzistojnë breza të tërë njerëzish që janë rritur e mbajtur me ndihmë sociale, ndeshim një mendësi të thellërrënjosur se ndihma sociale është diçka që atyre iu takon. Kisha e atjeshme ballafaqohet me rrezikun e madh se mund të bëhet pjesë e mëkatit të njerëzve për të shfrytëzuar të tjerët. Një kishë mund të vendosë që të shpërndajë peshq rregullisht, por edhe mund të vendosë që të zgjedhë një qasje kundërintuitive duke u dhënë njerëzve kallamin e peshkimit të ungjillit, dhe jo peshq, të paktën nga pikëpamja programore. Pleqtë dhe anëtarët e kishës do të shpërndajnë peshq personalisht dhe privatisht, por të gjitha shpërndarjet do të ndodhin kështu vetëm në kontekstin e marrëdhënieve. Në këtë mënyrë, kur të takoni një adoleshent që i ngjan shumë Mezit, do t’i jepni atij drekë, por do të uleni të hani bashkë!

Imigrantët e Virxhinias Veriore, nga ana tjetër, karakterizohen prej një etike të fortë pune, por nevojat e mëdha që kanë familjet e tyre në vendet prej nga vijnë, rrogat e ulëta dhe mundësitë e paqëndrueshme shpeshherë bashkëpunojnë që ata të vuajnë nga varfëria e thellë. Një kishë që gjendet në atë kontekst (sikurse kisha e Majkut), mund të ketë më shumë mundësi që ta shfaqë dashurinë e Krishtit duke shpërndarë si peshq ashtu edhe kallama peshkimi. Në qoftë se do të ngrini një shërbesë mëshire në kishën tuaj, duhet të shqyrtoni në lutje kontekstin tuaj, duke e vlerësuar vazhdimisht punën që po bëni, duke qenë përherë të gatshëm që t’i bëni asaj ndryshime në varësi të realitetit që do të ndeshni në terren.

Siç e thamë më sipër, fillimisht nuk donim që ta shkrua-

nim këtë kapitull. Jemi të vetëdijshëm për faktin se, ngaqë shkruam keq për shërbesat e mëshirës, do të na etiketojnë si Republikanë [përkrahës të Partisë Republikane në Shtetet e Bashkuara] (megjithëse nuk jemi të tillë) apo si legenë të pashpirt (megjithëse vetëm njëri prej nesh është i tillë). Mirëpo, e kemi përnjëmend, kur themi se nuk mendojmë se mesazhi ynë është i zhveshur nga dashuria dhe hiri. Jemi shumë mirënjohës për njerëzit që i plotësojnë me anë shërbesash vetëmohuese nevojat praktike të skamnorëve, të të pastrehëve, të të sëmurëve mendorë dhe të njerëzve të tjerë “në rrezik” në lagjet tona më të varfra. Këta njerëz duhen përlëvduar dhe mbështetur prej gjithë pastorëve dhe të krishterëve. Thjesht nuk duam ta shohim kishën që të fokusohet në përmbushjen e nevojave praktike duke lënë kështu pas dore misionin e saj të hirshëm.

Përfundim

Llogarit çmimin... dhe shpërblimin

Lejomëni (mua Majkun) që t'ju tregoj dy histori. Disa vjet më parë unë dhe ime shoqe po mendonim që të bëheshim prindër kujdestarë. Të punuarit mes fëmijëve në rrezik në lagjen tonë kishte sjellë për pasojë krijimin e një barre në zemrat tona për ta kthyer shtëpinë në një vend të sigurt për fëmijët që gjenden në situata të rrezikshme jetësore. Disa prej të rinjve, me të cilët kishim vendosur marrëdhënie përmes kishës ishin bërë tashmë prindër, dhe duke pasur parasysh kushtet e tyre të jetesës, si dhe mungesën e përgjithshme të mbështetjes në familjet përkatëse, bënim shpesh biseda me Shërbimet për Mbrojtjen e Fëmijëve në lidhje me mirëqenien e nënave dhe të fëmijëve. Të kthyerit në një familje kujdestare na u duk si një mënyrë e mirë për t'u lidhur edhe më tej me fushën tonë të misionit. Tekefundit, sa herë që SHMF-ja mendonte se një fëmijë i lagjes sonë duhej larguar nga shtëpia e vet, ata mund ta sillnin që të qëndronte me ne. Tashmë kishim hyrë në marrëdhënie me shumë prej këtyre familjeve (ose të paktën qemë relativisht pranë tyre), kështu që mendonim se vendosja e një fëmije në familjen tonë do të ishte një gjë më pak traumatike për familjen e fëmijës dhe një mundësi e mirë për ne që të ndanim ungjillin me ta.

Duke qenë se kjo ide zuri të na pëlqente, unë dhe Karen nisëm të kërkonim këshillën e anëtarëve të tjerë të kishës. Shumë prej përgjigjeve qenë deri diku të pritshme, nga inkurajimi i kujdesshëm (“Mendoj se nuk është një ide e keqe”) te shkurajimi i butë (“Vërtet mendoni se keni kohë për këtë?”). Mirëpo, në përgjithësi, njerëzit u ofruan të na ndihmonin, në qoftë se vendosnim ta bënim këtë.

Ama, njëri nga reagimet na mbeti në mendje. Po e përmbledh në një fjali të vetme reagimin: “Përse vallë i urreni kaq shumë fëmijët tuaj?”. Një person madje na lëshoi një lumë fjalësh në përpjekje për të na shpjeguar se fëmijët e vet do të ndiheshin të tradhtuar dhe të lënë pas dore nëse ai do të sillte një fëmijë në nevojë të birësuar në shtëpinë e vet. Një tjetër na pyeti se si na shkonte mendja t’i shtonim elementët e paperëndishmërisë dhe të prishjes së ekosistemit të brishtë të familjes sonë. Një tjetër na e tha troç se kishte frikë se mos po sakrifikonim mirëqenien e pesë fëmijëve tanë për hir të ambicieve të shërbesës.

Për nga natyra (ime e rënë?) jam shpirti i kundërshtimit. Në qoftë se më thua se nuk mund apo nuk duhet ta bëj diçka dhe pastaj më jep një arsye aspak bindëse për këtë, atëherë dije se do të më bësh që ta dua atë gjë edhe 1000% më tepër. Mirëpo, gruaja ime ka një zemër të madhe dhe ndërgjegje të fortë, dhe ajo u ndikua thellë prej këtyre kritikave. Tekefundit, të gjitha kritikata e kishin njëfarë të drejte. Ardhja e një fëmije të birësuar në familje natyrisht që do të kishte shumë ndikim te fëmijët tanë. Do të shtoheshin vështirësitë tona për administrimin e duhur të kohës dhe të parave; po ashtu do të na duhej të ballafaqoheshim me problemet në sjellje të këtyre fëmijëve. Kështu që, ngado që ta merrnim, nuk kishte asnjë mundësi që integrimi i një të huaji në strukturën e ngushtëlidhur të familjes sonë të mos sillte një çmim për t’u paguar prej fëmijëve tanë.

Pra, çfarë vendimi të merrnim? Nga njëra anë, kishim vizionin (pa dyshim të mbushur me ngjyrime romantike) të bërjes

së sakrificave për shpëtimin e një fëmije në kushte të këqija. Nga ana tjetër, ballafaqoheshim me mundësinë (pa dyshim të frikshme në mënyrë të ekzagjeruar) që fëmijët tanë, kur të rrite-shin, do ta urrenin Jezusin, dhe në fund do të na e merrnin hakun duke na lënë që të vdisnim në një azil pleqsh të dorës së fundit.

Si përfundim, u bëmë edhe ne një familje kujdestare. Pak kohë më pas, në familjen tonë sollën një adoleshente nga Amerika Qendrore. Njerku i saj, në vendin prej nga vinte, ia kishte shitur vajzën disa burrave në një shtet fqinj me tonin (në SHBA, kuptohet); ajo ia doli që të arratisej nga dhoma ku e mbanin mbyllur, dhe jetonte në një strehë për të rinj të pastrehë në një qytet pranë tonit. Vajza jetoi me ne për gjashtë muaj dhe me thënë të vërtetën qe një gjë e vështirë. Ajo nuk fliste anglisht dhe ne nuk kuptonim spanjisht. Ishte një fëmijë i këndshëm, por edhe mjaft nevrrik. Fëmijët tanë ishin të vegjël në atë kohë dhe ardhja e një adoleshenteje në shtëpinë tonë qe një tronditje e vërtetë për familjen. Kishte shumë lot e të qara asokohe.

Mirëpo, ardhja e saj i pati edhe të mirat e veta. E reja e dëgjoi ungjillin të përsëritej sa e sa herë. Ajo e pa edhe se si vihet në zbatim ungjilli në jetën e familjes dhe kishës sonë. Mbase për herë të parë në jetën e vet, ajo përfitoi përkujdesje fizike dhe emocionale. Nuk ka dyshim që ajo do të vazhdojë të ballafaqohet me vështirësi edhe në të ardhmen e afërt. Mirëpo, nuk kam dyshim që Zoti na përdori si familje për t'i realizuar qëllimet e Tij në jetën e saj. Sa herë që e kujtoj atë përvojë, them me vete: "Jam shumë i gëzuar që e bëmë këtë gjë."

Ama, lejomëni t'ju tregoj edhe një histori tjetër. Pak kohë pasi e reja la shtëpinë tonë, na morën sërish nga zyra e SHMF-së. Kësaj radhe ata kishin nevojë që ne të kujdeseshim për një fëmijë njëmbëdhjetëvjeçar, që vuante nga autizmi. Ai jetonte në një familje të çoroditur, ku nuk e merrte kujdesin shëndetësor dhe dentar, për të cilin kishte nevojë. Në qoftë se do të jetonte në një mjedis të qëndrueshëm e plot përkujdesje, mbase ai do

të rritej dhe do të bëhej dikush që mund të jetonte në mënyrë të pavarur në shoqëri. Mirëpo, për shkak të mjedisit ku jetonte, i cili karakterizohej nga mospërkujdesja dhe abuzimi, ai po mbyllej edhe më thellë në vetvete.

Sërish, vendosëm të kërkonim këshillë. Në një drekë të përmuajshme të pleqve të kishës, bashkë me gratë dhe fëmijët e tyre, u treguam atyre për kërkesën që na ishte bërë. Këta ishin partnerët tanë më të afërt në shërbesë, burrat dhe gratë, urtësisë së të cilëve ne i besojmë më tepër se kujtdo. Ata qenë të njëzëshëm në këshillën e tyre: nuk duhet ta pranoni assesi atë mundësi. Me shumë dashuri na i renditën një nga një të gjitha pikat, ku jeta jonë si familje gjendej pranë pikës së thyerjes. Ata nxorën në pah të gjitha nevojat urgjente që kishte kisha, kërkesat e fëmijëve tanë, si dhe një varg faktorësh stresi që qenë shfaqur në jetën tonë qysh prej përvojës së parë si familje kujdestare. Për ta nuk kishte asnjë dyshim që kjo ishte një ide aspak e mençur.

Atë natë, unë dhe Karen folëm rreth bisedave që kishim pasur gjatë drekës. SHMF-ja priste një përgjigje prej nesh të nesërmen në mëngjes, dhe pasi u lutëm dhe e pleqëruam këtë çështje, vendosëm që t'u thoshim po. Normalisht që nuk qe e lehtë që t'i kundërviheshim këshillës së gjithë atyre njerëzve, tek të cilët kishim shumë besim, por e ndiem se duhet ta paguanim çmimin e nevojshëm për t'i shërbyer Krishtit dhe njerëzve në nevojë. Karen ka një përvojë të jashtëzakonshme mjekësore dhe na dukej sikur ne ishim njerëzit më të përshtatshëm për t'i ardhur në ndihmë atij fëmije të pashpresë. Si mund t'i thoshim jo atij? Shkuam për të fjetur atë natë, pasi vendosëm që të nesërmen në mëngjes do ta merrja në telefon SHMF-në dhe do të bëja përgatitjet me ta për ta marrë atë fëmijë gjatë javës së ardhshme.

Kur u zgjova në mëngjes, mendimi i parë që më erdhi në mendje tek po pija kafe ishte: "Jemi në metro neve apo jo? Po ku kemi mundësi ta bëjmë këtë?". Befas ndihesha njëqind për

qind i sigurt se kjo ishte një ide shumë e gabuar. Nuk i kishim aspak mundësitë për ta marrë përsipër këtë lloj angazhimi. Dëmet anësore që do t'i shkaktonte ky lloj angazhimi fushave të tjera të jetës sonë do të ishin të konsiderueshme. Kur vajta t'i tregojta Karenit se kisha kthyer mendje, përpara se të nxirrja fjalën e parë nga goja, ajo tha me një frymë: “Nuk mund ta marrim dot përsipër.” Papritmas e papandehur i kishim idetë shumë të qarta, kështu që e mora në telefon SHMF-në dhe u thashë se më duhej ta refuzoja kërkesën e tyre.

Një javë më pas, Karen u rrëzua dhe dëmtoi shtyllën kurri-zore. Ajo qëndroi një javë e shtruar në spital dhe kur u kthye në shtëpi, qëndroi për ca kohë në shtrat. Një çast, në mes të kësaj urgjence shëndetësore, u kujtova dhe thashë me vete: “Falemi-nderit, o Zot, që nuk e kemi edhe fëmijën autik në mes të këtij halli që na ka zënë.” Në qoftë se do ta kishim pranuar atë, me siguri që do t'i ishte dashur të përballonte traumën e zhvendosjes në një familje tjetër, derisa të shërohej Karen. E shoh qartë se Zoti na shpëtoi ne (dhe fëmijën) nga një situatë shumë e keqe.

Atëherë si t'ia bëjmë që të vendosim kufijtë e duhur, kur vjen puna për t'u shërbyer njerëzve të vështirë në vende të vështira? Meqenëse nevojat janë të pafundme dhe nevoja për sakrificë është e jashtëzakonshme, kur është rasti i duhur për ta refuzuar një mundësi për të shërbyer? Si duhet të punoni për ta parë ungjillin që të përhapet mes skamnorëve në lagjen tuaj? A duhet të shkoni dhe të kërkoni mundësi të reja në vende të tjera? Përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve mund të mos jetë e lehtë edhe e dukshme, por më poshtë po rendisim katër parime që mund t'ju drejtojnë, teksa merrni vendime.

Parimi 1:

Perëndia nuk ka nevojë për ju

Çfarë e dallon Perëndinë e vërtetë të gjithësisë nga idhujt e kombeve është vetëmjaftueshmëria e Tij. Idhujt e kombeve

janë krejtësisht të pafuqishëm (Psalm 115:4–7). Ata nuk lëvizin nga vendi, po qe se bërësit e tyre nuk i ngarkojnë mbi kurriz dhe nuk i mbartin (Isaia 46:7). Mirëpo është një karakteristikë e gjendjes së njeriut që e bën atë ta parapëlqejë një perëndi të tillë. Na pëlqen të kemi kontroll mbi gjërat. Na pëlqen të mendojmë se Perëndia ka nevojë për ne, apo që është në borxh me ne, dhe se mund ta manipulojmë Atë me anë të sjelljes sonë. Mirëpo, në mesazhin e tij drejtuar athinasve, apostulli Pal e sqaron dhe e ndreq këtë keqkuptim në lidhje me natyrën e Perëndisë: “Perëndia që bëri botën dhe të gjitha sa janë në të, duke qenë Zot i qiellit dhe i tokës, nuk banon në tempuj të bërë nga duart e njeriut, dhe as shërbehet nga duart e njerëzve, sikur të kishte nevojë për ndonjë gjë, sepse ai u jep të gjithëve jetë, frymëmarrje dhe gjithçka” (Veprat e Apostujve 17:24–25).

Fjalët e Palit janë me shumë rëndësi, veçanërisht për dikë që mendon të shërbejë mes të varfërve. Zoti i vërtetë i gjithësisë është i pavarur; Ai nuk ka nevojë për asnjë, përfshirë këtu shërbesën tënde ose timen. Kështu që duhet ta ngulitim mirë në mendje, se megjithëse Perëndia mund të zgjedhë të na përdorë për të arritur qëllimet e Tij, përhapja e ungjillit mes të varfërve nuk varet në mënyrë përfundimtare prej nesh.

Vendet e vështira në botën tonë nuk kanë nevojë për ju që t’i shpëtoni ato, sepse Perëndia e ka siguruar tashmë Shpëtimtarin e tyre. Perëndia nuk i dërgon njerëzit në shërbesë, ngaqë është i paaftë ta bëjë punën Vetë. Përkundrazi, Ai ka zgjedhur në mënyrë bujare që të na bekojë duke na dhënë mundësinë për të shërbyer mes të varfërve. Neve na është bërë nderi që të bëhemi pjesë e veprës që Perëndia po kryen në botë.

Në qoftë se nuk e përvetësoni këtë të vërtetë, me shumë gjasë do të digjeni ose do të hidhëroheni kur të mos e shihni frytin e menjëhershëm të mundit tuaj ose kur njerëzit nuk e vlerësojnë atë që po bëni për ta. Në qoftë se e merrni mbi vete barrën e shpëtimit të njerëzve, shpejt do ta kuptoni se nuk jeni

në lartësi të kësaj detyre. Në qoftë se ju e përfytyroni Zotin e qiellit sikur po i fërkon duart gjithë ankth, duke shpresuar që ju t'ia dilni dhe ta kryeni punën, atëherë dështimet tuaja rrezikojnë që t'ju shtypin fare, ndërsa ato që në dukje shfaqen si sukses, do t'ju shtynë drejt krenarisë.

Parimi 2:

Nuk ka dishepullim të krishterë pa paguar një çmim për të

Jezusi tha disa gjëra që tingëllojnë të ëmbla dhe plot dashuri në veshët tanë, gjëra të tilla sikurse “duaj të afërmin” dhe “bëjuni të tjerëve atë që doni që ata t'jua bëjnë juve”. Kjo është një fe që i duket e përshtatshme shumicës së njerëzve. Mund ta zhvillojmë shërbesën mes të varfërve edhe në bazë të këtyre lloj urdhëresave, por nuk kemi për të shkuar shumë larg.

Mirëpo Jezusi tha edhe disa gjëra që ishin vërtet radikale, gjëra që e larguan prej Tij shumicën e dëgjuesve dhe që na paraqesin një tablo ekstreme të domethënies së të ndjekurit të Tij. Le të shohim vetëm tri shembuj të marrë nga Ungjilli i Lukës:

Por Ai u tha të gjithëve: “Nëse dikush do të vijë pas Meje, le ta mohojë vetveten, ta marrë çdo ditë kryqin e vet dhe të më ndjekë. Sepse kush dëshiron ta shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por kush do ta humbasë jetën e vet për shkakun Tim, do ta shpëtojë. Sepse ç'dobi ka njeriu po të fitojë tërë botën, dhe pastaj të humbasë veten dhe të shkojë dëm?” (Luka 9:23–25)

Ndodhi që, ndërsa po ecnin rrugës, dikush i tha: “Zot, unë do të të ndjek kudo të shkosh”. Dhe Jezusi i tha: “Dhelprat kanë strofka dhe zogjtë e qiellit fole; kurse Biri i njeriut nuk ka ku ta mbështesë kryet”. Pastaj i tha një tjetri: “Ndiqme!”. Por ai tha: “Zot, më lejo më parë të shkoj e të varros atin tim”. Jezusi i tha: “Lëri të vdekurit t'i varro-

sin të vdekurit e vet; por ti shko dhe prediko mbretërinë e Perëndisë”. Por edhe një tjetër i tha: “Zot, unë do të të ndjek ty, por më lejo më parë të ndahem me ata të shtëpisë sime”. Por Jezusi i tha: “Asnjëri që ka vënë dorë në parmendë dhe shikon prapa, nuk është i përshtatshëm për mbretërinë e Perëndisë.” (Luka 9:57–62)

Dhe turma të mëdha shkonin me Të. Dhe u kthye dhe u tha atyre: “Nëse ndokush vjen tek Unë dhe nuk urren atin e vet dhe nënën, gruan, fëmijët, vëllezërit dhe motrat, madje edhe jetën e vet, nuk mund të jetë dishepulli im”. (Luka 14:25–26)

Mund të themi shumë gjëra në lidhje me këto pasazhe, por për qëllimin tonë është e rëndësishme të vëmë re se tabloja që na pikturon Jezusi, na tregon se të qenët dishepull i Tij ka çmim të lartë. Nuk ekziston një plan “pa sakrifica”, të cilin ju mund ta zgjidhni nëse doni ta ndiqni Atë. Në qoftë se e ndiqni Jezusin, atëherë duhet të jeni gati që t’i shërbeni Atij, sado i shtrenjtë që të jetë çmimi që duhet paguar për këtë. Në qoftë se Jezusi është Zoti, atëherë Ai duhet të jetë parimi drejtues i të gjitha planeve dhe vendimeve tuaja. Nëse flasim pa dorashka, kjo do të thotë se nuk mund t’i thoni “jo” Atij, vetëm sepse shërbesa mes të varfërve mund të jetë e kushtueshme apo e frikshme. Të ndjekësh Jezusin do të thotë që mund ta humbasim jetën për këtë shkak dhe se gjithkush që nuk është i gatshëm për këtë, nuk është i përshtatshëm për të qenë dishepulli i Tij.

Kjo e vërtetë është kuptuar prej brezave të tërë misionarësh, që e kanë çuar ungjillin në vende të rrezikshme. Kjo e vërtetë i mban ata, teksa varrosin bashkëshortet dhe fëmijët e tyre në fushën e misionit. Kjo e vërtetë i ngushëllon ata, tek japin jetën e vet. Kjo e vërtetë na qëndron përpara, veçanërisht atëherë kur mendohemi në lidhje me ndikimin që do të ketë shërbesa mes skamnorëve mbi familjet tona. Nuk ka asnjë pjesë të jetëve

tona, ku Jezusi nuk mund të hyjë. Në kuptimin përfundimtar të fjalës, asgjë nuk është “e jona”. Kështu që, si do të dukej jeta dhe bindja juaj ndaj Krishtit, po qe se nuk do të kishit frikë për atë që mund të humbni?

Më duket sikur e dëgjoj kundërshtimin: “Mirëpo, si prind që jam, përparësia ime numër një është ungjillëzimi dhe dishepullimi i fëmijëve të mi! Më duket sikur po thua se duhet t’i harxhoj kohën dhe energjinë time në një drejtim të kundërt me këtë detyrë.” Po, dhe po deshe ta dëgjosh prapë: po. Prindërit duhet t’i ungjillëzojnë dhe dishepullojnë fëmijët e tyre. Mirëpo a mund të jetë vallë, që gjëja më e efikase për sa i përket ungjillëzimit që mund të bëjë një nënë a një baba, është që t’u tregojë fëmijëve të tyre se Jezusi është thesari më i madh që ekziston? Mbase pjesë e të qenët një prind i mirë është fakti se duhet t’i tregojmë fëmijës sonë se megjithëse e duam fort atë, ai ose ajo nuk është gjëja më e shtrenjtë në këtë botë, sepse vetëm Jezusi është i tillë për ne. Duke jetuar një jetë sakrificash përpara fëmijëve tanë, ne u tregojmë atyre se ç’formë ka dishepullimi i krishterë. Në qoftë se nuk sakrifikojmë kurrë apo nuk përfshihemi në një situatë të vështirë, sepse kemi frikë se kjo do t’u kushtojë fëmijëve tanë, ne u tregojmë atyre se çfarëdo që të themi me gojë, e vërteta është se ata, dhe jo Jezusi, janë përparësia jonë më sublime.

Natyrisht që nevojitet urtësi, tek i qasemi këtyre gjërave. Pa dyshim, që nuk po i nxis burrat që të harxhojnë orë pa fund larg grave dhe fëmijëve të tyre dhe pastaj të shfaqësohen: “Familja ime e dashur, po e bëj këtë për hir të shërbesës!” Sa bashkëshorte dhe fëmijë të drejtuesve të krishterë janë hidhëruar kundër besimit tonë për shkak të një bashkëshorti apo babai që duket se kujdeset më tepër për shërbesën e vet sesa për ata?

Po ashtu, nuk po them se sakrificat janë një qëllim në vetvete. Qëllimi nuk është që të gjejmë gjënë më me sakrificë dhe

ta bëjmë atë. Nuk jemi thirrur që të ngremë plaçkat dhe të shkojmë familjarisht për të predikuar rrugëve të kryeqytetit të Koresë së Veriut. Të jepesh pas rreziqeve, dhimbjeve dhe sakrificave thjesht për hir të tyre, nuk është ndonjë gjë e virtytshme në vetvete.

Mirëpo për shumicën prej nesh, nuk është ky problemi me të cilin ballafaqohemi. Si pastor, nuk vuaj prej një numri të madh anëtarësh kishe, që po sakrifikojnë sa më s'ka. Përkundrazi, shumë prej nesh tundohemi që t'i kthejmë fëmijët tanë në idhuj, duke e vendosur rehatinë dhe dëshirat e tyre mbi ato të Jezusit.

Kështu që, për të qenë të qartë, nuk po bëj thirrje për gjetjen e “ekuilibrit” mes punës dhe shërbesës. Po ju bëj thirrje që ta jepni veten tërësisht për shërbesën dhe tërësisht për familjen tuaj dhe pastaj lërinë gruan dhe fëmijët tuaj që t'i përjetojnë ato të dyja *bashkë* me ju. Zakonisht kjo do të thotë që ata duhet të sakrifikojnë një pjesë të gjërave që bota thotë se iu takojnë atyre me të drejtë.

Parimi 3:

Jo të gjitha sakrificat janë me rëndësi strategjike

Siç e kemi thënë më herët, me raste mund të mos e dimë se çfarë duhet bërë në një situatë të caktuar. Ekziston tundimi (me thënë të drejtën, do të dëshiroja ta ndeshja atë në bashkësinë time) që ta marrim përshkrimin që i bën Jezusi të qenët dishepull i Tij në shkallën më sipërore dhe të përpiqemi ta vëmë atë në zbatim në mënyrën më të tejskajshme të mundshme. Megjithëse me raste kjo mund të jetë një ide e mirë dhe mund të ketë për shtysë shumë arsye të mira, shpeshherë të krishterët nuk i mendojnë qartë mënyrat më të mira për ta investuar jetën e tyre për përhapjen e ungjillit.

Lërmëni t'ju tregoj ç'dua të them. Le të marrim për shembull dy anëtarë të një kishe:

- Çarlsi është i fiksuar pas teknologjisë dhe një njohës i shkëlqyer i saj. Ai fiton shumë para si projektues programesh, por nuk di se si të sillet, kur gjendet në shoqëri. Ai është një njeri i mirë, por është shumë i turpshëm dhe ka prirje që të flasë gabim, kur bëhet nervoz.
- Linda është shitëse në një dyqan ushqimesh. Ajo mezi ia del të sigurojë bukën e përditshme për veten dhe për dy fëmijët e saj, por është gjithashtu një ungjilltare shumë e zonja. Ajo ka një dhunti të veçantë për të hyrë në marrëdhënie me jobesimtarët dhe për ta çuar bisedën te Krishti. Ajo duket se ka një aftësi tërheqëse ndaj nevojtarëve.

Tani le të supozojmë se një të diel, në kishë, Çarlsi dhe Linda dëgjojnë një predikim në lidhje me çmimin e të qenët dishepull. Që të dy binden se Zoti dëshiron që ata ta shpenzojnë jetën e tyre me qëllimin që ungjilli të përhapet mes të varfërve dhe nevojtarëve të zonës së tyre. Në përgjigje të predikimit, Çarlsi vendos ta lërë punën dhe të fillojë të japë mësim në një shkollë, e cila gjendet në një lagje, ku kisha e tij po përpiqet të përhapë ungjillin. Linda vendos që të fillojë të punojë me turne të dyfish-ta, me qëllim që të ketë më tepër para për t'ua dhënë të varfërve.

Çfarë nuk shkon këtu? Të dy këta të krishterë po përpiqen të jetojnë në mënyrë radikale, që të dy ata i përgjigjen pozitivisht thirrjes ekstreme të të qenët dishepuj me bindjen e tyre. Mirëpo nuk është e qartë nëse, si Çarli ashtu edhe Linda, po veprojnë me urtësi apo jo. Secili prej tyre po bën sakrificë, por nuk është e thënë që të dy sakrificat e tyre të jenë strategjike. Që të dy ata nuk e kanë marrë parasysh mënyrën se si i ka krijuar Zoti, se çfarë dhuntish iu janë dhënë atyre dhe se si mund t'i përdorin ato në mënyrën më efektive të mundshme, që ata të japin fryt në të mirë të synimit për përhapjen e ungjillit mes nevojtarëve.

Çarlsi është me të vërtetë i aftë për të fituar para. Kështu që megjithëse ai duhet të vazhdojë të punojë për t'u bërë një ungjilltar më i mirë, mbase duhet gjithashtu që t'i përdorë

dhuntitë e veta në një mënyrë të tillë që të ndihmojë përhapjen e ungjillit dhe veprën e mëshirës tek të varfrit duke i financuar ato. Linda, nga ana tjetër, është shumë e aftë për t'u lidhur me njerëzit. Kështu që, megjithëse duhet të mendojë për mënyrën se si familja e saj të japë më tepër para për shërbesën e ungjillit, koha e saj nuk sakrifikohet *në mënyrën e duhur* duke punuar më shumë orë pune për një pagë të vogël. Përkundrazi, ajo duhet të përpiqet të ketë më shumë orë të lira në dispozicion, që të jetë më pranë njerëzve nevojtarë të lagjes së vet.

Në këtë pikë përfshirja në një kishë lokale kthehet në një gjë thelbësore. Në një kishë, mund të ketë një larmi dhuntish, pikash të forta, detyrimesh dhe burimesh. Duke punuar së bashku, kishat janë të afta që t'ia gjejnë gjithsecilit vendin e duhur në tablonë e madhe dhe t'i angazhojnë në mënyrë sakrifikuese dhuntitë e tyre të dhëna nga Perëndia, me qëllim që ta çojnë ungjillin në çdo qoshe të lagjes së tyre.

Parimi 4:

Sakrificat dhe shërbimi janë rruga drejt gëzimit më sublim

Mendoni për atë që ndodh kur dikush investon paratë e tij ose të saj në tregun e aksioneve. Personi në fjalë merr një të ardhur që zotëron (le të themi 1 000 dollarë), dhe sakrifikon të gjitha mënyrat se si ai mund t'i shijonte ato në periudhën afatshkurtër (p. sh. duke blerë shumë hamburgerë apo të gjitha videolojërat më të fundit apo veshmbathje të shtrenjta). Në vend që t'i shijojë të gjitha të mirat që mund të blejë me 1 000 dollarë që në këtë çast, ai i investon ato para me shpresën se do të ketë më shumë prej tyre në të ardhmen (ta zëmë, të ketë 1 500 dollarë pas dhjetë vjetësh).

I krishteri është thirrur që ta investojë jetën e tij në këtë botë në një mënyrë absolutisht të ngjashme. Kemi në dispozicion të gjitha burimet (kohën, aftësitë, paranë) që mund t'i për-

dorim për t'i sjellë vetes rehati dhe kënaqësi në çast, mirëpo a nuk është më mirë që t'i investojmë ato për kauzën e Jezusit? E po, mbase nuk ia vlen që të presim dhjetë vjet për të fituar 500 dollarë nga investimi ynë, por le t'i bëjmë një pyetje vetes: A mendoni se ia vlen që të investoni gjithë sa keni në veprën e Krishtit? A ofron Ai fitime të majme për investimin tuaj? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje duhet të lexojmë një pasazh të marrë nga Mateu 19:

Atëherë Pjetri iu përgjigj duke thënë: “Ja ne i lamë të gjitha dhe të ndoqëm; çfarë do të bëhet me ne?”. Jezusi u tha atyre: “Në të vërtetë po ju them, në krijimin e ri, kur Biri i njeriut të ulet në fronin e lavdisë së Vet, edhe ju që më keni ndjekur do të uleni mbi dymbëdhjetë frone për të gjykuar të dymbëdhjetë fiset e Izraelit. Dhe kushdo që ka lënë, për hir të emrit Tim, shtëpi, ose vëllezër, ose motra, ose atë, ose nënë, ose grua, ose bij, ose ara, do të marrë njëqindfish dhe do të trashëgojë jetë të përjetshme.” (Mateu 19:27–29)

Pjetri la gjithçka për të ndjekur Jezusin. Kështu që nervozizmi dhe nevoja e tij për t'u sqaruar janë të kuptueshme, apo jo? Ja pse Jezusi e siguron atë se ka investuar me zgjuarsia. Sakrifikimi i pronave, i zotërimeve dhe i familjes për Jezusin, do të sjellë fitime të majme që zgjasin për gjithë përjetësinë.

Në qoftë se do të kishit mundësinë për t'u kthyer pas në kohë dhe të blinit aksionet e shoqërive të tilla si Apple apo Google, do të ishit budallenj, po të mos e bënit këtë. Do të ishte budallallëk të mos i blinit ato, sepse janë aksionet që “nuk humbasin” asnjëherë vlerën. Faktikisht, do të ishit budallenj sikur të mos i shisnit të gjitha pronat tuaja, me qëllim që të kishit sa më shumë para për t'i investuar ato me shumicë në këto shoqëri. Në të njëjtën mënyrë, ne duhet ta investojmë gjithë sa kemi për hir të emrit të Jezusit. Fitimi që do të nxirrnit prej këtij investimi, do të jetë tej mase i bollshëm dhe i garantuar!

Përfundimi

Le t'i kthehemi pyetjes që bëmë në fillim të këtij kapitulli: duke pasur parasysh se nevojat dhe mundësitë për shërbesë janë të pakufizuara, si do ta dimë se çfarë duhet bërë dhe çfarë nuk duhet bërë? Nuk ekzistojnë përgjigje të lehta për këtë pyetje. Duhet të shqyrtojmë zemrat tona duke e ditur se jemi të prirë për t'u pushtuar nga frika, egoizmi dhe indiferenca. Po ashtu duhet t'u ruhem krenarisë dhe dëshirës për ta fituar shpëtimin tonë përmes veprave të shërbesës. Veç kësaj, duhet të jemi aq të urtë sa ta shqyrtojmë tonën shërbesë në dritën e rolit tonë në shërbesën më të gjerë të kishës lokale, së cilës i përkasim. Në fund të fundit, pyetja që shtrohet, nuk është nëse do të paguajmë një çmim për të qenët dishepull (sepse kjo është e pashmangshme), por si mund t'i investojmë jetët tona në mënyrën më të frytshme të mundshme në mbretërinë e Krishtit? A nuk mendoni se shpërblimi që na pret, vlen sa vetë jeta jonë? A nuk është vallë mbretëria e Perëndisë një perlë pafundësisht e çmuar për ta pasur, të cilën ia vlen që të shesim gjithë sa kemi dhe jemi?

20schemes

Gospel Churches for Scotland's Poorest

20Skemat ekziston për t'u sjellë shpresë komuniteteve më të varfra të Skocisë përmes rigjallërimit dhe mbjelljes së kishave të shëndetshme dhe që predikojnë ungjillin, të cilat përfundimisht udhëhiqen nga një brez i ardhshëm udhëheqësish vendas.

"Nëse dëshirojmë të shohim me të vërtetë një transformim në jetët e banorëve të komuniteteve tuaja më të varfra, atëherë duhet të përqafojmë një strategji radikale dhe afatgjatë, e cila do të sjellë shpresën e ungjillit te mijëra njerëz."

MEZ MCCONNELL, Drejtor Shërbese

Ne besojmë se ngritja e kishave të shëndetshme në komunitetet më të varfra të Skocisë do të sjellë ripërtëritje të vërtetë, të qëndrueshme dhe afatgjatë në jetë të panumërta njerëzish.

NEVOJA ËSHTË URGJENTE

Mëso më tepër rreth punës sonë dhe si mund të bëhesh partneri ynë:

20SCHEMES.COM

TWITTER.COM/20SCHEMES

FACEBOOK.COM/20SCHEMES

INSTAGRAM.COM/20SCHEMES

A ËSHTË KISHA JOTE E SHËNDETSHME?

9Marks ekziston për të pajisur udhëheqësit e kishave me një vizion biblik dhe me burime praktike, për ta shfaqur lavdinë e Perëndisë ndër kombe përmes kishave të shëndetshme.

Për këtë qëllim, ne duam t'i ndihmojmë kishat të rriten në nëntë shenjat e shëndetit, të cilat shpesh lihen pas dore:

1. Predikimi ekspozues
2. Doktrina e ungjillit
3. Një kuptim biblik i kthimit në besim dhe i ungjillëzimit
4. Anëtarësia biblike e kishës
5. Disiplina biblike e kishës
6. Interesimi biblik për dishepullimin dhe rritjen
7. Udhëheqja biblike e kishës
8. Kuptimi biblik i praktikës së lutjes
9. Kuptimi dhe praktika biblike e misioneve

Në organizatën 9Marks, ne shkruajmë artikuj, libra, vlerësime librash si dhe një revistë online. Ne organizojmë konferenca, regjistrojmë intervista dhe prodhojmë materiale të tjera për t'i pajisur kishat që ta shfaqin lavdinë e Perëndisë.

Vizitoni faqen tonë të internetit për të gjetur materiale në më shumë se 40 gjuhë të ndryshme dhe për t'u abonuar për revistën tonë falas online. Shihni një listë të plotë të të gjitha faqeve tona në gjuhë të huaja në adresën:

9marks.org/about/international-efforts/.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

McConnell, Mez

Kisha në vende të vështira: si u sjell jetë kisha lokale të varfërve dhe nevojtarëve /

Mez McConell, Mike McKinley; përkth.

Elton Tahirllari ; red. Vilma Dina. - Tiranë:

Vision Printing, 2023.

220 f. ; 13 x 20 cm

Tit. origj.: Church in Hard Places : How the Local Church Brings Life to the Poor and Needy.

9Marks ISBN: Shtypur në shtypshkronjën

“Vision Printing shpk”, Tiranë 2023

I.McKinley, Mike

1. Feja kristiane 2. Puna pastorale

ËSHTË E PAMUNDUR QË TË ZBUTET VARFËRIA, NË KUPTIMIN E SAJ TË PLOTË, JASHTË KISHËS LOKALE DHE NË MUNGESË TË SAJ.

Vitet e fundit, të krishterët kanë shfaqur një angazhim më të shtuar ndaj ndihmës për të varfrit. Mirëpo, ky interes i përtërirë në lehtësimin e varfërisë është i destinuar të dështojë nëse nuk i ka themelet në kishën lokale, e cila është mjeti i caktuar prej Perëndisë për t'i sjellë të shtypurit në një marrëdhënie transformuese me Vetën e Tij. Duke theksuar përparësinë e Ungjillit, Mez McConnell dhe Mike McKinley, që të dy pastorë me shërbesa të frytshme mes të varfërve, ofrojnë një udhërrëfyes biblik dhe strategji praktike për mbjelljen, rijetësimin dhe rritjen e kishave besnike në vende të vështira, të cilat gjenden në vendet tona dhe anembanë botës.

“Lutem që ky libër bindës dhe sfidues do të nxisë edhe shumë të tjerë që të mundohen për përhapjen e ungjillit aty ku sot nuk ka dëshmi të krishterë.”

MARK DEVER, Pastor kryesor, Kisha Baptiste Capitol Hill, Uashington, DC; President i 9Marks Ministries

“Kisha në vende të vështira ka ardhur vërtet në kohën e duhur dhe do të shërbejë për trajnimin e një brezi të interesuar për ta çuar ungjillin në vende dhe situata të vështira, si dhe për të mbjellë kisha atje.

J. LIGON DANKAN III, Kancelar dhe Drejtor Ekzekutiv, Seminari Teologjik i Reformuar, Jackson, Misisipi

“Më së fundi kemi në duar një libër në lidhje me këtë aspekt thelbësor të misionit të ungjillit që është i pasur me Biblën, me ungjillin në qendër dhe me kishën në fokus! *Kisha në vende të vështira* është një dhuratë për kishën.”

JARED C. WILSON, Drejtori për strategjinë e përmbajtjes, Seminari Baptist Teologjik i Midwestern

MEZ MCCONNELL (BA, Kolegji Moorlands) është pastori kryesor i Kishës Komunitare të Nidrit në Edinburg të Skocisë. Ai është themeluesi i 20Schemes, një shërbesë që i kushtohet mbjelljes së kishave me në qendër ungjillin nëpër lagjet e banesave sociale të Skocisë.

MIKE MCKINLEY (MDiv, Seminari Teologjik Uestminster) është pastori kryesor i Kishës Baptiste Sterling Park në Virxhinia të Amerikës. Ai është autori i librit *Church Planting Is for Wimps*.